

ROLI I TË INFILTRUARIT NË NJË PROCES PENAL

Eurela Mujaj

Dorëzuar
Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
(Shkenca Juridike), me profil (E drejtë penale), për marrjen e gradës shkencore
“Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. As. Dr. Irakli Koçollari

Numri i fjalëve: 66.980

Tiranë, 09.2015

© DEKLARATA E AUTORËSISË

Nën përgjegjësinë time deklaroj, se ky punim është shkruar prej meje, nuk është prezantar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është asnjëherë botuar i tëri. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve të cituara dhe referuara.

ABSTRAKT

“Veprimet simuluese” dhe “Punonjësi i policisë i infiltruar”, si burime të provave në një proces penal, janë metoda të reja hetimore në të drejtën procedurale penale shqiptare. Ato janë parashikuar në Kodin e Procedurës Penale, para disa vitesh, konkretisht me ligjin Nr. 9187 datë 12.02.2004, duke shtuar dhe nenet 294/a dhe 294/b në këtë Kod. Kjo bën, që ndjekja e procedurave përkatëse për këto institute dhe marrja e këtyre lloj provash të paraqesë probleme në praktikë”.

Ky studim do të fokusohet pikërisht, në teknikat e posaçme të hetimit, si mjete për marrjen e provave në proceset penale. Mjete këto, që kanë paraqitur problematika të mëdha gjatë përdorimit të tyre në praktike. Përmes një vëzhgimi të detajuar dhe përdorimit të metodave kërkimore shkencore hulumtuese dhe krahasuese, synoj të bëj:

- Trajtimin e pozitës juridike të të infiltruarit në përputhje me bazën ligjore të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë,
- Trajtimin e kësaj pozite, në lidhje me të drejtat e tjera ligjore e kushtetuese.
- Trajtimin e kufinjve të përdorimit të të infiltruarit si mjet për grumbullimin e provave hetimore, duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut si dhe, garancitë që duhet të ofrojë ligji në rastet kur infiltrimi kalon kufijtë e ligjshmërisë.

Fjalët kyçe: kriminalitet, teknika të posaçme hetimore, infiltrim, veprime simuluese, ligjshmëri, legjislacioni penal shqiptar.

ABSTRACT

“The simulating actions” and “infiltration”, as sources of evidence in a criminal process, are new institutes in the Albanian Penal Procedure Code. They have been both added to the Code of Penal Procedure by law no. 9187 dated 12.02.2004, including the articles 294/a and 294/b of this Code. This makes that the pursuit of the appropriate procedures for these institutions and taking these kind of evidences, submit problems in practice”.

This study will focus exactly on those special techniques of investigation, as means to obtain evidence for the penal processes. Nevertheless, a great many problems have come across when it came to putting these means in practice. Through a thorough observation and the use of the research and comparative methods of research, I aim to:

- The treatment of the juristic position of the infiltrated in accordance with the legal basis of The Criminal Code of the Republic of Albania.
- The treatment of such position with regard to the other legal and constitutional rights.
- The treatment of the legal boundaries of the infiltration as means of obtaining investigative evidence, with regard to the basic human rights and freedoms, as well as the guarantees provided by the law in the cases when infiltration crosses the legal line.

Keywords: criminality, special techniques of investigation, infiltration, simulating action, legality, Albanian penal legislation.

FALENDERIMET

Falenderimi dhe mirënjohja ime e sinqertë i drejtohet të gjithë atyre që u bënë pjesë në realizimin e këtij studimi:

Prof. As. Dr. Irakli KOÇOLLARI, udhëheqësit shkencor të këtij studimi, i cili drejtoi çdo hap të punimit me kërkesë shkencore dhe metodologjike. Kompetenca e tij shkencore, kultura e gjerë, përkushtimi në vëmendje të çdo detaji, më kanë ndihmuar dhe inkurajuar në përmbushje të objektivave dhe realizimin e punimit.

Mirënjohje e veçantë për profesor Spiro SPIRO, për vëmendjen ndaj çdo detaji si dhe për mendimet konstruktive dhe me profesionalizëm, që kanë ndihmuar t'i japin formë këtij studimi.

Stafi akademik i Departamentit të Shkencave Penale, profesorët e nderuar të programit të studimit të Shkollës Doktorale, të cilët transmetuan njohuri dhe profesionalizëm që ndërtoi formimin tim.

Familjen time për mbështetjen dhe ndihmën që më ka dhënë gjatë gjithë viteve të kërkimit.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Përmbajtja e lëndës.....	5
Terminologjia.....	10
Lista e shkurtimeve dhe definicioneve.....	11
Parathënia.....	12
KAPITULLI I: HYRJE.....	14
1.1 Qëllimi i studimit.....	14
1.2 Pyejtjet kërkimore.....	15
1.3 Hipoteza.....	16
1.4 Metodologjia e përdorur.....	16
1.5 Rëndësia e studimit.....	18
1.6 Kufizimet e punimit.....	19
1.7 Strukturimi i punimit.....	19
KAPITULLI II: ZANAFILLA HISTORIKE.....	23
2.1 Origjina historike e agjentit të infiltruar.....	23
2.1.1 Historiku i Shërbimeve Inteligjente në Shqipëri.....	24
2.1.2 Pavarësia e Shqipërisë dhe Shërbimet sekrete të shtetit Shqiptar.....	25
2.1.3 Mbretëria Zogiste.....	27
2.1.4 Lufta Nacional Çlirimtare.....	28
2.1.5 Ndryshimet demokratike në Shqipëri.....	30

2.2	Institucionet që merren me informacionin.....	31
-----	---	----

KAPITULLI III. VEPRIMTARITË E FSHEHTA DHE DINAMIKAT E HETIMEVE PARAPRAKE.....34

3.1	Veprimtaritë e fshehta dhe përfshirja e tyre në legjislacionin procedural.....	34
-----	--	----

3.1.1	Një vështrim i shkurtër historik i zhvillimeve në legjislacionin penal shqiptar.....	35
-------	--	----

3.2	Krimi i organizuar kërcënim global.....	38
-----	---	----

3.2.1	Lufta kundër krimit të organizuar dhe nevoja për ndryshime në legjislacion.....	40
-------	---	----

3.3	Dinamikat e hetimeve paraprake.....	41
-----	-------------------------------------	----

3.3.1	Ndryshimet, që ka njohur legjislacioni penal shqiptar, në lidhje me institutin e hetimeve paraprake.....	41
-------	--	----

3.3.2	Hetimet paraprake sipas legjislacionit aktual.....	43
-------	--	----

3.4	Roli dhe funksionet e policisë gjyqësore, sipas Kodit Procedural në fuqi në Republikën e Shqipërisë.....	43
-----	--	----

3.5	Roli i prokurorisë në hetimet paraprake, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.....	46
-----	---	----

3.6	Kompetencat e gjykatës në hetimet paraprake.....	56
-----	--	----

3.7	Praktika të ndryshme gjyqësore.....	59
-----	-------------------------------------	----

KAPITULLI IV: FIGURA E AGJENTIT TË INFILTRUAR.....74

4.1	Metoda e posaçme e hetimit paraprak dhe kufijtë e ligjshmërisë.....	74
-----	---	----

4.2	Subjektet procedurale garante të ligjshmërisë.....	77
-----	--	----

4.3 Kontrollet paralele, që prokuroria duhet t'i bëjë veprimtarisë së agjentit të infiltruar.....	79
4.3.1 Detyrimet e agjentit të infiltruar për të raportuar.....	82
4.4 Veprimet e kontrolluara.....	84
4.5 Veprimtaria e agjentit të infiltruar dhe atij simulues.....	85
4.6 Kuadri normativ.....	87
4.6.1 Ligji 8750, datë 26.03.2001 “Për parandalimin dhe luftën ndaj trafikut të lëndëve narkotike ose psikotrope”.....	89
4.6.2 Veprimet simuluese.....	90
4.6.3 Punonjësi i policisë i infiltruar.....	93
4.7 Përkufizimi i agjentit simulues dhe agjentit të infiltruar.....	96
4.7.1 Dallimet mes subjekteve të përfshirë në aktivitetin e fshehtë.....	97
4.8 Ndikimet e veprimtarisë nën mbulim në personalitetin e agjentëve të fshehtë.....	100
4.8.1 Problemet sociale të agjentit të fshehtë.....	103
4.8.2 Problemet psikologjike të agjentit të fshehtë.....	105
KAPITULLI V: PROFILI PROCEDURAL.....	109
5.1 Pozicioni procedural i agjentit të infiltruar.....	109
5.2 Dëshmia si provë.....	110
5.2.1 Dëshmitarët e mbrojtur dhe bashkëpunëtorët e drejtësisë.....	118
5.2.2 Dëshmitarët në Gjykatën për Krime të Rënda (GjKR).....	119
5.2.3 Dëshmitarët e tjerë.....	120

5.3 Dëshmia e agjentit të infiltruar ne proceset penale.....	122
5.4 Statusi i “agjentit të infiltruar” sipas legjislacionit shqiptar	126
5.5 Dëshmia e agjentit nën koperturë sipas shteteve të ndryshme.....	129
5.5.1 Mbrojtja e identitetit të agjentit të infiltruar	130
5.5.2 Statusi i “dëshmitarit anonim”.....	131
5.5.3 Anonimati i plotë.....	136
5.5.4 Anonimati i pjesshëm ose i limituar.....	136
5.5.5 Anonimati total ose i plotë.....	137
5.6 Provokimi për kryerjen e veprës penale.....	138
5.6.1 Dënueshmëria e oficerit të policisë.....	141
5.7 Dokumentacioni i operacionit të fshehtë dhe përdorshmëria në procese penale.....	149
5.8 Teknikat e posaçme hetimore sipas Jurisprudencën e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut.....	151
5.9 Avantazhet e përdorimit të “Veprimeve simuluese” dhe “Infiltrimit”.....	159
5.9.1 Agjenti i infiltruar në dhomat e “chat”-it.....	160
5.9.2 Profili krimilogjik i pedofilëve.....	161
5.9.3 Edukimi si masë mbrojtëse.....	162
5.10 Teknikat e posaçme hetimore sipas legjislacionit procedural penal shqiptar.....	166

5.10.1 Karakteri ndërkombëtar i krimit kibernetik dhe mekanizmat mbrojtës.....	167
KAPITULLI VI: AKTIVITETI I FSHEHTË. TRAJTIMI JURIDIK NGA LEGJISLACIONE	TË
HUAJA.....	170
6.1 Sistemi kontinental.....	170
6.2 Kuadri rregullues danez.....	171
6.3 Kuadri rregullues francez.....	172
6.4 Kuadri rregullues gjerman.....	176
6.5 Kuadri rregullues spanjoll.....	179
6.6 Kuadri rregullues zviceran.....	187
6.7 Agjenti i fshehtë në sistemet “ <i>common law</i> ”	195
KAPITULLI VII: KONKLuzionET DHE REKOMANDIMET.....	208
Lista e referencave/Bibliografia.....	217
LISTA E TABELAVE	
Tabela 5.1.....	117-119
LISTA E FIGURAVE	
Figura 1.....	26
Figura 2.....	27

TERMINOLOGJIA

Gjatë këtij punimi është përdorur një terminologji, e cila shpesh herë ka qenë e kondicionuar nga lloji i referencave, të cilave i është referuar. Kemi përdorur shpesh terma të ndryshëm, të cilat shprehin të njëjtin koncept. Kemi mendimin, se këto terma duhen sqaruar paraprakisht. Kjo, në funksion të një kuptimi më të mirë të çështjeve të trajtuara.

Hetimi pro-aktiv, gjatë punimit shprehet edhe përmes këtyre termave: hetim nën mbulim, hetim i fshehtë, metoda të posaçme hetimore, hetim i maskuar, metoda speciale hetimore, veprimtari nën mbulim, undercover operations, undercover investigation, técnica de investigación encubierta.

Punonjës i policisë i infiltruar, gjatë punimit shprehet edhe përmes këtyre termave: agjent i infiltruar, agjent nën mbulim, agjent i fshehtë, agjent nën koperturë, agente encubierto, undercover agent.

Punonjës i policisë nën mbulim, gjatë punimit shprehet edhe përmes këtyre termave: agjent provokator, agjent provokues, agjent simulues.

Blerje e simuluar, gjatë punimit shprehet edhe përmes këtyre termave: blerje e kontrolluar, veprime simuluese, dorëzim i kontrolluar, controlled delivery.

Identitet i fshehtë, gjatë punimit shprehet edhe përmes këtyre termave: identitet fiktiv, identitet i rremë.

LISTA E SHKURTIMEVE DHE DEFINICIONEVE

KEDNJ - Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut

K.Pr.P. - Kodi i Procedurës Penale

K.P. – Kodi Penal

GJEDNJ - Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut

GJKR - Gjykata e Krimeve të Rënda

GJNP - Gjykata Ndërkombëtare Penale

Parathënie

“Hetim pro-aktiv”, është një mjet i rëndësishëm hetimor, i cili shërben për grumbullimin e provave në proceset penale. Vitet e fundit, ky mjet hetimor ka njohur një përdorim të gjerë, pasi dhe vetë format e shfaqjes së krimit kanë ndryshuar rrufeshëm, duke u shfaqur në forma nga më të sofistikuarat. Hetimi pro-aktiv, përdoret kryesisht në luftën kundër krimit të organizuar, duke përmendur këtu, trafiket e drogës, armëve, prostitucionit etj., kjo, për arsye se në të tilla krime, denoncimet thuajse mungojnë dhe mjetet e tjera, të zakonshme hetimore, nuk do të mund t’i zbulonin dhe të nisnin procedimin penal për ato.

Në kuadër të luftës kundër këtij kriminaliteti, shumë legjislacione europiane, duke përfshirë këtu edhe Shqipërinë kanë bërë ndryshime në ligjet e tyre penale materiale dhe procedurale, duke pranuar konceptin e “belum justum”: ashpërsimin e masave të dënimit, zgjerimin e kompetencave të organeve të policisë, përdorimin e teknikave të posaçme të hetimit etj.

Në Kodin Procedural Penal të Rep. së Shqipërisë, të tilla ndryshime materializohen nën emërtimin e “Veprimeve simuluese” dhe të “Infiltrimit”, që parashikohen nga nenet 294/a dhe 294/b të Kodit të Procedurës Penale, shtuar me ligjin nr. 9187 të datës 12.02.2004.

Ajo çfarë përbën objekt të këtij punimi është trajtimi i aspekteve të ndryshme, që qëndrojnë në thelb të hetimit pro-aktiv. Ç’ka nënkupton, trajtimin e:

Limiteve legjislative, në të cilat vepron subjekti i ngarkuar me këtë detyrë. Këto limite, janë shumë të brishtë, aq të brishtë sa një tejkalim i këtyre limiteve do të sillte rezultate diametralisht të kundërta me ato të pritura. Oficeri i policisë gjyqësore vepron nën autoritetin e organit të prokurorisë, i cili përmes një akti juridik, që është “autorizimi me shkrim”, legjitimon aktivitetin e tij, pavarësisht se ky aktivitet konsiston në kryerjen e një veprimtarie

në dukje jo të ligjshme, por që justifikohet për sa kohë qëllimi i tij është parandalimi dhe zbulimi i krimit të organizuar.

Fushëveprimi i përdorimit, të hetimit pro-aktiv, duhet të jetë i mirëpërcaktuar në ligj. Duhet të përcaktohen llojet e krimeve në të cilat ky mjet hetimor mund të përfshihet dhe në cilat jo.

Përmes një vëzhgimi të detajuar dhe përdorimit të metodave kërkimore shkencore humtuese dhe krahasuese, kam patur si objektiv:

-Trajtimin e pozitës juridike të të infiltruarit, në përputhje me bazën ligjore të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë,

-Trajtimin e kësaj pozite, në lidhje me të drejtat e tjera ligjore dhe kushtetuese.

-Trajtimin e kufinjve të përdorimit të të infiltruarit, si mjet për grumbullimin e provave hetimore, duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut si dhe garancitë, që duhet të ofrojë ligji në rastet kur infiltrimi kalon kufijtë e ligjshmërisë.

Kërkimi bazohet në gjetjen dhe grumbullimin e praktikave të ndryshme gjyqësore, të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, në gjetjen dhe grumbullimin e praktikave gjyqësore të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë si dhe në paraqitjen e modeleve të ndryshme legislative, të shteteve të zhvilluara si, Danimarka, Franca, Gjermania, Spanja, Zvicra etj. Duke nxjerrë kështu rekomandimet përkatesë, përta i përket problematikave të pikasura, gjatë trajtimit të këtij punimi.

KAPITULLI I: HYRJE

Veprimet simuluese dhe infiltrimi, si metoda të reja hetimore në të drejtën penale shqiptare, janë një fushë me interes studimi, për të paraqitur përvojën e mirë në përdorimin e tyre si mjete të marrjes së provës në proceset penale në Shqipëri dhe në Europë. Këto mjete, paraqesin një rëndësi të veçantë, sidomos për zbulimin dhe procedimin e personave, që kryejnë vepra penale komplekse, të rënda, me një shkallë të lartë organizimi dhe që paraqesin rrezikshmëri të madhe shoqërore. Pavarësisht dobisë së madhe të këtyre mjeteve, është mjaft e rëndësishme të studiohen kufizimet e përcaktuara në ligj, që nuk i lënë vend abuzimit nga ana e personit të infiltruar, me qëllim mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut. Gjithashtu, është e rëndësishme të studiohen pasojat ligjore, që vijnë nga abuzimet në këtë rast.

Nenet 294\|a dhe 294\|b të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, parashikojnë rolin e oficerit të policisë gjyqësore në veprimet simuluese dhe si i infiltruar. Pavarësisht kësaj, është vërejtur që në praktika të ndryshme gjyqësore janë mbajtur qëndrime të ndryshme, diametralisht të kundërta. Vërehen edhe praktika për mendimin tonë të gabuara, si nga ana e prokurorisë gjatë hetimit të procedimeve penale, ashtu edhe nga gjykatat në gjykimet e këtyre çështjeve. Praktika këto që, kanë ardhur si pasojë e keqinterpretimit të këtyre dispozitave ligjore dhe më tej keqzbatimit të tyre.

1.1. Qëllimi i studimit

Studimi synon të trajtojë të gjitha aspektet procedurale të “Veprimeve simuluese” dhe “Infiltrimit”, si mjete të reja për grumbullimin e provave.

Synojmë të trajtojmë efikasitetin dhe të vlerësojmë pasojat që vijnë nga përdorimi i gabuar i këtyre mjeteve hetimore.

Për të realizuar këtë, vëmendja u përqëndrua mbi disa objektiva kërkimore:

- a- Analizimi i kuadrit normativ sipas legjislacionit tonë krahasuar kjo me legjislacionet e vendeve të zhvilluara.
- b- Analizimi i praktikave të ndryshme gjyqësore shqiptare dhe të huaja, ku si mjet për grumbullimin e provave janë përdorur “*Veprimet simuluese*” dhe “*Infiltrimi*”.

1.2. Pyejtjet kërkimore

Interesi është përqëndruar sidomos në përgjigjet e disa pyejtjeve, rreth zhvillimit të veprimtarisë së këtij instituti të ri në të drejtën tonë procedurale penale, si:

- Sa e plotë është baza ligjore që rregullon veprimtarinë e “*agjentit të infiltruar*”?
- A përcaktohet në ligj fushëveprimi i hetimit të fshehtë?
- Cili është pozicioni procedural i agjentit të infiltruar?
- A parashikohen në ligj mënyrat dhe rastet në të cilat lind nevoja e demontimit të kësaj veprimtarie hetimore?
- Cilët janë limitet juridike që duhet të njohë ligji sa i përket veprimtarisë së agjentit të infiltruar?
- Në gjykimin tonë, cili është ai shtet, i cili gëzon një rregullim të plotë normativ të “*aktivitetit nën mbulim*”?

1.3. Hipoteza

Përdorimi i *hetimit të fshehtë* si mjet për grumbullimin e provave, kërkon një rregullim ligjor më të përshtatshëm dhe të detajuar. Duke u nisur nga specifikat operationale si dhe nga brishtësia e kufijve ligjor brenda të cilëve zhvillohet kjo veprimtari hetimore, kërkohet përcaktimi i limiteve ligjore brenda të cilëve duhet të veprojë agjenti i infiltruar, kërkohet përcaktimi i fushëveprimit të hetimit të fshehtë, kërkohet përcaktimi i pozicionin procedural të agjentit të infiltruar si dhe përcaktimi i mënyrës dhe rasteve në të cilat lind nevoja e demontimit të kësaj veprimtarie hetimore.

Konkludojmë se, legjislacioni shqiptar, duhet të gëzojë një rregullim legjislativ të përshtatshëm dhe të njehsuar me shtetet, të cilët gëzojnë një rregullim të tillë, të plotë dhe të detajuar sa i përket hetimeve nën mbulim.

1.4. Metodologjia e përdorur

Përmes një vëzhgimi të detajuar dhe përdorimit të metodave kërkimore shkencore hulumtuese dhe krahasuese, synoj të bëj trajtimin historik të figurës së “*agjentit të infiltruar*”.

Duke u nisur nga fakti që, legjislacioni ynë procedural penal nuk njeh një traditë legjislative, sa i përket *hetimit pro-aktiv*, jemi ndalur në një analizë historike të figurës së “*agjentit të infiltruar*”, të cilin e gjejmë si një derivat të figurës së “*spiunit*”.

Edhe pse me terma të ndryshëm, në thelb, aktiviteti i tyre është i njëjtë dhe ka si qëllim grumbullimin e informacionit.

Mënyra e përfshirjes së këtyre subjekteve në këto veprimtari të fshehta hetimore, si dhe institucionet, të cilët trajtojnë këto informacione, ka ndryshuar ndjeshëm ndër vite duke iu përshtatur formave të reja të shfaqjes së kriminalitetit.

Meqënëse *hetimi pro-aktiv* apo siç trajtohet ndryshe gjatë punimit edhe përmes termave të tillë si: hetim nën mbulim, hetim i fshehtë, hetim i maskuar etj, është një mjet i ri hetimor i cili i është shtuar legjislacionit tonë procedural penal me ligjin 9187 të datë 12.02.2004, duke u materializuar kështu në nenet 294/a dhe 294/b të K. Pr. P., kjo ka bërë që përdorimi i këtij mjeti hetimor të paraqesë probleme gjatë vënies në praktikë.

Nisur nga sa sipër, jemi ndalur në trajtimin e pozitës juridike të të infiltuarit në përputhje me bazën ligjore të *Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë*, në trajtimin e kësaj pozite, në lidhje me të drejtat e tjera ligjore dhe kushtetuese, në të njëjtën kohë, jemi ndalur në trajtimin e kufijve ligjore të përdorimit të të infiltuarit si mjet për grumbullimin e provave hetimore, duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Analiza e rezultateve të kërkimit, konsiston në veçimin e praktikave të ndryshme gjyqësore shqiptare dhe të huaja, ku si mjet për grumbullimin e provave janë përdorur "*Veprimet simultuese*" dhe "*Infiltrimi*".

Kemi analizuar vendime të *Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*, të cilët në arsyetimet e tyre kanë trajtuar veprimtarinë e agjentëve të fshehtë si jo të ligjshme.

Kemi analizuar njëkohësisht dhe praktika të ndryshme gjyqësore të *GJEDNJ-së* (Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut), ku si mjet për grumbullimin e provave janë përdorur këto forma të posaçme hetimore.

Duke u nisur nga këto problematika, jemi ndalur në një analizë të detajuar të kuadrit normativ, që rregullon “*Veprimet Simuluese*” dhe “*Infiltrimin*”.

Në konstatim të një pamjaftueshmërie të kuadrit normativ shqiptar, për të rregulluar këtë veprimtari hetimore, si dhe duke u nisur nga rëndësia, që paraqesin “*Veprimet Simuluese*” dhe “*Infiltrimi*” në zbulimin e krimit të organizuar, kemi dhënë dhe rekomandimet përkatëse për shtesa dhe ndryshime në legjislacionin tonë procedural penal.

Në nxjerrjen e konkluzioneve si dhe në dhënien e rekomandimeve tona, jemi fokusuar edhe në rezultatet e nxjerra nga një analizë krahasimore mes legjislacioneve të vendeve të zhvilluara si: Danimarka, Gjermania, Spanja, Zvicra, Kanadaja, Mbretëritë e Bashkuara si dhe SHBA-ja, të cilët gëzojnë një rregullim ligjor të plotë dhe të detajuar sa i përket *hetimit pro-aktiv*.

1.5. Rëndësia e studimit

Rëndësia e këtij punimi qëndron në faktin se duke sjellë përvojën e çmuar të vendeve të zhvilluara, do të mund të kontribuonim në dhënien e rekomandimeve përkatëse, për të bërë të mundur përafrimin e legjislacionit tonë me atë të vendeve më të zhvilluara, duke sjellë kështu më shumë garanci për një proces të rregullt.

Numri i studimeve në këtë fushë është i kufizuar, ndaj dhe ky studim do të ishte i rëndësishëm për të plotësuar këtë boshllëk. Studimi do të mund të shërbente si pikënisje për studime të tjera më të thelluara në këtë fushë, duke zgjeruar apo edhe ndryshuar këndvështrimet e paraqitura.

1.6. Kufizimet e punimit

Mungesa e një tradite legislative sa i përket “*Veprimeve simuluese*” dhe “*Infiltrimit*”, në legjislacionin procedural penal shqiptar ka qënë një kufizim për këtë punim. Veç kësaj, kufizim përbënte numri i pakët i literaturës në gjuhën shqipe, si dhe në numri i kufizuar i praktikave gjyqësore ku si mjet për grumbullimin e provave janë përdorur “*Veprimet simuluese*” dhe “*Infiltrimi*”.

1.7. Strukturimi i punimit

Kapitujt në vazhdim trajtojnë “*Rolin e të infiltuarit në proceset penale*”, së bashku me dinamikat e hetimeve paraprake, në të cilat agjenti i infiltuar, është aktori kryesor.

Kapitulli i dytë, përmbledh të dhëna të cilat dëshmojnë rrënjët e hershme të figurës së agjentit të infiltuar, në historinë e njerëzimit.

Trajton historinë e shërbimeve sekrete në Shqipëri, si dhe evoluimin e tyre, sipas periudhave dhe sundimeve të ndryshme. Trajton institucionet, të cilat dhe ato, merren me grumbullimin e informacionit, por bëmë njëkohësisht dhe dallimet mes tyre.

Nëse në *kapitullin e dytë*, merremi me institucionin kryesor të mbledhjes së informacionit, në kapitujt në vijim trajtojmë subjekte të tjera, të cilat dhe ato çdo ditë e bazojnë veprimtarinë e tyre mbi grumbullimin e informacionit, por kanë si qëllim final përdorjen e tyre si prova në procese gjyqësore. Këto janë *subjektet procedurale penale*. Nëse deri në këtë pikë të studimit tonë trajtojmë figurën e “spiunit”, në kapitujt në vijim trajtojmë figurën e “agjentit të infiltuar”, i cili është derivat i këtij të parit, por e përshtatur sipas kushteve moderne në të cilat ne jetojmë dhe për t’u përdorur si instrument në luftën kundër formave të reja të shfaqjes së kriminalitetit.

Kapitulli i tretë, nis me ndryshimet legislative që ka pësuar instituti i hetimeve paraprake si dhe përcaktohet roli dhe funksionet e policisë gjyqësore, roli i prokurorisë si dhe roli i gjykatës në këtë fazë të procedimit. Bëhet përshkrimi i funksioneve të tyre, sipas legjislacionit aktual.

Në vazhdim jepet përkufizimi i hetimit pro-aktiv, si një formë e posaçme hetimore, e domosdoshme në luftën kundër krimit të organizuar si dhe konceptin e asaj, çfarë është krimi i organizuar.

Pjesa e fundit e këtij kapitulli, përmbledh analizën e rezultateve të kërkimit. Analizë kjo, që konsiston në veçimin e disa prej praktikave gjyqësore, ku për grumbullimin e provave, janë përdorur “*Veprimet simulese*” dhe “*Infiltrimi*”, duke nxjerrë në pah dhe problematikat përkatëse.

Duke konkluduar, do të thoshim se praktikat e ndryshme gjyqësore të trajtuara në këtë kapitull, janë një tabllë e qartë e anëve positive, por dhe atyre negative që ka paraqitur metoda e posaçme hetimore, e kryer përmes “*Veprimeve Simuluese*” dhe “*Infiltrimit*”. Kemi vendime të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, të cilat në arsyetimet e tyre kanë trajtuar veprimtarinë e agentëve të fshehtë si jo të ligjshme, pasi kanë vepruar në kapërcim të kufinjve të ligjshmërisë, kemi gjithashtu një konfuzion mes aktiviteteve (“*Veprimeve simuluese*” dhe “*Infiltrimit*”) dhe rrjedhimisht dhe mes subjekteve (të cilët janë të ndryshëm dhe si të tilla parashikohen në nenet 294/a dhe 294/b të K.Pr.P).

Është ngushëllues fakti, që këto problematika janë kapur, trajtuar dhe ndëshkuar (duke mos përdorur rezultatet e hetimeve të kryera në kundërshtim me ligjin) nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në ushtrim të funksionit të tyre për dhënie të drejtësisë, por na ligëson fakti, që këto problematika të kënë kaluar pa u vënë re nga dy shkallët e tjera të gjyqësorit,

si dhe nga prokurori, i cili duhej të ishte “gjuqtari” i parë i fakteve të grumbulluara nga oficeri i policisë me autorizimin e tij.

Kapitulli i katërt, na njeh me figurën e agjentit të infiltruar, e bën këtë duke trajtuar kuadrin normativ që rregullon veprimtarinë e tij. Bëhet dallimi mes dy figurave, agjentit të infiltruar dhe agjentit, i cili përfshihet në blerjet e simuluar. Bëhet njëkohësisht dallimi midis formave të ndryshme të përfshirjes së këtyre dy subjekteve, në këtë formë të posaçme hetimore.

Në pjesën e dytë të këtij kapitulli, ngremë një hipotezë, e cila konsiston në trajtimin e ndikimeve psikologjike, sociale dhe kriminologjike, që aktiviteti nën mbulim mund të sjellë tek agjenti i fshehtë, kur kjo veprimtari zgjatet në kohë. Njihemi me vështirësitë dhe problematikat me të cilat përballlet një oficer i policisë gjyqësore, nën petkun e agjentit të fshehtë.

Kapitulli i pestë. Duke bërë edhe një herë dallimin mes figurës së agjentit simulues dhe atij të infiltruar, jemi njohur me specifikat nga e cila karakterizohet secila figurë. Duke qenë se veprimtaria e agjentit të infiltruar nuk përfundon në fazën e hetimeve paraprake, por vazhdon edhe më tej përmes dëshmisë së tij në procesin penal, atëherë ne kemi abstraguar në lidhje me pozicionin procedural të oficerit të policisë gjyqësore si i infiltruar, gjë e cila nuk përcaktohet shprehimisht në legjislacionin tonë, ndryshe nga sa vihet re në legjislacionet e shteteve më të zhvilluara, në të cilat agjenti i infiltruar gëzon një status të veçantë, i cili e shoqëron atë gjatë gjithë kohëzgjatjes së procesit gjyqësor.

Më tej, kemi trajtuar konceptin e hetimit pro-aktiv, sipas së drejtës penale europiane, si dhe kemi sjellë praktika të ndryshme gjyqësore të GJEDNJ, në të cilat janë evidentuar raste flagrante të shkeljeve të të drejtave të njeriut.

Në pjesën e fundit të këtij kapitulli, kemi trajtuar avantazhet e përdorimit të “*Veprimeve simuluese*” dhe “*Infiltrimit*”, si një mjet i pazëvendësueshëm për zbulimin dhe parandalimin e krimit kibernetik, në të gjitha format e shfaqjes së tij.

Kapitulli i gjashtë. Në këtë kapitull, kemi marrë si modele legjislacionet e shteteve si: Danimarka, Gjermania, Spanja, Zvicra, Kanadaja, Mbretëritë e Bashkuara si dhe SHBA-ja, duke ndjekur evolucionin normativ të tyre, kemi konkluduar me dhënien e rekomandimeve tona, për mundësinë e ndërhyrjes në legjislacionin tonë procedural penal.

Konkludojmë se legjislacioni shqiptar, duhet të gëzojë një rregullim legjislativ të përshtatshëm dhe të njehsuar me shtetet, të cilët gëzojnë një rregullim të tillë, të plotë dhe të detajuar sa i përket hetimeve nën mbulim. Kjo do të shkonte në funksion të një bashkëpunimi potencial mes shteteve të ndryshme në këtë fushë. Nuk do të mund të mendohej, se një shtet si Zvicra me një normativë të tillë kaq të avancuar, të mund të pranonte një kërkesë për bashkëpunim transkufitar me shtetin tonë, pasi legjislacioni ynë nuk do të ofronte garancitë e nevojshme për një veprimtari të tillë hetimore që mund të aplikohet në vendin tonë. Një konstatim i tillë, do të bënte të domosdoshëm një adoptim legjislativ të tillë që të ishte i njehsuar në të gjitha vendet europiane, gjë e cila do të shkonte në funksion të një bashkëpunimi potencial mes shteteve të ndryshme në këtë fushë, përfshijmë këtu edhe shtetet jo komunitare.

Në këtë mënyrë, do të krijohej një hapsirë për të represionuar krimin e organizuar ndërkombëtar përmes agentëve të infiltruar, të vendeve të ndryshme, të cilët do ta bazonin aktivitetin e tyre hetimor mbi një rregullim ligjor të unifikuar.

KAPITULLI II: ZANAFILLA HISTORIKE

2.1. Origjina historike e agjentit të infiltruar

Të trajtosh origjinën historike të agjentit të infiltruar, do të thotë të kthehesh shumë e mbrapa në kohë.

Historikisht, termi më i përdorur për të treguar këtë tip aktiviteti, ishte ai i *spiunit*. Gjurmët e kësaj figure gjenden që në 1200-ën.

Impenjimi i spiunëve kishte një qëllim të dyfishtë, të eksploronte qëllimet dhe veprimtaritë politike të armiqve dhe të kontrollonte sjelljet armiqsore të bashkëardhetarëve, për të referuar më pas në të dy rastet tek autoritetet përkatëse. (Jannone, 2007)

- *Figura e spiunit*

Spiuni është një agjent i ngarkuar, për të grumbulluar sekrete. Edhe termi agjent i inteligjencës është përdorur për të përshkruar një anëtar të forcave të armatosura, një agjent të policisë ose të një agjencie të spiunazhit civil, që është e specializuar në mbledhjen, grumbullimin dhe analizimin e informacioneve në favor të shtetit ose të ndonjë organizatë tjetër. Krahas kësaj figure, egzistojnë një tjetër kategori spiunësh, që adoptojnë edhe teknika sabotazhi, dizinformimi, vrasje nën shënjestër, deri në ç'orjentime, në kryerjen e veprave kriminale për të çuar përpara drejtësisë së shtetit të tyre, individë të rrezikshëm (Agjenti provokator), nën veprimtarinë e një komande të vërtetë.

“*Spiunazhin*”, shpesh e kemi dëgjuar të konsiderohet si art, në fakt *spiunazhi* është profesion, dhe mendohet të jetë i dyti më i vjetër në botë, kjo nisur nga fakte, personazhe dhe ngjarje shumë të rëndësishme, të cilët kanë lënë gjurmë në histori, por në shumë raste dhe e kanë ndryshuar atë.¹

¹ Espionage and Intelligence, Early Historical Foundations, "Gale Encyclopedia of Espionage & Intelligence", Marrë nga: <http://www.answers.com/topic/espionage-and-intelligence-early-historical-foundations>, parë më 01. 04. 2013.

- *Aktiviteti i spiunazhit*

"Spiunazhi është një proces, i cili angazhon agjentë apo mjete teknike për të siguruar informacion, i cili nuk është i arritshëm publikisht, por vetëm përmes mjeteve dhe mënyrave sekrete" (Jannone, 2007)

Që në Kohë të Lashta e deri në ditët tona shoqëri, shtete, ndërmarrje private, individë etj, e kanë përdorur spiunazhin si mjet për të manipuluar, vjedhur, sabotuar informacione dhe interesa.

Në sajë të spiunazhit janë fituar luftëra, perandori të mëdha janë gjuhëzuar, janë shkatërruar jetë njerëzish, por edhe janë shpëtuar në të njëjtën kohë. Operacione të fshehta dhe klandestine mblodhën intrigën më të madhe, por historia e spiunazhit është përshkruar më mirë në aspektin e evolucionit të komponentëve të saj. Gjatë gjithë historisë, inteligjenca është përkufizuar si mbledhje, grumbullim, analizim dhe shpërndarje e informatave kritike dhe strategjike.

2.1.1. Historiku i shërbimeve inteligjente në Shqipëri

Shërbimet sekrete në vendin tonë, nga lashtësia dhe deri në mesjetë, janë një fushë fare pak e studiuar. Kjo nuk do të thotë se rrjeti informativ gjatë kësaj periudhe ishte inegzistent. Sinjale të egzistencës së një rrjeti tepër aktiv u ngritën nga Skënderbeu. Shërbimet e tij informative u rradhitën ndër më të mirët e kohës dhe më cilësorët në Europë.²

Në vijim do të trajtojmë historinë e plotë të Shërbimit Sekret Shqiptar, që nga krijimi i këtij shërbimi në qeverinë e Vlorës në 1912, duke vazhduar me konsolidimin e Shërbimit Sekret Shqiptar në qeverinë e Ahmet Zogut, për të kaluar në rregjimin komunist, ku Shërbimi Sekret Shqiptar u kthye në Sigurimin e Shtetit dhe duke përfunduar më pas në demokraci.

² Koçollari, Cikël leksionesh, pranë Ak. Ushtarake të R. SH., "Shërbimet e sigurisë dhe vendi i tyre në demokraci".


2.1.2. Pavarësia e Shqipërisë dhe Shërbimet sekrete të shtetit shqiptar

Pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, më 28 Nëntor 1912, u formua Qeveria, me kryeministër Ismail Qemalin, e cila filloi ngritjen e institucioneve të Shtetit Shqiptar. Ndër to, më 17 Dhjetor 1912, u mor Vendimi për themelimin e Shërbimit Sekret Shqiptar. Në këtë Vendim thuhej: “Të organizohet një shërbim i msheftë për vise të shkeluna të Shqipërisë”. Për rganizimin e tij u ngarkuan persona konkretë, ndërmjet të cilëve *Lef Nosi* e *Bajram Curri*.³

Pavarësia dhe formimi i shtetit shqiptar, ishte një periudhe shumë e rëndësishme, për Shqipërinë. Me formimin e qeverisë së Vlorës rezultojnë dokumenta që faktojnë ngritjen e strukturave të Shërbimeve Informative dhe pikërisht egziston një dokument, që mban *Nr. 329 me datë 4 Shenendre 1912*, i hartuar nga vete anëtarët e Qeverisë së Vlorës. Në të thuhet:

”...Duhet ngritur struktura të një Shërbimi Informativ, të cilat të njoftojnë në kohë, lëvizjet dhe kërcënimin, që i vjen territoreve tona nga forcat serbe...”⁴


³ Shërbimi informativ i shtetit, “Historiku”, Marrë më: <http://www.shish.gov.al/historiku.html>, (parë më 06.06.2013).



Vazhdimësinë e shërbimit sekret shqiptar e shohim përsëri pas ardhjes së princ Vilhelm Vidit (në vitin 1913), gjatë Luftës së Parë Botërore dhe pas saj.⁵

Që nga viti 1912 kur Shqipëria u shpall shtet i lirë dhe i pavarur duke deklaruar shkëputjen e çdo lloj lidhjeje me Perandorinë Osmane të asaj kohe, data më e vjetër e krijimit të Shërbimit Sekret të shtetit shqiptar është 17 dhjetori i vitit 1912.

Qeveria e Ismail Qemalit e zgjedhur pas shpalljes së pavarësisë më 28 nëntor 1912, në kuadër të masave komplekse ushtarake, mobilizuese, diplomatike e vepruese, mori vendim më 17 dhjetor 1912 për krijimin e një shërbimi të fshehtë për viset e banuara prej shqiptarëve. Siç shkruhet fjalë për fjalë në pikën 6 të vendimit të qeverisë së Ismail Qemalit: “Të organizohet një shërbim i msheftë për vise të shkeluna të Shqipërisë”⁶ Krijimi i Shërbimit të Fshehtë Shqiptar nuk u la vetëm në letër, por për organizimin e tij u ngarkuan persona konkretë



⁴ Koçollari, Cikël leksionesh, pranë Ak. Ushtarake të R. SH., "Shërbimet e sigurisë dhe vendi i tyre në demokraci".

⁵ Shërbimi informativ i shtetit, "Historiku", Marrë më: <http://www.shish.gov.al/historiku.html>, (parë më 06.06.2013).

⁶ Këto të dhëna i përkasin Fondit nr.145 në Arkivin Qendror të Shtetit dhe i përkasin Kryesisë të Përkohshme të Vlorës, viti 1912, dosja II-2 "Vendime dhe Proces-Verbale të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës mbi çështjen politike, ushtarake dhe financiare.

ndërmjet të cilëve Lef Nosi e Bajram Curri. Për funksionimin e këtij Shërbimi ka të dhëna edhe pas ardhjes së princ Vilhelm Vidit si sundimtar i Shqipërisë i vendosur nga “Konferenca e Paqes në Londër” në vitin 1913. (Zavalani, 1966: 236).

Vazhdimësinë e shërbimit sekret shqiptar e shohim përsëri pas Luftës së Parë botërore dhe largimit të princ Vidit nga Shqipëria. Statuti i Lushnjës i hartuar në Kongresin Kombëtar të Lushnjës më 21 janar 1920, risanksionoi ndarjen e pushteteve, ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor dhe ndër të tjera u krijua Ministria e Brendshme, pjesë e së cilës ishte edhe Shërbimi Sekret. Ministër i punëve të brendshme u caktua Ahmet Zogu. Pas Luftës së Dytë Botërore, shteti shqiptar që në periudhën dhjetor 1944 - mars 1945 i kushtoi rëndësi të veçantë krijimit të Organeve të Sigurimit të Shtetit.⁷

2.1.3. Mbretëria Zogiste

Më pas me ardhjen në sundim të Mbretërisë Zogiste, Mbreti Zog ngriti Ministrinë e Mbrendshme, xhandarmërinë, e cila kishte edhe detyrat e infomimit, zbatimit të vendimeve të gjykatave si dhe të kontrollit të kundërshtarëve politike.⁸

- *Konsolidimi i Shërbimit Sekret Shqiptar në Qeverinë e Ahmet Zogut 1921 - 1939.*

Më 21 janar 1920, Kongresi Kombëtar i Lushnjës bëri organizimin e Këshillit të Naltë dhe risanksionoi ndarjen e pushteteve, ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor, si dhe krijimin e Ministrisë së Brendshme. Më datë 24 dhjetor 1921, Ministër i Punëve të Brendshme u dekretua Ahmet Zogu, i cili bëri riorganizimin e MPB-së, duke krijuar dhe Seksionin Sekret. Drejtues i këtij Seksioni u caktua Haki Stërmilli.⁹ Parë në planin historik, shërbimi kryesor inteligjent shqiptar, gjatë kësaj periudhe, ka patur këto emërtesa: në vitin 1922, Sekretari Sekrete dhe,

⁷ “Historia e Shqipërisë”, tekst i shkurtuar, 2006.

⁸ Koçollari, Cikël leksionesh, pranë Ak. Ushtarake të R. SH., “Shërbimet e sigurisë dhe vendi i tyre në demokraci”

⁹ “Krijimi i Shërbimit Sekret Shqiptar në Qeverinë e Vlorës 1912”, Marrë më <http://www.shish.gov.al/historik.html>, (parë më 23.08. 2012).

në vitet 1923-1939, Zyra Sekrete. Në nivel qendror, veprimtaria e shërbimit sekret do të drejtohej nga Zyra Sekrete, ndërsa në nivel vendor drejtohej nga Prefekti, i cili kishte ngritur një zyrë të posaçme që merrej me “*çështje rezervate*”.¹⁰

Në konsolidimin e institucioneve të Shtetit Shqiptar, nga janari 1927, pati rëndësi edhe organizimi i Shërbimit Informativ të Jashtëm, me qendër në Ministrinë e Punëve të Jashtme, e përfaqësuar nga selitë tona diplomatike, duke organizuar një rrjet informativ që vepronte i lidhur me mekanizmin konsullatë - legatë -prefekturë. Klane dhe forca politike të ndryshme, gjatë periudhës 1925 -1939, të shtyra nga interesa të ngushta dhe të përkrahura nga jashtë, kanë provokuar trazira, komplete, vrasje, kryengritje, etj. , me qëllim destabilizimin e vendit dhe cënimin e sigurisë kombëtare.¹¹

2.1.4. Lufta Nacional Çlirimtare

Edhe gjatë periudhës së Luftës Nacional Çlirimtare, egzistojnë dokumente, që vërtetojnë egzistencën e një rrjeti të mirëfilltë informativ dhe pikërisht në vitin 1943 egziston një qarkore e njësave partizane, në të cilën kërkohej:

“...Ngritja e Rrjetit Informativ, që do të shërbejë në kohë lufte për të mbledhur të dhëna për levizjet e armikut, armatimin, numrin e forcave, qëllimet etj, por edhe në kohë paqeje...”¹²

Organet e Sigurimit të Shtetit 1944 - 1991

Pas Luftës së Dytë Botërore, në periudhën dhjetor 1944 - mars 1945, Shteti Shqiptar i kushtoi menjëherë rëndësi të veçantë krijimit të Organeve të Sigurimit të Shtetit. Këto ishin vijuese të Shërbimit Informativ Ushtarak gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Fil-

¹⁰ “Krijimi i Shërbimit Sekret Shqiptar në Qeverinë e Vlorës 1912”, Marrë më <http://www.shish.gov.al/historik.html>, (parë më 23.08. 2012).

¹¹ “Krijimi i Shërbimit Sekret Shqiptar në Qeverinë e Vlorës 1912”, Marrë më <http://www.shish.gov.al/historik.html>, (parë më 23.08. 2012).

¹² Koçollari, Cikël leksionesh, pranë Ak. Ushtarake të R. SH., “Shërbimet e sigurisë dhe vendi i tyre në demokraci”.

limisht, pas çlirimit të vendit u krijua Drejtoria e Mbrojtjes së Popullit, në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes, e cila funksionoi deri në vitin 1946, kohë kur u krijua Drejtoria e Sigurimit të Shtetit. Në vitin 1966 u bë riorganizimi në tre drejtori: e para e Kundërzbulimit, e dyta e Udhëheqjes dhe e treta e Zbulimit Politik, strukturë që e ruajtën deri në vitin 1991. Organet e Sigurimit të Shtetit organizuan veprimtarinë e tyre bazuar në një platformë të ish-byrosë politike dhe të pambështetur në Kushtetutë dhe në ligj. Kjo solli shkelje të rënda të të drejtave të njeriut. Gjatë veprimtarisë së tij u bënë shumë shkelje ligjore. Ai vuri në survejim gjithë sektorët e jetës së vendit, kuadrot dhe njerëzit e thjeshtë, zbatoi praktika të padrejta dhe tejkaloi kompetencat, sidomos në kuadrin e luftës së klasave dhe të nxitjes artificiale të saj. Një numër qytetarësh u bënë viktima të kësaj veprimtarie.¹³

Organizimi intitucional i mirëfilltë i shërbimit informative, faktehet më së miri gjatë periudhës së pas luftës, ose e njohur ndryshe si periudha e çlirimit të Shqipërisë. Këtë kohë kemi një organizim të Divizionit të Mbrojtjes së Popullit, i cili kishte si mision mbrojtjen e kufinjve, ndjekjen e kolaboracionistëve si dhe kontrollin e kundërshtarëve politik të pushtetit. Në vitin 1949 formohet Ministria e Brendshme me struktura më të profilizuara: Policia, sigurimi dhe kufiri. Strukturat e brendshme në këtë periudhë kanë qënë: Drejtoria e Sigurimit, Drejtoria e Policisë, Drejtoria e Zbulimit, Drejtoria e Kufirit, Drejtoria e Personelit, Drejtoria Ekonomike.¹⁴

¹³ "Krijimi i Shërbimit Sekret Shqiptar në Qeverinë e Vlorës 1912", Marrë më <http://www.shish.gov.al/historik.html>, (parë më 23.08. 2012).

¹⁴ Koçollari, Cikël leksionesh, pranë Ak. Ushtarake të R. SH., "Shërbimet e sigurisë dhe vendi i tyre në demokraci".

2.1.5. Ndryshimet demokratike në Shqipëri

Ndryshimet demokratike në Shqipëri ishin të shumta në legjislativ, edhe shërbimi informativ nuk ngeli pa pësuar ndryshimet e tij. Për nga mënyra e organizimit, Ministria e Brendshme u nda në Ministrinë e Rendit Publik dhe më pas u krijua me ligj SHIK-u.

U caktua me ligj veprimtaria e SHIK-ut. Objekti i SHIK-ut ishte, siguria kombëtare, sovraniteti dhe korrupsioni. Natyra e veprimtarisë së SHIK-ut ishte thjesht informative.

Si tregues i parë për demokratizimin e veprimtarisë së SHIK-ut ishte përjashtimi me ligj i kontrollit së lirisë së mendimit, ndryshe kjo nga rregjimet totalitare dhe paratotalitare, që janë si indikator i parë i veprimtarisë antidemokratike.¹⁵

- *Reformimi i Shërbimit Sekret Shqiptar 1991 e në vazhdim.*

Pas vitit 1990, në kuadrin e ndryshimeve cilësore që ndodhën me vendosjen e pluralizmit politik në Shqipëri, Organet e Sigurimit të Shtetit u reformuan plotësisht duke iu përshtatur kërkesave të shtetit ligjor. Kështu në vitin 1991 u krijua Shërbimi Informativ Kombëtar, me ligjin nr.7495, datë 02.07.1991 “*Për organizimin e Shërbimit Informativ Kombëtar*”. Detyrë parësore e këtij Shërbimi u vendos, parandalimi, zbulimi e ndërprerja e çdo veprimtarie antikushtetuese që cënon lirinë, pavarësinë, aftësinë mbrojtëse, tërësinë territoriale dhe pasurinë kombëtare të Republikës së Shqipërisë. SHIK u krijua si një institucion i depolitizuar dhe si i tillë ai u ka pësuar vazhdimisht ndryshime të herëpashershme. Në vitin 1999 me vendimin nr.61, datë 22.11.1999 të Gjykatës Kushtetuese të RSH, SHIK ndryshon emërtimin nga Shërbimi Informativ Kombëtar në Shërbimi Informativ Shtetëror.

Në vitin 2005 miratohet ligji nr. 9357, datë 17.03.2005 “*Për statusin e punonjësit të Shërbimit Informativ Shtetëror*”.

¹⁵ Koçollari, Cikël leksionesh, pranë Ak. Ushtarake të R. SH., “Shërbimet e sigorisë dhe vendi i tyre në demokraci”.

Ky ligj përcaktonte statusin e punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit, pozitën juridike, administrative, kriteret e pranimit dhe të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, detyrimet e të drejtat e punonjësit të këtij Shërbimi dhe garancitë ligjore për realizimin e tyre. Për realizimin e detyrave të tij Shërbimi Informativ Shtetëror ruan raporte të drejta ndërmjet nevojës së sigurimit të informacionit të domosdoshëm dhe respektimit të të drejtave dhe të lirive të individit. *Ligjshmëria, objektiviteti dhe sekreti janë parimet bazë të punës së këtij institucioni.*¹⁶

2.2. Institucionet që merren me informacionin

Duke pasë si bazë informacionin apo të dhënat, ngrihet edhe një numër, strukturash apo institucionesh, siç mund të jenë ato mediatike, siç është gazetaria, radioja, televizioni, institucione analizash dhe ato studimore etj.¹⁷

- *Lind pyejtja cili dallimi mes inteligjencës nga institucionet e tjera që merren me informacionin?*

Shërbimet inteligjente kane objekt, detyra si dhe mënyra të të mbledhurit të informacionit të mirëpërcaktuara me ligj, ndryshe kjo nga strukturat e tjera mediatike.

- *Shërbimet Inteligjente kanë një objekt të caktuar me ligj dhe nuk mbledhin çdo lloj informacioni, ndërsa mediat mund të mbledhin çdo lloj informacioni, mjafton të bëjnë sensacion.*
- *Shërbimet Inteligjente programojnë dhe planifikojnë mbledhjen e informacionit, bazuar këto në plane vjetore, mujore, prespektive.*
- *Shërbimet Inteligjente organizojnë në mënyrë të kualifikuar mbledhjen e tij, përmes planeve të studiuara, kombinacioneve, vijësjelljeve, ofrimeve.*
- *Shërbimet Inteligjente përzgjedhin, përgatisin, kualifikojnë dhe drejtojnë në mënyra dhe metodologji sekrete burime informacionit.*

¹⁶ “Krijimi i Shërbimit Sekret Shqiptar në Qeverinë e Vlorës 1912”, Marrë më <http://www.shish.gov.al/historik.html>, (parë më 23.08. 2012).

¹⁷ Koçollari, Cikël leksionesh, pranë Ak. Ushtarake të R. SH., “Shërbimet e sigurisë dhe vendi i tyre në demokraci”.

- *Shërbimet Inteligjente përdorin mjete dhe teknika të veçanta për grumbullimin e tij, ndër të cilat mund të përmendim, aparatura të sofistikuar, teknika elektronike përgjimi, filmime etj.*
- *Shërbimet informative e përdorin në mënyrë të kualifikuar informacionin ashtu dhe dizinformacionin.*
- *Shërbimet Informative e konservojnë dhe vendosin kritere dhe shenja sekrecie “Sec”, “burim i besuar”, “i dyshimtë”, “gënjeshhtar”... nisur kjo nga vlera e informacionit, ndërsa gazetaria nuk e bën një vlerësim të tillë.*
- *Informativët përcaktojnë kritere ligjore në shpërndarjen, njohjen apo deklasifikimin e tij.*
- *Shërbimet Inteligjentë kanë një instikt të ruajnë nga ekspozimi informacionin, pra të ruajnë sekrecinë e tij, ndërsa media e shpall menjëherë atë në mënyrë, që të prodhojë sensacion.*
- *Nevoja dhe sukcesi në ruajtjen e sekrecisë së informacionit është faktor rentable dhe pse jo determinant në përcaktimin e suksesit të vetë operacioneve dhe misioneve të Shërbimit, ndryshe nga mediat, për të cilat shpallja e dokumentit sekret është kulmi i suksesit.¹⁸*

Vetëm atëherë kur Inteligjenca (Shërbimi Informativ) dhe punonjësit e saj vendosin raporte të tilla me informacionin mund të themi se, Inteligjenca ka vendosur themele të sigurta të një grehinë, që premtion. Por, në morinë e pafundë të informacioneve dhe të fondeve të të dhënave. Inteligjenca nuk grumbullon gjithçka! Ajo qëmton dhe seleksionon ato të dhëna të një natyrë të veçantë, që lidhen me misionin e saj.¹⁹

Sa trajtojmë në kapitullin e dytë, ka të bëjë me historinë e lindjes dhe zhvillimit të spiunazhit. Trajtojmë historinë e Shërbimeve Sekrete në Shqipëri, si dhe evoluimin e tyre, sipas periudhave dhe sundimeve të ndryshme. Trajtojmë institucionet, të cilat dhe ato, merren me grumbullimin e informacionit, por bëjmë njëkohësisht dhe dallimet mes tyre.

¹⁸ Koçollari, Cikël leksionesh, pranë Ak. Ushtarake të R. SH., “Shërbimet e sigurisë dhe vendi i tyre në demokraci”.

¹⁹ Koçollari, Cikël leksionesh, pranë Ak. Ushtarake të R. SH., “Shërbimet e sigurisë dhe vendi i tyre në demokraci”.

Nëse në kapitullin e dytë, merremi me institucionin kryesor të mbledhjes së informacionit, në kapitujt në vijim trajtojmë subjekte të tjera, të cilat dhe ato çdo ditë e bazojnë veprimtarinë e tyre mbi grumbullimin e informacionit, por kanë si qëllim final përdorjen e tyre si prova në proçese gjyqësore. Këto janë *subjektet procedurale penale*. Nëse deri në këtë pikë të studimit tonë trajtojmë figurën e “spiunit”, në kapitujt në vijim trajtojmë figurën e “agjentit të infiltruar”, i cili është derivat i këtij të parit, por e përshtatur sipas kushteve moderne në të cilat ne jetojmë dhe për t’u përdorur si instrument në luftën kundër formave të reja të shfaqjes së kriminalitetit.

KAPITULLI III. VEPRIMTARITË E FSHEHTA DHE DINAMIKAT E HETIMEVE PARAPRAKE

3.1. Veprimtaritë e fshehta dhe përfshirja e tyre në legjislacionin procedural

Si pasojë e globalizimit format e kriminalitetit kanë pësuar ndryshime të menjëhershëm, duke u shfaqur gjithnjë e më shumë në forma nga më të sofistikuarat. Në kuadër të luftës kundër kriminalitetit, shumë legjislacione europiane, duke përfshirë këtu edhe Shqipërinë kanë bërë ndryshime në ligjet e tyre penale materiale dhe procedurale, duke pranuar konceptin e “*belum justum*”: ashpërsimin e masave të dënimit, zgjerimin e kompetencave të organeve të policisë, përdorimin e teknikave të posaçme të hetimit etj.

Në Kodin Procedural Penal Shqiptar, të tilla ndryshime materializohen nën emërtimin e “*Veprimeve simuluese*” dhe të “*Infiltrimit*”, këto janë mjete për marrjen e provave në proceset penale. Në legjislacione të ndryshme njihen si teknika të posaçme të hetimit apo e thënë ndryshe “*hetim proaktiv*”.²⁰

Vitet e fundit, edhe Shqipëria ashtu si shumë vende të tjera të botës është njohur me forma nga më komplekset të shfaqjes së kriminalitetit. Kriminalitet ky, që paraqet një rrezikshmëri të madhe shoqërore dhe që minon demokracinë e një vendi. Në kuadër të luftës ndaj këtij fenomeni, janë bërë dhe akoma vazhdojnë të bëhen ndryshime legjislative, të cilat janë huazuar nga legjislacionet penale bashkëkohore të vendeve të zhvilluara dhe me një demokraci solide. Në fokus të këtij kapitulli do të jetë ajo formë e veçantë investigative, e cila sipas Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë njihet nën emërtimin e “*Veprimeve simuluese*” dhe të “*Infiltrimit*”.

- Lind pyejtja se çfarë përfaqësojnë këto forma të posaçme hetimore?

²⁰ Ndryshe “*hetimi i fshehtë*”.

Veprimet simuluese dhe infiltrimi, si metoda të reja hetimore në të drejtën penale shqiptare janë një fushë me interes studimi, për të paraqitur përvojën e mirë në përdorimin e tyre si mjete të marrjes së provës në proceset penale në Shqipëri dhe në Europë. Këto mjete paraqesin një rëndësi të veçantë, sidomos për zbulimin dhe procedimin e personave, që kryejnë vepra penale komplekse, të rënda, të mirëorganizuara dhe që paraqesin rrezikshmëri të madhe shoqërore. Pavarësisht dobisë së madhe të këtyre mjeteve, është mjaft e rëndësishme të studiohen ndalimet e përcaktuara në ligj, që nuk i lënë vend abuzimit nga ana e personit të infiltruar, me qëllim mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut. Gjithashtu, është e rëndësishme të studiohen pasojat juridike, që passjellin abuzimet në këtë rast.

Ligji nr. 9187 date 12.02.2004, duke shtuar dhe *nenet 294\ a* dhe *294\ b* të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, parashikojnë rolin e oficerit të policisë gjyqësore në veprimet simuluese dhe si i infiltruar, por pavarësisht kësaj është vërejtur, që në praktika të ndryshme gjyqësore janë mbajtur qëndrime të ndryshme, diametralisht të kundërt, gjë që tregon se ka edhe praktika të gabuara, si nga ana e prokurorisë gjatë hetimit të procedimeve penale, ashtu edhe nga gjykatat në gjykimet e këtyre çështjeve, të cilat kanë ardhur si pasojë e keqinterpretimit të këtyre dispozitave ligjore dhe më tej keqzbatimit të tyre. (Mujaj, 2013: 6-13)

3.1.1. Një vështrim i shkurtër historik i zhvillimeve në legjislacionin penal shqiptar

Në vitin 1990 në Shqipëri u përmbys sistemi totalitar komunist, i cili u zëvendësua me një sistem demokratik, duke ndjekur modelin e shteteve demokratike në mbarë botën. Ky ndryshim u shoqërua edhe me ndryshimin e ligjeve në Shqipëri. Për herë të parë pas periudhës totalitariste, parimet themelore demokratike të shtetit të së drejtës, gjetën vend në ligjin 7491 datë 29.04.1991 “*Për dispozitat kryesore kushtetuese*”, i ndryshuar me ligjin 7561 datë

29.04.1992. Mbi bazën e këtyre parimeve u miratua Kodi i Ri Penal me ligjin 7895 datë 27.01.1995. Ky Kod u ndërtua sipas modeleve të kodeve penale bashkëkohorë të disa shteteve demokratikë europianë (kryesisht Itali, Francë, Gjermani). Pas miratimit të tij në vitin 1995 e deri më sot, kur kanë kaluar më tepër se 20 vjet në demokraci dhe Shqipëria ka ndërmarrë një sërë reformash të mëtejshme institucionale, duke miratuar Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë në vitin 1998, si akt themelor i shtetit shqiptar, si dhe duke ratifikuar akte të ndryshëm ndërkombëtarë, në reflektim të të cilëve lindi e nevojshme bëra e një sërë ndryshimesh në Kodin Penal, nëpërmjet ligjeve amenduese të tij. Këto ndryshime erdhën si pasojë e nevojës së përshtatjes me standartet, që kërkohen nga çdo vend aspirant për në BE. Ndër aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria në fushën e të drejtës Penale përmendim:

- 1- Konventa e skllavërisë në Gjenevë, më 25.10.1926, ndryshuar nga protokolli, New York, 1953. Ratifikuar nga Shqipëria më 02.07.1957.
- 2- Konventa shtesë për heqjen e skllavërisë, tregtisë së skllavërve dhe institucioneve dhe praktikave të ngjashme me skllavërinë, bërë në Gjenëvë, 07. 09.1956. Ratifikuar nga Shqipëria më 06.11.1958.
- 3- Konventa Ndërkombëtare kundër marrjes së Pengjeve, bërë në New York, 17.12.1979. Ratifikuar nga Shqipëria më 22.01. 2002.
- 4- Konventa për parandalimin e dënimit e krimeve kundër personave të mbrojtur në planin ndërkombëtar, duke përfshirë agjentët diplomatike, bërë në New York, 14.12.1973. Ratifikuar nga Shqipëria më 22.01.2002.
- 5- Konventa për Sigurinë e Kombeve të Bashkuara dhe personelit, që ka lidhje me të, bërë në New York, më 09.12.1994. Ratifikuar nga Shqipëria më 30.03.2001.

- 6- Konventa Ndërkombëtare për Shtypjen e Bombardimeve Terroriste, bërë në New York, më 15.12.1997. Ratifikuar nga Shqipëria më 22.01.2002.
- 7- Statuti i Romës për Gjykatën Ndërkombëtare Penale, bërë në Romë, 17.07.1998. Ratifikuar nga Shqipëria më 31.01.2003.
- 8- Konventa Ndërkombëtare për shtypjen e Financimin e Terrorizmit, bërë në New York, më 09.12.1999. Ratifikuar nga Shqipëria më 10.04.2002.
- 9- Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar Ndërkombëtar, bërë në Palermo, më 15.12.2000.

“Protokolli kundër prodhimit të paligjshëm dhe trafikimit të armëve të zjarrit pjesëve të tyre, komponentëve dhe municioneve, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar”, hyrë në fuqi më 02.03.2008. Ratifikuar nga Shqipëria më 21.08.2002.
- 10-Protokolli për parandalimin e Shtypjen dhe Dënimin e Trafikut të Personave, në veçanti të Grave dhe fëmijëve, që plotëson Konventën e OKB-së kundër krimit të organizuar Ndërkombëtar, bërë në Palermo, 15.11.2000. Ratifikuar nga Shqipëria më 21.08.2002.
- 11-Protokolli kundër Trafikut të Migrantëve nga Toka, Deti dhe Ajri, që plotëson konventën e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar Ndërkombëtar, bërë në Palermo, 15.11.2000. Ratifikuar nga Shqipëria më 21.08.2002.
- 12- Marrëveshja për imunitet dhe privilegjet e Gjykatës Ndërkombëtare Penale, bërë në New York, 09.09.2002. Ratifikuar nga Shqipëria më 01.09.2006.

13- Konventa e OKB-se kundër korrupsionit, bërë në New York, më 31.10.2003. Ratifikuar nga Shqipëria më 25. 05.2006.

14- Konventa Ndërkombëtare për shtypjen e Akteve të Terrorizmit Nuklear, bërë në New York 13.04.2005. Nënshkruar nga Shqipëria më 23.11.2005.

Ratifikimi nga shteti shqiptar i akteve juridike ndërkombëtare të lartpërmëndura, mundësoi reforma të mëdha ligjore dhe institucionale edhe në fushën e të drejtës penale. Reforma këto, që u shoqëruan me inkriminimin e veprave të reja penale, si ato për *krimin e organizuar, trafiket e paligjshme, korrupsionin, terrorizmin e deri tek veprat kompjuterike*. Shtesat dhe ndryshimet e bëra, në Kodin Penal kanë luajtur një rol të rëndësishëm në forcimin e luftës kundër kriminalitetit, sidomos kundër krimit të organizuar duke qënë dhe forma më e rrezikshme e shfaqjes së krimit, e cila dikton dhe nevojën e përdorimit të *metodave të posaçme hetimore*. (Mujaj, 2013: 478-481)

3.2. Krimi i organizuar kërcënim global

Për të parandaluar dhe luftuar efektivisht *krimin e organizuar* dhe për të kuptuar rëndësinë e përfshirjes së metodave të posaçme hetimore në zbulimin dhe procedimin e autoreve të këtyre krimeve duhet ta trajtojmë atë dhe në aspektin kriminologjik duke kuptuar më qartë atë se çfarë është krimi i organizuar.

Termi "*krim i organizuar*" është përdorur për herë të parë në vitin 1896, në raportin vjetor të Shoqatës për Parandalimin e Krimit, në New York. Dhe i referohej pikërisht veprimtarisë së prostitucionit dhe të bixhozit, të mbrojtura nga zyrtarët publikë. (Fijnuat, Paoli, 2004: 23)

Më pas rreth *viteve 1920-1930* studiuesit bënë përpjekje për të përkufizuar konceptin e krimit të organizuar duke përfshirë në këtë grup edhe kërcënimet që u bëheshin pronarëve

dhe biznesmenëve, shërbimet e ndryshme ilegale, falsifikimin e dokumentave, trafikimin e drogave dhe të alkoleve. Por, për një kohë të gjatë krimi i organizuar vazhdoi të identifikohet me mafian italiane. Për herë të parë koncepti “*krimi i organizuar*”, u sanksionua me ligj, konkretisht në statutet federale të Amerikës, në vitin 1968. (Hysi, 2010: 275).

Me krim të organizuar nënkuptojmë aktivitetin e jashtëligjshëm të anëtarëve të mirorganizuar, një bashkim i disiplinuar dhe i angazhuar në mbështetjen e shërbimeve dhe të tregtisë ilegale, përfshirë: bixhozin, narkotikët, kërcënimet në punë si dhe aktivitete të tjera kriminale të anëtarëve të këtyre grupimeve. (Adamoli, 1998:4)

Konceptet ndaj krimit të organizuar kanë qënë nga më të ndryshmet. Përpjekje për t’i dhënë një përkufizim këtij nocioni janë bërë dhe në nivel ndërkombëtar. Në Konferencën Botërore të Ministrave “*Për krimin ndërkombëtar të organizuar*” (Napoli, 1994) u miratua deklarata politike e Kombeve të Bashkuara si dhe Plani i Veprimit Global kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar. Në këtë plan u përcaktuan gjashtë karakteristika të krimit të organizuar:

“grup i organizuar për të kryer një krim, lidhje hierarkike ose personale, të cilat i japin drejtuesit mundësi për të kontrolluar grupin, përdorim i forcës, kërcënimet dhe korrupsionit për të pasur përfitime dhe për të kontrolluar territorin ose tregun, mashtrim i të ardhurave të paligjshme dhe infiltrim në ekonominë e ligjshme, mundësi për t’u zgjeruar në ndonjë aktivitet të ri tej kufinjve kombëtar dhe bashkëpunimi me organizate të tjera ndërkombëtare.”
(Adamoli, 1998:7)

Edhe pse nuk ekziston një definicion i njehsuar për “*krimin e organizuar*”, i cili teorikisht të jetë pranuar nga të gjithë vendet e botës, mund të themi se, “*krimi i organizuar*” është një formë specifike profesionale, bashkëkohore e sjelljes kriminale, e cila esencialisht ndryshon nga format e tjera tradicionale të bashkëveprimit kriminal, si dhe nga format klasike të krimit në përgjithësi.

Mungesa e një definicioni unik, nuk ka penguar shtetet në njohjen e karakteristikave bazë, nga të cilat karakterizohen këto formacione kriminale. Duke studiuar karakteristikat, ndërgjegjësohemi për rrezikshmërinë e madhe shoqërore, që paraqesin veprimtaritë e tyre kriminale, si dhe imunitetin që ato gëzojnë ndaj përballjes me drejtësinë, falë strukturës të padëpërtueshme, që ato kanë.

3.2.1. Lufta kundër krimit të organizuar dhe nevoja për ndryshime në legjislacion

Mbledhja e informacionit të fshehtë është një funksion themelor, që kryhet në çdo shtet në interes të sigurisë kombëtare, mirëqënies ekonomike dhe të sigurisë publike. (Dyrmishi, 2011)

Në funksion të arritjes së këtyre qëllimeve shtetet u japin organeve të tyre informative kompetenca të natyrave të ndryshme. Kompetenca këto, të cilat po u keqpërdoren do të cënonin të drejtat dhe liritë themelore të qytetarëve, do të shtrembëronin të vërtetën si dhe do të cënonin demokracinë e një vendi. Në mënyrë që, e gjithë kjo të parandalohet duhet që institucionet shtetërore që merren me grumbullimin e informacionit, të veprojnë në mënyrë efikase, të përgjegjshme dhe për një garanci më shumë të mbikqyren në mënyrë periodike nga institucione të tjera të specializuara dhe të paanshme. Kontrollime të tilla, do të garantonin kryerjen e një veprimtarie nga ana e institucioneve në fjalë në përputhje të plotë me bazën ligjore dhe patejkaluar kompetencat e përcaktuara me ligj. Legjislatori shqiptar duke qënë nën presionin e të drejtës ndërkombëtare, akteve të ndryshme ndërkombëtare të ratifikuara, të cilat që nga momenti i ratifikimit konsiderohen pjesë integrale e sistemit tonë të brendshëm (neni 122 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë), ka mundësuar aplikimin e metodave të veçanta hetimore. Në nenin 20, pika 1 të "*Konventës së Kombeve të*

Bashkuara kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar" dhe dy Protokolleve shtesë të saj parashihen:

*Teknikat e veçanta hetimore "Në rast se lejohet nga parimet themelore të sistemit ligjor të brendshëm, çdo Shtet Palë duhet të marrë masat përkatëse për të lejuar përdorimin e duhur të dërgesave të kontrolluara dhe në rast se është e domosdoshme të teknikave të tjera të veçanta hetimore, siç është mbikëqyrja elektronike ose forma të tjera të saj dhe operacionet e mbuluara, brenda mundësive të tij dhe sipas kushteve të përcaktuara nga legjislacioni i tij i brendshëm"*²¹

3.3. Dinamikat e hetimeve paraprake

Legjislacioni penal shqiptar gjatë viteve ka njohur ndryshime të njëpasnjëshme, pjesë e këtyre ndryshimeve kanë qënë dhe hetimet paraprake. Kanë pësuar ndryshime organet të cilat kishin kompetencë të kryenin këto hetime si dhe me rregullat procedurale, mbi të cilat bazoheshin hetimet paraprake. (Mujaj, 2013: 6)

3.3.1. Ndryshimet, që ka njohur legjislacioni penal shqiptar, në lidhje me fazën e hetimeve paraprake.

Në periudhën e Shpalljes së Pavarësisë zbatoheshin rregullat e legjislacionit Osman, duke pasuar me zbatimin e Kodit të vitit 1928 të Mbretërisë Zogiste, ndjekur më pas nga Kodi i Procedurës Penale italiane të asaj kohe. Pas luftës u krijua një legjislacion procedural sipas modelit rus, sipas të cilit hetimet paraprake, në pjesën më të madhe, kryheshin nga Prokuroria, nga Policia (veprat penale me rrezikshmëri më të vogël) dhe hetuesia e Sigurimit të Shtetit (veprat kundër shtetit). (Islami, Hoxha, Panda, 2003: 389)

Në fillim të viteve '70 u braktis edhe modeli rus, u suprimua avokatia dhe veprimtaria hetimore u përqëndrua në Ministrinë e Brendshme. Me Kushtetutën e vitit 1974 u krijua një or-

²¹ Ligj, Nr. 8920, datë 11.07.2002, Për ratifikimin e "Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimin të organizuar ndërkombëtar" dhe dy protokolleve shtesë të saj: Fletore Zyrtare fq. 1195

gan i veçantë, *Hetuesia*, së cilës iu njoh funksioni i ndjekjes penale, duke u zhvendosur prokuroria nga ky funksion. (Islami, Hoxha, Panda, 2003: 389).

U kalua kështu në një model original, i cili e largoi edhe më shumë procedimin penal nga standartet demokratike ndërkombëtare. Ky organ u suprimua në vitin 1991. Të gjitha këto modele kishin të përbashkët pabarazinë e palëve, mohimin e të drejtës për t'u mbrojtur me avokat. Dhe caktimin e masave të sigurimit nga vetë prokurori, të pakufizuara në afat dhe të paankimueshme në gjykatë. (Islami, Hoxha, Panda, 2003: 389)

Në vitin 1990, u miratuan norma të reja procedurale, të cilat fatkeqsisht gjetën një zbatim të vakët, kjo, pasojë dhe e mendësive dhe praktikave të vjetra, që mbizotëronin në atë periudhë. Vendosja e standarteve demokratike edhe në këtë periudhë mbetej akoma një aspiratë, pasi ndryshimet e njëpasnjëshme nuk lejonin konsolidimin e këtyre standarteve. (Islami, Hoxha, Panda, 2003: 389)

Më pas, në vitin 1995 në Kodin e Procedurës Penale u vendosën rregulla në përputhje me standartet ndërkombëtare sa i përket hetimeve paraprake. U njoh roli i Prokurorit si organ i ndjekjes penale dhe u krijua Policia Gjyqësore, që deri atëherë nuk njihej as me emër. (Islami, Hoxha, Panda, 2003: 390)

Edhe kjo situatë njohu vështirësitë e veta, pasi kërkoheshin ndryshime rrënjësore të praktikave dhe koncepteve të vjetra të bazuara mbi këto praktika të përdorura për një kohë aq të gjatë. Kërkoheshin përpjekje për organizimin dhe aftësimin e Policisë Gjyqësore, për krijimin dhe konsolidimin e koncepteve të drejta mbi rolin e prokurorit në hetimet paraprake dhe ajo çka është e rëndësishme raportet e tija me Policinë Gjyqësore, si dhe ndërgjësimit mbi përgjegjësitë në zbatimin e ligjshmërisë, si dhe rritjen e profesionalizmit në krytjen e detyrave. (Islami, Hoxha, Panda, 2003: 390)

Mungesa e një tradite legislative të konsoliduar, ka bërë, që faza e hetimeve paraprake, që të paraqesë problematika të mëdha. Problematika këto, që çenojnë në mënyrë direkte standartet demokratike të një vendi.

3.3.2. Hetimet paraprake sipas legjislacionit aktual

Sipas legjislacionit aktual penal, hetimet paraprake kryhen nga Prokurori dhe Policia Gjyqësore, në përputhje me kompetencat e përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale. Hetimet paraprake përbëjnë bazën e procedimit penal. Kjo fazë është vendimtare për të zgjidhur një sërë problemesh, të procedimit penal, që konsistojnë në; fillimin e procedimit penal, caktimin e masave të sigurimit, njoftimin e akuzës, marrjen e provat, që nuk mund të përsëriten, kryerjen e kontrollimeve, sekuestrimeve dhe përgjimeve, kqyrje, ekspertime dhe eksperimentime, grumbullimin e të dhënave të nevojshme për përcaktimin e veprës penale dhe individualizimin e atij që ka kryer veprën. (Islami, Hoxha, Panda, 2003: 390) Fillimi i gabuar i një procedimi penal do të kishte pasoja negative për çështjen në fjalë, e cila do të pasohej nga dhënia e një masë sigurimi jo të drejtë, pasojë kjo e provave të grumbulluara në mënyrë jo të ligjshme ose edhe më keq akoma në pushimin e pabazuar të çështjes në fjalë. (Islami, Hoxha, Panda, 2003: 390)

3.4. Roli dhe funksionet e policisë gjyqësore, sipas Kodit Procedural në fuqi në Republikën e Shqipërisë

Policia gjyqësore është një nga subjektet e rëndësishme të procedimit penal. Roli dhe funksionet e *policisë gjyqësore* parashikohen në nenet 30-33 dhe 293- 302 të K.Pr. P.

Në këndvështrimin historik, në vitin 1995, me hyrjen në fuqi të K.Pr.Penale u suprimua struktura organizative e Hetuesisë së Prokurorisë dhe Policisë Hetimore të Ministrisë së Brendshme dhe në zbatim të ligjit Nr. 8007 datë 05.10.1995 "Për miratimin e dekretit

nr.1188 datë 10.08.1995 "Për Policinë Gjyqësore", u krijua struktura organizative dhe filloi rishtazi funksionimi i Policisë Gjyqësore. Me ligjin Nr. 8677 datë 02.11.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore" u shfuqizua dekret-ligji i lartpërmendur, me synim riorganizimin dhe ngritjen në një nivel më të lartë cilësor të punës së saj.²²

Sipas legjislacionit procedural penal, veprimtaria procedurale penale e oficerëve dhe agentëve të Policisë Gjyqësore të të gjitha strukturave kryhet nën drejtimin, kontrollin dhe urdhërat e udhëzimet e prokurorit që ka në kompetencë lëndore e tokësore të ndjekë procedimin. Kjo veprimtari kryhet sipas rregullave të caktuara në Kodin e Procedurës Penale.²³ Ligji parashikon se, nëpërmjet prokurorit edhe Gjykata ngarkon ose urdhëron Policinë Gjyqësore për kryerjen e detyrave procedurale. (Neni 33 i K.Pr.P., pika 4)

Policia Gjyqësore, gjithashtu, është e detyruar të përmbushë funksionet e saj pavarësisht nga territori dhe rrethana ku ndodhet si dhe kur ndodhet jashtë kohës së kryerjes së shërbimit.

Në zbatim të detyrave të parashikuara në nenet 30, 277 të K.Pr.P, dhe kreun *IV mbi veprimtarinë me iniciativë të Policisë Gjyqësore* si dhe *udhëzimit të përbashkët midis Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrit të Rendit* është Policia Gjyqësore²⁴ ajo që duhet të kryejë hetime për të zbuluar dhe dokumentuar në rrugë procedurale veprimtarinë kriminale të çdo subjekti të veprës penale.

Më konkretisht, bazuar në ligjin nr.10 301, datë 15.7.2010, Neni 3, "*Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore*", të ndryshuar, si dhe në Kodin e Procedurës Penale funksionet e policisë gjyqësore janë këto:

²² "Judicial Police", Marrë më http://www.gjykata.gov.al/portal_main/Police_explanation.aspx, (parë më 20.05.2014.

²³ Ligji nr. 8677, datë 2.11.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore", neni 13.

²⁴ Ligj, Nr.8677, datë 02.11.2000, Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore, ndryshuar me ligjin 10 301, datë 15.07.2010

1. Policia Gjyqësore, me cilësinë e subjektit të procedimit penal, kryen këto funksione:

a) merr dijeni për veprat penale;

b) parandalon ose pengon pasojat e mëtejshme që rrjedhin nga veprat penale;

c) kërkon autorët e veprave penale;

ç) kryen veprimet e nevojshme për të siguruar burimet e provës dhe për të grumbulluar gjithçka që i shërben zbatimit të ligjit penal;

d) kryen çdo hetim dhe veprim të urdhëruar ose të deleguar nga organi proçedues;

dh) kryen veprime proçedurale për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale;

e) kryen veprime në kuadër të marrëdhënive juridiksionale penale me autoritetet e huaja brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;

ë) kryen veprimet në zbatim të ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë";

f) kryen çdo detyrë të tjetër të parashikuar në legjislacionin në fuqi. (Ligji nr.10 301, datë 15.07.2010, Neni 3)

Funksionet e policisë gjyqësore kryen nga oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore që u përkasin, organeve, të cilëve ligji u ngarkon detyrën për të kryer hetime që nga çasti që marrin dijeni për veprën penale, nga seksionet e policisë gjyqësore të krijuara pranë çdo prokurorie rrethi dhe të përbëra nga një personel i policisë gjyqësore si dhe nga shërbimet e policisë gjyqësore të parashikuara me ligj.²⁵

Sipas *nenit 277* të K.Pr.P. organet e ngarkuara për kryerjen e hetimeve paraprake janë prokurori dhe Policia Gjyqësore. Këto dy organe, brenda kompetencave të caktuara me ligj ndërveprojnë mes tyre. Në këtë mënyrë krijohen raporte proçedurale, të cilat vihen në funksion të hetimeve paraprake. Raportet mes tyre fillojnë që nga momenti i referimit të ve-

²⁵ Neni 31 i K. Pr. P. të Rep. së Shqipërisë

prës penale (*neni 293 të K.Pr.P.*),²⁶ vazhdojnë gjatë procesit të ndjekjes penale në hetim dhe duhet të vazhdojnë derisa vendimi i Gjykatës të marrë formë të prerë, dhe në ekzekutimin e vendimeve penale.

Sipas *nenit 294* të K.Pr.P., Policia Gjyqësore edhe pas referimit të veprës penale te prokurori me iniciativën e vetë duhet të marrë dijeni për veprat penale, të pengojë ardhjen e pasojave të mëtejshme, të kërkojë autorët e tyre, të kryejë hetime dhe të grumbullojë gjithçka që i shërben zbatimit të ligjit penal. Ajo kryen çdo veprim hetimor që i është urdhëruar ose deleguar nga prokurori. Policia Gjyqësore bën sigurimin e burimeve të provave: (*neni 294 i K.Pr.Penale*)

1. Për kërkimin dhe fiksimin e sendeve dhe të gjurmëve të veprës penale.
2. Për kërkimin dhe pyetjen e personave që janë në gjendje të tregojnë rrethanat e faktit etj.

Policia Gjyqësore në bazë të *nenit 295* të K.Pr.P.²⁷ bën identifikimin e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime. Në vendin e ngjarjes ose në veprat penale të dukshme oficerët e Policisë Gjyqësore, edhe pa praninë e mbrojtësit mund të marrin ndaj personit të cilit zhvillohen hetime qoftë edhe i arrestuar në flagrancë ose i ndaluar të dhëna të nevojshme për vazhdimin e hetimeve. Policia Gjyqësore mund të kërkojë të kryhen ekspertime kur kërkohen njohuri të

²⁶ Neni 293, të K.Pr.P pika 1:

“Me marrjen e njoftimit për një vepër penale, policia gjyqësore, pa vonesë, i referohet prokurorit me shkrim, elementët thelbësor të faktit dhe elementët e tjerë, që janë mbledhur deri atëherë. Ajo njofton kur është e mundur, edhe gjeneralitetet, banesën dhe çdo gjë, që vlen për identifikimin e personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet, të personit të dëmtuar dhe atyre që janë në gjendje të tregojnë rrethanat e faktit”

²⁷ Neni 295, i Kodit të Procedurës Penale

Identifikimi i personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet

1. Për identifikimin e personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet policia gjyqësore kryen të gjitha veprimet e nevojshme, duke përfshirë edhe rievimet daktiloskopike, fotografike dhe antropometrike.
2. Kur ai refuzon të identifikohet ose jep gjeneralitete apo dokumente identifikimi që dyshohet se janë të rreme, policia gjyqësore e shoqëron në zyrat e saj dhe e mban atje për aq kohë sa është e domosdoshme për identifikimin, por jo më tepër se dymbëdhjetë orë.
3. Për shoqërimin dhe lirimin vihet menjëherë në dijeni prokurori

posaçme teknike. Ajo mund të marrë deklarime nga persona që mund të tregojnë rrethana të dobishme për qëllimin e hetimit. Policia Gjyqësore në raste të ngutshme e të flagrancës mund të kryejë kontrollime, sekuestrime mbi provat materiale dhe sendet që lidhen me veprën penale. Për sekuestrimet dhe kontrollimet si veprime proceduriale që çenojnë liritë e të drejtat e njeriut kërkohet që brenda 48 orëve të vlerësohen nga prokurori që drejton hetimin.²⁸

Në bazë të *nenit 294/2* të K.Pr.P., pas referimit të veprës penale tek prokurori, rregjistrimit të saj në rregjistrat e Prokurorisë, pra pas ndërhyrjes së prokurorit në hetim, Policia Gjyqësore kryen veprime që i janë deleguar posaçërisht nga prokurori, urdhërat e prokurorit për marrjen dhe administrimin e provave si dhe të gjitha veprimet e ngutshme që çmon Policia Gjyqësore se duhen marrë dhe administruar për të vërtetuar veprën penale.

Bazuar në *nenit 303* të K.Pr.P., Policia Gjyqësore dokumenton me procesverbal të gjitha veprimet hetimore të kryera dhe së bashku me provat materiale dhe sendet që lidhen me veprën penale i vë në dispozicion të prokurorit.

Pra sa parashikohet në legjislacionin procedural penal, Policia Gjyqësore ka barrën dhe përgjegjësinë për zbulimin, hetimin dhe dokumentimin e veprës penale. Më pas, pasi kryen veprimet e nevojshme hetimore, Policia Gjyqësore i dërgon aktet prokurorit bashkë me një relacion shpjegues për faktin dhe provat si dhe sugjerimet e veta për mënyrën e përfundimit të hetimeve. Prokurori pasi studion dosjen e procedimit penal vendos nëse duhet ose jo të dërgohet dosja për gjykim në Gjykatë.

²⁸ Neni 298, i K. Pr. P.

Sipas *nenit 304* të K.Pr.Penale,²⁹ prokurori drejton veprimtarinë hetimore dhe mund të kryejë vetë çdo veprim hetimor që e çmon te nevojshëm. Prokurori i jep urdhëra oficerit të Policisë Gjyqësore për të kryer veprime të veçanta hetimore. Këto urdhëra si rregull i jep me shkrim, por në raste të ngutshme ose të veçanta për shkak të largësisë që mund të ndodhet me oficerin e Policisë Gjyqësore mund t'i japë dhe me gojë. Ndërsa kontrolli i Prokurorit ndaj veprimtarisë hetimore të ushtruar nga policia gjyqësore, duhet të kryhet në mënyrë periodike deri në përfundim të hetimeve paraprake të një procedimi penal.

3.5. Roli i prokurorisë në hetimet paraprake, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi

Në ligjin kushtetues nr.7561, datë 29.09.1992, Prokuroria u sanksionua si një organ i pavarur nga pushtetet e tjera, unik dhe i centralizuar. Prokurori i Përgjithshëm dhe zëvendësit e tij, zgjidheshin nga Kuvendi.

Sipas *nenit 148 të Kushtetutës* së Republikës së Shqipërisë, që u miratua në Kuvend në 21 Tetor 1998, dhe me referendum në 22 Nëntor 1998, Prokuroria u sanksionua si organ kushtetues që ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq, në emër të shtetit, se prokurorët janë të organizuar dhe funksionojnë pranë sistemit gjyqësor, si një organ i centralizuar, se në ushtrimin e kompetencave të tyre ata i nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve.

Sipas *nenit 149 të Kushtetutës*, Prokurori i Përgjithshëm emërohet nga Presidenti i Republikës me pëlqimin e Kuvendit për një mandat 5-vjeçar, me të drejtë riemërimi. Ai mund të shkar-

²⁹ Neni 304, i Kodit të Procedurës Penale

1. Prokurori drejton veprimtarinë hetimore dhe kryen vetë çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm.
2. Ai mund të kërkojë nga policia gjyqësore kryerjen e veprimeve të deleguara posaçërisht, përfshirë edhe marrjen në pyetje të të pandehurit dhe ballafaqimet, në të cilat merr pjesë i pandehuri dhe mbrojtësi i tij. Në këtë rast policia gjyqësore respekton dispozitat përcaktimin dhe pjesëmarrjen e mbrojtësit në veprimet hetimore.
3. Për veprime të veçanta që duhen kryer në një rreth tjetër, kur nuk mendon të procedojë personalisht, mund të delegojë, sipas kompetencës lëndore përkatëse, prokurorin e atij rrethi. Kur ka arsye të ngutshme ose shkaqe të rëndësishme, prokurori i deleguar ka të drejtë të kryejë me iniciativën e tij çdo veprim të domosdoshëm për qëllimet e hetimit

kohet nga Presidenti i Republikës, me propozim të Kuvendit, për shkelje të Kushtetutës ose për shkelje të rënda të ligjit gjatë ushtrimit të funksioneve të tij, për paaftësi mendore a fizike, për akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e Prokurorit. Prokurorët e tjerë emërohen dhe shkarkohen nga Presidenti i Republikës me propozim të Prokurorit të Përgjithshëm. Prokurori i Përgjithshëm raporton ne Kuvend për gjendjen e kriminalitetit.

Veprimtaria e prokurorit parashikohet në Kreun V të Kodit të Procedurës Penale në nenet 304-315 si dhe në ligjin nr.8737, datë 12.2.2001”*Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë*”, ndryshuar me ligjin nr.10 051, datë 29.12.2008.

Ligji nr.8737, datë 12.2.2001”*Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë*”, rregullon në mënyrë të detajuar organizimin dhe funksionimin e prokurorisë.

Sipas këtij ligji, prokuroria organizohet dhe funksionon nën drejtimin e Prokurorit të Përgjithshëm si një strukturë e centralizuar. Aty përfshihen *Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm*,³⁰ *Këshilli i Prokurorisë*³¹ dhe *Prokuroritë pranë sistemit gjyqësor*.³²

Prokurorët në ushtrimin e detyrës u nënshtrohen Kushtetutës dhe Ligjeve si dhe i ushtrojnë kompetencat e tyre duke respektuar parimet e procedimit të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor dhe mbrojtjes të së drejtave, interesave dhe të lirive të ligjshme të njeriut.

Organet e prokurorisë janë: Prokuroria e Përgjithshme e Republikës, prokuroria pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, prokuroritë pranë gjykatave të apelit, prokuroria

³⁰ Ligji nr.8737, datë 12.2.2001”*Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë*”, Kreu III, neni 9.

³¹ Ligji nr.8737, datë 12.2.2001”*Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë*”, Kreu IV, neni 10.

³² Ligji nr.8737, datë 12.2.2001”*Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë*”, Kreu V, neni 13.

pranë gjykatës së shkallës së parë për krime të rënda dhe prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë.³³

Përfaqësimi i prokurorisë bëhet nga: Prokurori i Përgjithshëm, drejtuesit e prokurorive pranë gjykatave të apelit si dhe nga drejtuesit e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë.³⁴

Nisur nga *shkalla e hierarkisë* në prokurori, prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme janë prokurorët më të lartë, prokurorët e prokurorive pranë gjykatave të apelit, prokurorët e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë. Pas tyre vijnë, prokurorët e prokurorive pranë gjykatave të apelit, në gjykimet e çështjeve të apeluara që kanë në juridiksion, janë prokurorë më të lartë se prokurorët e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë, të cilët i përkasin atij juridiksioni. Si dhe pas tyre vijnë prokurorët pranë gjykatave të shkallës së parë, sipas kompetencës, lëndore dhe tokësore, janë prokurorë të nivelit të parë në prokurori.³⁵

Prokurori i Përgjithshëm është ai i cili qëndron në krye të të gjithë sistemit dhe strukturës së Prokurorisë. Ai është përgjegjësi kryesor për mbarëvajtjen e punëve në Prokurori si dhe për plotësimin e detyrave nga ana e saj.

Kompetencat apo detyrat kryesore të Prokurorit të Përgjithshëm konsistojnë në propozimet që Prokurori i Përgjithshëm i bën Presidentit të Republikës për përcaktimin e numrit të përgjithshëm të prokurorëve, pasi të ketë marrë mendimin e Ministrit të Drejtësisë si dhe në propozimet për emërimin, transferimin, ngritjen në detyrë dhe shkarkimin e prokurorëve. Prokurori i Përgjithshëm njëkohësisht cakton drejtuesit e prokurorive dhe zëvendësit e tyre

³³ Ligji nr.8737, datë 12.2.2001" Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", neni 3/a.

³⁴ Ligji nr.8737, datë 12.2.2001" Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", neni 3/a/2.

³⁵ Ligji nr.8737, datë 12.2.2001" Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", neni 3/b.

në Prokuroritë pranë Gjykatave, miraton strukturën, organikën dhe rregulloret e funksionimit të Prokurorive pranë Gjykatave dhe të Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, urdhëron komandimin e prokurorëve, ushtron funksionet e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Lartë, emëron dhe shkarkon punonjësit e administratës në strukturat e Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, përfaqëson Prokurorinë në marrëdhëniet me të tretët, përcakton pagesat për rastet e shpërblimit të dëshmitarëve apo për sigurimin e provave të rëndësishme për hetimet si dhe jep udhëzime për punën e Policisë Gjyqësore.³⁶

Përmes urdhërave dhe udhëzimeve, Prokurori i Përgjithshëm ushtron funksionet e lartpërmendura, të cilat përcaktohen në Kushtetutë dhe në ligje.

*Pranë çdo niveli të sistemit gjyqësor kemi edhe Prokurorinë përkatëse. Pranë Gjykatës së Lartë funksionet e Prokurorisë ushtrohen nga prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme. Prokurorët pranë Gjykatës së Lartë ushtrojnë ndjekjen penale, si dhe përfaqësojnë akuzën në gjyq kundër Presidentit të Republikës, Kryeministrit dhe anëtarëve të Këshillit të Ministrave, deputetëve, gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë.*³⁷

*Pranë Gjykatave të Apelit funksionet e Prokurorisë ushtrohen nga prokurorët e Apelit. Juridiksioni i tyre përfshin të gjithë territorin, ku shtrihet juridiksioni i Gjykatës përkatëse.*³⁸

Pranë Gjykatave të Shkallës së Parë funksionet e Prokurorisë ushtrohen nga prokurorët e shkallës së parë. Juridiksioni i tyre përfshin të gjithë territorin ku shtrihet juridiksioni i

³⁶ Ligji nr.8737, datë 12.2.2001" Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", neni 8.

³⁷ Ligji nr.8737, datë 12.2.2001" Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", neni 13.

³⁸ Ligji nr.8737, datë 12.2.2001" Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", neni 14.

Gjykatës përkatëse.³⁹ Me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm, prokurori më i lartë zhvillon hetime dhe përfaqëson akuzën si prokuror i shkallëve më të ulëta.⁴⁰

Ligji për Prokurorinë, për t'i mbrojtur prokurorët nga ndikimet e ndryshme dhe për të siguruar pavarësinë e tyre, ka dhënë shumë garanci në lidhje me ngritjen në detyrë dhe transferimin, pezullimin, largimin dhe shkarkimin e tyre nga puna. Ngritja në një detyrë më të lartë ose transferimi mund të bëhet, vetëm për nevoja dhe interes të punës nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm, pasi të jetë marrë mendimi i prokurorit. Edhe rastet e shkarkimit të tyre janë përcaktuar në mënyrë taksative në ligj. Shkarkimi bëhet vetëm si rezultat i procedimit disiplinor në qoftë se përmbushen disa kushte të caktuara dhe vetëm me vendim të Presidentit të Republikës.

Veprimtaria hetimore e prokurorit përveç ligjit të lartpërmendur, rregullohet siç e thamë, në Kreun V të Kodit të Procedurës Penale, ndërsa marrëdhëniet mes policisë gjyqësore dhe prokurorisë në fazën e hetimeve paraprake, gjejnë shprehje në Kreun III të këtij Kodi si dhe në *ligjin 8677, datë 02.11.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore"*.

Funksionet e prokurorit parashikohen në *nenin 24* të Kodit të Procedurës Penale. Sipas të cilit:

“1. Prokurori ushtron ndjekjen penale, bën hetime, kontrollon hetimet paraprake, ngre akuzë në gjykatë dhe merr masa për ekzekutimin e vendimeve në përputhje me rregullat e caktuara në këtë Kod.

2. Prokurori ka të drejtë të mos fillojë ose të pushojë procedimin penal në rastet e parashikuara në këtë Kod.

³⁹ Ligji nr.8737, datë 12.2.2001“Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 15.

⁴⁰ Ligji nr.8737, datë 12.2.2001“Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 16.

3. Kur nuk është i domosdoshëm ankimi ose autorizimi për procedim, ndjekja penale ushtrohet kryesisht.
4. Urdhrat dhe udhëzimet e prokurorit më të lartë janë të detyrueshme për prokurorin më të ulët.
5. Prokurori më i lartë ka të drejtë të vendosë ndryshimin ose shfuqizimin e vendimeve të marra nga prokurori më i ulët me ankim ose kryesisht.”

Në nenet 30 dhe 33 të Kodit të Procedurës Penale janë sanksionuar rregullat e varësisë së Policisë Gjyqësore nga Prokurori dhe konkretisht:

- Oficeri që shërben në Policinë Gjyqësore përgjigjet para prokurorit të rrethit për veprimtarinë e zhvilluar nga ai vetë dhe personeli vartës (neni33\2).
- Oficeri dhe agjentët e policisë Gjyqësore janë të detyruar të zbatojnë detyrat që u janë caktuar nga prokurori(neni 33\3)
- Seksionet e policisë varen nga drejtuesit e prokurorive të rretheve (neni33\1)

Sipas nenit 277 të K. Pr. P. dhe ligjit 8677, datë 02.11.2000, ”Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, prokurori kryen vetë hetimet dhe drejton e kontrollon Policinë Gjyqësore. Ai vihet në dijeni për çdo vepër penale dhe ka kompetencë të disponojë për çdo gjë që lidhet me hetimet paraprake. Urdhërat dhe porositë e tija janë të detyrueshme për oficerët dhe agjentët e Policisë Gjyqësore. Ato jepen nga drejtuesi i prokurorisë dhe prokurorët e tjerë. Urdhërat dhe porositë jepen me shkrim ose me gojë, sipas rastit dhe rëndësisë së tyre. Ai që do t’i zbatojë ka të drejtë që urdhëri apo porosia të jepen me shkrim. Edhe pse në ligj nuk është parashikuar, kuptohet që çdo urdhër mund të ankimohet tek drejtuesi i prokurorisë, kurse urdhërat e këtij të fundit tek Prokurori i Përgjithshëm, por ankimimi nuk e pezullon zbatimin e urdhërit.⁴¹

Sa sipër në bazë të ligjit ”Për policinë gjyqësore” neni 13 thuhet se, policia gjyqësore i kryen funksionet e saj nën drejtimin dhe kontrollimin e prokurorit të përcaktuara në detaje për të

⁴¹ Neni 277 të K. Pr. P. dhe ligji 8677 datë 02.11.2000, ”Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”.

gjitha fazat e hetimit paraprak.⁴² Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore detyrohen të njoftojnë menjëherë prokurorin për çdo vepër penale (neni 293). Për arrestimin në flagrancë, ose ndalimin e të dyshuarit për kryerjen e një krimi (neni 255), për kontrollet dhe sekuestrimet e ngutshme (nenet 202, 298, 299) të zbatojnë porositë e tij dhe të kryejnë veprimet hetimore të deleguara nga ai (neni 30, 33, 204 të K.Pr.P). Policia gjyqësore detyrohet të zbulojë veprat penale dhe të informojë menjëherë prokurorin. Por, njoftimi i veprës tek prokurori nuk duhet të pengojë kryerjen e veprimeve të ngutshme nga policia gjyqësore. Oficeri ose agjenti i policisë gjyqësore, që procedon në rastin e dhënë duhet të zbatojë kompetencat, që ka në bazë të *nenit 30 të K.Pr. P.* si para ashtu edhe pas njoftimit të veprës të prokurori duke grumbulluar dhe fiksuar çdo gjë që është e vlefshme për rindërtimin e faktit dhe identifikimin e autorit të veprës. (Islami, Hoxha, Panda, 2003:116-119) Varësia e Policisë gjyqësore nga prokurori dhe raportet midis tyre janë normuar hollësisht në ligjin *"Për policinë gjyqësore dhe në udhëzimin e përbashkët të ministrit të rendit dhe prokurorit të përgjithshëm nr.10 datë 17.01.2002. "Funksionimi i shërbimeve të Policisë Gjyqësore në policinë e shtetit"*. (Islami, Hoxha, Panda, 2003: 118)

Ka shumë rëndësi të kuptohet se bashkëpunimi i Prokurorisë me Policinë Gjyqësore është kusht i rëndësishëm për zhvillimin dhe përfundimin e suksesshëm të hetimeve paraprake. (Islami, Hoxha, Panda, 2003: 118) Ky bashkëpunim duhet të jetë konkret, i vazhdueshëm dhe efektiv. Ai mund të jetë i tillë vetëm kur prokurori informohet rregullisht dhe në kohë për veprimet e kryera nga Policia Gjyqësore, kur njihen në vazhdimësi me aktet në pro-

⁴² Ligji 8677, datë 02.11.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore", ndryshuar me ligjin, nr.10301, Dt.Aktit:15.07.2010, Dt.Miratimit:15.07.2010, Flet.Zyrtare Nr.115, Faqe: 5761.

Neni 13

"Ushtrimi i veprimtarisë gjyqësore nga oficeri dhe agjentët e saj drejtohet dhe kontrollohet nga prokurori sipas rregullave të caktuara në kodin e procedurës penale. Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore lidhur me të dhënat dhe ecurinë e hetimit duhet të përgjigjen dhe të raportojnë vetëm të prokurori kompetent".

cedimit, i kontrollon ato dhe jep detyra konkrete për plotësimin e boshllëqeve dhe ndreqjen e të metave. (Islami, Hoxha, Panda, 2003: 118)

Kjo, sa i përket, bazës ligjore që rregullon marrëdhënien e ndërsjellë mes policisë gjyqësore dhe prokurorisë në fazën e hetimeve paraprake, të cilat u trajtuan në mënyrë më të detajuar edhe më lart.

Sipas *nenit 304 të K.Pr.P.*, Prokurori drejton veprimtarinë hetimore dhe kryen vetë çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm. Ai mund të kërkojë nga policia gjyqësore kryerjen e veprimeve të deleguara posaçërisht, përfshirë edhe marrjen në pyetje të të pandehurit dhe ballafaqimet, në të cilat merr pjesë i pandehuri dhe mbrojtësi i tij. Në këtë rast policia gjyqësore respekton dispozitat përcaktimin dhe pjesëmarrjen e mbrojtësit në veprimet hetimore. Për veprime të veçanta që duhen kryer në një rreth tjetër, kur nuk mendon të procedojë personalisht, mund të delegojë, sipas kompetencës lëndore përkatëse, prokurorin e atij rrethi. Kur ka arsye të ngutshme ose shkaqe të rëndësishme, prokurori i deleguar ka të drejtë të kryejë me iniciativën e tij çdo veprim të domosdoshëm për qëllimet e hetimit.⁴³

Prokuroritë që procedojnë në hetime të lidhura⁴⁴ bashkërendojnë punën midis tyre. Për këtë qëllim shkëmbejnë akte dhe informacione si dhe njoftime për udhëzimet që i jepen policisë gjyqësore. Ato mund të procedojnë edhe bashkërisht në kryerjen e veprimeve të veçanta.⁴⁵

Prokurori fton personin ndaj të cilit zhvillohen hetime të paraqitet kur do ta marrë në pyetje ose kur duhet të kryejë veprime që kërkojnë praninë e tij.⁴⁶

⁴³ Neni 304, i K.Pr.P.

⁴⁴ Neni 306/2, i K.Pr.P.

2. Hetimet e dy prokurorive të ndryshme quhen të lidhura:

a) në rastet e bashkimit të procedimeve ose kur është fjala për vepra penale të kryera nga disa persona në dëm të njëri-tjetrit;

b) kur prova e një vepre penale ose e ndonjë rrethane të saj ndikon mbi provën e një vepre penale tjetër ose të një rrethane tjetër;

c) kur prova e disa veprave penale rrjedh, edhe pjesërisht, nga i njëjti burim

⁴⁵ Neni 306, K.Pr.P.

Në *nenin 307* parashikohen rastet kur personi që ka marrë dijeni se ndaj tij zhvillohen hetime, paraqitet vetë tek prokurori për të bërë deklaratime. Kur ai që paraqet vetë e kundërshton faktin për të cili procedohet dhe lejohet të parashtrijë shfajësimet e tij, veprimi i kryer barazohet me marrjen në pyetje. Prokurori mban procesverbal, për kallëzimet dhe ankesat e paraqitura me gojë, për këqyrjet, kontrollimet dhe sekuestrimet, për marrjen në pyetje dhe ballafaqimet me të pandehurin, për të dhënat e marra nga personat që tregojnë rrethana të dobishme për qëllimet e hetimit, për verifikimet që kanë të bëjnë me persona, sende ose vende, gjendja e të cilëve është ndryshuar.

Veprimet dokumentohen gjatë kryerjes së tyre ose menjëherë më pas, kur ekzistojnë rrethana të pakapërcyeshme që pengojnë dokumentimin aty për aty. Akti që përmban marrjen në dijeni për veprën penale dhe dokumentacioni që lidhet me hetimet, si urdhrat e porositë për policinë gjyqësore, kërkesat drejtuar gjykatës, njoftimet etj. ruhen në një fashikull të posaçëm në sekretarinë e prokurorisë së bashku me aktet e ardhura nga policia gjyqësore.⁴⁷

3.6. Kompetencat e gjykatës në hetimet paraprake

Në përputhje me sistemin e ri procedural dhe konventat ndërkombëtare, në *nenin 278* të K.Pr.P. është pranuar *kontrolli i gjykatës mbi hetimet paraprake*,⁴⁸ si garanci për zbatimin e lirive dhe të drejtave të individit në këtë fazë të procedimit. *Ndërhyrja e gjykatës bëhet me kërkesën e prokurorit, të pandehurit, të dëmtuarit, paditësit dhe të paditurit civil vetëm nga rastet e parashikuara nga ligji.*

⁴⁶ Neni 308, K.Pr.P.

⁴⁷ Neni 315, K.Pr.P.

⁴⁸ Neni 278 - Kompetencat e gjykatës në hetimet paraprake

1. *Gjatë hetimeve paraprake, për rastet e parashikuara nga ligji, mbi kërkesën e prokurorit, të pandehurit, të dëmtuarit dhe palëve private, vendos gjykata.*

2. *Të gjitha veprimet e prokurorit gjatë hetimeve paraprake shqyrtohen nga i njëjti gjyqtar.*

Është fjala për miratimin apo rivleresimin nga gjykata e akteve procedurale si dhe për shqyrtimin e ankimeve ndaj akteve të prokurorit gjatë hetimeve paraprake. Kështu masa e sigurimit, e kontrollimit, sekuestrimet e përgjimet caktohen nga gjyqtari me kërkesën e prokurorit. I pandehuri dhe mbrojtësi i tij kanë të drejtë të ankohen në gjykatë për kohëzgjatjen e paraburgimit dhe zgjatjen e afateve të hetimit paraprak nga prokurori. I dëmtuari mund të ankohet në gjykatë kundër vendimit të prokurorit për mosfillimin ose pushimin e procedimit penal. Kërkesat e prokurorit për miratimin nga gjykata të akteve më të rëndësishme dhe shqyrtimi i ankimeve në gjykatë kundër akteve të prokurorit, bëhen në gjykatën ku ka kompetencë lëndore dhe tokësore për gjykimin e çështjeve penale, në të cilat përfshihen këto akte. Ato shqyrtohen nga gjyqtari i caktuar në çdo rast konkret dhe jo nga gjyqtari i ngarkuar vetëm me këtë detyrë, që në disa legjislacione procedurale quhet "*gjyqtari për hetimet*", i cili ka të drejtë të vendosë për të drejtat e palëve gjatë hetimeve paraprake si dhe për pushimin apo dërgimin e çështjeve në gjykatë. Figura procedurale e një gjyqtari të tillë është e diskutueshme dhe përgjithësisht ajo kritikohet me arsyetimin se ai bëhet si pjesë e krahut të ndjekjes penale dhe i interesuar për mënyrën e përfundimit të hetimeve. (Islami, Hoxha, Panda, 2003: 116-119), (Mujaj, 2013:482)

Sipas legjislacionit tonë nuk egziston figura e "*gjykatësit hetues*". Por po të hedhim një vështrim në organizimin e gjykatave sipas statutit të Romës, parashikohet egzistenca e: Kryesisë, Divizionit për ankesat, Divizionit për Gjykime, Divizionit për procedurat paraprake, Zyra e Prokurorit, Sekretari. Egzistenca e Divizionit për Proçedurën Paraprake është një hallkë e ngjashme me figurën e *gjyqtarit hetues*, sanksionon në fazën e procedurës paraprake elementë të sistemit inkuizitor.⁴⁹

⁴⁹ Një nga elementet më të fortë të këtij sistemi është egzistenca e gjyqtarit hetues, e cila është figura kryesore e drejtimit të hetimeve. Qëllimi i veprimtarisë së tij dhe gjithë fazës së hetimeve është kërkimi i së vërtetës. Më

Me ligjin nr. 8813, datë 13.06.2002, në nenin 278 është shtuar një paragraf me këtë përmbajtje: "Të gjitha veprimet e prokurorit gjatë hetimeve paraprake shqyrtohen nga i njëjti gjyqtar". (Islami, Hoxha, Panda, 2003: 116-119)

Mungon përcaktimi, i rasteve kur:

- 1- Gjyqtari mund të sëmuret apo edhe të vdes edhe gjatë shqyrtimit të çështjes në themel.

Subjektet që bëjnë ankime në gjykatë janë:

Prokurori (neni 408 i K. Pr. P.), i pandehuri (neni 410 i K. Pr. P.), i dëmtuari akuzues (neni 410 i K. Pr. P.), paditësi civil dhe i padituri civil (neni 411 i K. Pr. P.), pasi ato ankohen kundër veprimeve procedurale të kryera nga prokurori gjatë hetimeve paraprake kurse kërkesa në gjykatë gjatë hetimeve paraprake zakonisht i bën prokurori pasi për disa veprime procedurale të rëndësishme gjatë hetimeve paraprake ai duhet të marrë miratimin e gjykatës, por ka raste të parashikuara nga ligji që dhe i pandehuri i drejton kërkesa gjykatës. (Karanxha, 2011)

Në bazë të nenit 15, paragrafi 2 të K.Pr.P, gjyqtari që ka vleftësuar masën e sigurimit ose çdo kërkesë tjetër të prokurorit të paraqitur gjatë hetimeve paraprake nuk mund të marrë pjesë në gjykimin e kësaj çështjeje. Ky rast është shkak për përjashtimin e gjyqtarit, prandaj në praktikë duhet patur kujdes, sepse shkelja e tij sjell me vete pavlefshmërinë e gjykimit të çështjes. (Islami, Hoxha, Panda, 2003:340)

Bazuar në përvojën e vendeve të zhvilluara të tilla si Zvicra, Franca etj., do të rekomandim përfshirjen e figurës së "gjyqtarit hetues" edhe në legjisllacionin tonë. Kjo figurë do të përbënte një garanci më shumë për një proces të rregullt ligjor.

pas ai nuk është më pjesëmarrës në gjykim, madje i ndalohet të marrë pjesë në të gjitha shkallët e tjera të gjykimit, për të njëjtin të pandehur.

3.7. Praktika të ndryshme gjyqësore

Në Shqipëri, hetimi pro-aktiv si metodë të veçantë hetimore, duke mos njohur një traditë të gjatë në përdorim, ka shfaqur problematika jo të pakta. Këto problematika, dalin në pah gjatë analizimit të praktikave të ndryshme gjyqësore, në të cilat si mjet për grumbullimin e provave, janë përdorur “*Veprimet simulese*” dhe “*Infiltrimi*”.

Nga këto kemi veçuar disa vendime:

1. *Vendimi nr. 85, datë 06.03.2013, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.*

Në ngarkim të të pandehurve V.E., K. Ç. dhe V.A., rëndon akuza e veprën penale “Falsifikim të dokumentave”, “Falsifikim të letërnjoftimeve, pasaportave dhe vizave”, si dhe të “Dhënies ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit”.

Baza Ligjore: Nenet 186/1, 189/2 dhe 298/3 të Kodit Penal.

Në përfundim të këtij vendimi *Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë*, ka vendosur:

“Prishjen e vendimit nr.25, datë 25.02.2010 të Gjykatës së Apelit Korçë dhe të vendimit nr.192, datë 08.06.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe pushimin e çështjes në ngarkim të të gjykuarve”.

Veç të tjerave dhe me arsyetimin si më poshtë:

“...Përsa i takon veprimit simulues Kolegji Penal konstaton se ka pasur provokim nga ana e punonjësit të policisë që ka simuluar. Kështu agjenti me emrin fiktiv L. Sh. me datën 14.10.2008 ka kontaktuar me shtetasin V. E. ku ka qenë i pranishëm edhe shoku i tij, V. A. Gjatë bisedës shtetasi V. E. i sqaron personit të infiltruar të gjithë mekanizmin se si do ta çonte atë në Greqi, duke i thënë dhe sa do të paguante dhe njëkohësisht i ka marrë dhe numrin e pasaportës që kishte me vete. Rezulton se agjenti i infiltruar nuk ka asistuar në kryerjen e ndonjë veprë penale përpara provokimit që i ka bërë të gjykuarit V. E.

Në lidhje me veprimet e simulimit, në çështjen Ramanauskas kundër Lituaniës GJEDNJ ka arritur në përfundimin se për të konstatuar nëse oficerët e policisë e kanë kufizuar veten për të “hetuar veprimtarinë kriminale në thelb në mënyrë pasive”, nga ana e tyre nuk duhet të

kryen veprime aktive por duhet ta hetojnë veprimtarinë kriminale në mënyrë pasive. Rasti objekt shqyrtimi në GJEDNJ kishte të bënte me mungesën e provave më të hershme në kohë se veprimi i simulimit, që të krijonin dyshimin se personi do të kryente vepër penale pa qenë i ndikuar nga oficerët.

Kështu, edhe në rastin konkret agjenti i infiltruar nuk është mjaftuar në hetimin e veprimtarisë kriminale në mënyrë pasive, por ka kryer veprime aktive, duke i kërkuar pajisjen me vizë shengen falso, kundrejt shpërblimit. Nuk rezulton që agjenti të ketë konstatuar ekzistencën e ndonjë veprimtarie kriminale të kryer nga i gjykuari me persona të tjerë, ku ky agjent të ketë pasur rol pasiv.

Nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk konstatohen prova që të provojnë se i dyshuari do të kryente vepër penale pa qenë i ndikuar nga oficerët.

Në lidhje me rregullat e marrjes së provave nga organi procedues është shprehur edhe Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr.14, datë 03.05.2011, e cila thekson se: "... Në bazë të KEDNJ-se, gjykata e ka për detyrë të vlerësojë në tërësi nëse ishte e drejtë procedura lidhur me mënyrën se si u siguruan provat.

Mënyra e marrjes së provave ka rëndësi thelbësore për zhvillimin e drejtë të procesit penal. Sigurimi i paligjshëm i provës dhe pranimi i saj nga trupi gjykues nuk mund të mos nënkuptojë që procesi ishte i parregullt. Asnjë gjykatë nuk ka mundësi, që pa dëmtuar dhënien e "përmasës së duhur të drejtësisë", të mbështetet në prova që janë marrë jo vetëm".

Prandaj, bazuar në nenin 294/a/3 të K.Pr.Penale, ky kolegji çmon se veprimet e simulimit janë të pavlefshme dhe si të tilla nuk mund të shërbejnë si provë të fajësisë së të gjykuarit".

Ky vendim është një shembull i qartë i përdorimit të "Veprimeve Simuluese", si mjet për grumbullimin e provave, të cilat janë përdorur në kundërshtim me sa parashikon ligji procedural penal, konkretisht neni 294/a/3 të K.Pr.P.

Në rastin konkret i infiltruari nëpërmjet provokimit ka nxitur një akt kriminal, i cili në të kundërt nuk do të kishte ndodhur.

Organi i akuzës, nuk ka ushtruar një nga funksionet kryesore të tij, (Neni 24/1, Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë)⁵⁰ siç është kontrollimi dhe mbikqyrja e hetimit

⁵⁰ Funksionet e prokurorit

meve paraprake dhe për më tepër nuk duhej të kalohej me pasivitet nga ana e dy shkallëve të gjyqësorit.

2. *Vendimi nr. 201 të datës 05.07.2012, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.*

Në ngarkim të të pandehurve A.B., A.Ç., A.C., D.I., E.B., E.M., dhe E.D., rëndon akuza e “Trafikimit të narkotikëve” dhe të “Trafikimit të armëve dhe municionit luftarak” të kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë.

Baza ligjore: Neni 283/a/2, 278/a/2 dhe 22 i K.Penal.

Në përfundim të këtij vendimi *Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë*, ka vendosur, ndër të tjera:

...Pushimin e gjyqësorit për të gjykuarit D. I., E. B. dhe E. D. në lidhje me akuzat e prodhimit dhe të shitjes së narkotikëve të parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal, “prodhimit dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake dhe të municionit” të parashikuar nga neni 278/2 dhe 278/3 të Kodit Penal.

Veç të tjerave dhe me arsyetimin si më poshtë:

“...18. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë konstaton se, një nga çështjet më të rëndësishme, që është pretenduar nga të gjithë mbrojtësit e të gjithë të pandehurve, si dhe është shtruar për diskutim nga të dy gjykatat e faktit është përdorimi i metodës speciale të: “Veprimet simuluese”, të parashikuar nga neni 294/a të Kodit të Procedurës, nga ana e akuzës, ku është shtruar për diskutim çështja nëse kjo metodë e posaçme hetimi është përdorur në kufijtë dhe në përputhje me kërkesat e ligjit.

19. Analizimi i përdorimit të metodës speciale të hetimit të: “Veprimet simuluese”, të parashikuar nga neni 294/a të Kodit të Procedurës, ku si person që do të kryente këto veprime për akuzën, ka shërbyer shtetasi R. Xh., vlerësohet nga ky Kolegj se ka rëndësi të madhe, për faktin se vendimet e të dy gjykatave kanë përdorur si provë kryesore për të konkluduar në fajësinë e të gjykuarve, pikërisht dëshminë e bërë nga shtetasi i mësipërm dhe në varësi të faktit nëse “veprimet simuluese” të kryera nga ky shtetas, kanë qenë apo jo në përputhje me

“Prokurori ushtron ndjekjen penale në hetime, kontrollon hetimet paraprake, ngre akuzë në gjykatë dhe merr masa për ekzekutimin e vendimeve në përputhje me rregullat e caktuara në këtë Kod”.

ligjin, do të përcaktohet edhe nëse do të ketë vlerë për t'u përdorur ose jo dëshmia e tij në këtë gjykim.

20. Kolegji Penal çmon se, përpara se të analizojë faktin nëse metoda speciale e hetimit "Veprimet simuluese", e përdorur nga akuza gjatë hetimit të kësaj çështje është marrë në kufijtë dhe sipas procedurës së përcaktuar në ligj, të bëjë një parashtrim të përmbledhur sesi ligji e ka parashikuar këtë metodë të veçantë të hetimit pro-aktiv.

21. Metoda speciale e "Veprimet simuluese" është e parashikuar nga neni 294/a të Kodit të Procedurës Penale, në të cilin thuhet:

" 1. Oficeri dhe agjenti i policisë gjyqësore ose personi i autorizuar prej tyre mund të ngarkohen për blerje të simuluar të sendeve, që rrjedhin nga një krim ose simulim i një akti korruptiv ose të kryejnë veprime të tjera simuluese, për të zbuluar të dhëna financiare ose pronësie të një personi, për të cilin ka dyshime për kryerjen e një krimi, duke fshehur bashkëpunimin me policinë ose detyrën e tyre si punonjës policie.

2. Këto veprime bëhen me autorizimin e prokurorit që kontrollon hetimet ose të prokurorit që ka në juridiksion territorin ku do të zhvillohet hetimi. Pas kryerjes së veprimeve, policia gjyqësore duhet t'i dorëzojë prokurorit të gjitha provat e mbledhura dhe një raport përmbledhës.

3. Nuk duhet provokuar një akt kriminal, duke shtyrë një person që të kryejë një krim, të cilin nuk do ta kishte kryer po të mos ishte ndërhyrja e policisë. Kur vërtetohet provokimi rezultati nuk mund të përdoret".

Nga rregullimi ligjor që ligji procedural penal i ka bërë kësaj metode speciale të hetimit rezulton se:

- a) Kjo metodë përdoret vetëm me autorizimin paraprak të prokurorit, i cili kontrollon dhe mbikëqyrë të gjitha veprimet e kryera në këtë rast;
- b) Në zbatimin e kësaj metode të veçantë hetimi, nuk lejohet provokimi i kryerjes së veprës penale, sepse në të kundërt rezultati nuk mund të përdoret;
- c) Si person i cili mund të autorizohet nga prokurori për kryerjen e kësaj metode hetimi, mund të jetë oficeri ose agjenti i policisë gjyqësore apo një person i autorizuar prej tyre;
- ç) Metoda speciale e hetimit "Veprimet simuluese" përdoret jo për të kryer çdo veprim, por vetëm për të kryer ato veprime që parashikohen në mënyrë të shprehur nga ligji (pika 1 e nenit 294/a të Kodit Procedural), veprime të cilat janë vetëm tre:
 - i) ose për blerje të simuluar të sendeve që rrjedhin nga një krim;

ii) ose për simulimin e një akti korruptiv;

iii) ose për kryerjen e veprimeve të tjera simuluese, për të zbuluar të dhëna financiare ose pronësie të një personi.

d) Kryerja e një ose disa nga veprimet e mësipërme nga ana e oficerit ose agentit të policisë gjyqësore apo të personit të autorizuar prej tyre, mund të bëhet vetëm në rastet kur ka dyshime për kryerjen e një krimi dhe jo për provokimin e një krimi siç ka ndodhur në çështjen kundër të gjykuarve.

22. Nga formulimi i kësaj dispozite duke qenë se veprimtaria e kundraligjshme e pjesëtarëve të policisë justifikohet nga mandati që ata kanë për të njohur, zbuluar dhe goditur veprimtarinë kriminale, ligjvënësi ka përcaktuar *kufijtë e ligjshmërisë duke bërë dallimin midis policit, i cili zbulon veprën penale e cila ka ndodhur (gjë që është e ligjshme) dhe policit i cili provokon një sjellje kriminale (futja në kurth) e cila nuk është e ligjshme.*

23. Duke bërë ballafaqimin e kërkesave ligjore që kërkon ligji procedural penal për zbatimin e metodës speciale të: *“Veprimet simuluese”*, me rastin konkret të përdorur nga akuza, ku si person që do të kryente këto veprime ishte shtetasi R. Xh., ky Kolegj konstaton se mënyra se si ka vepruar organi i prokurorisë është në kundërshtim me kërkesat e nenit 294/a të Kodit të Procedurës Penale me pasojë *papërdorshmërinë e rezultatit të përfutur si provë në bazë të nenit 151/4 të K.Pr.Penale.*

24. Kolegji Penal vlerëson se personi që është autorizuar nga prokurori për kryerjen e *“veprimeve simuluese”*, nuk është autorizuar për kryerjen e asnjë prej tre veprimeve të përcaktuara në germën “ç”, të analizës së bërë nga ky Kolegj në këtë vendim dhe ky person përveçse nuk ka qenë i autorizuar për kryerjen e një ose disa veprimeve të tilla edhe realisht nuk ka kryer asnjë prej veprimeve të mësipërme, por, ka kryer veprimet që i takojnë një punonjësi policie të infiltruar, rast i cili parashikohet nga neni 294/b i Kodit të Procedurës Penale.

25. Përveç kësaj shkelje të hapur ligjore, e cila e bën të papërdorshme të gjithë rezultatit e përfutur prej saj dhe për pasojë edhe dëshminë e shtetasit R. Xh. që jep të dhëna pikërisht mbi bazën e veprimeve të kryera në kundërshtim me ligjin nga ky shtetas, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vlerëson se vendimi i prokurorit për lejimin e përdorimit të metodës speciale të hetimit *“Veprimet simuluese”*, i datës 01.02.2008 është marrë në kundërshtim me ligjin, sepse në rastin konkret nuk rezulton që të jetë provuar se ekzistojnë dyshime të arsyeshme për kryerjen e një krimi, duke mos u plotësuar kështu kërkesa e përcaktuar në pikën “d” të analizës së kësaj gjykate, kërkesë e cila parashikohet në mënyrë të shprehur në pikën 1 të nenit 294/a i Kodit të Procedurës Penale.

26. Në lidhje me kufijtë e ligjshmërisë të përdorimit të metodës speciale të infiltrimit GJEDNJ-ja në çështjen *Teixeira de Castro v. Portugal 09-06-1988* është shprehur se; “Gjykata Europiane e të drejtave të Njeriut vendosi se përdorimi i agjentëve të fshehtë duhet të kufizohet dhe të vendosen garanci edhe në rastet që lidhen me luftën kundër trafikimit të narkotikëve. Ndërsa rritja e krimit të organizuar padyshim kërkon që të merren masat e duhura, e drejta për administrimin e drejtë të drejtësisë megjithatë mban një vend të rëndësishëm, të tillë që ajo nuk mund të sakrifkohet për hir të përshtatshmërisë. Kërkesat e përgjithshme të drejtësisë të mishëruara në nenin 6, të zbatohen për procedurat në lidhje me gjitha llojet e veprave penale, nga më të hapurat deri me komplekset. Interesi publik nuk mund të justifikojë prova të marra si rezultat i nxitjes së policisë. Autoritet kompetente nuk kanë pasur arsye të forta për të dyshuar se ankuesi ishte një trafikant droge”.

27. Duke iu referuar akteve dhe provave që ndodhen në dosje, rezulton se për marrjen e një vendimi të tillë, akuza nuk ka përdorur asnjë një provë ose të dhënë direkte apo indirekte që të tregonte se në këtë rast ndodhemi para dyshimeve për kryerjen e një krimi, por e ka marrë vendimin duke u bazuar vetëm në kërkesën që i ka bërë oficeri i policisë gjyqësore, e cila edhe ajo mban datën 01.02.2008. Ky qëndrim i akuzës, është i gabuar dhe i pabazuar në ligj, sepse para se ajo të vendoste përdorimin e metodës speciale të “Veprimeve simuluese”, duhej që minimumi të kishte siguruar disa të dhëna apo indicje, qoftë edhe fillestare, që tregonin se ekzistojnë dyshime për kryerjen e një krimi, pasi një kërkesë e tillë është e parashikuar në mënyrë të shprehur në ligj, dhe moszbatimi i saj, e bën të gjithë rezultatin e veprimit të paligjshëm dhe për pasojë edhe dëshminë e dhënë nga shtetasi R. Xh., i cili ka dëshmuar për fakte dhe të dhëna që janë mbledhur në mënyrë të paligjshme prej tij, e bën atë të papërdorshme. Një gjë e tillë rezulton në mënyrë të shprehur në pikën 4 të nenit 151 të Kodit të Procedurës Penale në të cilën parashikohet se: “Provat e marra në shkëlqje të ndalimeve të parashikuara në ligj nuk mund të përdoren. Papërdorshmëria ngrihet edhe kryesisht në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit”

28. Përveç sa më sipër, ashtu siç me të drejtë ka konstatuar edhe mbrojtësi i të gjykuarit D. I., në rekursin e paraqitur para Gjykatës së Lartë, ky Kolegj, duke iu referuar dëshmisë së bërë nga shtetasi Robert Xhezairaj në gjykim, si dhe procesverbaleve të përgjimeve të bisedave telefonike, vlerëson se “veprimet simuluese” të kryera nga ky shtetas, në të vërtetë nuk kanë qenë veprime që mund të kryhen sipas nenit 294/a të Kodit të Procedurës Penale, por kanë qenë veprime që kanë të bëjnë me infiltrimin e tij në grupin e personave që mund të kryenin një krim, të cilat nuk mund të kryhen kurrësi nga një shtetas i zakonshëm, siç është shtetasi R. Xh., por vetëm nga një oficer i policisë gjyqësore. Një gjë e tillë rezulton e parashikuar në mënyrë të shprehur nga pika 1 e nenit 294/b të Kodit të Procedurës Penale në të cilën parashikohet se:

“1. Për qëllimet e zbulimit të krimeve të rënda, oficeri i policisë gjyqësore, me autorizimin e prokurorit, mund të futet në përbërjen e një grupi kriminal për të individualizuar pjesëtarët e grupit dhe për të mbledhur të dhëna të nevojshme për hetimin, duke fshehur bashkëpunimin me policinë ose detyrën e vet si punonjës policie.

29. Duke iu referuar akteve dhe provave të shqyrtuara, rezultoi se ajo çfarë ka bërë shtetasi R. Xh., megjithëse me “*autorizimin*” e paligjshëm të prokurorit, nuk është gjë tjetër, veçse *infiltrimi në një grup kriminal, ku më pas, ka bërë individualizimin e personave dhe ka mbledhur të dhëna të nevojshme për hetimin, veprime që sipas akuzës janë “kurorëzuar” me sukses me arrestimin e të pandehurve, por, që këto veprime ky shtetas nuk kishte asnjë të drejtë ligjore që t’i kryente dhe për pasojë të gjitha rezultatet e ardhura prej tyre, përfshirë edhe dëshminë e tij të bëra para gjykatës, janë të paligjshme dhe nuk mund të përdoren.*

30. Dëshmia e dhënë nga shtetasi R. Xh. në gjykim, në vlerësim të këtij Kolegji, përveç ndalimeve të mësipërme ligjore, është e pabesueshme dhe nuk mund të ketë vlerë provuese në drejtim të fajësisë së të gjykuarve edhe për faktin se, ashtu siç ka arsyetuar edhe Gjykata e Shkallës së Parë në vendimin e saj, kjo dëshmi, në disa pjesë të rëndësishme, ka mospërputhje të hapur, me provat e tjera të shqyrtuara në këtë gjykim...”

“...33. Përveç sa më sipër, dëshmia e bëra nga shtetasi R. Xh., vlerësohet e dyshimtë nga ky Kolegj edhe për faktin tjetër se, ka rezultuar e provuar që ndërmjet shtetasit R. Xh. dhe familjarëve të të gjykuarit E. D., *ka pasur konflikte dhe mosmarrëveshje të mëparshme, gjë që tregon se të gjitha veprimet e bëra nga ky shtetas, megjithëse, në kundërshtim me ligjin, të mund të jenë bërë me qëllim hakmarrjen ndaj të gjykuarit E. D. dhe familjarëve të tij...*”

“... 43. Përfundimisht, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, konkludon se në lidhje me të gjykuarit D. I., E. B., E. D. dhe A. B., për sa i përket akuzave të: “*Trafikimit të narkotikëve*” dhe “*Trafikimit të armëve luftarake dhe municionit*”, të kryera në bashkëpunim dhe të mbetura në tentativë, të parashikuar nga nenet 283/a/2; 278/a/2 e 22 të Kodit Penal, duke qenë se nga ana e gjykatave të faktit, janë shkelur nenet 294/a; 294/b; 151/4 dhe 152/1 të Kodit të Procedurës Penale, në lidhje me këto akuza çështja penale në ngarkim të tyre do të pushohet, pasi ndjekja penale nuk mund të vazhdojë, konform gurmës “a” të pikës 1 të nenit 442 të Kodit të Procedurës Penale në të cilën parashikohet se: “1. Gjykata e Lartë vendos prishjen e vendimit dhe zgjidhjen e çështjes pa e kthyer për rishqyrtim kur:

a) fakti nuk parashikohet si vepër penale, vepra penale është shuar ose ndjekja penale nuk duhet të fillonte e të vazhdonte”.⁵¹

⁵¹ Vendimi nr. 201, datë 05.07.2012, i Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë.

Edhe në këtë vendim dalin qartë mangësitë e punës së organit të akuzës, i cili në formulimin e akuzës ndaj të pandehurve ka marrë si provë kryesore dhe të vetme dëshminë e qytetarit R.Xh. (në rolin e të infiltruarit).

1. Qytetari R.Xh. edhe pse ka qënë i paisur me autorizim nga prokurori për kryerjen e “*Veprimeve Simuluese*”, ai ka kryer veprime të cilat parashikohen nga neni 294/b, të cilat mund të kryhen vetëm nga një oficer i policisë gjyqësore dhe jo nga një qytetar i thjeshtë, siç ishte R.Xh.
2. Veç kësaj, qytetari R.Xh. nuk duhej të ishte përfshirë në një veprimtari të tillë, pasi egzistonte një konflikt i hershëm mes këtij qytetari dhe familjes së njërit nga të pandehurit. Duke nxitur kështu instiktin e hakmarrjes ndaj të pandehurit dhe për rrjedhojë do të kishim mungesë objektiviteti gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tij.

Veç vendimeve të sipërcituara kemi dhe vendime të tjera, në të cilat janë përdorur si mjete për grumbullimin e provave “*Veprimet Simuluese*” dhe “*Infiltrimi*”, të tilla janë:

3. *Vendimi nr. 148, i datës 09.11.2011, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.*

Në ngarkim të të pandehurve A.L., dhe E. P., rëndon akuza e kryerjes së veprës penale të “*Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve*” të kryer në bashkëpunim.

Baza ligjore: neni 283/2 i K.Penal.

Në përfundim të këtij vendimi *Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë*, ka vendosur:

“*Lënien në fuqi të vendimit nr.465, datë 25.07.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë*”

Me arsyetimin se:

“*...Duhet pasur parasysh, sikurse del qartë, se nga ndjekja e organizuar nga policia kriminale ndodheshin para dyshimeve dhe të dhënave se të dënuarit A. L. e E. P. kryenin veprimet*”

mtari kriminale në drejtim të mbajtjes dhe shpërndarjes e shitjes së lëndëve narkotike. Pra, kjo veprimtari ishte në vazhdim dhe nuk u provokua të realizohej nga punonjësi i policisë i infiltruar, pra nga shitësja F. K. e lidhur me punonjësit e policisë, por u futën persona (infiltruar) për të individualizuar pjesëtarët e grupit kriminal, për të mbledhur të dhëna të nevojshme për hetimin të ngarkuar me detyrën për blerje të simuluar të lëndëve narkotike, pra ndodhemi para një veprimtarie kriminale në vazhdim të të dënuarve dhe jo të nxitjes fillestare të kësaj veprimtarie nga personi F. K., e cila u përdor nga i infiltruari për të siguruar blerjen e simuluar duke dhënë ndihmën me bashkëpunimin e saj. Një gjë e tillë përmendet edhe në vendimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas të cilit, shërbimet e policisë gjyqësore pranë Drejtorisë së Luftës kundër Krimin të Organizuar dhe Mbrojtjes së Dëshmitarëve, pas kryerjes së një sërë veprimesh hetimore të urdhëruara nga prokurori, duke vënë në përdorim dhe përfshirjen e mjeteve speciale hetimore të parashikuara nga nenet 221 e vijues të K. Pr. Penale, bënë të mundur kapjen e të dënuarve me një sasi kokaine prej 887 gram të vendosura në dy qeska të mbuluara me natriban.

Së dyti, duhet theksuar se e gjithë veprimtaria për futjen e personave të infiltruar është bërë në përputhje me kërkesat ligjore. Duke pasur parasysh se po realizohej një veprimtari kriminale, nga ana e Drejtorisë së Policisë në datën 02.05.2006 i është bërë kërkesë prokurorit për ta autorizuar përdorimin e metodës speciale të hetimit të blerjes së simuluar dhe lejimin e përgjimit dhe po në të njëjtën datë është lëshuar autorizimi nga prokurori. Në funksion të mospranimit të pretendimeve të së gjykuarve dhe mbrojtësve të tyre se veprimet e të infiltruarve janë në kundërshtim me kërkesat e nenit 294/a të K.Pr.Penale (për të cilat gjatë shqyrtimit gjyqësor është kërkuar papërdorshmëria e tyre), janë edhe disa raporte shërbimi që bëjnë fjalë për takimet në lokalin që posedon F. K. apo në vende të tjera me F., punonjësit të policisë i prezantuar (B.) e personit të quajtur A. për sigurimin dhe blerjen e lëndës narkotike. Në to del qartë se kërkesat për blerje i ka bërë F., e cila njihej si person i interesuar për shitje të lëndës narkotike.

Nga analiza e mësipërme del se veprimet e kryera për individualizimin e pjesëtarëve të grupit kriminal dhe blerje të simuluar të lëndës narkotike, janë kryer në përputhje me kërkesat e neneve 294/a e 294/b të K. Pr. Penale, gjë që rrëzon pretendimet për shkelje të tyre, që pas sjellin papërdorshmërinë.”

Në këtë rast Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, ka vlerësuar si të drejtë metodën speciale hetimore të përdorur nga organi procedurës, e cila është zhvilluar në përputhje të plotë me bazën ligjore, duke sjellë si rezultat zbulimin dhe goditjen në kohë të këtij aktiviteti kriminal, i cili ishte në vazhdim nga të pandehurit. Element ky, i domosdoshëm bazuar dhe në çështjen *Ramanauskas kundër Lituaniës të GJEDNJ*.

4. *Vendimi nr. 17, i datës 19.01.2012, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.*

Në ngarkim të të pandehurit E. H., rëndon akuza *“Për kryerjen e veprës penale të trafikimit të lëndëve plasëse, djegëse, helmuese dhe radio aktive”*, kryer në bashkëpunim, si dhe të *“Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve dhe municioneve luftarake”*,

Baza ligjore: nenet 282/a/2, 278/2 të K.Penal.

Si dhe në ngarkim të të pandehurve Sh.Gj. dhe A. M., rëndon akuza *“Për kryerjen e veprës penale të trafikimit të lëndëve plasëse, djegëse, helmuese dhe radioaktive”*, kryer në bashkëpunim.

Baza ligjore: neni 282/a/2 i K.Penal.

Si dhe në ngarkim të të pandehurit H. H., rëndon akuza për kryerjen e veprës penale të *“Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve dhe municioneve luftarake”*,

Baza ligjore: neni 278/4 i K.Penal

Në përfundim të këtij vendimi *Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë*, ka vendosur:

“Prishjen e vendimit nr.17, datë 24.03.2009 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit nr.74, datë 24.12.2008 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë”

Me arsyetimin, ndër të tjera se:

“... Kolegji Penal e gjen të paprovuar pretendimin e të gjykuarit Glerjan Hyseni se veprën penale e ka kryer i provokuar nga oficerët e policisë gjyqësore, çka i bën të papërdorshme rezultatet e këtij veprimi procedural. Në bazë të akteve të fashikullit rezulton se nga ana e organit të akuzës janë zbatuar kërkesat procedurale të parashikuara në nenin 294/a të K.Pr.Penale. Oficerët e policisë gjyqësore kanë vepruar në bazë të autorizimit paraprak të lëshuar nga prokurori që kontrollonte hetimin në bazë të të dhënave paraprake që disponoheshin për përfshirjen e këtij të gjykuari në veprimtarinë e kundraligjshme të prodhimit dhe mbajtjes së armëve luftarake. Kalimi në hetimin proaktiv nëpërmjet veprimit të blerjes së simuluar është kryer mbasi organi i akuzës ka patur të dhëna për këtë të gjykuar në bazë të përgjimeve telefonike të autorizuara se ishte i përfshirë në shitblerjen e armëve luftarake. Ky

fakt i provuar hedh poshtë pretendimin për nxitje nga ana e oficerëve të policisë gjyqësore duke provokuar një akt kriminal me pasojë papërdorshmërinë e akteve procedurale të përfutuara nga veprimi simulues...”

Edhe në këtë vendim, organi i akuzës, përmes hetimit proaktiv, ka arritur të godasë krimin e organizuar. Hetimi pro-aktiv është ngritur mbi bazën e të dhënave paraprake, që organi procedurës dispononte për të pandehurit në këtë gjykim. Ky fakt është vlerësuar dhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.

5. *Vendimi nr. 264, i datës 10.10.2012, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.*

Në ngarkim të të pandehurve M. R., E. B., K. T., rëndon akuza për veprën penale të *“Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”*, në bashkëpunim.

Baza ligjore: neni 283/2 i K.Penal.

Si dhe të të pandehurit L. C., në ngarkim të të cilit rëndon për veprën penale të *“Moskallëzimit të krimit”*

Baza ligjore: neni 300/1 i K.Penal.

Në përfundim të këtij vendimi *Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë*, ka vendosur:

“Lënien në fuqi të vendimit nr.537, datë 06.11.2009 të Gjykatës së Apelit Vlorë”.

Me arsyetimin, ndër të tjera se:

“...14. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë çmon se vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë është marrë në zbatim të drejtë të ligjit procedural dhe atij material penal dhe si i fillë duhet të lihet në fuqi.

15. Nga shqyrtimi gjyqësor në të dy shkallët e gjykimit në bazë të akteve të hetimit të cilat janë pranuar si prova për shkak të procedimit me formën e gjykimit të posaçëm, atë të gjykimit të shkurtuar, është provuar plotësisht fakti penal dhe autorësia e të gjykuarve në pjesmarrjen e tyre në një veprimtari të kundraligjshme penalisht të dënueshme.

16. Në bazë të provave të pranuar për shqyrtim, siç janë: procesverbali i kapjes në flagrancë, procesverbali i kqyrjes së automjetit, procesverbali për sekuestrimet e provave materiale, procesverbali për kqyrjeve të telefonave celularë të përdorur prej të gjykuarve, akti i ekspertimit kimik, procesverbali i përgjimit të bisedave telefonike, deklaratimet e të

gjkumarve K. T. dhe M. R.; provohet se të gjykuarit kanë bashkëpunuar për mbajtjen dhe shitjen e një sasive të lëndës narkotike cannabis sativa në mënyrë të kundraligjshme për qëllime fitimi.

17. *Kolegji Penal e gjen të paprovuar pretendimin e të gjykuarit E. B. se veprën penale e ka kryer i provokuar nga oficerët e policisë gjyqësore, ç'ka i bën të papërdorshme rezultatet e këtij veprimi procedural. Në bazë të akteve të fashikullit rezulton se nga ana e organit të akuzës janë zbatuar kërkesat procedurale të parashikuara në nenin 294/a të K.Pr.Penale.*

18. *Oficerët e policisë gjyqësore kanë vepruar në bazë të autorizimit paraprak të lëshuar nga prokurori që kontrollonte hetimin në bazë të të dhënave paraprake që disponoheshin për përfshirjen e këtij të gjykuari në veprimtarinë e kundraligjshme të mbajtjes dhe shitjes së lëndëve narkotike. Kalimi në hetimin proaktiv, nëpërmjet veprimit të blerjes së simuluar, është kryer mbasi organi i akuzës ka patur të dhëna për këtë të gjykuar në bazë të përgjimeve telefonike të autorizuar, se ishte i përfshirë në shitblerjen e lëndës narkotike. Ky fakt i provuar hedh poshtë pretendimin për nxitje nga ana e oficerëve të policisë gjyqësore duke provokuar një akt kriminal me pasojë papërdorshmërinë e akteve procedurale të përfutuara nga veprimi simulues...”*

Edhe në këtë vendim Kolegji Penal të Gjykatës së Lartë ka vlerësuar si në përputhje të plotë me ligjin përdorimin e hetimit pro-aktiv nga ana e organit të akuzës, duke hedhur poshtë pretendimet e të pandehurve për nxitje nga ana e oficerëve të policisë gjyqësore dhe si rrjedhojë papërdorshmërinë e rezultateve të përfutuara nga hetimi pro-aktiv, si mjet për marrjen e provave. Kjo, pasi organi i akuzës kishte patur të dhëna paraprake në lidhje me përfshirjen e të pandehurve në veprimtari të tjera shitblerjeje të lëndëve narkotike.

Në çështjet e sipërcituara, por edhe në çështje të tjera kemi përdorimin e “*Veprimeve simuluese*” ose/dhe “*Infiltrimit*”, kryesisht në çështje të “*Trafikimit të armëve*”, “*Trafikimit të lëndëve plasëse, djegëse, helmuese dhe radioaktive*”, dhe të “*Falsifikim të dokumentave*”.

Siç vihet re, praktikat tona gjyqësore nuk njohin përdorim të këtyre mjeteve hetimore në çështje të tjera të cilat nuk mund të themi se janë inegzistente, mund të përmendim: *krimin*

kibernetik me të gjitha format e shfaqjes së tij, korrupsionin, trafikimin e qënieve njerëzore etj. Ajo që duam të themi është se, shtrirja e hetimeve pro-aktive deri tani ka një fuqishëveprim të kufizuar. Kjo, mbase vjen si pasojë e mungesës së një rregullimi të detajuar legjislativ apo nga mungesa e një trajnimit të posaçëm të oficerëve të policisë gjyqësore për t'u përfshirë në çështje të tjera. Ligjet penale, agjencitë e forcave të ligjit, prokuroritë dhe gjykatat, normalisht janë strukturuar dhe shpesh veprojnë vetëm brenda kufijve të një vendi. (Udhëzues për bashkëpunimin ndërkombëtar, 2010:12) Duke qënë se krimi tashmë nuk ngelet brenda kufinjve të territorit të një shteti, përbën një sfidë të rëndësishme ndaj aftësisë së vendeve për të hetuar dhe ndjekur penalisht (Udhëzues për bashkëpunimin ndërkombëtar, 2010:12) krimet transkufitare. Ka faktorë të shumtë praktikë dhe politikë që mund të pengojnë bashkëpunimin ndërkombëtar në hetimet dhe ndjekjet penale. Këto përfshijnë sfidat e komunikimit me homologët të cilët flasin tjetër gjuhë, dallimet midis traditave juridike, politike dhe kulturore, argumentet politike dhe madje, hezitim për të bashkëpunuar me kolegët e një vendi tjetër. Por, përkundër sfidave të shumta, ka edhe avantazhe të rëndësishme. Përmes ligjeve kombëtare dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, shumica e vendeve kanë vënë në zbatim një varg instrumentesh që mund të përdoren nga agjencitë e drejtësisë penale për të mundësuar bashkëpunimin përtej kufijve, në çështjet penale. (Udhëzues për bashkëpunimin ndërkombëtar, 2010:12)

Edhe vetë koncepti i *hetimit të fshehtë* (nenin 14) është i tillë, që të përfshihet në fushën e kriminalitetit transkufitar të organizuar, ku hetuesit e kanë shpesh të nevojshme të veprojnë me mbulesë, nën një identitet të rremë: në këtë rast ata kryejnë atë që quajmë "*hetim i fshehtë*". Në paragrafin e parë të nenit 14 parashikohet, që:

"Shteti anëtar kërkues dhe Shteti Anëtar i kërkuar mund të merren vesh për t'i dhënë njeri-tjetrit ndihmesë të ndërsjellë për kryerjen e hetimeve penale edhe nëpërmjet agjentëve, të cilët veprojnë fshehurazi dhe me identitet të rremë (hetime të fshehta)".

Autoritet e shtetit të kërkuar vendosin për çdo lloj rasti për përgjigjen që i duhet dhënë kërkesës duhet respektuar legjislacionin kombëtar të këtij shteti. Në rast përgjigjeje positive, të dy shtetet merren vesh në lidhje me kohëzgjatjen dhe modalitetet e hetimit.

Në këto raste zbatohet legjislacioni në fuqi në territorin e shtetit, ku zhvillohet operacioni i fshehtë. Por asgjë nuk e pengon shtetin kërkuar të bashkëpunojë me shtetin e kërkuar për përgatitjen dhe ekzekutimin e hetimit. Këtu kërkohej tre raste të ndryshme bashkëpunimi:

1. Vazhdimi i një infiltrimi dhe në territorin e një shteti tjetër;
2. Huazimi i një agjenti të huaj nën mbulim me qëllim, që të infiltrohet në territorin e tij;
3. Një infiltrim në territorin e shtetit të kërkuar i kryer nga një agjent sekret i këtij shteti, me kërkesë të shtetit kërkuar.

- Ajo çfarë na shqetëson është fakti nëse:

1. Baza ligjore, që rregullon hetimet e fshehta në legjislacionin tonë i përgjigjet nevojave për goditjen e krimit transkufitar.
2. Shtetet të cilat gëzojnë një rregullim ligjor të plotë, në këtë aspekt (i referohemi këtu modelit zviceran) në rast të një nevoje bashkëpunimi të mundshëm në territorin tonë shtetëror, a do të pranonin të bashkëpunonin me autoritetet tona proceduese, duke qënë përpara një rregullimi ligjor, të pamjaftueshëm (sipas gjyqimit tonë) dhe duke u ndodhur përpara një tradite jo të gjatë në përdorimin e këtij mjete të posaçëm hetimor?

Duke konkluduar, do të thoshim se praktikatat e ndryshme gjyqësore të trajtuara më lart, janë një tablo e qartë e anëve positive, por dhe atyre negative që ka paraqitur metoda e posaçme hetimore, e kryer përmes “*Veprimeve Simuluese*” dhe “*Infiltrimit*”. Kemi vendime të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, të cilat në arsyetimet e tyre kanë trajtuar veprimtarinë e

agjentëve të fshehtë si jo të ligjshme, pasi kanë vepruar në kapërcim të kufinjve të ligjshmërisë, kemi gjithashtu një konfuzion mes aktiviteteve (“Veprimeve simuluese” dhe “Infiltrimit”) dhe rrjedhimisht dhe mes subjekteve (të cilët janë të ndryshëm dhe si të tilla parashikohen në nenet 294/a dhe 294/b të K.Pr.P).⁵²

Është ngushëllues fakti, që këto problematika janë kapur, trajtuar dhe ndëshkuar (duke mos përdorur rezultatet e hetimeve të kryera në kundërshtim me ligjin) nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në ushtrim të funksionit të tyre për dhënie të drejtësisë, por na ligëson fakti, që këto problematika të kenë kaluar pa u vënë re nga dy shkallët e tjera të gjyqësorit, si dhe nga organi procedurës, që duhej të ishte “gjyqtari” i parë i fakteve të grumbulluara nga oficeri i policisë me autorizimin e tij.

⁵² Vendimi nr. 85, datë 06.03.2013, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.

KAPITULLI IV: FIGURA E AGJENTIT TE INFILTRUAR

4.1. Metoda e posaçme e hetimit paraprak dhe kufinjte e ligjshmërisë

Sot në të gjitha vendet, kryesisht në çështjet e trafikut të drogës, ku denoncimet janë shumë të rralla, policët përdorin procedura aktive (flasim për hetim pro-aktiv), ata infiltrohen në rrjete dhe u propozojnë anëtarëve të tyre që të blejnë ose të shesin drogë. (Pradel, 2008: 261).

Përdorimi i kësaj metodë hetimore edhe në shtetet e tjera ka shfaqur probematika jo të pakta. *Pika më delikate e këtyre hetimeve qëndron në kufirin e brishtë, që egziston mes të “ligjshmes” dhe të “paligjshmes”.* Në lidhje me kufijtë e ligjshmërisë të përdorimit të metodës speciale të infiltrimit GJEDNJ-ja në çështjen *Teixeira de Castro v. Portugal* 09-06-1988 është shprehur se,

*“Gjykata Europiane e të drejtave të Njeriut vendosi se përdorimi i agentëve të fshehtë duhet të kufizohet dhe të vendosë garanci edhe në rastet që lidhen me luftën kundër trafikimit të narkotikëve. Ndërsa rritja e krimit të organizuar padyshim kërkon që të merren masat e duhura, e drejta për administrimin e drejtë të drejtësisë megjithatë mban një vend të rëndësishëm, të tillë që ajo nuk mund të sakrifkohet për hir të përshatshmërisë. Kërkesat e përgjithshme të drejtësisë të mishëruara në nenin 6, të zbatohen për procedurat në lidhje me gjitha llojet e veprave penale, nga më të hapurat deri me komplekset. Interesi publik nuk mund të justifikojë prova të marra si rezultat i nxitjes së policisë. Autoritet kompetente nuk kanë pasur arsye të forta për të dyshuar se ankuesi ishte një trafikant droge”.*⁵³

Në një vendim të vitit 1998, GJEDNJ vë përballë agentit të thjeshtë të infiltruar dhe agentin, që është në rolin e agentit provokues.

⁵³ Vendimi i GJEDNJ 9.06.1998, *Teixeira de Castro vs Portugal*, paragraph 36; Vendimi i GJEDNJ 22. 07. 2003, *Edward et Lewis vs Royaume-Uni*, paragraph 49; Vendimi i GJEDNJ 15 .12. 2005. *Vanyan vs Russie*, paragraf 49; Vendimi i GJEDNJ 05.02. 2008. *Ramanauskas vs Lituania*, RSC 2008, 694, obs. J.–F. Margue-Naud, për një prokuror, që bie në kurthin e një polici që i kishte dhënë para në këmbim të lirimit të një personi të tretë.

Më konkretisht ajo e pranon agjentin e infiltruar, kur natyra e veprës e justifikon atë duke shtuar se “*interesi publik nuk do ta justifikonte përdorimin e elementeve të siguruara nëpërmjet një provokimi policor.*”

Kështu jurisprudenca europiane bashkohet me të drejtat e brendshme (legjislative dhe / ose jurisprudenciale): në momentin që policët “ushtrojnë një influencë, e cila e nxit të pandehurin të kryejë një vepër”, në vend që “të kufizohen në shqyrtimin pasiv të aktivitetit kriminal”⁵⁴ ata nënvlerësojnë parimin e procesit të rregullt ligjor” që aplikohet në procedurat, për të gjitha tiparet e veprave kriminale, nga më të thjeshtat deri tek më të ndërlikuarat”⁵⁵. Parimi i ligjshmërisë aplikohet edhe për provat e mbledhura si rezultat i një kurthi “privat”, që ngrihet nga një individ dhe jo nga një hetues, kur i ashtëquajhuri individ nuk vepron në emër të shtetit. (Mujaj, 2013:484)

Legjislacionet e vendeve të ndryshme bëjnë dallimin mes policit që synon vetëm të nxjerrë në pah veprën penale, që individi e ka kryer tashmë (gjë që është e ligjshme), dhe policit që nëpërmjet provokimit synon të krijojë një vepër penale (gjë që është e paligjshme). (Pradel, 2008: 261)

Ky dallim është i përcaktuar qartë edhe në dispozitat e *neneve 294\ a dhe 294\ b*, por kjo nuk ka shmangur konfondimin e këtyre roleve gjatë vënies në praktikë të kësaj metode hetimore, në Shqipëri. Në *vendimi nr.201 të datës 05.07.2012*, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë është shprehur:

⁵⁴ Vendimi Teixeira, i sipërcituar. Shih edhe GJEDNJ 26 .10. 2006; Khoudobine vs Russie, dënim i Rusisë për shkak të një delikti të provokuar nga policia dhe 07.09. 2004, Eurofinacom vs France, rregullsia e procedurës në të cilën dyshimet e policit bazoheshin në “elemente konkrete, që tregonin fillimin e kryerjes së veprës penale”

⁵⁵ GJEDNJ 06.04. 2006, Shannon vs Royaume- Uni, aktor anglez i dënuar se i kishte dhënë drogë një gazetari, që i kishte ngritur një kurth duke u hequr si sheik që kërkonte kokainë.

“...se mënyra se si ka vepruar organi i prokurorisë është në kundërshtim me kërkesat e nenit 294/a të Kodit të Procedurës Penale me pasojë papërdorshmërinë e rezultatit të përfutur si provë në bazë të nenit 151/4 të K.Pr.Penale.”⁵⁶

Kolegji Penal vlerëson, se personi që është autorizuar nga prokurori për kryerjen e “veprimeve simuluese”, nuk është autorizuar për kryerjen e asnjë prej tre veprimeve të përcaktuar në germën “ç”, të analizës së bërë nga ky Kolegj në këtë vendim dhe ky person përveçse nuk ka qenë i autorizuar për kryerjen e një ose disa veprimeve të tilla edhe realisht nuk ka kryer asnjë prej veprimeve të mësipërme, por, ka kryer veprimet që i takojnë një punonjësi policie të infiltruar, rast i cili parashikohet nga neni 294/b i Kodit të Procedurës Penale. Përveç kësaj shkelje të hapur ligjore, e cila e bën të papërdorshme të gjithë rezultatit e përfutur prej saj dhe për pasojë edhe dëshminë e shtetasit R. Xh. që jep të dhëna pikërisht mbi bazën e veprimeve të kryera në kundërshtim me ligjin nga ky shtetas, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vlerëson se vendimi i prokurorit për lejimin e përdorimit të metodës speciale të hetimit “Veprimet simuluese”, i datës 01.02.2008 është marrë në kundërshtim me ligjin, sepse në rastin konkret nuk rezulton që të jetë provuar se ekzistojnë dyshime të arsyeshme për kryerjen e një krimi, duke mos u plotësuar kështu kërkesa e përcaktuar në pikën “d” të analizës së kësaj gjykate, kërkesë e cila parashikohet në mënyrë të shprehur në pikën 1 të nenit 294/a i Kodit të Procedurës Penale”.⁵⁷

Vendimi i sipërcituar, dëshmon qartë problematikat që paraqet vënia në praktikë e “Veprimeve simuluese” dhe “Infiltrimit”. Në praktika të ndryshëm gjyqësore, në të cilat si mjet për grumbullimin e provave janë përdorur “Veprimet simuluese” dhe “Infiltrimi”, kanë qënë shpesh objekte kontestimi nga ana e mbrojtësve të të pandehurve, pikërisht

⁵⁶ Neni 151/4 K.Pr.Penale – Marrja e provave- Provat e marra në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji nuk mund të përdoren. Papërdorshmëria ngrihet edhe kryesisht në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit.

⁵⁷ Vendimi nr. 201, datë 05.07.2012, i Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë.

“ligjshmëria e veprimtarisë së agjentëve të fshehtë” dhe rezultateve të përfuara nga kjo veprimtari.⁵⁸ Kjo na bën të mendojmë që jemi përpara mosrespektimit korrekt të ligjit, nga ana e organeve proceduese gjatë ushtrimin e aktivitetit të fshehtë. Edhe pse, kjo dispozitë është e re në vendin tonë, qëllimi i kryerjes së këtyre veprimeve nga oficeri i policisë gjyqësore synon në zbulimin e autorëve të veprave penale dhe të strukturës kriminale të grupit apo organizatës kriminale. Prandaj simulimi i një akti kriminal duhet të dallohet nga provokimi i kryerjes së një krimi. Nga interpretimi i dispozitës del qartë se oficeri policisë gjyqësore, *duhet të jetë përballë një ofertë egzistuese*, duhet të konstatojë egzistencën e një veprimtarie kriminale dhe këtu ai mund të futet dhe të kryejë blerjen e simuluar nga grupet kriminale. Pra, në zbatimin e kësaj metode të veçantë hetimi, nuk lejohet provokimi i kryerjes së veprës penale, sepse në të kundërt rezultati nuk mund të përdoret. (Mujaj, 2013: 6-13)

4.2. Subjektet procedurale garante të ligjshmërisë

Duke iu referuar neneve 304-315 të K.Pr.P, trajtojmë funksionet dhe kompetencat e subjekteve procedurale. Vërejmë, se detyra e subjekteve procedurale çdo ditë përbëhet nga një ritual, që ka të bëjë me zbulimin dhe procedimin e veprave kriminale. Pra, prokurorin si subjekti, që merret me hetimin dhe kontrollimin e hetimeve paraprake fillimisht e shohim në rolin e hetuesit, të një çështjeje penale për të cilën hetimi tashmë ka filluar. Prokurori mbledh provat, i shqyrton ato dhe vendos nëse janë ose jo të mjaftueshme për të ngritur një akuzë. Ai ka përgjegjësinë fillestare, të përcaktojë nëse provat mund ta mbështesin akuzën

⁵⁸ Në lidhje me rregullat e marrjes së provave nga organi procedues është shprehur edhe *Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr.14, datë 03.05.2011, e cila thekson se:*

“...Në bazë të KEDNJ-se, gjykata e ka për detyrë të vlerësojë në tërësi nëse ishte e drejtë procedura lidhur me mënyrën se si u siguruan provat.

Mënyra e marrjes së provave ka rëndësi thelbësore për zhvillimin e drejtë të procesit penal. Sigurimi i paligjshëm i provës dhe pranimit të saj nga trupi gjyqësor nuk mund të mos nënkuptojë që procesi ishte i parregullt. Asnjë gjykatë nuk ka mundësi, që pa dëmtuar dhënien e “përmasës së duhur të drejtësisë”, të mbështetet në prova që janë marrë jo vetëm”.

penale dhe nëse janë të mjaftueshme për ta dërguar të pandehurin para gjykatës. Nisur nga përmbajtja e neneve 327, 328 dhe 331 të K.Pr.P-së prokurori ka kompetencë për të vendosur, si shkallë e parë e shqyrtimit, nëse provat janë të mjaftueshme për të çuar më tej çështjen. Prokurori ka peshën e të qenit “gjyqtar”, ai duhet të procedojë me hetimin sikur të ishte një arbitër i paanshëm dhe i pandikuar. (Udhëzues për hetimin e korrupsionit dhe krimit financiar, 2010) Në momentin kur akuza është ngritur dhe çështja dorëzohet në gjykatë, prokurori merr një tjetër pozicion, atë të *palës në proces*. Këtu jemi përballë përfaqësuesit të shtetit në një proces gjyqësor penal. Sigurisht, duke qënë përfaqësues i shtetit detyra e prokurorit është të kërkojë “drejtësi” dhe drejtësi do të thotë në disa raste se çështja nuk duhet të vazhdojë më tej, por të pushohet në mungesë të provave të mjaftueshme për të mbështetur akuzën. Prokurori duhet të karakterizohet nga një bindje e fortë dhe e palëkundur mbi akuzën e ngritur, bindje kjo që mbështetet nga prova të mjaftueshme dhe të pakontestueshme.

Do të ishte me vend të propozonim një plotësim legjislacioni në këtë aspekt, duke marrë si model Statutin e GJNP (Gjykatës Ndërkombëtare Penale).⁵⁹ *Sipas këtij Statuti, prokurori nuk është thjesht pala, që përfaqëson akuzën, por ai është i detyruar të kërkojë, të mbledhë dhe t'i kalojë palës mbrojtëse çdo provë shfajësuese për të akuzuarin. Pra, prokurori vepron më tepër si një “organ i drejtësisë”, sesa si një palë e mirëfilltë në gjykim.* (Pradel, 2008)

Sipas legjislacioni shqiptar, organi i prokurorisë është aktori i vetëm, i cili ka kompetencën të kontrollojë hetimet paraprake (përfshirë bërjen e rastet, kur me kërkesë të palëve ndërhyjnë dhe gjykata). Vërejmë një mori kompetencash, që ligji procedural penal ia atribuon prokuro-

⁵⁹ Në bazë të nenit 54\1 të Statutit të GjNP, Prokurori:

Në mënyrë, që të zbulojë të vërtetën i zgjeron hetimet për të mbuluar të gjitha faktet dhe provat përkatëse për të vlerësuar a egziston përgjegjësia penale sipas Statutit, dhe duke bërë këtë heton rrethanat inkriminuese dhe ato shfajësuese në mënyrë të barabartë.

rit gjatë hetimeve paraprake. Kompetenca këto, që duhet të njohin një limit të vendosur qartë në ligj. Pasi prokurorin në një hetim paraprak e shohim një herë si hetues, më pas si “gjyqtar” (në momentin kur ai vlerëson provat e grumbulluara, nëse ato janë të mjaftueshme për të dërguar çështjen për gjykim) dhe në fund si një palë në proces apo e thënë ndryshe si avokati i shtetit apo të palës së dëmtuar. I vetmi pozicion në të cilin e kemi të pamundur ta shohim prokurorin është si organ i drejtësisë. Të jesh organ i drejtësisë do të thotë të jesh i paanshëm, të gjykosh me objektivizëm. Pozicion ky, në të cilin nuk na ndodh të shohim prokurorët shqiptarë. Prokurori shqiptar është avokat i njëjës palë (shtetit apo palës së dëmtuar) dhe rotor i mbi të cilin ata e nisin punën e tyre është nga prezumimi apo nga teoria, sipas të cilës i pandehuri është fajtor për krimin për të cilin ai po hetohet. Nuk e shohim si pjesë të karakterit profesional të prokurorit të nisur nga prezumimi i pafajësisë, i cili është një parim kushtetues (neni 30) “*Kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë*” (neni 30, Kushtetuta e Rep. Shqipërisë), që gjen shprehje dhe në Konventën Europiane të të Drejtave të njeriut (neni 6\2).

*“Çdo person i akuzuar për një vepër penale, prezumohet i pafajshëm, deri sa fajësia të provohet ligjërisht”.*⁶⁰

Duke vënë theksi mbi atë që është dhe më primarja “të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”, mendojmë se duhet përfshirë gjykata në çdo hap të hetimeve paraprake, Pasi vetëm nën kontrollin e organit gjyqësor do të garantohej drejtësia. (Mujaj, 2013: 6-13)

⁶⁰ Konventa Europiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, neni 6\2, “E drejta për një proces të rregullt”

4.3. Kontrollat paralele, që prokuroria duhet t'i bëjë veprimtarisë së agjentit të infiltruar

Sipas të drejtës penale, prokuroria është organ shtetëror, të cilit i është besuar funksioni i ndjekjes penale në procedurë për vepra penale të cilat ndiqen kryesisht dhe me kallëzim, si dhe një varg të drejtash dhe detyrash të tjera në procedurën penale dhe jashtë saj. Në relacion me respektimin dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, prokurori posedon autorizime të rëndësishme në fushën e ndjekjes penale në përgjithësi, e veçmas si iniciator dhe subjekt në procedurën penale. Këto autorizime të prokurorit si organ shtetëror i takojnë edhe liritë dhe të drejtat e njeriut dhe si palë në procedurën penale është në pozitë që të vëjë barazpeshë midis kërkesës për ushtrimin e detyrës së mbrojtjes së lirive dhe të drejtave në një anë, dhe të iniciojë kufizimin apo privimin e lirive dhe të drejtave në procedurë penale, në anën tjetër. (Salihu, 2011:99)

Autorizimet e dyfishta të prokurorit lidhur me liritë dhe të drejtat e njeriut, kanë imponuar kërkesën, që në të drejtën ndërkombëtare, të përcaktohen normat juridike, si dhe norma etike dhe standarte me qëllim të ushtrimit të funksionit të prokurorit në mënyrë efikase të ligjshme, të pavarur, dhe autonome. Gjithashtu këto norma, kanë për qëllim, që në aspektin e lirive dhe të drejtave të njeriut, prokurori t'i kontribuojë, gjykimin të drejtë dhe respektimit të prezumcionit të pafajësisë, të drejtës për gjykim të paanshëm dhe për gjykatë të pavarur. (Salihu, 2011:99)

Respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut, të cilat ndërlidhen ngushtë me funksionin e prokurorisë, janë paraparë në mënyrë shprehimore dhe mjaft hollësisht në parimet lidhur me rolin e prokurorit, të aprovuar në *Kongresin e VIII të Kombeve të Bashkuara për parandalimi-*

min e kriminalitetit dhe Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në vitin 1990. (Salihu, 2011:99)

Sasipër, sipas të drejtës penale ndërkombëtare veprimtaria e punonjësit të infiltuar në organizata të ndryshme kriminale nuk mund të bëhet jashtë kontrollit të prokurorit.

Edhe sipas legjislacionit shqiptar, për të shmangur abuzimin dhe arbitraritetin në këtë fazë delikate të procedimit, ligjvënësi ka përcaktuar prokurorin si garant dhe si kontrollor të veprimtarisë së punonjësit të policisë së infiltuar, sikundër ka zgjedhur si akt me të cilin ai duhet ta realizojë detyrimin e tij “autorizimin me shkrim”.

Ky autorizim duhet të përmbajë:

- 1- afatin e infiltrimit, afat, që mund të zgjatet nga prokurori deri në gjashtë muaj;
- 2- hapsirën e lejueshme për punonjësën e infiltuar, duke treguar konkretisht cilat do të jenë ato veprime të paligjshme që i infiltuari mund të kryejë, gjithmonë pa rrezikuar jetën e tij si dhe jetën e të tjerëve.

Mungesa e autorizimit të prokurorit i bën të pavlefshme veprimet e kryera dhe rezultatet nga veprimet simuluese. Autorizimi, është akti bazë procedural, që do të legjitimonte veprimet e personit të infiltuar.

Duke iu kthyer dispozitës së nenit 294\ a të Kodit të Procedurës Penale, rezulton se autorizimi duhet të lëshohet:

- 1- nga prokurori që kontrollon hetimet, ose
- 2- nga prokurori që ka në juridiksion territorin ku do të zhvillohet veprimi (simulues)

Në rastin e parë, prokurori nuk mund të kontrollojë hetime jashtë egzistencës së një procedimi penal, çka do të thotë që ai kontrollon hetimet, kur çështja është e rregjistruar. Kjo

për arsyen e thjeshtë se veprimet e agjentit të policisë, që kryen një blerje të simuluar a veprime të tjera simuluese, mund të marrin vlerë provuese vetëm në kuadrin e formalizimit të tyre nga pikëpamja procedurale.

Veprimet simuluese do të ishin veprime të kundraligjshme, që do ta penalizonin agjentin e policisë që i kryen ato, po të mos ligjërohen nga autoriteti i ngarkuar me ligj, në rastin konkret nga prokurori.

Në rastit i dytë, autorizimi mund të lëshohet edhe nga prokurori që ka në juridiksion territorin, ku do të kryhet veprimi.

Por, dhënia e autorizimit nga prokurori, që ka në juridiksion territorin ku do të kryhen veprimet simuluese, nuk presupozon mosekzistencën e një procedimi penal, përkundrazi procedimi penal ekziston por jo në rregjistrin përkatës të rrethit në juridiksionin e të cilit do të kryhet ky veprim, por ekziston në rregjistrin e prokurorive të tjera.

Sa sipër, janë shumë të rëndësishme pasi, prokurori mund të konstatojë ekzistencën e provokimeve gjatë kontrollit të procedurave të kryerjes së veprimeve simuluese pas autorizimit të lëshuar prej tij. Prokurori që lëshon autorizimin duhet të jetë dhe garanti, që nuk është përdorur provokimi nga personi, që kryen veprimin simulues apo punonjësi i policisë i infiltruar.

Veprimet implikuese, që duhet t'i lejohen agjentit, që kryen veprime simuluese, duhet të jenë të specifikuara, pasi vetëm prokurori mund të përcaktojë në këtë fazë statusin e agjentit, që kryen veprime simuluese dhe të depenalizojë atë për veprimet e kundraligjshme, që ky i fundit mund të kryejë.

4.3.1. Detyrimet e agjentit të infiltruar për të raportuar

Sasipër, i gjithë aktiviteti i oficerit të policisë gjyqësore si agjent i fshehtë, zhvillohet nën autoritetin dhe kontrollin e prokurorit. Përmes një akti procedural, siç është “*autorizimi me shkrim*”, prokurori përcakton atributet, që oficeri i policisë gjyqësore gëzon gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij. Përcakton kufinj të brenda të cilit i lejohet oficerit të policisë të veprojë si dhe legjitimon një aktivitet, i cili po të mos kryej nga një efektiv i policisë dhe brenda limiteve që përcakton autorizimi, do të konsiderohej si penalisht i dënueshëm. Të tilla të drejta, duhet të shoqërohen dhe nga detyrime nga ana e oficerit. Detyrime këto, që legjislatori i ka parashikuar në pikën 3 të nenit 294/a. Bëhet fjalë për *detyrimin e agjentit të infiltruar për të raportuar*. Ky raportim, bëhet përmes një raporti përmbledhës për të gjitha provat e mbledhura si dhe mbi veprimtarinë e tij. Në këtë mënyrë prokurorit i krijohet mundësia reale për të ushtruar kontrole mbi aktivitetin e oficerit të policisë gjyqësore, duke verifikuar kështu përputhshmërinë e kësaj veprimtarie me direktivat që përmban *autorizimi me shkrim*. Një komunikim i munguar mes këtyre dy organeve të procedimit penal, do t'i hiqte çdo mundësi legjitimimi këtij aktiviteti. (Mimma, 2003: 123)

Përmëtepër, një autorizim i bërë paraprakisht nuk do të mund të parashikonte, çdo situatë të mundshme në të cilën do të ndodhej oficeri i policisë, kështu që përmes referimit apo raportimit të detajuar oficeri i policisë gjyqësore, përmes përmbushjes së detyrimit të tij ligjor i jep mundësinë prokurorit të ushtrojë të drejtën e tij për të administruar dhe drejtuar më tej, aktivitetin hetimor.

4.4. Veprimet e kontrolluara⁶¹

Instituti i *controlled delivery*, (Neni 11, Konventa kundër Trafikut të paligjshëm të Drogave narkotike dhe Substancave Psikotrope) është përfshirë në legjislacionin ndërkombëtar në nenin 11 të *Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Trafikut të paligjshëm të Drogave narkotike dhe Substancave Psikotrope*, bërë në Vjenë më 20 Dhjetor 1988, ratifikuar nga Shqipëria me ligjin 8722 datë 26.12.2000.

Pikërisht këtu kërkohet nevoja e përfshirjes së teknikave speciale hetimore, si për shembull survejimin elektronik apo lloje të tjera të veprimtarive nën koperturë (undercover operations). (Striano, 2012)

Veprimet e kontrolluara dhe operacionet nën koperturë apo e thënë ndryshe operacionet nën mbulesë, njihen si *special investigative techniques* (teknika hetimore speciale) adoptimi i të cilave është rekomanduar në arenën ndërkombëtare, për të cilën është bërë e një rëndësie të veçantë nevoja për të pasur një të drejtë të brendshme mundësisht të unifikuar. (Striano, 2012)

Konventa e Vjenës, ashtu si dhe aktet e tjera ndërkombëtare për shtetet kontraktuese konsiderohet bazë juridike që duhet zbatuar, kjo bazuar dhe në *Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë neni 122* i saj, ku thuhet:

”1. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji. Ndryshimi, plotësimi dhe shfuqizimi i ligjeve të miratuara me shumicën

⁶¹ Me “*Veprime të kontrolluara*”, nënkuptojmë teknika të cilat mundësojnë kalimin apo dorëzimin e mallrave të paligjshëm apo të supozuara si të tilla, jashta territorit apo përmes territorit të një apo më shumë shteteve, me vetëdije dhe nën kontrollin e autoriteteve kompetente. Kjo, me qëllim hetimin mbi një veprimtari kriminale të mundshme si dhe për të identifikuar personat e përfshirë në këto veprimtari.

e të gjithë anëtarëve të Kuvendit për efekt të ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare bëhet me të njëjtën shumicë.

2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të”.

Duke mos u mjaftuar me kaq legjislatori shqiptar, duke pasë dhe si qëllim përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë vendeve të zhvilluara të Europës dhe duke iu bashkuar iniciativës mbarëkombëtare për një luftë sa më efektive ndaj krimit të organizuar ka ndërhyrë dhe në Kodin Procedural Penal, duke përfshirë “veprimet e kontrolluara” në këtë Kod, përmes ligjeve të tija amenduese.

4.5. Veprimtaria e agjentit të infiltruar dhe atij simulues

Siç e përmendëm dhe me lart, për t’ju kundërvënë fenomeneve kriminale aq shumë të përhapur, të tilla si: trafiqet e ndryshme të narkotikëve, të qënieve të gjalla, të armëve etj, autoritetet janë drejtuar drejt përdorimit të figurës *fictus emptor*, (Barrocu, 2009:11) (blerës i rremë), dhe të të ashtëquajturës *viktimë e rreme* të çështjeve në fjalë duke e ndarë doktrinën rreth mundësisë për ta inkuadruar këtë figurë me atë të agjentit provokator (simulues). Të njohura sipas legjislacionit tonë si:

- Figura e *agjentit të infiltruar*, na jep të kuptojmë, se kemi të bëjmë me një teknikë të posaçme hetimi, në të cilën një pjesëtar i forcave të policisë, duke simuluar një identitet të rremë (ndryshe nga identiteti i vërtetë), është në gjendje të veprojë në një ambient kriminal dhe të marrë informacione, të cilat më pas të përmbledhura në një relacion, mund të përfaqësojnë një burim të rëndësishëm provash. (Jannone, 2007)
- *Agjenti i infiltruar* vepron përmes përfshirjes apo penetrimit të tij në organizata kriminale duke fituar besimin e anëtarëve të saj dhe duke u hequr si bashkëpunëtor në krim me anëtarët e tjerë. E gjithë kjo veprimtari kryhet nën një fshehtësi të plotë dhe duke pasë si qëllim final identifikimin e anëtarëve të organizatës, strukturës së

saj, zbulimit në gjerësi e thellësi të veprimtarisë së saj dhe duke e përmbyllur me kapjen në flagrancë të kriminelëve të prezumuar.

- *Agjenti simulues* është një tjetër subjekt, i cili e ushtron aktivitetin dhe ai nën një fshehtësi të plotë, por në ndryshim nga i pari, aktiviteti i tij ka të bëjë me përshpejtimin e aktit kriminal. Përshpejtim ky, që bëhet përmes stimulimit të vullnetit psikik në kryerjen e një vepre që ishte egzistente tashmë në *reo*. (Barrocu, 2009: 11)

Në këtë mënyrë agjenti ndërhyr në mënyrë të drejtpërdrejtë në procesin e formimit të vullnetit të personit që do të provokojë, duke qartësuar kështu qëllimin e tij kriminal. (Barrocu, 2009: 11)

Duke trajtuar rast pas rasti veprimtaritë në të cilat përfshihen agjentët nën koperturë do të arrijmë të veçojmë, se në cilat prej tyre ndërhyrja e forcave policore ka karakter *preventiv* dhe në cilat ka karakter *represiv*. Në rastin e veprimtarive të paligjshme, siç mund të jetë tregtimi i substancave narkotike, kërkohet përfshirja e veprimeve parandaluese të forcave të rendit, ku agjenti provokator, apo i infiltruari nën koperturë, është një figurë e një rëndësie ekstreme, (Pezzoni, 2013) por pavarësisht kësaj shumë shpesh aktiviteti i tyre ka qënë dhe objekt kritikash. Rolin parandalues, e shohim edhe në rastet kur ky mjet apo e thënë ndryshe, kjo “*armë kundër kriminalitetit*”, përdoret për të luftuar Pedofilinë—online. Në të tilla forma të reja të shfaqjes së kriminalitetit është parë si oportune përfshirja e agjentëve të fshehtë, për të hyrë në kontakt me pedofilët, që ndodhen në rrjet. Duke qënë se *Chat-i*⁶² është ai sektor, ku manifestohen më së shumti, rreziqet për të miturit.

Karakterin *represiv* të kësaj veprimtarie mund ta shohim në përfshirjen e tyre në brendësi të një organizate kriminale, ku marrin pjesë në përgatitjen dhe ekzekutimin e një akti kriminal,

⁶² Dhomë bisedash. Bëhet fjalë për një shërbim, i cili u mundëson përdoruesve të komunikojnë në kohë reale me njëri-tjetrin, përmes postimit të mesazheve.

nën petkun e një bashkëpunëtori të mirëfilltë. Qëllimi në këtë rast është identifikimi i anëtarëve të organizatës kriminale, pritja e momentit të duhur para se veprimtaria kriminale të ekzekutohet dhe duke proceduar menjëherë me kapjen në flagrancë të tyre. Këtu kemi të bëjmë me një reagim represiv ndaj krimit në fjalë.

4.6. Kuadri normativ

Është e kuptueshme se lindja e një sërë dyshimesh në lidhje me këtë tipologji të veçantë hetimore ka të bëjë me vështirësinë e përcaktimit të raporteve mes aktivitetit hetimor dhe shqyrtimit gjyqësor. Përmëtepër si tipar thelbësor i këtij mjetei hetimor, ka qënë rrezikshmëria e lartë të veprave penale, e cila ka legjitimuar përdorimin e aktivitetit të fshehtë. (Barrocu, 2009:10-11)

Kodifikimi i këtij mjetei hetimor të materializuar tashmë, në legjislacionin tonë procedural penal, nuk njih një traditë të gjatë në përdorim, por emergjenca e përshkallëzuar e krimeve me rrezikshmëri të lartë kanë kërkuar përfshirje dhe rregullimin me ligj të këtij hetimi të posaçëm.

Ajo çfarë neve na ngjall diskutime, është pikërisht ligjshmëria, që ka të bëjë me përdorimin e një instrumenti të tillë, dhe nga ana tjetër vlerësojmë vëmendjen e veçantë të studiuesve, të cilët jo paqëllim kanë ngritur si shqetësim, atë që ka të bëjë me mosegzistencën e një figure të unifikuar “*të agjentit të fshehtë*”. (Barrocu, 2009:10-11)

Një fakt i tillë në legjislacione të ndryshme, ku tradita legjislative është më e hershme, ka lejuar një përdorim analog të dispozitave, të cilat rregullonin këtë veprimtari dhe nuk ka mundësuar një interpretim të konsoliduar në lidhje me zgjidhjen e çështjeve, në të cilat ishin përfshirë veprimtaritë e fshehta. (Barrocu, 2009:10-11)

Problematikat, që kishin të bënin me interpretimin, kërkonin nevojën e nxjerrjes së dispozitave të reja. Për t’i dhënë zgjidhje këtij fragmentarizimi të dispozitave (Barrocu,

2009:10-11) ka ardhur në ndihmë “Konventa dhe protokollet e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar Ndërkombëtar”,⁶³ bërë në Palermo më 15.12.2000, e cila është ratifikuar dhe nga Shqipëria me datë 21.08.2002. Qëllimi i kësaj konvente është të nxisë bashkëpunimin për të parandaluar dhe luftuar efektivisht krimin e organizuar ndërkombëtar.⁶⁴

Nenet 294\|a dhe 294\|b të K.Pr.P të Republikës së Shqipërisë, është një përgjigje e nevojës për ekzekutimin dhe zbatimin e nenit 20 të Konventës, i cili trajton në mënyrë eksplicite, detyrimin e secilit shtet për të adoptuar,

”...masat përkatëse për të lejuar përdorimin e duhur të dërgesave të kontrolluara (controlled delivery) dhe në rast se është e domosdoshme të teknikave të tjera të veçanta hetimore, siç është mbikëqyrja elektronike ose forma të tjera të saj dhe operacionet e mbuluara (undercover operations), brenda mundësive të tij dhe sipas kushteve të përcaktuara nga legjislacioni i tij i brendshëm”⁶⁵

E gjithë kjo duhet të përfshihet domosdoshmërisht në një kontekst investigativ të karakterizuar nga një lloj kompleksiteti, e cila zhvillohet përmes veprimtarive specifike hetimore të policisë. (Striano, 2012)

Edhe sipas legjislacionit tonë, (Nenet 30-33 dhe 293-302 K.Pr.P.) *Policia gjyqësore* është subjekti, i cili në një procedim penal ka detyrë të bashkëpunojë me autoritetet gjyqësore në aktivitetin e represionit ndaj krimeve, ka detyrë të grumbullojë të dhëna rreth krimit (*notitia criminis*), të bëjë kërkime, të individualizojë dhe sigurojë burimet e provave për autorët e supozuar. Ndër aktivitetet me iniciativë të policisë gjyqësore, aktiviteti informativ merr një rëndësi prioritare dhe mund të identifikohet në ushtrimin e dy funksioneve të dallueshme

⁶³ Ligj, Nr.8920, datë 21.08.2002, Për ratifikimin e "Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar" dhe dy protokolleve shtesë të saj: 1195)

⁶⁴ Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar" dhe dy protokollet shtesë të saj.

⁶⁵ Neni 20 i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar dhe dy protokolleve shtesë të saj.

nga njëra-tjetra, që konsiston në: *grumbullimin e informacionit rreth krimit dhe komunikimin e këtij informacioni tek prokurori*. Zbulimi i një informacioni për një krim të mundshëm, përbën një motor të pazëvendësueshëm kërkimi në fazën e *hetimit paraprak* dhe të veprimtarisë parandaluese të krimit. (Auricchio, Panico, Pini, 2013).

4.6.1. Ligji 8750, datë 26.03.2001 “Për parandalimin dhe luftën ndaj trafikut të lëndëve narkotike ose psikotrope”

Blerja e simuluar, si veprimtari hetimore, për herë të parë është parashikuar me ligjin nr.8750, datë 26.03.2001 “Për parandalimin dhe luftën ndaj trafikut të lëndëve narkotike ose psikotrope”. Sipas këtij ligji:

*“oficeri dhe agjenti i Policisë Gjyqësore, i shërbimit kundër drogës ose personi i autorizuar prej tyre, mund të ngarkohet për të kryer “blerjen e simuluar”, të lëndëve narkotike ose psikotrope, duke fshehur bashkëpunimin me policinë ose cilësinë e tij si punonjës policie”.*⁶⁶

Ata pajisen me dokumente identifikimi, të cilat përmbajnë gjeneralite të pavërteta.

“Blerja e stimuluar”, bëhet me autorizim të Prokurorit të Përgjithshëm, të prokurorit që ka filluar procedimin penal ose të prokurorit, që ka në juridiksion territorin ku do të zhvillohet ky veprim. Ky veprim ka për qëllim *grumbullimin e provave, identifikimin dhe arrestimin e personave të përfshirë në trafikun e drogës.*⁶⁷

- Në këtë ligj është parashikuar edhe *“punonjësi i policisë i infiltruar”*, me të cilin kuptohet oficeri ose agjenti i policisë gjyqësore, pjesëtar i shërbimit të luftës kundër drogës ose person i autorizuar prej tyre, i cili futet në brendësi të një organizate kriminale për të individualizuar pjesëtarët e organizatës dhe për të mbledhur prova në ngarkim të tyre, duke fshehur bashkëpunimin me policinë ose cilësinë e tij si punonjës policie.

⁶⁶ Ligji nr. 8750, datë 26.03.2001, “Për parandalimin dhe luftën ndaj trafikut të lëndëve narkotike ose psikotrope”, Flet.Zyrtare Nr.14, neni 2/1.

⁶⁷ Ligj, Nr.8750, (2001), Për parandalimin dhe luftën ndaj trafikut të substancave narkotike ose psikotrope, Flet.Zyrtare Nr.14, neni 2/1.

Punonjësit e Shërbimit Qëndror të Luftës Kundër Drogës, në cilësinë e oficerit dhe të agentit të policisë gjyqësore kanë të drejtë të bëjnë interceptime të bisedave dhe të komunikimeve me mjete teknike e shkencore të bëjnë vëzhgime fotografime sekrete, sipas rregullave të caktura në Kodin e Procedurës Penale. Për interceptimet duhet të zbatohen rregullat e parashikuara në nenet 221-226 të K.Pr.P.

Kuptohet që, kur këto metoda nuk janë zbatuar apo nuk kanë qënë të suksesshme dhe veprimi i blerjes apo i infiltrimit nuk mund të provohet me mënyra të tjera, *ai që bën “blerjen e simuluar” apo që “infiltron” në organizatën kriminale mund të thirret si dëshmitar për të shpjeguar rrethanat e blerjes së lëndës narkotike*. (Islami, Hoxha, Panda, 2003: 223)

Ky ligj u ndryshua me ligjin nr.10 375, datë 10.2.2011, për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8750, datë 26.03.2001, "*Për parandalimin dhe luftën ndaj trafikut të substancave narkotike ose psikotrope*". Ndryshimet e bëra nuk patën ndikim në atë çfarë përbën objekt trajtimi në punimin tonë.

4.6.2. Veprimet simuluese

Me ligjin 9187, datë 12.02.2004, Kodit të Procedurës Penale shqiptare i shtohet *neni 294*⁶⁸ i cili parashikon si një veprimtari të oficerit të policisë gjyqësore: *veprimet simuluese*.

⁶⁸ Neni 294/a K.Pr.P-Veprimet simuluese

1. *Oficeri dhe agjenti i policisë gjyqësore ose personi i autorizuar prej tyre mund të ngarkohen për blerje të simuluar të sendeve, që rrjedhin nga një krim ose simulim i një akti korruptiv, ose të kryejnë veprime të tjera simuluese, për të zbuluar të dhëna financiare ose pronësie të një personi, për të cilin ka dyshime për kryerjen e një krimi, duke fshehur bashkëpunimin me policinë ose detyrën e tyre si punonjës policie.*

2. *Këto veprime bëhen me autorizimin e prokurorit që kontrollon hetimet ose të prokurorit që ka në juridiksion territorin ku do të zhvillohet veprimi. Pas kryerjes së këtyre veprimeve, policia gjyqësore duhet t'i dorëzojë prokurorit të gjitha provat e mbledhura dhe një raport përmbledhës.*

3. *Nuk duhet provokuar një akt kriminal, duke shtyrë një person të kryejë një krim, të cilin nuk do ta kishte kryer po të mos ishte ndërhyrja e policisë. Kur vërtetohet provokimi, rezultati nuk mund të përdoret.*

Ky ndryshim ligjor i ka hapur rrugë një forme të veçantë të hetimit paraprak, të panjohur më parë. Bëhet fjalë për hetimin pro-aktiv apo siç njihet ndryshe hetime të fshehta. Këto hetime zhvillohen nga policia gjyqësore, përmes oficerit të policisë gjyqësore, agjentit të infiltruar ose përmes një personi tjetër të autorizuar prej tyre.

- *Veprimtaria e oficerit të policisë gjyqësore sipas nenit 294/a të K.Pr.P. :*

1- Oficeri i policisë gjyqësore që do të kryejë veprime simuluese, sipas dispozitës së parashikuar në nenin 294/a pika 1, të Kodit të Procedurës Penale, kryen këto veprime simuluese:

- 1. blerje të simuluar të sendeve, që rrjedhin nga një krim*
- 2. simulim të një akti korruptiv*
- 3. veprime të tjera simuluese, që synojnë zbulimin e të dhënave financiare ose pronësinë e personave për të cilët ka dyshime në kryerjen e veprave penale*

Del qartë se, metoda speciale e hetimit “*Veprimet simuluese*”, përdoret jo për të kryer çdo veprim, por vetëm për të kryer ato veprime që parashikohen në mënyrë të shprehur nga ligji (pika 1 e nenit 294/a të Kodit të Procedurës Penale). Veprime të tilla janë vetëm tre të mësipërmet.

Por, duhet thënë se ashtu edhe siç është pranuar gjerësisht, kjo dispozitë dhe praktikë është e re në vendin tonë. Qëllimi kryerjes së këtyre veprimeve nga oficeri i policisë gjyqësore konsiston në zbulimin e autorëve të veprave penale dhe të strukturës kriminale të grupit apo organizatës kriminale. Por, *simulimi i një akti kriminal* duhet të dallohet nga *provokimi i kryerjes së një krimi*.

2- Sipas nenit në fjalë në pikën 2 të tij, kjo veprimtari do të kryhet me autorizimin dhe kontrollin e prokurorit, i cili mund të jetë prokurori i cili po kryen hetimet për çështjet

konkrete apo ai i cili ka nën juridiksion territorin, ku po zhvillohet veprimi. E gjithë kjo veprimtari, konsiderohet një mjet, i cili ka si qëllim grumbullimin e provave, prova të cilat, do t'i dorëzohen prokurorit nga policia gjyqësore, përmes një raporti përmbledhës.

3- Ligji i njeh ndalime punonjësve të policisë. Ato janë të shprehura në *nenin 294/a, paragrafi i tretë* i Kodit të Procedurës Penale. Përkatësisht:

*“Nuk duhet provokuar një akt kriminal, duke shtyrë një person të kryejë një krim, të cilin nuk do ta kishte kryer po të mos ishte ndërhyrja e policisë. Kur vërtetohet provokimi, rezultati nuk mund të përdoret”.*⁶⁹

Pra, nga interpretimi i dispozitës në fjalë, del e qartë se oficeri i policisë gjyqësore *duhet të jetë përballë një ofertë ekzistuese*, duhet të konstatojë ekzistencën e një veprimtarie kriminale dhe këtu ai mund të futet dhe të kryejë veprimet simuluese.

Pra, në zbatimin e kësaj metode të veçantë hetimi, nuk lejohet provokimi i kryerjes së veprës penale, sepse në të kundërt rezultati nuk mund të përdoret.

Në lidhje me veprimet e simulimit, në çështjen Ramanauskas kundër Lituaniës. GJEDNJ ka arritur në përfundimin, se për të konstatuar nëse oficerët e policisë e kanë kufizuar veten për të "hetuar veprimtarinë kriminale në thelb në mënyrë pasive", nga ana e tyre nuk duhet të kryen veprime aktive por duhet ta hetojnë veprimtarinë kriminale në mënyrë pasive. Rasti objekt shqyrtimi në GJEDNJ kishte të bënte me mungesën e provave më të hershme në kohë se veprimi i simulimit, që të krijonin dyshimin se personi do të kryente veprë penale pa qenë i ndikuar nga oficerët.

Edhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në vendimin nr.85, datë 06.03.2013, ka arsyetuar në të njëjtën mënyrë, duke kërkuar:

“Prishjen e vendimit nr. 25, datë 25.02.2010 të Gjykatës së Apelit Korçë dhe të vendimit nr.192, datë 08.06.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe pushimin e çështjes në ngarkim të të gjykuarve”.

⁶⁹ Neni 294\ a, pika 3, Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë “Veprimet simuluese”.

Kjo, pasi nga ana e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nuk ishin konstatuar prova që të provonin se i dyshuari do të kryente veprë penale, në rast se nuk do të kishte qënë i ndikuar nga oficerët e policisë gjyqësore.

Ndërhyrja e agjentit të infiltruar, nuk ishte mjaftuar në hetimin e veprimtarisë kriminale në mënyrë pasive. Ata kishin kryer veprime aktive, duke i kërkuar të pandehurit pajisjen me vizë Shengen fallso, kundrejt shpërblimit, duke vepruar kështu në kundërshtim me sa parashikohet në pikën 3 të nenit 294/a të K.Pr.P.

4.6.3. Punonjësi i policisë i infiltruar

*Neni 294\ b*⁷⁰ i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, shtuar me *ligjin 9187, datë 12.02.2004*, përcakton qëllimin e veprimtarisë së punonjësit të policisë, i cili duhet të zbulojë krimet e rënda.

1- Sipas *pikës 1*, të këtij neni, me autorizim të prokurorit, punonjësi i infiltruar, do të futet në brendësi të një grupi kriminal, për të individualizuar pjesëtarët e grupit si dhe për të mbledhur të dhëna të nevojshme për hetimin, gjithmonë, duke fshehur bashkëpunimin me policinë dhe detyrën e tij si punonjës policie.

2- *Pika 2* e këtij neni përcakton qartë kufinj të veprimtarisë së punonjësit të policisë të infiltruar, si dhe papërdorshmërinë e rezultateve të këtyre veprimeve, kur jemi përpara tejkalimit të kufijve të ligjshmërisë.

⁷⁰ Neni 294\ b, - Punonjësi i policisë i infiltruar

1. Për qëllimet e zbulimit të krimeve të rënda, oficeri i policisë gjyqësore, me autorizimin e prokurorit, mund të futet në përbërjen e një grupi kriminal për të individualizuar pjesëtarët e grupit dhe për të mbledhur të dhënat e nevojshme për hetimin, duke fshehur bashkëpunimin me policinë ose detyrën e vet si punonjës policie.

2. Punonjësi i policisë i infiltruar nuk duhet të provokojë një akt kriminal, i cili, pa ndërhyrjen e tij, nuk do të ishte kryer. Kur vërtetohet provokimi, rezultati nuk mund të përdoret.

3. Autorizimi i prokurorit duhet të përcaktojë afatin e infiltrimit, që mund të zgjatet nga prokurori deri në gjashtë muaj dhe hapësirën e lejueshme për punonjësin e infiltruar, duke treguar, sipas rastit, veprimet e paligjshme që mund të kryejë ai, pa rrezikuar jetën e të tjerëve.

4. Punonjësi i policisë i infiltruar mund të pyetet si dëshmitar.

3- Në *pikën 3* të këtij neni, përcaktohet afati i infiltrimit, i cili mund të shtyhet deri në gjashtë muaj, nga prokurori. Aty përcaktohet gjithashtu, edhe hapsira e lejueshme, në të cilën do të kryhen këto veprime.

2- Në *pikën e fundit* të këtij neni shprehet mundësia e thirrjes, së punonjësit të policisë të infiltruar si *dëshmitar*.

Përsa i përket vlerës provuese të dëshmisë së oficerit të policisë të infiltruar, shpesh diskutohet nëse ajo përbën ose jo provë dhe nëse po, nëse ajo është provë tipike apo provë atipike.

Sa i takon të parës, në kushtet e legjislacionit procedural penal në fuqi, në Republikën e Shqipërisë, çështja është zgjidhur pozitivisht. Në *pikën 4* të dispozitës të nenit 294/b të K.Pr.Penale thuhet shprehimisht se,

“Punonjësi i policisë i infiltruar *mund të pyetet si dëshmitar*”.

Këtëj pa asnjë mëdyshje, për mendimin tim, arrihet në përfundimin se, kur organi procedural vlerëson nevojën e pyetjes si dëshmitar të punonjësit të policisë të infiltruar, dëshmia e tij, përmbush kushtet e kërkuara në ligj (neni 149 të K.Pr.Penale)⁷¹ për të qënë provë, në kuptimin që i jep provës kjo dispozitë.

Çmimi i dëshmisë së punonjësit të policisë i infiltruar, do t'i nënshtrohet procesit të çmuarjes së provave, sipas bindjes së brendshme të gjykatës, marrë në tërësi me përfundimet e ar-

⁷¹ Neni 149, Kuptimi i provës

1. Prova janë njoftimet mbi faktet e rrethanat që lidhen me veprën penale, që merren prej burimeve të parashikuara në ligjin procedural penal, në përputhje me rregullat e caktuara prej tij dhe që shërbejnë për të vërtetuar kryerjen ose jo të veprës penale, pasojat e ardhura prej saj, fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit dhe shkallën e përgjegjësisë së tij.

ritura nga gjykata, pas shqyrtimit të të gjitha provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes (neni 152 i K.Pr. Penale).⁷²

Mendoj se, mbas kësaj, bazuar në mënyrën se si është konceptuar kuptimi i provës në legjislacionin procedural penal në fuqi dhe praktikën e gjertanishme gjyqësore, dëshmia e punonjësit të policisë i infiltuar, mendoj se, është plotësisht ligjore (tipike). Kurse mendimi i hedhur sipas të cilit pranimi i saj si e tillë (provë ligjore-tipike) mund të cënojë të drejta të personit edhe sipas Kushtetutës së Rep. së Shqipërisë, KEDNJ dhe akteve të tjera në këtë fushë, është konfirmuar pohimi se të drejtat e parashikuara në këto akte, mund të kufizohen me ligj.

Kuptohet se diskrecioni në këtë pikë, i takon ligjvënësit, sikundër ka ndodhur në K.Pr. Penale në fuqi të Rep. së Shqipërisë, qëndrim të cilin e gjej plotësisht me vend.

Në rastin e parë (neni 294\ a) oficeri, agjenti i policisë gjyqësore, si dhe personi i autorizuar prej tyre, mund të përfshihet në një “blerje të simuluar”,⁷³ pa qënë nevoja, që ato të jenë punonjës të policisë, ndërsa në rastin e dytë (neni 294\ b) punonjësi i policisë i infiltuar duhet domosdoshmërisht të jetë i regjistruar si punonjës i policisë, për t’u infiltuar në brendësi të një grupi kriminal. Në dispozitat e nenit 294\ a dhe 294\ b të K. Pr.P., përcaktohen veprimet dhe subjektet, që do të përfshihen në këtë veprimtari. Vetë legjislatori në pikat a dhe b të nenit 294, ka bërë dallimin mes personave të veshur më këtë pushtet.

⁷² Neni 152, Çmuarja e provave

1. Çmuarja e provave është përcaktimi i vërtetësisë dhe fuqisë provuese të tyre. Çdo provë i nënshtrohet shqyrtimit dhe nuk ka vlerë të paracaktuar. Gjykata i çmon provat sipas bindjes së formuar pas shqyrtimit të tyre në tërësi.

⁷³ Ligji 8750, datë 26.03.2001 “Për parandalimin dhe luftën ndaj trafikut të lëndëve narkotike ose psikotropë”, neni 2, pika 1.

“Blerje e stimuluar” kuptohet rasti kur oficeri ose agjenti i Policisë Gjyqësore, i zyrës së luftës kundër drogës ose një personi i autorizuar prej tyre blen substanca narkotike ose psikotropë, substanca kimike bazë, prekursorë, duke fshehur bashkëpunimin me policinë ose cilësinë e tij si punonjës policie.

4.7. Përkufizimi i agentit simulues dhe agentit të infiltruar

Në *nenet 294\ a dhe 294\ b*, shtuar me ligjin 9187 datë 12.02.2004, u përfshi për herë të parë figura e agentit të infiltruar dhe e agentit simulues apo provokator në legjislacioni procedural penal shqiptar. Për të trajtuar çdo detaj të veprimitarisë së tyre ndalemi në dhënien e një përkufizimi për secilin subjekt. Ky përkufizim do të bazohet në trajtimet e bëra nga doktrina e huaj, duke qënë se studimet në këtë fushë në Shqipëri janë të kufizuara.

- Me termin “*agent provokator*” (simulues), kuptohet personi përgjithësisht pjesëtar i forcave të policisë, i cili me veprimet apo këshillimet e tij ndikon tek të tjerët, të kryejnë një krim ose bëhet pjesëmarrës në ekzekutimin e krimit me qëllim zbulimin dhe dënimin e autorëve. (Giovagnoli, 2008)

Një figurë e tillë i ka rrënjët në *Francë* gjatë shekujve XVII dhe XVIII, ku tirania e shtetit karakterizohej nga e ashtëquajtura periudhë historike e krijimit të terreneve të përshtatshme për shtimin e informatorëve sekretë, duke parë nevojën e sovranit për të ruajtur dhe për të rritur forcën e tij përmes eliminimit të kundërshtarëve të regjimit. Kjo lidhej me interesin e disa qytetarëve për të marrë merita pranë autoriteteve shtetërore. Në këto rrethana u desh përfshirja e informatorëve private, të cilët shumë shpejt kaluan në krijimin e *policisë sekrete*, e cila kryente po të njëjtin aktivitet edhe pse me një tjetër qëllim, që kishte të bënte pikërisht me realizimin e detyrave zyrtare. *Aktiviteti në fjalë, siç ndodh akoma sot, nuk ishte e limituar thjesht në vrojtimin e një aktiviteti potencialisht të paligjshëm, por shtyhej shpesh në nxitjen dhe forcimin e qëllimeve kriminale tek subjektet e dyshuara.* Kjo veprimtari nga ana dogmatike është inkuadruar si një konkurim i moralit të personave, nën ndikimin e nxitjes. Me kalimin e kohës doktrina e huaj, ka vënë në dukje, mënyrën se si i janë atribuar agentit provokator situata të figurave heterogjene, duke përmendur këtu;

- figurën e agentit, i cili nxit një akt kriminal,

- figurën e agjentit, i cili merr pjesë në ekzekutimin e një veprimtarie kriminale, që tashmë ka filluar
- dhe të agjentit, i cili merr rolin e viktimës së krimit. (Giovagnoli, 2008)
- Me figurën e “*agjent të infiltruar*”, kuptojmë një subjekt, i cili përfshihet në rrjetin e një organizate kriminale, me qëllim zbulimin e pjesëtarëve, strukturës dhe qëllimeve të saja. (Giovagnoli, 2008)

Nevoja për të ndjekur, të tilla qëllime, i është përshtatur nevojës në rritje për zbulimin e formave të sofistikuara të krimit të organizuar, për më tepër është parë si nevojë imediate nga ana e legjislatorit, i cili si fillim i është referuar disa formave tipike të agjentit provokator për të arritur më pas tek agjenti i infiltruar, i cili është përfshirë tashmë dhe në legjislacionin tonë procedural penal, duke u materializuar në nenin 294**b** të K.Pr.P. të Republikës së Shqipërisë.

4.7.1. Dallimet mes personave të përfshirë në aktivitetin e fshehtë

Agjenti i infiltruar dhe ai *simulues* janë dy figura, që shpesh konsiderohen të njëjta edhe pse secila karakterizohet nga një aktivitet specifik. Është e rëndësishme që përmes trajtimit të veprimtarisë që ato kryejnë, të bëjmë edhe dallimin mes tyre.

- Më kompleks është aktiviteti i *agjentit të infiltruar*. Ai përmes veprimtarisë hetimore të fshehtë punon aktivisht në terren. Për të është i nevojshëm një mbulim biografik. Që do të thotë:
 - se ai ka nevojë të pajiset me dokumenta të reja në të cilat të pasqyrohet një identitet i ndryshëm nga ai që agjenti në të vërtetë ka,
 - vendime fajësie, që të vërtetojnë një të shkuar me precedent penale për agjentin në fjalë,
 - dokumenta, që të vërtetojnë daljen nga institucione ndërshkimore.

Veç sa sipër, kërkohet një prepatitje psiqike dhe kulturore të agjentit dhe përmetepër kërkohet që ai të kryejë veprimtari të plota hetimore. (Catana, 2005)

Agjenti i "infiltruar", bashkëpunon ose është pjesë e forcave policore, përfshihet në një aktivitet investigativ (hetimor) zyrtar, veprimtaria e tij konsiston në vëzhgimin dhe mbajtjen nën kontroll të një veprimtarie potencialisht të paligjshme. (Striano, 2012)

Ai futet në një ose më shumë aktivitete penalisht të dënueshme, më të vetmin objektiv të grumbullojë prova mbi krime dhe mbi persona, që i kanë kryer këto krime. E thënë ndryshe, *objektivi i aktivitetit është të kapë në flagrancë përgjegjësit e një apo më shumë krimeve.*

Kjo, gjen shprehje edhe në ligjin 8750, datë 26.01.2001, sipas të cilit,

*"Punonjës i policisë i infiltruar" kuptohet oficeri ose agjenti i Policisë Gjyqësore, i shërbimit të luftës kundër drogës ose një person i autorizuar prej tyre, i cili, për një hetim të Policisë Gjyqësore, futet në brendësi të një organizate kriminale, për të individualizuar pjesëtarët e organizatës dhe për të mbledhur prova në ngarkim të tyre, duke fshehur bashkëpunimin me policinë ose cilësinë si punonjës policie"*⁷⁴

Hetimet duhet të zbulojnë kanalet strukturore të organizatës, ku ai do të infiltrohet. Më pas aktiviteti i tij përfundon në momentin e kapjes në flagrancë të anëtarëve të një organizate kriminale, si rrjedhojë e grumbullimit të provave. Këto prova paraqiten në procesin penal kundër personave nën hetim. Është pikërisht ky momenti, i cili ka paraqitur problematika jo të pakta dhe që do të trajtohet gjatë këtij punimi. (Mujaj, 2013: 6)

- Me emërtimin *agjent simulues*,⁷⁵ identifikojmë agjentin i cili kryen *veprime simuluese*. Ai përmes nxitjes, ofron rastin për të përshpejtuar kryerjen e një krimi, me të vetmin qëllim për të kapur fajtorët dhe për të siguruar provat.

⁷⁴ Ligj, Nr.8750, (2001), Për parandalimin dhe luftën ndaj trafikut të substancave narkotike ose psikotrope, Flet.Zyrtare Nr.14.

⁷⁵ Agjenti, që merr pjesë në përdorimin e metodave të "blerjes së stimuluar" e "dorëzimit të kontrolluar".

Sjellja e agentit "simulues" (provokator) mund të konsiderohet nxitje e ligjshme atëherë kur, aktiviteti i agentit simulon një vullnet psikik tashmë egzistues në personin e provokuar, për të kryer një krim. Ai mund të marri formë përcaktuese, kur agjenti sqaron apo nxjerr në pah qëllimin kriminal të personit të provokuar. Sjellje të mëtejshme, mund të jenë ato me pjesëmarrjen materiale, kur agjenti edhe pse nuk ka nxitur, gjithësesi merr pjesë në kryerjen e krimit.

Shumë shpesh ndodh, që agjenti "simulues" merr pjesë në formimin e vullnetit për të kryer një krim bashkë me personin e provokuar. Në këtë rast aktiviteti i tij me vështirësi mund të gjejë justifikim. (Catana, 2005)

Në raste të tilla, nga ana e agentit "simulues" çënohen ndalimet e parashikuara nga neni 294/a i K.Pr.Penal, pika 3, ku shprehimisht thuhet:

"Nuk duhet provokuar një akt kriminal, duke shtyrë një person të kryejë një krim, të cilin nuk do ta kishte kryer po të mos ishte ndërhyrja e policisë. Kur vërtetohet provokimi, rezultati nuk mund të përdoret."

Agjenti "simulues", ndryshe nga agjenti i infiltruar, është ai i cili edhe pse gjenden në të njëjtat kushte me këta të fundit, ka një sjellje aktive ose përfshirëse në idejimin dhe ekzekutimin e një apo më shumë fakteve penalisht të dënueshme. (Striano, 2012)

Kjo, referuar dhe ligjit 8750, neni 2:

"Punonjës i policisë nën mbulim", kuptohet oficeri ose agjenti i Policisë Gjyqësore, pjesëtar i shërbimit të luftës kundër drogës ose personi i autorizuar prej tyre, që merr pjesë në përdorimin e metodave të "blerjes së stimuluar" e "dorëzimit të kontrolluar",⁷⁶ duke fshehur bashkëpunimin me policinë ose cilësinë e tij si punonjës policie.

⁷⁶ Ligji 8750, datë 26.03.2001 "Për parandalimin dhe luftën ndaj trafikut të lëndëve narkotike ose psiko-trope", neni 2, pika 2.

Edhe në nenet 294/a dhe 294/b, shtuar me ligjin 9187, datë 12.02.2004, është bërë një dallim mes subjekteve dhe mes aktiviteteve të tyre hetimore, por pavarësisht kësaj, shpesh herë, kanë qenë objekt konfondimesh gjatë vënies në praktikë nga ana e organit procedues.⁷⁷

4.8. Ndikimet e veprimtarisë nën mbulim në personalitetin e agjentëve të fshehtë

Agjenti i infiltruar është një person, i cili përfshihet në një aktivitet hetimor, sa të veçantë aq dhe shumë delikat. Aktiviteti i tij karakterizohet nga një skenar operativ kompleks dhe që paraqet një rrezikshmëri të madhe për jetën e agjentit në fjalë. E gjithë kjo shkon në rrafsh të drejtë me nevojën e gjetjes së rezultateve. Vështirësitë reale për të menaxhuar një instrument të tillë inovativ, do të marrim në konsideratë variablin e natyrës psiko-socio-kriminologjike, më të cilën përballlet aktiviteti nën koperturë (undercover). (Striano, 2012)

Këtë trajtesë do ta fillonim duke u nisur nga motivet, të cilat e shtyjnë një person të përfshihet në një aktivitet të tillë.

- *Cili është ai motiv, që e shtyn agjentin e fshehtë të përfshihet në një aktivitet të tillë, përmëtepër, kur ai është i vetëdijshëm për të gjitha pasojat e mundshme me të cilat ai ose/dhe familja e tij do të përballen?*

Për të dhënë një përgjigje të tillë, në rastin më të keq do t'i referoheshim teorisë së psikoanalizës së Frojdit dhe frojdistëve të rinj, të cilët interesimin e opinionit për krimin, e shpjegojnë, (Halili, 2011:12)

”me përpjekjen e qytetarëve që t'i ndrydhin dhe frënojnë çytjet e tyre të brendshme dhe instiktet kriminale, të cilat flenë thellë në vetëdijen e çdo njeriu”. Sipas tyre, çdo njeri është kriminel potencial. (Halili, 2011:12)

Të njëjtin mendim ka patur edhe kriminologu J.V.Bemelen, autor i shquar holandez në fushën e kërkimeve dhe të studimeve të faktorëve të brendshëm psikikë të krimit, duke trajtuar arsyet e interesimit për krimin, në opinion, dhe duke intervistuar shumë delinkuente, policë

⁷⁷ Shih kapitullin IV. Vendimi nr. 201, dt. 05.07.2012, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë

dhe agjentë, që merren me zbulimin dhe ndjekjen e krimeve, konkludoi se, interesimi për krimin, në shumë raste vjen si rezultat i shtytjeve të brendshme të individëve të ndryshëm, që në ndërdijen e tyre, të identifikohen me kryesit e krimit, bile disa njerëz i zgjedhin profesionet e tyre të shtyrë nga kjo nxitje. (Halili, 2011:12)

Nisur nga teoritë e sipërcituara, policët dhe agjentët, të cilët përfshihen në organizatat kriminale, me qëllim zbulimin dhe proçedimin e subjekteve dhe aktiviteteve të tyre kriminale, s'janë gjë tjetër veçse, "kriminelë potencial", të cilëve u është besuar një detyrë aq sublimë, siç është luftimi i krimit të organizuar.

Në rastin më të mirë, do t'i jepnim përgjigje pyetjes së mësipërme duke iu referuar argumenteve të parashtruara nga autori amerikan E. Jonson, i cili ndryshe nga të parët, mendon se, shumë njerëz interesohen për krimin dhe i përkushtohen atij, ndërkohë të tjerë zgjedhin pikërisht ato profesione me qëllim që ta luftojnë atë, d.m.th nisen nga ndjenja humanitare dhe jo ndjenja kriminale, duke pasur si qëllim mbrojtjen e shoqërisë nga krimi. (Jonson, 1974:8-9)

Në pamundësi për t'i dhënë një përgjigje definitive pyetjes së mësipërme, ajo që është e sigurt është se detyra *undercover* paraqet një rrezik serioz, në të cilin subjekti duhet të jetë i paisur me një besueshmëri të fortë në aktivitetin në të cilin ai vepron. Dhe e gjithë kjo e fituar përmes një trajnimi kompleks dhe profesional, duke u finalizuar me menaxhimin e stresit pa anashkaluar ato elemente tekniko-operativ, që karakterizojnë hetimet, në të cilat agjenti i infiltruar vepron. (Jonson, 1974: 8-9)

Për të bërë më të qarta specifikat e kësaj veprimtarie, aktivitetin e agjentit të infiltruar mund ta trajtojmë në analogji me një nga metodat kriminologjike të studimit të kriminalitetit. Ajo njihet si *metoda e eksperimentimit, krahasimit dhe matjes*.

Metoda e eksperimentit është një metodë, e cila aplikohet zakonisht në shkencat natyrore dhe ekzakte. Në shkencat shoqërore, aplikimi i kësaj metode është i kufizuar dhe i rrallë. Të

eksperimentosh, siç dihet, do të thotë që në mënyrë artificiale t'i nxitësh dhe të shkaktosh proceset, për veprimet dhe dukuritë e ndryshme në botën reale. Përderisa në shkencat natyrore dhe ekzakte, si p.sh kimi, fizike, biologji, medicinë etj., është e mundur nxitja në mënyrë artificiale e shumë proceseve, dukurive dhe veprimeve, në shkencat shoqërore, është e vështirë ose shpeshherë e pamundur që të shkaktohen dhe të nxiten në mënyrë artificiale disa veprime, procese dhe dukuri kriminale. (Halili, 2011: 45)

Kështu, me të drejtë një autor, thekson se kriminaliteti është veprim i rrezikshëm dhe i dëmshëm shoqëror dhe nuk është e lejuar, që ai në mënyrë artificiale, të nxitet dhe të shkaktohet për qëllime të studimit apo të vrojtimit,⁷⁸ sepse në këtë mënyrë do të kryhej një veprë e re penale. (Halili, 2011: 45)

Përmetepër, duke trajtuar *Metodën e vrojtimit-observimit*, si një tjetër metodë kriminologjike mbi studimin e krimit, mes të tjerave parashtrohet se *vrojtimi direkt* është i pamundur të zbatohet në praktikë. Kjo për arsye, se infiltrimi i studiuesit ⁷⁹në grupin e delinkuentëve ose biseda e drejtëpërdrejtë me delinkuentin gjatë kryerjes së veprës penale është e vështirë por edhe e rrezikshme, pasi që asnjë grup delinkuentësh dhe asnjë delinkuent nuk lejon që gjatë kryerjes së veprës penale të marrë pjesë dikush, që nuk është anëtar i grupit ose nuk është drejtëpërsëdrejti i kyqur në kryerjen e krimit. Gjithashtu, edhe në rastet kur studiuesi është infiltruar pa dijen e delinkuentit apo grupit të delinkuentëve, ai mund të zbulohet dhe ta pësojë. *Po ashtu qëndrimi në grupin e delinkuentëve imponon që studiuesi apo hulumtuesi të sillet dhe të veprojë siç veprojnë delinkuentët, me fjalë të tjera, d.m.th. edhe ai të kryejë veprime kriminale, e kjo pastaj nuk është në interes të hulumtimit dhe studimit të veprimtarisë kriminale. (Halili, 2011: 45)*

⁷⁸ Vrojtim të cilin agjenti i infiltruar e bën përmes infiltrimit të tij në një grup kriminal, neni 294\b.

⁷⁹ Bëjmë analogji me figurën e *agjentin e infiltruar*, pasi si studiuesi ashtu edhe agjenti, përmes infiltrimit kryjnë të njëjtën veprimtari, por me pasoja të ndryshme për kriminelët e prezumuar. Studimi apo vrojtimi nga ana e studiuesit kanë si qëllim ndricimin e shkaqeve dhe formave të shfaqjes së krimit me qëllim, që të ndihmojë në parandalimin dhe mbrojtjen e shoqërisë nga dukuritë kriminale, por pa sjellë pasoja direkte për subjektet e aktivitetit në fjalë. Ndërsa, vrojtimi nga ana e agjentit të infiltruar, ka si qëllim identifikimin dhe zbulimin e strukturave kriminale dhe proçedimin e anëtarëve të saj, duke sjellë kështu pasoja direkte, për subjektet nën vrojtim.

Nga ana tjetër, shpesh herë ndodh, që studiuesi duke qëndruar për një kohë të gjatë në mesin e delinkuentëve, përkatësisht kriminelëve, t'i humbë kriteret për vlerësimin objektiv të karakteristikave dhe vetive të delinkuentëve të tillë. Në literaturë përmenden edhe raste kur studiues të këtillë, për shkak të ndikimit të delinkuentëve, kanë filluar të merren edhe vetë me aktivitete kriminale. Për këtë arsye, rreziqet në përdorimin e kësaj metode janë të shumta. (Halili, 2011: 44)

Veç sa trajtuam më lart, faktorët që paraqesin rrezikshmëri janë të shumtë, ku ndër to mund të shtojmë dhe: një keqmenaxhim të mundshëm të parave të vëna në dispozicion të tij për të bërë një *blerje të simuluar*, nevoja për të shkuar në vende jo të përshtatshme, të cilat nuk mund të kontrollohen dhe në të cilat agjenti rrezikon të mbahet peng. Grackat mund të jenë të shumta dhe lind nevoja e përgatitjes për t'u përballur në mënyrën më të mirë të mundshme. (Halili, 2011: 44)

4.8.1. Problemet sociale të agjentit të fshehtë

Pasi trajtuam aspektin kriminologjik të agjentit të infiltruar në raport me veprimtarinë, që ai ushtron, nuk mund të mos trajtojmë dhe impaktin social të kësaj veprimtarie, apo dhe problematikat, që vijnë si rrjedhojë e kësaj.

Puna në polici është njohur nga literaturë si shumë stresuese. Padyshim, që agjentët e policisë janë vazhdimisht të ekspozuar ndaj ngjarjeve traumatike apo stresuese gjatë kryerjes së punës së tyre. Përvojat traumatike të përjetuara në punë, mund të shkaktojnë dëme psikologjike në zhvillimin e çrregullimeve nga stresi post-traumatike. (Pietrantonio, Prati, Morelli, 2003:2)

Për të tilla çrregullime të aspektit psikologjik, të agjentëve të policisë do të ndalemi në paragrafët pasardhës, tani do të ndalemi në problematikat sociale me të cilat duhet të përballen agjentët e policisë gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tyre.

Puna si agjent i fshehtë, sjell pasoja të tilla si: lodhje kronike, ankthe dhe konflikte të njëpasnjëshme me kolegë, vështirësi në marrëdhëniet në çift, si dhe propabilitet për të pasur pasoja të rënda nga pikëpamja psikologjike. (Pietrantonio, Prati, Morelli, 2003: 7) Faktorët që ndikon janë të shumtë.

Ndër to mund të radhisim:

1. Ngjarjet stresuese të jashtme, që lidhen me organizimit burokratik të policisë, psh. Puna e zhvilluar nga sistemi gjyqësor, privilegjet në favor të kriminelëve, imazhi i keq social i policëve.

2. Ngjarje stresuese të brendshme, të lidhura me burokracitë dhe procedurat e brendshme organizative të policisë. Shembuj mund të jenë mungesa e mbështetjes, trajnimi adekuat, mbikëqyrja, një pagesë e ulët apo dhe ngjarje që kanë të bëjnë me organizimin siç është mungesa e komunikimit, mundësi të papërshtatshme që lidhen me karrierën, puna me turne si dhe pamundësia për të lëvizur në seksione të tjera.

3. Ngjarje stresuese, që lidhen me detyrën. Disa shembuj përfshijnë punën e organizuar në turne, konflikte rolesh si dhe mbingarkesa me punë.

Ngjarje stresuese individuale, që nuk lidhen me mjedisin e punës. Si shembuj marrim divorcet ose dhe probleme, që lidhen me shëndetin e vetë personit apo të familjarëve të tij (Pietrantonio, Prati, Morelli, 2003:7)

Një sërë faktorësh dhe elementësh të rëndësishëm për t'u marrë në konsideratë, sillen rreth mënyrës më të përshtatshme të mundshme në administrimin e identitetit të dyfishtë të agjentit të infiltruar, përmëtepër kur kushtet e stresit arrijnë pragun e *alert*. Koha që ai kalon “nën mbulim”, mund të vërë në moto një humbje të lehtë dhe graduale të identitetit të tij të vërtetë, ndihet një rritje të vazhdueshme të ndjenjës së izolimit, në fakt agjenti i infiltruar duhet të luftojë kundër prirjes për t'u identifikuar terësisht në rolin e kriminelit, duke arritur kështu të dhunojë dhe vlerat e tija morale (duke dhënë si shembull përdorimin e drogës apo

krijimin e lidhjeve sentimentale me persona të cilët kanë lidhje me familjet kriminale, të cilët janë objekt hetimi) duke u larguar kështu gjithmonë dhe më shumë nga roli i tij prej agjenti të policisë. (Striano, 2012)

4.8.2. Problemet psikologjike të agjentit të fshehtë

Agjensitë e ligjit në mbarë botën, punësojnë psikologë, për të zgjedhur, trajnuar, monitoruar dhe ndihmuar *oficerët e fshehtë*. Studime te ndryshme kanë dalë në konkluzionin, që një e katërta e agjentëve të fshehte aktivë shfaqin çrregullime psikologjike, kështu që, FBI në SHBA njih prej kohësh nevojën për ndihmë të konsiderueshme psikologjike. Akoma sot shërbimet britanike, për aq sa dimë, mbeten të dyshimtë ndaj psikologjisë shkencore, dhe janë vazhdimisht duke vuajtur pasojat. (Persaud, Canter, 2013)

Psikologu *Michel Girodo* nga kërkimet e tij mbi agjentët federale ka dalë në përfundimin se, “*në të shumtën e rasteve aktiviteti nën koperturë përbën një shtysë për agjentët në një përfshirje të mundshme në probleme me drogën, alkoolin, si dhe në probleme disiplinore*”.

Profesor *Michel Girodo*, *Trevor Deck* dhe *Melanie Morrison* nga Universiteti i Otavës, kohët e fundit ishin të frymëzuar shkencërisht për të hetuar ndikimin psikologjik të aktivitetit të fshehtë. Kjo, nisur nga historia e *Clifton James*, i cili kishte qenë i përfshirë në Shërbimet Sekrete Britanike gjatë Luftës së Dytë Botërore. I caktuar për t’u personifikuar në *Gjeneralin MONTGOMERY*, ai u ankua për lodhje në ruajtjen e identitetit të rremë, dhe për pakontrollueshmëri në rishfaqjen e personalitetit të ”*Monty*“, për një kohë të gjatë edhe pasi operacioni kishte përfunduar. (Persaud, Canter, 2013)

Të tjerë në mesin e *Mossad* - Shërbimit Sekret izraelit, kanë raportuar shqetësime në lidhje me identitetin e rremë. Për shembull, një agjent i infiltruar në një grup në Siri, pas disa

vitesh në këtë rol, u bë konfuz në lidhje me emrin dhe identitetin e tij të vërtetë. *Girodo, Deck* dhe *Morrison* përshkruajnë në një studim rreth oficerëve të fshehtë në Hawaii, të cilët zbuluan se 21 % e oficerëve u ankua se e përjetonin veten e tyre si "*joreale*" gjatë detyrave e tyre të fshehta. Çrregullimet me identitetin përfshijnë një agjent të fshehtë të FBI-së, i cili punonte në këtë profesion për dy vjet e gjysmë. U arrestua për vjedhje dyqani, duke pranuar se kishte vepruar nën identitetin e personit, të cilin ai po personifikonte, duke kryer veprime, të cilat nuk kishin të bënin fare me detyrën nën mbulim. Nuk arrinte të shpjegonte pse- në e kësaj rishfaqjeje të këtij personaliteti të rremë. (Persaud, Canter, 2013)

Një tjetër rast i raportuar nga *Girodo* dhe kolegët e tij, ka të bëjë me një agjent të FBI-së, i cili ishte përfshirë për 15 vite në role të thella nën koperturë, është arrestuar për "*vrasje të mbetur në tentativë*". Çrregullime shkëputëse nga identiteti (*Dissociative Identity Disorder*), e njohur si çrregullim të personalitetit shumëfish (*Multiple Personality Disorder*), hyri në mbrojtje të kapacitetit të zvogëluar. Personaliteti i tjetërsuar i agjentit, siç u pohua, kishte "marrë përsipër" ta drejtonte atë drejt një pengmarrjeje. (Persaud, Canter, 2013)

Në një studim të tyrin të titulluar "Dissociative-type Identity Disturbances in Undercover Agents: Socio-Cognitive Factors behind false-identity appearances and re-enactments". (Girondo, Deck, Morrison, 2002)

Girodo dhe kolegët e tij kanë hetuar 48 oficerë të policisë federale duke kaluar nëpër trajnime të fshehta në terren. 66 % e tyre, u identifikuan si persona, të cilët nxirnin identitetin e tyre të rremë jashtë kuadrit operacional. Një shpjegim i mundshëm për këto rezultate, botuar në revistën akademike "*Social Behaviour and Personality*", është se si aktorët, agjentët e fshehtë të suksesshëm inkorporojnë veten e tyre sa më shumë të jetë e mundur në identitetet e tyre të rremë. Ashtu si një aktor, agjentët e fshehtë përpiqen të përfshihen dhe të identifiko-

hen personalisht me pjesën. A mundet kjo, të këtë kontribuar në konfuzionin e identitetit të tij? A janë lloje të caktuara të personalitetit, të cilët tërhiqen nga rolet nën koperturë? (Persaud, Canter, 2013)

Në një tjetër hetim të titulluar *“Vice isn't nice: a look at the effects of working undercover”*, Profesorët *Mark Pogrebin* dhe *Eric Poole* nga Universiteti i Kolorados në Denver argumentuan, se fshehtësia e nevojshme për punën e policisë klandestine inkurajon vetë- përforsim, në shumë agjentë zhvillon një sens të ekzagjeruar të pushtetit. Ajo ka gjithashtu një cilësi varësie me përvojat e intrigës, një eksitim dhe një kontakt të mbrojtur me ilegalitetin. (Persaud, Canter, 2013)

Studimi i publikuar në *“Journal of Criminal Justice”*, thekson se agjenti i infiltruar zakonisht duhet të operojë vetëm, për më tepër, sa më i thellë të jetë niveli nën mbulim i kërkuar në një hetim të caktuar, aq më i izoluar bëhet oficeri. *Izolimi i tij në këto role mund të nxisin ndryshime të vërteta në qëndrime, vlera, besime, zakone, mënyrën e sjelljes, karakterin, dhe në identitet.* (Persaud, Canter, 2013)

Në këtë kapitull, njihemi me figurën e agjentit të infiltruar dhe atij simulues. Bëjmë dallimet mes këtyre dy figurave, si dhe mes veprimtarive që ato kryejnë. Trajtojmë bazën ligjore mbi të cilën mbështetet kjo veprimtari hetimore, sipas legjislacionit tonë.

Nisur nga kompleksiteti nga i cili karakterizohet kjo veprimtari, ndalemi në një analizë së detajuar, mbi ndikimet e mundshme të kësaj veprimtarie hetimore tek personaliteti i vetë agjentëve të fshehtë.

Në përfundim të kësaj analize arrijmë në konkluzionin se:

“Përfshirja për një periudhë kohore relativisht të gjatë në ushtrimin e këtij aktiviteti, çon në dobësimin gjithnjë dhe shumë të kontakteve me realitetin të agjentëve në fjalë, si dhe ripërfshirja e këtyre të fundit në aktivitete të tjera të të njëjtit lloj, nuk do t’i shërbente më qëllimit për të cilin ato do të angazhoheshin”.

KAPITULLI V: PROFILI PROCEDURAL

5.1. Pozicioni procedural i agjentit të infiltruar

Siç e kemi trajtuar dhe në kapitujt e mësipërm, aktiviteti nën mbulim, si një veprimtari e re hetimore, ka gjetur aplikim të gjërë kryesisht në disa sfera të veçanta të shfaqjes së krimit, ku denoncimet thuajse mungojnë, të tilla si: *krimet e korrupsionin, trafikëve, prostitucionit, krimi kibernetik etj.*

Rezultatet e përftuara nga veprimtaria e fshehtë- E gjithë kjo veprimtari ka si qëllim final grumbullimin e provave, (Neni 294/1 e K. Pr. P. të Rep. së Shqipërisë) që lidhen me aktivitetin kriminal për të cilin po hetohet, duke shërbyer kështu si një burim i rëndësishëm prove.

- Cili është kuptimi i provave sipas legjislacionit tonë procedural penal?

Kuptimi i provës penale jepet në nenin 149 të K.Pr.Penale, dispozitë në të cilën përcaktohen edhe elementët përbërës të saj. Nga kuptimi që i jep provës penale, legjislacioni ynë, mund të bëjmë përkufizimin e mëposhtëm;

“provë penale konsiderohet çdo njoftim, e dhënë, fakt apo rrethanë, që lidhet me një veprë penale të caktuar, që merret prej burimeve të njohura dhe parashikuara nga ligji procedural, në përputhje me rregullat e caktuara prej tij dhe që shërbejnë për të vërtetuar kryerjen ose jo të veprës penale, pasojat e ardhura prej saj, fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit dhe shkallën e përgjegjësisë së tij, si dhe çdo njoftim me interes për zgjidhjen e drejtë të çështje”. (Elezi, 2012:32)

Nisur nga përkufizimi i mësipërm, përmes të cilit është dhënë kuptimi provës penale, theksojmë rëndësinë që ka prova në zgjidhjen e çështjes, rëndësinë e marrjes së këtyre provave në përputhje me rregullat e përcaktuara me ligj, duke qënë se janë përcaktuese për fajësimin ose jo të personit të marrë nën hetim, si dhe shkallën e tij të përgjegjësisë. Në thelb

të gjithë kësaj qëndron dispozita e pikës 4 të nenit 151 të K. Pr. P., ku citojmë: “*Provat nuk mund të përdoret kur është marrë në shkelje të ndalimeve të parashikuar nga ligji*”.⁸⁰

Ligji përcakton qartë fatin e atyre provave të cilat janë marrë në shkelje të ndalimeve të përcaktuara me ligj, “*Provat nuk mund të përdoret*”.

Problematika, që përbën thelbin e këtij kapitulli është mënyra se si do të paraqiten këto prova në procesin penal. Kjo, nisur nga rëndësia e faktit që agjenti i infiltruar është i vetmi person, i cili ka dijeni rreth fakteve dhe provave të grumbulluara, si dhe duke ditur njëkohësisht që vetë ligji procedural penal, nuk e përjashton *agjentin e infiltruar* nga mundësia për të dëshmuar në proceset penale,⁸¹ në lidhje me provat e grumbulluara prej tij.

- Atëherë, ajo çfarë duhet sqaruar është pikërisht, mënyra e marrjes së kësaj dëshmie, në proceset penale.

Dimë që në shumë legjislacione të huaja marrja e dëshmisë, përcaktohet në bazë të *statusit procedural*, që gëzon me ligj agjenti gjatë kësaj fazë të procedimit penal.

- Sipas legjislacionit tonë, agjenti i infiltruar a e gëzon një status të tillë?

5.2. Dëshmia si provë

Dëshmitarët janë pjesëmarrës të rëndësishëm në pjesën më të madhe të proceseve gjyqësore. Për këtë arsye është e nevojshme të sigurohet sa më shumë të jetë e mundur që dëshmitarët të paraqiten në gjykim dhe të japin dëshmi të sakta dhe të vërteta. Kjo do të thotë që të ketë masa për parandalimin e dëmtimit, frikësimit, kanosjes apo ndikimit në forma të tjera të dëshmitarëve.

⁸⁰ Neni 151/ 4, K. Pr. P. të Rep. së Shqipërisë.

⁸¹ Neni 294/b/4, K.Pr.P. të Rep. së Shqipërisë.

Rëndësia e dëshmisë ka qënë dhe mbetet evidente. Dëshmia edhe sot mbetet aktuale në legjislacion tonë procedural penal dhe praktikën gjyqësore. Jo rrallë ajo paraqitet edhe si provë e vetme direkte, me njoftime të drejtpërdrejta në procesin penal.

Nga legjislacionet procedurale moderne dhe nga praktikat gjyqësore kjo provë konsiderohet si transmetim i gjallë i njoftimeve nga personat që kanë parë ngjarjen tek personat që do të vendosin e gjykojnë për ngjarjen e ndodhur. Dëshmia si provë ka rëndësi të madhe për të zbuluar të fshehtat që përmban në vetvete ngjarja kriminale, ajo është provë që luan rol të rëndësishëm në formimin e bindjes së brendshme të gjykatës në dhënien e drejtësisë penale. (Elezi, 2012:50)

Rregullat e përgjithshme mbi dëshminë. Në legjislacionin tonë procedural penal, dëshmia si provë parashikohet në dispozitat e kreut II-të (sek I) të Titullit IV të K.Pr.Penale.⁸² Në këto dispozita përcaktohet qartë objekti, kufijtë, llojet, zotësia për të dëshmuar si dhe të drejtat e detyrimet e dëshmitarit. Sipas legjislacionit tonë⁸³ prova e dhënë nga dëshmitari nëpërmjet dëshmisë tij për shkak të burimit të marrjes së njoftimit nga dëshmitari, direkt apo indirekt, mund të jetë e drejtpërdrejtë apo indirekte e prejardhur ose e tërthortë. (Elezi, 2012:50) Nga ky rregull i përgjithshëm, nuk bën përjashtim as *dëshmia e agjentit të infiltruar*, e paraqitur si provë në procesin penal.

⁸² Nenet 153-165 të K.Pr.Penale

⁸³ Neni 153/1,2,3 të K.Pr.Penale, Objekti dhe kufijtë e dëshmisë

1. Dëshmitari pyetet për faktet që përbëjnë objekt prove. Ai nuk mund të dëshmojë për qëndrimin moral të të pandehurit, përveçse kur çështja lidhet me fakte që vlejnë për përcaktimin e personalitetit të tij në lidhje me veprën penale dhe me rrezikshmërinë shoqërore.

2. Pyetja e dëshmitarit mund të shtrihet edhe në marrëdhëniet e farefisnisë dhe të interesave që ekzistojnë ndërmjet dëshmitarit dhe palëve apo dëshmitarëve të tjerë, si dhe mbi rrethanat, vërtetimi i të cilave është i nevojshëm për vlerësimin e besueshmërisë së tij. Dëshmia mbi faktet që shërbejnë për të përcaktuar personalitetin e të dëmtuarit nga vepra penale pranohet vetëm kur akuza e të pandehurit duhet të çmohet në raport me sjelljen e të dëmtuarit.

3. Dëshmitari pyetet për fakte të caktuara. Ai nuk mund të dëshmojë për çka flitet në publik dhe as të shprehë vlerësime personale, me përjashtim të rasteve kur ato nuk mund të ndahen nga dëshmia për faktet.

Dimë që një nga shkaqet më të shpeshta për vonesën e proceseve gjyqësore në Shqipëri është mosparaqitja e dëshmitarëve. Kjo mund të ndodhë për shkaqe të ndryshme, që nga vonesat për të lokalizuar dhe njoftuar dëshmitarët deri tek refuzimi nga ana e dëshmitarëve për t'u paraqitur nga frika për ndëshkim. Dëshmitarët mund të vriten me qëllim që të mos dëshmojnë, gjithashtu mbi ta mund të ushtrohet presion me anë të dhunës apo kërcënimeve ose ata edhe mund të “blihen”. Kur dëshmitarët paraqiten në gjyq, në përgjithësi nuk ekziston një ambient i mbrojtur për ta, gjë që në shumë raste lejon që ata të konfrontohen me palët ose me persona që kanë lidhje me palët. Kjo gjë bën që dëshmitarët të jenë pre e kërcënimit dhe dhunës. Ka gjithashtu edhe dëshmitarë të cilët mund të mos frikësohen nga presionet, por që dëshmia e tyre mund të ndikohet negativisht nga prania e të pandehurit apo personave të tjerë.⁸⁴

Detyrimi për t'u paraqitur si dëshmitar duhet të balançohet nga ana tjetër me të drejtën e jetës të dëshmitarit dhe të familjes siç shprehet në *nenet 2 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut* dhe me të drejtën e përgjithshme për sigurinë e personit dhe të pronës.⁸⁵

Po t'i referohemi çështjes “*Doorson*”, *Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut u shpreh:*

Është e vërtetë që neni 6, nuk kërkon shprehimisht që të merren parasysh interesat e dëshmitarëve në përgjithësi dhe në veçanti interesat e viktimave që thirren për të dëshmuar. Gjithsesi, mund të vihet në rrezik jeta, liria apo siguria e personit si dhe interesat që rrjedhin përgjithësisht nga neni 8 i Konventës. Të tilla interesa të dëshmitarëve dhe viktimave në parim mbrohen nga dispozita të tjera të shkruara të Konventës, të cilat nënkuptojnë që Shtetet kontraktuese duhet t'i organizojnë procedimet e tyre penale në mënyrë të tillë, që këto interesa të mos vihen në rrezik pa arsye të justifikueshme. Në këtë kontekst, parimet e procesit të rregullt gjyqësor kërkojnë që aty ku është e përshtatshme, interesat e mbrojtjes të balançohen me ato të dëshmitarëve apo viktimave të thirrura për të dëshmuar. (Çështja e Gjykatës

⁸⁴ Nenet 153-165 të K.Pr.Penale

⁸⁵ Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë Prezenca në Shqipëri(OSCE), (2006), Analizë e sistemit të Drejtësisë Penale në Shqipëri, “RAPORT I PROGRAMIT PËR ZHVILLIMIN E NJË GJYKIMI TË DREJTË”: 191-192.

Europiane të të Drejtave të Njeriut, "Doorson kundër Hollandës", 26 mars 1996, paragrafi 70)

Programi i mbrojtjes së dëshmitarëve përfaqëson mjetin e fundit, me anë të të cilit sigurohet dëshmia e plotë e një personi në një proces penal. Në këtë kuptim, njëri nga kushtet e pranimin në këtë program është ekzistenca e rrezikut për jetën ose shëndetin që i paraqitet personit për shkak të bashkëpunimit të tij me organin procedues.⁸⁶

Më datë 22 tetor 2009 u miratua nga *ligji nr. 10173 "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë"*, i cili dhe ky u ndryshua me *ligjin nr. 10 461* të datës 13.09.2011.⁸⁷

Këto ligje zëvendësuan *ligjin nr.9205*, datë 15.3.2004, i cili ishte ligji që krijoi programin e parë të mbrojtjes së dëshmitarëve. Ligji i vitit 2004 ofronte një mekanizëm që u jepte mbrojtje vetëm dëshmitarëve në çështjet e krimeve të rënda, pra veprave penale që janë në kompetencën e gjykatave për krimet e rënda. Sipas ligjit të ri, fusha e veprimit të programit të mbrojtjes shtrihet në të gjitha krimet, për të cilat parashikohet dënim me burgim jo më pak se katër vjet në minimum.⁸⁸ (Mujaj, 2013: 8)

Qëllimi i ligjit është të sigurojë një mbrojtje efektive për dëshmitarët dhe bashkëpunëtorët e drejtësisë të përfshirë në raste krimesh të rënda. Përkufizimi i "*krimit të rëndë*" në zbatim të ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve, ka një fushë veprimi të ndryshme nga juridiksioni i Gjykatave për Krime të Rënda. Kjo do të thotë, që raste që përfshijnë persona nën mbrojtje mund të gjykohen nga gjykata të ndryshme rrethesh, por do të thotë gjithashtu që masat për mbrojtjen e dëshmitarëve nuk janë të zbatueshme për të gjithë personat e përfshirë në pro-

⁸⁶ Çështja e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, "Doorson kundër Hollandës", 26 mars 1996, paragrafi 70.

⁸⁷ Ligj, nr.10461, datë 13.09.2011, Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10 173, datë 22.10.2009 "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë".

⁸⁸ Udhëzues për Hetimin e Korrupsionit dhe Krimin Financiar, 2010:79.

ceset gjyqësore të Gjykatave për Krime të Rënda. Megjithatë, në shumicën e rasteve, personat që janë subjekt i mbrojtjes sipas ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve, d.m.th., dëshmitarë të mbrojtur dhe bashkëpunëtorë të drejtësisë, janë të përfshirë në çështje që gjykohen nga Gjykatat e Krimeve të Rënda (GjKR).⁸⁹

Kjo pasqyrohet qartë në vendimin e Gjykatës së Shkallës së parë për Krimet e Rënda të datës me 16.01.2012, me të pandehur L.B., P.D., I.T., E. D., D. C., (bashkëpunëtori i drejtësisë), S.S., etj., (e njohur si çështja e “Bandës së Durrësit”).⁹⁰

⁸⁹ Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë Prezenca në Shqipëri (OSCE), (2006), Analizë e sistemit të Drejtësisë Penale në Shqipëri, “RAPORT I PROGRAMIT PËR ZHVILLIMIN E NJË GJYKIMI TË DREJTË”:193.

⁹⁰ “I pandehuri Coli, si gjatë fazës së hetimeve paraprake edhe në gjykim, rezulton se ka dhënë ndihmesë të çmuar për zbardhjen e së vërtetës për një sërë çështjesh penale të ndodhur në Durrës e rrethinat e tij, në periudhën Tetor 1998, deri në Tetor 2005.

Po kështu, në lidhje me pretendimet e disa mbrojtësve se i pandehuri Coli ka qënë kontradiktor, se nuk ka qënë i sinqertë në deklaratimet e dhëna para gjykatës, sepse ka bërë shtesa e ndryshime të deklaratimeve të dhëna në fazën e hetimeve paraprake, se nuk ka dhënë rrethana të disa ngjarjeve të tjera kriminale etj, e për këtë shkak, jo vetëm deklaratimet e tij, por edhe marrëveshja me organin e Prokurorisë nuk është e vlefshme, Gjykata vlerëson se këto pretendime nuk qëndrojnë.

Gjykata vlerëson kurajon, përkushtimin sinqeritetin e të pandehurit Coli për t’i bërë prezent dijenitë e tij rreth veprimtarisë kriminale të kryer prej tij dhe të të pandehurve të tjerë në gjykim.

Sigurisht ai duke qënë qenie humane, nuk mund të deklarojë në çdo rast, në mënyrë të përpiktë detaje të hollesishme, të njëjta të ngjarjeve që ka përjetuar. Ndryshimet që pretendojnë disa prej mbrojtësve në deklaratimet e tij, brenda këtij gjykimi, (në të cilin, siç është thënë në fillim të këtij arsytimi, ka qëndruar përballë palëve në gjykim për shumë senaca gjyqësore) apo me deklaratimet e dhëna në fazën e hetimeve paraprake, janë brënda logjikës së përgjigjeve të një njeriu të zakonshëm.

Gjykata nuk konstaton kontradikta thelbësore, por, ndonëse nuk i vë në dyshim ato, në rastin e vlerësimit si provë në procesin penal, i merr në konsideratë në themel të këtij vendimi, vetëm për aq sa këto deklaratime konfirmohen nga provat e tjera, sipas parashikimit të nenit 152/3 të K.pr.Penale.

Prandaj në llojin e masën e dënimit për të pandehurin Dritan (Adriatik) Coli, duke vlerësuar se ai i është përmbajtur plotësisht marrëveshjes së bashkëpunimit me Prokurorinë për Krime të Rënda, Gjykata do të ketë në konsideratë parashikimin e nenit 28/7 të K.Penal në lidhje me nenet 37/a të K.Pr.Penale si dhe të dispozitave respektive të ligjit të mëparshëm “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”, si atë të vitit 2004, ashtu edhe të ligjit aktual sipas ligjit të vitit 2009 dhe çmon ta dënojë përfundimisht me dhjetë vjet burgim.”

Sipas tabelave përmbledhëse të: Analizës së sistemit të Drejtësisë Penale në Shqipëri, “RAPORTI I PROGRAMIT PËR ZHVILLIMIN E NJË GJYKIMI TË DREJTË”, OSCE, Tiranë.⁹¹

Fusha e veprimit e ligjit për mbrojtjen e Dëshmitarëve		Juridiksioni i Gjykatave për Krime të Rënda	
Neni i KP	Vepra Penale	Neni i KP	Vepra Penale
73	Genocidi	73	Genocidi
74	Krime kundër njerëzimit	74	Krime kundër njerëzimit
75	Krimet e luftës	75	Krimet e luftës
79 a-ë	Vrasje me dashje për arsye të cilësive të veçanta të viktimës	79 c, ç	Vetëm kundër funksionarëve publikë(c), kallëzuesit, dëshmitarit, të dëmtuarit ndërgjyqëse(ç)
89/a	Shitblerja e transplantëve		
100	Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur		
101	Marredheniet seksuale ose homoseksuale me dhune me të miturit të moshës 14-18 vjeç		
109	Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit	109	Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit
		109/b	Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë
110/a	Trafikimi i personave	110/a	Trafikimi i personave
111	Rrëmbimi i avionëve, anijeve dhe të mjeteve të tjera	111	Rrëmbimi i avionëve, anijeve dhe mjeteve të tjera
114/a	Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana renduese		

⁹¹ Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë Prezenca në Shqipëri(OSCE), (2006), Analizë e sistemit të Drejtësisë Penale në Shqipëri, “RAPORTI I PROGRAMIT PËR ZHVILLIMIN E NJË GJYKIMI TË DREJTË”:194-195.

114/b	Trafikimi i femrave për Prostitucion	114/b	Trafikimi i femrave për Prostitucion
128/b	Trafikimi i të miturve	128/b	Trafikimi i të miturve
208	Dorëzimi i territorit		
209	Dorëzimi i forcave të armatosura		
211	Provokimi i luftës		
213	Dhënia e informatave sekrete		
219	Atentati	219	Atentati
220	Komploti	220	Komploti
221	Kryengritja	220	Komploti
222	Thirrjet për armatosje ose marrja pa të drejtë e komandës		
230	Aktet terroriste	230	Aktet terroriste
230/a	Financimi i terrorizmit	230/a	Financimi i ter- rorizmit
		230/b	Fshehja e fondeve dhe e pasurive të tjera, që financojnë tërror- izmin
231	Veprat e dhunshme ndaj Pasurisë	231	Veprat e dhunshme ndaj Pasurisë
232	Shpërndarja e substancave të Rrezikshme	232	Shpërndarja e substancave të Rrezikshme
233	Krijimi i turmave të Armatosura	233	Krijimi i turmave të Armatosura
234	Prodhimi i armëve luftarake	234	Prodhimi i armëve Luftarake
		234/a	Organizata terror-

			iste
		234/b	Banda e armatosur
278/a	Trafikimi i armëve dhe i Municionit	278/a	Trafikimi i armëve dhe i Municionit
283	Prodhimi dhe shitja e narkotikeve		
		283/a	Trafikimi i narkotikëve
284/a	Organizimi dhe drejtimi i	284/a	Organizimi dhe drejtimi
	organizatave kriminale		i organizatave kriminale
284/c	Prodhimi dhe fabrikimi i lëndëve narkotike dhe psikotrope		
284/ç	Prodhimi, tregtimi dhe përdorimi i paligjshëm i prekursorëve		
286	Nxitja për përdorimin e drogës		
287	Pastrimi i produkteve të veprës penale		
		287/a	Çelja e llogarive Anonime
333	Organizata Kriminale	333	Organizata kriminale
		333/a	Grupi i strukturuar Kriminal
334	Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal	334	Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal

Tabela 5.1

Në këtë kapitull, dëshmitarët ndahen, jo me shumë rigorozitet, në tri kategori: **dëshmitarë të mbrojtur, dëshmitarë të përfshirë në çështje të Gjykatës për Krime të Rënda dhe dëshmitarë të tjerë.**⁹²

5.2.1. Dëshmitarët e mbrojtur dhe bashkëpunëtorët e drejtësisë

Për t'u cilësuar si të tillë, dëshmitarët dhe bashkëpunëtorët duhet të jenë të përfshirë në një çështje “*krimi të rëndë*”, siç përcaktohet në ligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve. Dëshmia e personit duhet të jetë e një rëndësie themelore për çështjen ose duhet të shërbejë për të parandaluar krime të tjera të rënda dhe personi duhet të jetë “*në gjendje rreziku aktual, konkret dhe serioz*” dhe të jetë i gatshëm të bashkëpunojë plotësisht.⁹³

Masat e posaçme të mbrojtjes janë:

*“Ndryshimi i identitetit, ndryshimi i vendbanimit, mbrojtja e përkohshme e identitetit, e të dhënave dhe dokumenteve, masa të veçanta mbrojtëse, fizike dhe teknike, rehabilitimi social, ruajtja, ndryshimi dhe sigurimi i përkohshëm i vendit të punës, dhënia e ndihmës financiare, rikualifikimi profesional, dhënia e këshillave dhe e ndihmës së specializuar” ligjore ose mënyra të tjera të caktuara sipas ligjit.”*⁹⁴

Sipas këtij ligji, edhe personat e afërm ose të lidhur me një dëshmitar të mbrojtur apo bashkëpunëtor të drejtësisë mund të përfitojnë masat e posaçme të mbrojtjes. Ligji i përkufizon “*personat e afërm*” si personat që ndodhen në gjendje rreziku aktual, konkret dhe serioz për shkak të lidhjeve familjare, të gjinisë a krushqisë me dëshmitarin ose bashkëpunëtorin e

⁹² Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë Prezenca në Shqipëri (OSCE), (2006), Analizë e sistemit të Drejtësisë Penale në Shqipëri, “RAPORT I PROGRAMIT PËR ZHVILLIMIN E NJË GJYKIMI TË DREJTË”:192.

⁹³ Ligj, nr.10461, date 13.09.2011, Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10 173, datë 22.10.2009 “*Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë*”

⁹⁴ Ligj, nr.10461, date 13.09.2011, Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10 173, datë 22.10.2009 “*Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë*”, neni 10.

drejtësisë, ndërsa “*personat e lidhur*” përcaktohen si personat që, për shkak të natyrës së marrëdhënieve konkrete që kanë me dëshmitarin ose bashkëpunëtorin e drejtësisë, ndodhen në gjendje rreziku aktual, konkret dhe serioz.⁹⁵ Në seancat gjyqësore, *dëshmitarët e mbrojtur dhe bashkëpunëtorët e drejtësisë* mund të dëgjohen nën një identitet tjetër/të rremë me anë të metodave të posaçme për deformimin e zërit ose me anë të lidhjes audiovizive.⁹⁶

5.2.2. Dëshmitarët në Gjykatën për Krime të Rënda (GJKR)

Përveç masave të rezervuara për dëshmitarët e mbrojtur dhe bashkëpunëtorët e drejtësisë,⁹⁷ GJKR mund të lejojë që përpara tyre të pyetet çfarëdo dëshmitari në prani të të pandehurit dhe avokatit mbrojtës, por pa qenë në kontakt vizual me ta.⁹⁸ GJKR-së i lejohej më tepër se gjykatave të tjera për të mbajtur seanca me dyer të mbyllura, sidomos kur bëhet fjalë për sigurinë e ndonjë pjesëmarrësi.⁹⁹ Sidoqoftë, përdorimi i dëshmitarëve anonimë duhet të jetë i kufizuar, pasi kjo gjë e mbart në vetvete rrezikun që i pandehuri të mos ketë mundësinë t’i kundërshtoj efektivisht deklaratat e një dëshmitari. Gjykata Evropiane ka gjykuar, se dëshmitarët anonim nuk janë provë e mjaftueshme për të bazuar dënimin dhe që kur përdoren *dëshmitarë anonim*, problemi që kjo gjë i shkakton mbrojtjes duhet kompensuar me anë të procedurave që ndiqen nga autoritetet gjyqësore.¹⁰⁰

⁹⁵ Ligj, nr.10461, date 13.09.2011, Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10 173, datë 22.10.2009 “*Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë*”, Flet. Zyrtare Nr.135, Faqe : 6090, neni 2, paragrafi 3, 4, dhe neni 9.

⁹⁶ Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve, neni 10 paragrafi 1 d), K.Pr.P neni 361/a dhe ligji “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda”, neni 8 c.

⁹⁷ Vendimi i Gjykatës së Shkallës së parë për Krimet e Rënda të datës me 16.01.2012, me të pandehur L.B., P.D., I.T., E. D., D. C., (bashkëpunëtori i drejtësisë), S.S., etj., (e njohur si çështja e “Bandës së Durrësit”)

⁹⁸ Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë Prezenca në Shqipëri(OSCE), (2006), Analizë e sistemit të Drejtësisë Penale në Shqipëri, “RAPORT I PROGRAMIT PËR ZHVILLIMIN E NJË GJYKIMI TË DREJTË”, Shtëpia botuese & Shtypshkronja Pegi, Tiranë, fq. 196.

⁹⁹ Ligji nr. 9110, date 24.07. 2003, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave për Krime Të Rënda”, Flet.Zyrtare Nr.78, Faqe: 3487, neni 7.

¹⁰⁰ Çështja “Kostovski kundër Hollandës”, 20 nëntor 1989, paragrafi 43, 44, si dhe çështja “Doorson kundër Hollandës”, 26 mars 1996, paragrafi 71 e në vazhdim.

5.2.3. Dëshmitarët e tjerë

Fakti që një dëshmitar nuk i përmbush kriteret për të qenë i mbrojtur sipas ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve, apo nuk pyetet në GJKR, nuk do të thotë që nuk ekziston kërcënimi, madje i fortë, ndaj një dëshmitari të tillë. Për më tepër, siç u theksua edhe më sipër, në rastet që kanë të bëjnë sidomos me dhunën në familje apo dhunën seksuale, mund të jetë shumë e vështirë për dëshmitarët të flasin lirshëm në prani të të pandehurit dhe/apo të personave të tjerë. Prandaj, është e nevojshme të shihet në tërësi se çfarë masash mund të merren në raste të ndryshme dhe çfarë mund të bëhet për të përmirësuar situatën pa kompromentuar të drejtat e mbrojtjes. Për ata dëshmitarë të cilët nuk janë as dëshmitarë të mbrojtur as të thirrur në GJKR, zbatohen rregullat e zakonshme për dëgjimin e dëshmitarëve. Në këto kushte, si rregull i përgjithshëm dëshmitari paraqitet në një seancë publike ku identiteti dhe adresa e të cilit bëhen të ditura dhe ku ai përballlet me të pandehurin dhe avokatin mbrojtës.¹⁰¹

Në kuadrin aktual ligjor ka një sërë rregullash që mund të përdoren për të ndaluar ndikimin apo kërcënimin e dëshmitarëve. Këto rregulla janë të zbatueshme për të gjithë dëshmitarët në çështjet penale.¹⁰² Kështu që, aty ku ka arsye për të besuar se personi mund të jetë i ekspozuar ndaj dhunës, kërcënimeve apo të ofertave përfitimi me qëllim që të mos dëshmojë apo të bëjë dëshmi të rreme, mund të sigurohet prova gjatë hetimit paraprak. Kjo do të thotë se dëshmitarit nuk do t'i duhet të paraqitet në gjyq dhe që në këtë mënyrë krijohen më pak premisa për të ndikuar dëshmitarin.¹⁰³ Seanca kryhet në praninë e detyrueshme të avokatit

¹⁰¹ Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë Prezenca në Shqipëri(OSCE), (2006). Analizë e sistemit të Drejtësisë Penale në Shqipëri, "RAPORT I PROGRAMIT PËR ZHVILLIMIN E NJË GJYKIMI TË DREJTË", Shtëpia botuese &Shtypshkronja Pegi, Tiranë, fq. 197.

¹⁰² Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë Prezenca në Shqipëri(OSCE), (2006). Analizë e sistemit të Drejtësisë Penale në Shqipëri, "RAPORT I PROGRAMIT PËR ZHVILLIMIN E NJË GJYKIMI TË DREJTË", Shtëpia botuese &Shtypshkronja Pegi, Tiranë, fq. 197.

¹⁰³ Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, neni 316.

mbrojtës dhe i pandehuri ka të drejtë të jetë i pranishëm.¹⁰⁴ Një arsye për të mbajtur një seancë me dyer të mbyllura, d.m.th., seancë pa praninë e publikut dhe medias, është që të mbrohen dëshmitarët apo të pandehurit në çështjet penale.¹⁰⁵ Në ato çështje penale ku është absolutisht e pamundur paraqitja e dëshmitarit, gjykata, me kërkesën e palëve, mund të vendosë të marrë në pyetje një dëshmitar apo ekspert në vendbanimin e tij.¹⁰⁶ Për sa i përket konceptit pamundësi absolute, kjo shprehje e fortë tregon se kjo dispozitë është e zbatueshme vetëm kur dëshmitari nuk mund të paraqitet për shkak të një sëmundjeje të rëndë apo për arsye të tjera shtrënguese. Megjithatë, në Komentarin e K.Pr.P. shpjegohet vetëm që kur dëshmitari nuk paraqitet për arsye të përligjura, seanca mund të mbahet në vendqëndrimin e tij. (Islami, Hoxha, Panda, 2003: 489)

Për këtë arsye, mund të argumentojmë se në rastet kur kërcënohet siguria e një dëshmitari dhe dëshmitari nuk i përmbush kriteret për mbrojtje nga ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve, mund të zbatohet kjo dispozitë, dhe në raste të tilla i pandehuri mund të përjashtohet kur shihet e nevojshme. Në çështjet penale gjykata mund të largojë cilindo person, që pengon zhvillimin normal të seancës.¹⁰⁷

Konventa e Palermos,¹⁰⁸ ku Shqipëria është palë, e cila është e zbatueshme për krimin ndërkombëtar e të organizuar, u kërkon shteteve anëtare të përcaktojnë rregulla të qarta për të lejuar që dëshmitë e dëshmitarëve të jepen në mënyrë të tillë që të mbrojnë sigurinë e dëshmitarit/viktimës, siç janë lejimi i dhënies së dëshmisë nëpërmjet lidhjes audiovizive apo

¹⁰⁴ K. Pr. P., neni 321, 322.

¹⁰⁵ K. Pr. P., neni 340.

¹⁰⁶ K. Pr. P., neni 364.

¹⁰⁷ K. Pr. P., neni 341.

¹⁰⁸ Ligj, Nr.8920, datë 11.07.2002, "Për ratifikimin e "Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar" dhe dy protokolleve shtesë të saj (Konventa e Palermos), Flet.Zyrtare Nr.41, Faqe:1195.

mjeteve të tjera të përshtatshme.¹⁰⁹ Për më tepër neni 361/a, i cili u miratua me të njëjtin ligj, si dhe pika 7 e nenit 361,¹¹⁰ parashikon që:

“Kur disponon mjete teknike, gjykata mund të vendosë që marrja në pyetje e tyre të zhvillohet në distancë me anë të lidhjes audiovizive, sipas rregullave të parashikuara në pikën 7 të nenit 361”.

Kjo dispozitë në veçanti dhe referimi ndaj pikës 7 të nenit 361, është një tregues mjaft i qartë që masat e përcaktuara në pikën 7 të nenit 361, janë të zbatueshme vetëm për *dëshmitarët e mbrojtur dhe bashkëpunëtorët e drejtësisë*. Në anën tjetër, duke pasur parasysh se pika 7 e nenit 361 nuk përmban kufizime apo kushte për zbatimin e saj, duhet arsyetuar se kjo dispozitë është e zbatueshme për të gjithë dëshmitarët, kur ekzistojnë probleme sigurie.¹¹¹ (Mujaj, 2013:10).

5.3. Dëshmia e agjentit të infiltruar në proceset penale

Gjatë marrjes së dëshmisë së agjentit të policisë të infiltruar në një veprimtari kriminale veç kërkesës imperative për respektimin dhe zbatimin e procedurave të K.Pr.P të parashikuara në dispozitat e neneve 153-168 të K.Pr.P., duhet të merret në konsideratë edhe disa specifika. Specifikat gjatë kryerjes së këtij veprimi procedural, burojnë nga statusi i veçantë procedural, që i është dhënë figurës së agjentit të infiltruar dhe personit që kryen veprimet simuluese.

1- Jemi përballë rreziqeve evidente, sa i përket sigurisë fizike të agjentit të infiltruar, për më tepër rreziku shtohet, nëse ai është një qytetar i thjeshtë.

¹⁰⁹ Konventa e Palermos, neni 24, paragrafët 2 b dhe 4, shih gjithashtu nenin 18, paragrafin 18.

¹¹⁰ Ligji nr. 9276, datë 16. 09. 2004, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21. 03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”, Flet.Zyrtare Nr.69, Faqe: 4599.

¹¹¹ Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë Prezenca në Shqipëri(OSCE), (2006), Analizë e sistemit të Drejtësisë Penale në Shqipëri, “RAPORT I PROGRAMIT PËR ZHVILLIMIN E NJË GJYKIMI TË DREJTË”, Shtëpia botuese & Shtypshkronja Pegi, Tiranë, fq. 198.

2- Mund të digjet çdo mundësi tjetër punësimi i agjentit në veprimtari të tjera të të njëjtit lloj, përmëtepër aktiviteti i tij nënkupton infiltrimin në organizata kriminale të mirëstrukturuara dhe të organizuara në territor. Përballë një mekanizmi të tillë, do të ishte një vetëvrasje e vërtetë për kredibilitetin e këtij institucioni si dhe besueshmërinë, që çdo qytetar duhet të ushqejë në raport me këtë institucion.

Duke qënë se sipas legjislacionit shqiptar veprimet hetimore të “*Veprimeve simuluese*” dhe “*Punonjësi i policisë i infiltruar*”, janë mjete që shërbejnë si burim prove, e gjithë veprimtaria e agjentit të infiltruar gjatë fazës hetimore duhet të finalizojë me grumbullimin e provave.¹¹² Problematika, që përbën thelbin e kësaj trajtese është pikërisht pozicioni procedural i agjentit të infiltruar dhe mënyra se si do të paraqiten provat e grumbulluara në procesin penal.

Mënyra e marrjes së dëshmisë nga gjykata mund të ndryshojë me vendim të ndërmjetëm të saj, kjo në varësi të kushteve dhe shkaqeve objektive që rezultojnë gjatë gjykimit të çështjes. Këtu janë rastet kur dëshmitari ndodhet jashtë shtetit, nuk gjendet dhe shkaqe të tjera mbi bazën e të cilave nga gjykata procedohet me leximin e thenieve të tij para prokurorit apo marrjen nëpërmjet letërporosisë, sipas nenit 509 të K.Pr.Penale. Marrjen e dëshmisë nga dëshmitarë të cilët ndodhen jashtë shtetit, bëhet duke repektuar jo vetëm kërkesat e nenit 360, 361 të këtij kodi por edhe ato të parashikuara nga neni 509 dhe 511 të K.Pr.Penale dhe Konventën “*Për ndihmë të ndërsjelltë juridike në fushën penale*”, ratifikuar me ligjin Nr. 8498 datë 10.06.1999. Shteti shqiptar e ka nëshkruar këtë konventë me rezervë me kushtin e respektimit të kërkesave të nenit 360 të Kodit tonë të Procedurës Penale, kusht ky i cili është bërë pjesë e nenit 3 të Konventës së mësipërme. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur shteti italian dhe shtete të tjera, kur kanë ratifikuar “*Konventën Europiane për ndihmë të ndërjeslltë ju-*

¹¹² Neni 294, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë.

ridike në fushën penale” në përputhje me kërkesat dhe parimet e së drejtës tyre të brendshme. (Elezi, F., 2012: 69)

*“...dëshmia e M.P dhënë para autoriteve italiane në bazë të kërkesës dhe në zbatim të letërporosisës autoriteve shqiptare... rezulton se dëshmitarja është paralajmëruar... për të thënë të vërtetën...si dhe për përgjegjësinë nëse jep shpjegime të rrejshme”.*¹¹³

Në këtë kuptim, që dëshmia të këtë vlerën e provës gjyqësore, duhet detyrimisht që nga ana e shtetit që ekzekuton letërporosinë, në zbatim të nenit 509 të K.Pr.Penale dhe Konventës, marrjen e dëshmisë duhet ta realizojë gjykata si i vetmi autoritet që ka njohur legjislacioni ynë procedural. Ky tashmë është qëndrim i qartë i mbajtur nga ana e gjykatave të apelit dhe sidomos nga ana e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Marrja e dëshmisë nga autoritetet e huaja në ekzekutim të letërporosisë duhet të bëhet nga gjykata sipas rregullave procedurale mbi marrjen e dëshmisë në gjykim dhe jo nga organe të tjera proceduese. (Elezi, F., 2012:70)

*“..marrja e deklarimeve të shtetasve grekë, dëshmitarve Dh.S, L.R, P.K dhe Dh.K. në zbatim të letërporosisë konform nenit 509 të K.Pr.Penale, nuk është ekzekutuar në gjykatë, duke mos u marrë dëshmitë gjatë hetimit gjyqësor, por një procedurë e tillë është realizuar përpara autoritetit të hetuesisë të shtetit Grek, pra dëshmitë nuk janë marrë e verifikuar nga gjykata, në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit shqiptar, nenit 360 të K.Pr.Penale”.*¹¹⁴

Jurisprudenca e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut për efekt të respektimit të detyrimeve që rrjedhin nga përcaktimet e nenit 6/3 pika “d”, të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut,¹¹⁵ në përkufizimin “*dëshmitar*” ka përfshirë edhe shpjegimet e dhëna

¹¹³ Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në vendimin Nr 51 datë 22.02.2012 arsyeton në lidhje me respektimin e kërkesave të nenit 360 të K.Pr.Penale në kushtet kur dëshmia merret në një shtet të huaj në ekzekutim të letërporosisë sipas nenit 509 të K.Pr.Penale dhe nenit 3 të Konventës “*Për ndihmë të ndërsjellë juridike në fushën penale*”.

¹¹⁴ Arsyetim i vendimit Nr 29 datë 25.05.2009 të Gjykatës Apelit për Krime të Rënda Tiranë, vendim i cili është prishur nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin Nr 44 datë 08.02.2012 dhe çështja është kthyer për rigjykim në atë gjykatë, për të realizuar sipas nenit 427 të K.Pr.Penale, marrjen e provave, dëshmive të deklaruara të papërdorshme për mos respektim të neneve 360, 509 dhe 511 të K.Pr.Penale, të shtetasve grekë, dëshmitarve Dh.S, L.R, P.K dhe Dh.K

¹¹⁵ K. E.D. Nj. Neni 6\3, E drejta për një proces të rregullt

në gjykim nga ekspertët, palët civile, *personat e infiltruar në veprimtarinë kriminale*, si dhe të pandehurit në një procedim të lidhur.¹¹⁶

Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda me vendimin e saj nr. 40, datë 05.10.2006, ka mbajtur një qëndrim të kundër me sa trajtuam më lart, ku edhe pse është kërkuar nga mbrojtja dhe nga përfaqësuesit e organit të akuzës dhe pranuar nga gjykata,¹¹⁷ thirrja e “*agjentit të infiltruar*” me inicjalet X.Y. për t’u dëgjuar si dëshmitar në seancë gjyqësore, në një seancë të mëvonshme, kjo gjykatë ndër të tjera argumenton, se meqë në seancën gjyqësore nga ana e përfaqësuesit të organit të akuzës, u hoq dorë nga pyetja me cilësinë e dëshmitarit të shtetasit X.Y., kjo për shkak se në bazë të informacionit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë Shtetit me shkresën perkatëse, në bazë të së cilës rezulton se ky shtetas aktualisht nuk ndodhet në Shqipëri prej disa kohësh, largimi i tij është bërë privatisht për arsye të sigurisë së tij dhe familjes. Gjykata bazuar në nenin 357/2 të K.Pr.Penale, revokon vendimin e saj të ndërmjetëm për marrjen si provë të pyetjes me cilësinë e

3.Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:

a) të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij;

b) t’i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;

c) të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij ose, në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaft eshme për të shpërblyer mbrojtësin, t’i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;

d) të pyesë, ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës

¹¹⁶ Çështje të Gjykatës së të Drejtave të Njeriut datë 15.06.1992, në çështjen *Ludi* kundër *Zvicrës*, datë 06.05.1985, *Bonisc* kundër *Austrisë*, datë 07.07.1989, *Bricmond* kundër *Belgjikës*, datë 27.02.2001, *Luka* kundër *Italisë* etj.

¹¹⁷ V E N D I M

Trupi gjykues tërhiqet për vendim dhe pasi u kthye vendosi :

Gjykata, pasi u këshillua lidhur me parashtrimin hyrës dhe kërkesën për prova të bërë nga prokurori si dhe kërkesën për papërdorshmëri të akteve, parashtrimin hyrës dhe kërkesën për prova të bërë nga mbrojtësit e të pandehurve dhe nga vetë të pandehurit bazuar në nenin 357/1, 151, 152 të K.Pr.Penale vendos të marrë për shqyrtim në këtë gjykim provat e kërkuara nga palët si më poshtë :

- *Të pyesë me cilësinë e dëshmitarit shtetasit:*

-.... X. Y.(me cilësinë e *agjentit të infiltruar*) (I kërkuar nga mbrojtja e të pandehurit X. X. si dhe nga përfaqësuesit e organit të akuzës)

(kërkuar sa më lart nga mbrojtja e të pandehurit X. X.)...

dëshmitarit X. Y., duke mbetur kështu i kërkuar marrja si provë e pyetjes së tij nga mbrojtësi i të pandehurit X. X. av. F. K.

Vendim ky, i cili bie në kundërshtim me kërkesat e nenit 360, 361 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe të kërkesave të parashikuara nga neni 509 dhe 511 të K.Pr.Penale. Duke rënë gjithashtu në kundërshtim me Konventën “Për ndihmë të ndërsjelltë juridike në fushën penale”, të ratifikuar me ligjin nr. 8498 datë 10.06.1999. Konventë, të cilën shteti shqiptar e ka nëshkruar me rezervë dhe në përputhje me kërkesat dhe parimet e së drejtës tonë të brendshme. (neni 360 të Kodit të Procedurës Penale)

Duhet thënë gjithashtu, që një qëndrim i tillë i mbajtur nga gjykata, sipas gjykimit tonë, ka cënuar të drejtën që lidhet me mbrojtjen e të drejtave procedurale të mbrojtjes dhe në veçanti me parimet e barazisë së armëve dhe të drejtës për një debat kontradiktor.

5.4. Statusi i “agjentit të infiltruar” sipas legjislacionit shqiptar

Agjenti i infiltruar, sipas legjislacionit tonë nuk përjashtohet nga mundësia për të dëshmuar në proceset penale,¹¹⁸ në lidhje me faktet për të cilat ai është në dijeni dhe në lidhje me provat e grumbulluara prej tij. Ajo çfarë nuk është përcaktuar në ligj, është statusi i tij procedural.

- Cili është statusi, që gëzon subjekti në fjalë, sipas legjislacionit tonë?

Duke iu referuar nenin 361\ a, parashikohet pyejtja e “*bashkëpunëtorëve të drejtësisë dhe e dëshmitarëve të mbrojtur*”, në këtë nen nuk egziston një dispozitë, e cila të përfshijë “*agjentin e infiltruar*” në këtë status.

¹¹⁸ Neni 294\ b, pika 4, i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë.

Ligji për Gjykatën e Krimeve të Rënda, parashikon për gjykatën, kur e sheh me vend, të urdhërojë që dëshmia të jepet pa kontakt vizual me të pandehurin, pa i komunikuar të pandehurit identitetin e dëshmitarit, ose në raste të tjera parashikuar sipas legjislacionit për mbrojtjen e dëshmitarit,¹¹⁹ por ne jemi të mendimit se duhen përcaktuar saktë subjektet të cilët përfshihen në këtë kategori të dëshmitarëve.

Sipas *Konventës së Palermos*,¹²⁰ku Shqipëria është palë, e cila është e zbatueshme për krimin ndërkombëtar e të organizuar, u kërkon shteteve anëtare të përcaktojnë rregulla të qarta për të lejuar, që dëshmitë e dëshmitarëve të jepen në mënyrë të tillë që të mbrojnë sigurinë e dëshmitarit/viktimës, siç janë lejimi i dhënies së dëshmisë nëpërmjet lidhjes audiovizive apo mjeteve të tjera të përshtatshme. Për më tepër neni 361/a, i cili u miratua me të njëjtin ligj, si dhe pika 7 e nenit 361,¹²¹ parashikon që,

"Kur disponon mjete teknike, gjykata mund të vendosë që marrja në pyetje e tyre të zhvillohet në distancë me anë të lidhjes audiovizive, sipas rregullave të parashikuara në pikën 7 të nenit 361". Në këtë dispozitë është e përcaktuar mjaft qartë, se për cilën kategori të dëshmitarëve janë të zbatueshme këto masa. Bëhet fjalë vetëm për *dëshmitarët e mbrojtur dhe bashkëpunëtorët e drejtësisë*. (Mujaj, 2013: 6).

Jurisprudenca e GJEDNJ dëshminë e dëshmitarëve me identitet të fshehur, marrjen vlerësimin dhe çmuarjen e saj si provë gjyqësore e ka lidhur me ekzistencën njëkohësisht të tre kushteve, dhe konkretisht;

¹¹⁹ Ligji nr. 9110, datë 24.07.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave për Krimet e Rënda.

¹²⁰ Ligji nr.8920, për ratifikimin e "Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar" dhe dy protokolleve shtesë të saj, datë 11.07.2002, Fletore zyrtare nr. 41, fq. 1195.

¹²¹ Neni 361/a, Kodi i Pr. P. të Republikës së Shqipërisë

Pyetja e bashkëpunëtorëve të drejtësisë dhe e dëshmitarëve të mbrojtur

1. Pyetja e bashkëpunëtorëve të drejtësisë dhe e dëshmitarëve të mbrojtur zhvillohet nën masa të veçanta për mbrojtjen e tyre, të cilat përcaktohen nga gjykata, kryesisht ose me kërkesën e palëve. Kur disponon mjete teknike, gjykata mund të vendosë që marrja në pyetje e tyre të zhvillohet në distancë me anë të lidhjes audiovizive, sipas rregullave të parashikuara në pikën 7 të nenit 361.

1) Marrja e dëshmisë së një dëshmitari me identitet të fshehur bëhet në rastet e evitimit të hakmarrjes ndaj tij (dëshmitarin e mbrojtur) apo kur ky dëshmitar është akoma i infiltruar në veprimtarinë kriminale.¹²²Sipas legjislacionit tonë kjo kategori dëshmitarësh parashikohet në ligjin “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë” nr. 9205 datë 15.03.2004.

2) Në marrjen e dëshmisë në këto raste duhet të pakësohen në maksimum kufizimet e të drejtës së mbrojtjes së të akuzuarit. Dëshmia duhet të dëgjohet nga një gjyqtar i paanshëm që njeh identitetin e dëshmitarit të fshehur dhe ka mundësi të verifikojë vërtetësinë e dëshmisë tij.¹²³

3) Vendimi gjyqësor mbi deklarinin fajtor të akuzuarit, nuk duhet të bazohet vetëm apo kryesisht në dëshminë e dëshmitarëve me identitet të fshehur.¹²⁴

Kundërshtimi i dëshmisë. Në rastet kur dëshmia e dhënë nga dëshmitari në gjykim është e ndryshme me thëniet e tij gjatë hetimeve paraprake, kundërshtimi tërësisht ose pjesërisht i saj, nga palët në gjykim bëhet sipas parashikimeve të nenit 362 të K.Pr.Penale. “*Parimi i procesit të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën e palëve për të njohur, komentuar e kundërshtuar çdo provë, që i është paraqitur trupit gjykues pavarësisht prejardhjes saj*”. Marrja e kësaj prove, dëshmisë në cilësinë e kërkuar nga ligji bëhet jo vetëm nëpërmjet shqyrtimit e verifikimit të saj nga gjykata, por edhe nëpërmjet kundërshtimit të saj nga palët, duke respektuar parimin e barazisë së armëve, kontradiktorialitetit, realizimin e të drejtave të palëve në gjykim, sidomos të akuzuarit, të cilat janë në themel të sistemit akuzator dhe burojnë nga neni 17/2, 31, 32 të Kushtetutës, nga neni 6 i KEDNJ dhe ligji procedural penal. (Elezi, F., 2012:76)

Duke përcaktuar rolin e pazëvendësueshëm të agjentëve të fshehtë, në zbulimin dhe procedimin e krimit të organizuar dhe njëkohësisht duke vlerësuar nevojën për mbrojtjen dhe

¹²² Vendimi i GJEDNJ datë 26.03.1996, në çështjen Doorson kundër Hollandës, vendimi datë 15.06.1992, në çështjen Ludi kundër Zvicrës, vendimi datë 23.04.1997, në çështjen Van Mechelen kundër Hollandës.

¹²³ Vendimi i GJEDNJ datë 20.11.1989, në çështjen Kostovski kundër Hollandës, vendimi date 26.03.1996, në çështjen Doorson kundër Hollandës.

¹²⁴ Vendimi i GJEDNJ datë 26.03.1996, në çështjen Doorson kundër Hollandës, vendimi datë 23.04.1997, në çështjen Van Mechelen kundër Hollandës.

mbajtjen sekret të identitetit dhe të karakteristikave të tyre fizike nuk duhet të nënvlerësojmë apo të anashkalojmë parimin e *barazisë së armëve*, që duhet të gëzojnë palët në proces, dhe të drejtën për një debat kontradiktor.

Mbajtja e fshehtë e të dhënave rreth agjentëve të fshehtë, të cilët dëshmojnë në një proces penal, bën t'i konsiderojmë ato "*dëshmitarë anonimë*", status i cili në shumë legjislacione të huaja njihet me ligj. Por pavarësisht kornizave ligjore brenda të cilave na duket se veprimi, përdorimi i "*dëshmitarëve anonim*" duhet të jetë i kufizuar, pasi kjo gjë e mbart në vetvete rrezikun që i pandehuri të mos ketë mundësinë t'i kundërshtoj efektivisht deklaratat e një dëshmitari, duke cënuar të drejtën për një proces të rregullt. Në mbështetje të sa trajtuam më lart, edhe *Gjykata Evropiane ka gjykuar se dëshmitarët anonim nuk janë provë e mjaftueshme për të bazuar dënimin dhe që kur përdoren dëshmitarë anonim, problemi që kjo gjë i shkakton mbrojtjes duhet kompensuar me anë të procedurave që ndiqen nga autoritetet gjyqësore*. (Mujaj, 2013:6-13)

5.5. Dëshmia e agjentit nën koperturë sipas shteteve të ndryshme

Modeli *gjerman* parashikon, mundësinë që në rastet e aktiviteteve nën koperturë të bëjë të mundur ndërhyrjen në debatin gjyqësor të një dëshmitari të ndërmjetësuar, i cili raporton aq sa i është referuar nga agjenti provokator. (Në veçanti mekanizmi procedural parashikon, që të jetë Ministri i Brendshëm, ai i cili do të urdhërojë zëvendësimin e dëshmisë se agjenti provokator me atë të një shefi policie të zyrës përkatëse), ndërsa modeli *spanjoll* lejon agjentin e infiltruar të marrë pjesë në proces me gjeneralitete të fshehta të përdorura gjatë aktivitetit të fshehtë. Është përballur me kritika zgjidhja gjermane për arsye të dukshme, të cilat nuk përputheshin me një rit akuzator dhe u panë si një burim problematikash të mëdha sa i përket vërtetësisë dhe saktësisë së dëshmisë rreth veprës. Modeli më i praktikuar duket

ai i përmendur në Kodin e Procedurës Penale të *Iberisë*, edhe pse nuk e zgjidh problematikën kryesore të këtij trajtimi, që ka të bëjë pikërisht me mbrojtjen e identitetit fizik të agjentit provokues. (Mimma, Sutura_Sardo, 2003:163).

Një zgjidhje më të mirë të kësaj çështjeje, Mimma e Sutura- Sardo, e gjejnë në legjislacionin e *Italisë*, ku legjislatori ka krijuar një tjetër kategori subjektsh, të cilët janë “*bashkëpunëtorët e drejtësisë*”. Këta të fundit gëzojnë edhe në fazën procedurale një sërë garancish sa i përket mbrojtjes së identitetit dhe karakteristikave fizike, të cilat mbesin sekret për palët në proces, *por jo për gjykatën*. Gjykata ka mundësinë të vlerësojë, përveç deklaratave edhe shprehjet e fytyrës që shoqërojnë pyejtjet, që vijnë nga palët. E gjithë kjo bëhet pa kompromentuar në asnjë mënyrë debatin mes palëve, si një garanci për një proces të rregullt gjyqësor. Në këtë mënyrë palët në proces kanë të drejtë të shqyrtojnë e të rishqyrtojnë agjentin provokues, në respekt të plotë të të gjitha garancive procedurale dhe në të njëjtën kohë t’i sigurojnë agjentit të infiltruar një minimum të anonimatit, që mund të përforcohet nga një masë e motivuar nga gjykata, e cila autorizon agjentin provokator, që në momentin marrjes së këtij angazhimi të thotë të vërtetën, të japë generalitetet nën mbulim, në mënyrë të tillë, që të rrisë efektivitetin e dëshmisë së dhënë. (Mimma, Sutura_Sardo, 2003: 163)

5.5.1. Mbrojtja e identitetit të agjentit të infiltruar

Në një numër të caktuar shtetesh, gjykata mund të vendosë të aplikojë masa specifike gjatë dëgjimit të dëshmisë për të siguruar, që dëshmitarët të dëshmojnë pa ndjerë kërcënim dhe frikë për jetën e tyre. Këto masa mund të aplikohen dhe në çështje të tjera të ndjeshme (mes të tjerash, trafikimi i personave, krimet seksuale, dëshmitë e të miturve dhe krimet brenda familjes). Për të parandaluar riviktimizimin e dëshmitarit-viktimë, duke kufizuar ekspozimin e tyre në publik dhe në media, gjatë seancës gjyqësore.

Ata përfshijnë:

- 1- Përdorimin e deklaratës paraprake të dëshmitarit, në vend të dëshmisë në seancë gjyqësore;
- 2- Prania e një personi shoqëruar për mbështetje psikologjike;
- 3- Dëshmia përmes një qarku të mbyllur televizioni ose videokonference;
- 4- Deformim zëri dhe fytyrë;
- 5- Largimin e mbrojtjes ose të publikut nga salla e gjyqit;
- 6- Dëshmia anonime.¹²⁵

5.5.2. Statusi i “dëshmitarit anonim”

Në disa legjislacione të huaja dëshmitarët, të cilët kanë nevojë për një mbrojtje të posaçme të identitetit dhe të karakteristikave fizike të tyre përfshihen nën statusin e “*dëshmitarit anonim*”.

Lind pyejtja cilët janë dëshmitarët, të cilët gëzojnë statusin e “*dëshmitarit anonim*”?

Mbajtja e disa ose e të gjitha detajeve rreth identitetit të dëshmitarit, të fshehura nga mbrojtësit dhe nga publiku mund të jetë një mjet efektiv mbrojtjeje në ato raste të rralla, ku thelbi i dëshmisë në vetvete nuk e identifikon dëshmitarin për mbrojtjen dhe atëherë kur dëshmia është vërtetuar me prova të tjera. Masa është e dhënë zakonisht nga gjykata me kërkesë të dëshmitarit dhe vendimi mund të apelohej dhe është i revokueshëm.

Në vendet, ku *dëshmitë anonime* janë të lejueshme, lejohet:

- 1- Të mbahet evidenca e identitetit të dëshmitarit veçmas nga procesverbali i seancës dhe në një lokacion të sigurt;

¹²⁵ United Nations Office on Drugs and Crime, (2008), “Good practices for the protection of witnesses in criminal proceedings involving organized crime”, Vienna, fq. 31.

2- Parashikohet sanksion apo ndjekje penale në përputhje me ligjin, kundrejt çdo përpjekjeje të mundshme për të zbuluar identitetin e dëshmitarit anonim;¹²⁶ (Mujaj, 2013 -13).

- Cili është qëndrimi i mbajtur nga GjEDNj në lidhje me praktikatat e ndryshme gjyqësore, në të cilat janë aplikuar dëshmitë anonime?

Në të dyja rastet Ramanauskas kundër Lithuanisë dhe Khudobin kundër Rusisë, aplikantët (të akuzuarit) nuk kishin mundësinë për të vënë në diskutim dëshminë e personave edhe pse dëshmia e tyre kishte një rol vendimtar për t'i fajësuar ata; aplikuesit ishin privuar nga një mundësi e tillë pa ndonjë arsye. Duhet vënë re, se në rastin e Ludi kundër Zvicrës,¹²⁷ i dyshuari nuk mund të vinte në pikëpyetje agjentin nën mbulim sepse ai kishte fituar statusin e dëshmitarit anonim. Statusi i është dhënë me qëllim për ta përdoruar agjentin në operatione të mëvonshme të ngjashme, që lidhen me trafikimin e drogës si dhe me qëllim mbrojtjen e identitetit të tij.

Në vitin 1993, GjEDNj dha vendimin *Saidi* kundër Francës.

I njohuri si shpërndarës heroinë nga tre toksimane me të cilët ai ishte përballur nëpërmjet një xham pasqyrë, i interesuari u dënua nga drejtësia franceze, ndërkohë që kishte kërkuar një përballje të vërtetë. Siç thekson GjEDNj-ja dënimi ishte bazuar vetëm në këto dëshmi, për pasojë, procedura nuk kishte qënë e rregullt, edhe pse,

“Gjykata nuk i nënvlerëson vështirësitë e pamohueshme të luftës kundër trafikut të lëndëve narkotike, veçanërisht përsa u përket mbledhjes dhe administrimit të provave dhe aq më pak shkatërrimin që ai sjell në shoqëri”¹²⁸

Në përfundim gjyqtarët e Strasburgut i dhanë më shumë përparësi parimit të kontradiktoritetit, sesa mbrojtjes së dëshmitarëve.

¹²⁶ United Nations Office on Drugs and Crime, (2008), “Good practices for the protection of witnesses in criminal proceedings involving organized crime”, Vienna, fq. 50.

¹²⁷ GjEDNj 15 qershor 1992, Ludi vs Suisse, serie A, nr. 238; obs. Coussirat-Caustere, *Annuaire fr. dr. int.* 1992, f. 629; obs. E. Decaux et F. Tavernier au JDI 1993, f. 733; obs. F. Sudre a la RTDH 1993, f. 167; 1992, f. 629; obs. E. Decaux et F. Tavernier au JDI 1993, f. 733; obs. F. Sudre a la RTDH 1993, f. 167; obs. C. de Valkeneer a la RTDH 1993, f. 313

¹²⁸ *Saidi* kundër Francës, 20. 09. 1993, serie A, nr. 261, parag. 44.

Çështja *Doorson* e vitit 1996.¹²⁹

Ky vendim përcakton qartë kushtet e përdorimit të dëshmisë anonime duke konfirmuar në parim një kufi për të: duhet të këtë arsye të mjaftueshme për të garantuar anonimin e dëshmitarëve dhe gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit anonim, gjyqtari duhet të ndërhyjë, duhet që gjyqtari të krijojë një ide sa i përket besueshmërisë së dëshmisë së dëshmitarit, duhet që gjithashtu krahas provës së siguruar përmes dëshmisë anonime të këtë dhe prova të tjera (aplikimi i teorisë së konfirmimit). Meqënëse në këtë rast kushtet përmbusheshin, Gjykata nuk e dënoi Hollandën.

Ndryshe ndodh në çështjen e *Van Mechelen* në vitin 1997.¹³⁰

Në këtë çështje dhjetë policë me automjete vihen në ndjekje të bandidëve që lëvizin gjithashtu me automjete. Në një moment të caktuar kapaku i bagazhit të makinës së keqbërësve hapet nga brenda dhe nga kjo hapsirë e vogël ata qëllonjë mbi agjentët e forcave të rendit. Pas një ndjekjeje me makinat keqbërësit ndalohen. Gjatë seancës gjyqësore policët refuzojnë të dëshmojnë me kontakt vizual. Megjithatë ishin marrë të gjitha masat për të siguruar autenticitetin e dëshmisë së tyre. Gjyqtari hetues, sekretari dhe dëshmitarët e dëgjuar qëndronin në një dhomë, kurse të akuzuarit, këshillat e tyre dhe avokati i përgjithshëm qëndronin në një dhomë tjetër. Në sajë të një lidhje zanore, ata kishin mundësi të dëgjonin të gjitha pyejtjet, që u bëheshin dëshmitarëve si dhe përgjigjet që ata jepnin. Gjyqtari ia përsëriste sekretarit deklaratat e dëshmitarëve, i cili i mbante shënim ato. Të 11 policët anonimë identifikoheshin vetëm nëpërmjet numrave (001, etj). Gjykata theksoi përsëri se, “*përdorimi i dëshmive anonime për të caktuar dënimin nuk është i pajtueshëm në çdo rrethanë me Konventën e Drejtave të Njeriut*”. Ajo shtoi se pranimi i dëshmive anonime varet nga tre kushte:

- 1- Gjyqtari duhet të ndërhyjë për të verifikuar besueshmërinë e dëshmitarëve,
- 2- Mbrojtja duhet të këtë mundësi të paraqesë dyshimet e veta për deklaratat e dëshmitarëve, çka nënkupton se ajo duhet të këtë mundësi t’i pyese ata dhe të krijojë gjykimin e vet mbi qëndrimin e tyre, Pra, mund të themi se Gjykata kërkon, që midis mbrojtjes dhe dëshmitarëve të këtë kontakt, i cili do të mund t’i lejonte mbrojtjes të vërente reagimet e dëshmitarëve ndaj pyejtjeve të bëra. Por, në këtë rast GjEDNJ-ja vlerëson se nuk janë përmbushur të gjitha kushtet: nuk kishte prova të tjera përcaktuese dhe mbrojtja nuk kishte mundur të pyesë dëshmitarët në prani të tyre, në një kohë që procedura nuk e kompenson mjaftueshmërisht këtë pengesë. Përmetepër, GJEDNJ nënvizon, se këta dëshmitarë të posaçëm, pra policët, “*janë të detyruar t’u binden autoriteteve ekzekutive dhe duhet të përdoren si dëshmitarë anonime vetëm në rrethanë të jashtëzakonshme*” (paragrafi 56). Ky vendim është shqetësues edhe pse nuk përjashton mundësinë për t’ia fshehur të akuzuarit identitetin e

¹²⁹ Doorson kundër Pays-Bas, 26. 03. 1996.

¹³⁰ Van Mechelen kundër Pays-Bas, 23. 04. 1997.

dëshmitarit. Krijohet ideja sikur GJEDNJ- ja ndryshon jurisprudencën, pasi të dhënat faktike ishin të ngjashme me ato të çështjes *Doorson*, ku Holanda nuk u dënua. Krijohet përshtypja së GJEDNJ- ja praktikon teknikën e lundrimit pa mjete orientuese. Gjithësesi në disa çështje, përdorimi i dëshmimeve anonime është i domosdoshëm dhe është shumë delikate të bëhet dallimi midis dëshmitarëve policë ose jo që mund të jenë vetë objekt i hakmarrjes, kjo e fundit mund të drejtohet edhe ndaj familjes apo pasurisë së tyre. Rreziku i dyfishtë i jurisprudencës *Van Mechelen*, qëndron në faktin, që punonjësit e policisë mund të mbyllim sytë ndaj kriminalitetit të organizuar nga frika e hakmarrjes dhe të thërrasin të penduar(pentiti) me moral të dyshimtë. Për gjyqtarët i vetmi justifikim i vendimit *Van Mechelen* qëndron në faktin që ata vlerësojnë se përveç deklaratave të dëshmitarëve anonime nuk kishte prova të tjera serioze. (Prandel, Corstens, Vermeulen, 2010:387-388)

- 3- Së fundi, do të citojmë një çështje të mëvonshme ku duket se GJEDNJ- ja nuk kërkon më që mbrojtja të këtë mundësi të vëzhgojë reagimet e dëshmitarëve.¹³¹

Nga e gjithë jurisprudenca rezulton se pranueshmëria e dëshmisë anonime varet nga tri kushte, që plotësojnë njëri-tjetrin.

- Duhet të ketë arsye të mjaftueshme për të garantuar anonimatin e dëshmitarit, për shembull sepse duhet evituar hakmarrja, ose sepse policia dëshiron ta mbajë akoma dëshmitarin për qëllime ndjekjeje ose operacione të tjera secrete (vendimet *Doorson*, *Ludi*, *Van Mechelen*)
- Duhet pakësuar në maksimum cënimet e të drejtës për mbrojtje, çka nënkupton,
 1. Që dëshmitari anonim duhet të dëgjohet nga një gjyqtar i pavarur dhe i paanshëm që e njih identitetin e tij dhe që mund të japë një vlerësim për arsyet që e justifikojnë anonimatin dhe për besueshmërinë e deklaratave (vendimi *Kotovski*)
 2. Që mbrojtja duhet të këtë mundësi të pyesë drejtpërsëdrejti dëshmitarin, në prani të avokatit dhe gjyqtarit (vendimi *Doorson* dhe *Kotovski*), ndërkohë që nuk është e domosdoshme që mbrojtja të këtë mundësi të vërejë personalisht reagimet e dëshmitarit anonim ndaj pyetjeve të tij te drejtpërdrejta (vendimi *Kok*)
 3. Së fundi, duhet që dënimi të mos jetë i bazuar vetëm dhe as në një masë të madhe në deklaratat anonime (vendimi *Doorson* dhe *Van Mechelen*). (Prandel, Corstens, Vermeulen, 2010:389).

Situata, kur agjentët e fshehtë bëhen dëshmitarë anonim shkakton mjaft probleme, që lidhen me mbrojtjen e të drejtave procedurale të mbrojtjes, në veçanti me parimet e *barazisë së armëve* dhe të drejtës për një debat kontradiktor. Duhet theksuar, se në situatë ta tilla, kon-

¹³¹ *Kok kundër Pys-Bas*, 05.07. 2000.

flikti mes dy të drejtave është shumë i qartë. Nga njëra anë kemi mbrojtjen e dëshmitarit anonim dhe nga ana tjetër kemi mbrojtjen e të drejtave procedurale të mbrojtjes. (Stariene, 2009:263–284)

Gjithësesi, nëse do të analizohet në tërësinë e saj jurisprudenca e Strasburgut, do të arrihej në konkluzionin se përdorimi i teknikës së dëshmisë anonime është i ligjshëm, me kusht që të respektohen disa kushte, të cilat janë të përmendura shumë mirë në çështjen *Doorson*. Për disa arsye praktike kjo gjë është për t'u vlerësuar. Por, nuk duhen harruar problemet juridike që lindin nga kjo situatë faktike. *I pari*, që është përmendur tashmë, lidhet me parimin e kontradiktoritetit; i akuzuari duhej të kishte mundësi që në një mënyrë ose në një tjetër të pyeste në një moment të caktuar dëshmitarët e akuzës. Kështu për shembull në disa vende parashikohej marrja në mënyrë indirekte në pyetje dhe pyejtjet bëhen më gojë ose me shkrim nëpërmjet një sistemi që transformon zërat. Një tjetër problem juridik është ai që lidhet me respektimin e jetës private në rastin e “dëshmitarëve të infiltruar”. (Prandel, Corstens, Vermeulen, 2010: 389)

Në çështjen *Ludi* ishte evokuar shkelja e nenit 8 të KEDNJ- së (së bashku me nenin 6 të KEDNJ). Sigurisht Gjykata e Strasburgut, e rrëzoi argumentin e nenit 8. Por megjithatë kundërshtimi duhet parashikuar, sepse strategjitë janë shumë të ndryshme “*undercover*” dhe disa prej tyre mund të çënojnë konkretisht nenin 8. Në të vërtetë nuk mendohet se mund të kundërshtohet vlefshmëria e këtyre teknikave të infiltrimit, sepse nuk duhet harruar që shumë shpesh përdorimi i mjeteve për marrjen e provës mund të shkelë intimitetin e jetës private. Madje vetë neni 8, pranon që mund të çënohet intimiteti me kusht që të parashikohet nga një ligj i brendshëm, që bëhet fjalë për mbrojtjen e rendit publik. Dhe ky rast ishte i tillë. (Prandel, Corstens, Vermeulen, 2010:389)

5.5.3. Anonimati i plotë

Anonimati i plotë është një masë e veçantë dhe mund të ketë pasoja serioze në lidhje me të drejtën e të pandehurit për një proces të rregullt dhe të hapur gjyqësor, debatin kontradiktor si dhe replikën gjatë shqyrtimit gjyqësor. *Anonimati vendos limitime në të drejtën për të sfiduar saktësinë, vërtetësinë dhe sinqeritetin e dëshmisë.*

Mbrojtja në të tilla raste nuk është në gjendje të verifikojë:

1. Çdo marrëdhënie me të pandehurin, që mund të jetë shkaku i një qëndrimi paragjykses;
2. Origjinën e dijes;
3. Çdo histori personale, që mund të ketë ndikim në besueshmërinë e dëshmitarit (gjendjen mendore, të dhënat kriminale, etj) ¹³²

5.5.4. Anonimati i pjesshëm ose i limituar

Aty ku, nga gjykata, është marrë masa e një *anonimati të pjesshëm ose të limituar*, dëshmitari mund të merret në pyetje në gjykatë nga ana e mbrojtjes, por nuk është i detyruar të deklarojë emrin e tij ose të saj të vërtete, apo detaje të tjera personale. Të tilla si: adresën, profesionin apo vendin e punës. Kjo masë është veçanërisht e dobishme, kur dëgjimi i dëshmisë së agjentit të fshehtë dhe i anëtarëve të ekipeve të vëzhgimit, të cilët do të jenë në rrezik, nëse identiteti i tyre i vërtetë do të bëhej i ditur për publikun. Në një rast të tillë dëshmitari, zakonisht jep dëshminë e tij përpara gjykatës nën një emër me të cilin ai ose ajo supozohet të jenë njohur gjatë operacionit, por deklaron funksionet e tij ose të saj të vërteta (oficer policie, investigator etj).¹³³ (Mujaj, 2013:10)

¹³² United Nations Office on Drugs and Crime, (2008), "Good practices for the protection of witnesses in criminal proceedings involving organized crime", Vienna, fq. 50.

¹³³ United Nations Office on Drugs and Crime, (2008), "Good practices for the protection of witnesses in criminal proceedings involving organized crime", Vienna, fq. 50.

5.5.5. Anonimati total ose i plotë

Aty ku, nga gjykata, është marrë masa e një anonimati total ose të plotë, të gjitha informacionet që kanë të bëjnë me identitetin e dëshmitarit mbeten sekret. Dëshmitari paraqitet në gjykatë për të dëshmuar, prapa një mburojë, i maskuar ose nëpërmjet shtreberimit të zërit. Në praktikë, kjo masë është e dobishme vetëm në rastet kur dëshmitarët ishin kalimtare të pafajshëm të krimit, dhe për këtë arsye, raste të tilla rrallë përfshijnë ndjekjen penale të udhëheqësve të bandës, të cilët zakonisht urdhërojnë të tjerët për të kryer skenat e tyre të dhunshme. Nëse i pandehuri njih dëshmitarin, pastaj ruajtja e anonimatis të plotë do të ishte joreale, pasi i pandehuri mund të identifikojë dëshmitarin përmes dëshmisë së tij ose të kontekstit të dëshmisë së dhënë.¹³⁴

Në *Gjermani*, kur anonimati i plotë është siguruar, një oficer i zbatimit të ligjit jep dëshmi në gjykatë në vend të dëshmitarit, duke deklaruar atë çfarë dëshmitari pa. Me përjashtim të informacioneve, që lidhen me të dhënat e identifikimit të dëshmitarit. Nuk ka kufizime për të drejtën e mbrojtjes për të kundërshtuar dëshminë. Përveç kësaj, mbrojtja ka të drejtë të paraqesë pyejtjet me shkim, për t'u raportuar më pas nga zyrtari tek dëshmitari anonim, i cili më pas do të raportojë dhe përgjigjet në gjykatë. Gjykata Federale e Drejtësisë ka vendosur që, për shkak të karakterit të saj jo zyrtar, apo siç ndryshe kane quajtur “thashathemnajë”, dëshmi të tilla kanë vlerë të kufizuar ose ndryshe duhen vërtetuar nga prova të tjera materiale. (Këshilli i Evropës, Terrorizmi: Mbrojtja e Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë). (Mujaj, 2013:11)

5.6. Provokimi për kryerjen e veprës penale

¹³⁴ United Nations Office on Drugs and Crime, (2008), “Good practices for the protection of witnesses in criminal proceedings involving organized crime”, Vienna, fq. 40.

Sot në të gjitha vendet, kryesisht në çështjet e trafikut të drogës, ku denoncimet janë shumë të rralla, policët përdorin procedura aktive (flasim për hetim pro-aktiv), ata infiltrohen në rrjete dhe *u propozojnë anëtarëve të tyre që të blejnë ose të shesin drogë*. Të drejtat kombëtare bëjnë dallimin mes policit që synon vetëm të nxjerrë në pah veprën penale, që individi e ka kryer tashmë (*gjë që është e ligjshme*), dhe policit që nëpërmjet provokimit synon të krijojë një vepër penale (*gjë që nuk është e ligjshme*). (Pradel, 2008)

GJEDNJ-ja në një vendim të vitit 1998 ajo vë përballë *agjentit të thjeshtë të infiltruar dhe agjentin, që është në rolin e agjentit provokues*. Më konkretisht, ajo e pranon agjentin e infiltruar, kur natyra e veprës e justifikon atë duke shtuar se *“interesi publik nuk do ta justifikonte përdorimin e elementeve të siguruara nëpërmjet një provokimi policor”*.¹³⁵ Kështu *jurisprudenca europiane bashkohet me të drejtat e brendshme (legjislative dhe / ose jurisprudentiale)*: në momentin që policët *“ushtrojnë një influencë, e cila e nxit të pandehurin të kryejë një vepër”*, në vend që *“të kufizohen në shqyrtimin pasiv të aktivitetit kriminal”*¹³⁶ ata nënvlerësojnë parimin e procesit të rregullt ligjor”, që aplikohet në procedurat, për të gjitha tiparet e veprave kriminale, nga më të thjeshtat deri tek më të ndërlikuarat”.¹³⁷ Parimi i ligjshmërisë aplikohet edhe për provat e mbledhura si rezultat i një kurthi”privat”, që ngrihet nga një individ dhe jo nga një hetues, kur i ashtëquajhuri individ nuk vepron në emër të shtetit.¹³⁸

¹³⁵ GJEDNJ 9 qershor 1998, Teixeira de Castro vs Portugal, 36; JCP 1999.I.105, obs. F. Sudre, RSC 1999, 401, obs. R. Koering-Joulin; 22 Korrik 2003, Edward et Lewis vs Royaume-Uni, 49; 15 dhjetor 2005. Vanyan vs Russie, 49; gr. Ch. 5 shkurt 2008. Ramanauskas vs Lituanie, RSC 2008, 694, obs. J.-F. Margue-Naud, për një prokuror, që bie në kurthin e një polici që i kishte dhënë para në këmbim të lirit tek një personi të tretë.

¹³⁶ Siç analizohet në çështjen Teixeira de Castro kundër Portugalisë, 09.06.1998, i sipërcituar.

Shih edhe GJEDNJ 26 tetor 2006; Khoudobine kundër Ruisë, dënim i Ruisë për shkak të një delikti të provokuar nga policia dhe 7 shtator 2004, Eurofinacom kundër Francës, rregullsia e procedurës në të cilën dyshimet e policit bazoheshin në “elemente konkrete, që tregonin fillimin e kryerjes së veprës penale”

¹³⁷ Vendimi Teixeira, i sipërcituar.

¹³⁸ GJEDNJ 6 Prill 2006, Shannon vs Royaume- Uni, aktor anglez i dënuar se i kishte dhënë drogë një gazetari, që i kishte ngritur një kurth duke u hequr si sheik që kërkonte kokainë.

Në çështjen e shumë folur *Texiera de Castro* kundër *Portugalisë*, Gjykata Europiane u ndal në verifikimin e ligjshmërisë së masës së dënimit të lëshuar si rezultat i një operacioni të fshehtë të ndërmarrë nga oficerët e policisë Portugeze. Masë kjo, e marrë kundër një subjekti pa precedentë specifike, me synimin për t'i dhënë atij “mundësinë për të kryer krime”. Është censuruar kështu mundësia e njohjes së përgjegjësisë penale për një subjekt, përgjegjësia e të cili ka lindur si pasojë e një nxitjeje nga ana e policisë. Duke hyrë në detaje të motivimit, dalin në pah dy profile të paligjshëm. (Barrocu, 2011: 96)

Së pari, duket e drejtë se provat e përfuara nga një aktivitet nën mbulim janë plotësisht të pranueshme, me kushtin e vetëm, që aktiviteti i të infiltruarve të limitohet në një aktivitet të thjeshtë infiltrimi, (Vallini, 1999:197) dhe jo ta shtyjë atë “positivisht” në kryerjen e një krimi, me qëllim që të zbulojë qëllimet e tija kriminale.

Së dyti, një tjetër element që merr një vlerë themelore, që lartëson përdorshmërinë e rezultateve të përfuara, por me një kusht paraprak të domosdoshëm për çdo aktivitet nën koperturë; lloji i hetimeve të kryera në dukje është tërësisht në shkelje të të drejtave të njeriut, pasi ka realizuar të jetë kryer *jashta një procesi të menaxhuar nga autoritetet gjyqësore*. Në lidhje me kufijtë e ligjshmërisë të përdorimit të metodës speciale të infiltrimit përmes “*Veprimeve Simuluese*”, të parashikuar nga neni 294/a¹³⁹ të K.Pr.P., është shprehur edhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin e saj nr. 00-2012-941(201), datë 05.07.2012 me të gjykuarit: A.B., A.Ç., A.C., D. I., E. B., E. M., E.D., me objekt kryerjen e

¹³⁹ Neni 294/a K.Pr.Penale - *Veprimet simuluese*

1. Oficeri dhe agjenti i policisë gjyqësore ose personi i autorizuar prej tyre mund të ngarkohen për blerje të simuluar të sendeve, që rrjedhin nga një krim ose simulim i një akti korruptiv, ose të kryejnë veprime të tjera simuluese, për të zbuluar të dhëna financiare ose pronësie të një personi, për të cilin ka dyshime për kryerjen e një krimi, duke fshehur bashkëpunimin me policinë ose detyrën e tyre si punonjës policie.

2. Këto veprime bëhen me autorizimin e prokurorit që kontrollon hetimet ose të prokurorit që ka në juridiksion territorin ku do të zhvillohet veprimi. Pas kryerjes së këtyre veprimeve, policia gjyqësore duhet t'i dorëzojë prokurorit të gjitha provat e mbledhura dhe një raport përmbledhës.

3. Nuk duhet provokuar një akt kriminal, duke shtyrë një person të kryejë një krim, të cilin nuk do ta kishte kryer po të mos ishte ndërhyrja e policisë. Kur vërtetohet provokimi, rezultati nuk mund të përdoret.

veprave penale të “Trafikimit të narkotikëve” dhe të “Trafikimit të armëve dhe të municionit luftarak”, të kryer në bashkëpunim.

“Duke bërë ballafaqimin e kërkesave ligjore që kërkon ligji procedural penal për zbatimin e metodës speciale të: “Veprimet simuluese”, me rastin konkret të përdorur nga akuza, ku si person që do të kryente këto veprime ishte shtetasi R. Xh., ky Kolegj konstaton se mënyra se si ka vepruar organi i prokurorisë është në kundërshtim me kërkesat e nenit 294/a të Kodit të Procedurës Penale me pasojë papërdorshmërinë e rezultatit të përfutur si provë në bazë të nenit 151/4 të K. Pr. P.

Kolegji Penal vlerëson se personi që është autorizuar nga prokurori për kryerjen e “veprimeve simuluese”, nuk është autorizuar për kryerjen e asnjë prej tre veprimeve të përcaktuara në germen “ç”,¹⁴⁰ të analizës së bërë nga ky Kolegj në këtë vendim dhe ky person përveçse nuk ka qenë i autorizuar për kryerjen e një ose disa veprimeve të tilla edhe realisht nuk ka kryer asnjë prej veprimeve të mësipërme, por, ka kryer veprimet që i takojnë një punonjësi policie të infiltuar, rast i cili parashikohet nga neni 294/b i Kodit të Procedurës Penale.

Përveç kësaj shkelje të hapur ligjore, e cila e bën të papërdorshme të gjithë rezultatit të përfutur prej saj dhe për pasojë edhe dëshminë e shtetasit R. Xh. që jep të dhëna pikërisht mbi bazën e veprimeve të kryera në kundërshtim me ligjin nga ky shtetas, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vlerëson se vendimi i prokurorit për lejimin e përdorimit të metodës speciale të hetimit “Veprimet simuluese”, i datës 01.02.2008 është marrë në kundërshtim me ligjin, sepse në rastin konkret nuk rezulton që të jetë provuar se ekzistojnë dyshime të arsyeshme për kryerjen e një krimi, duke mos u plotësuar kështu kërkesa e përcaktuar në pikën “d”¹⁴¹ të analizës së kësaj gjykate, kërkesë e cila parashikohet në mënyrë të shprehur në pikën 1 të nenit 294/a i Kodit të Procedurës Penale”.

Në të dy vendimet e parashtruara sa sipër, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut si dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë, në dhënien e vendimit të tyre përfundimtar gjatë arsyetimit janë shprehur në lidhje me kufinj të ligjshmërisë së aktivitetit të

¹⁴⁰ ç) Metoda speciale e hetimit “Veprimet simuluese” përdoret jo për të kryer çdo veprim, por vetëm për të kryer ato veprime që parashikohen në mënyrë të shprehur nga ligji (pika 1 e nenit 294/a të Kodit Procedural), veprime të cilat janë vetëm tre:

i) ose për blerje të simuluar të sendeve që rrjedhin nga një krim;
ii) ose për simulimin e një akti korruptiv;
iii) ose për kryerjen e veprimeve të tjera simuluese, për të zbuluar të dhëna financiare ose pronësi të një personi.

¹⁴¹ d) Kryerja e një ose disa nga veprimet e mësipërme nga ana e oficerit ose agjentit të policisë gjyqësore apo të personit të autorizuar prej tyre, mund të bëhet vetëm në rastet kur ka dyshime për kryerjen e një krimi dhe jo për provokimin e një krimi siç ka ndodhur në çështjen kundër të gjykuarve.

agjentit të infiltruar, si dhe në lidhje me papërdorshmërinë e provave të përfutuara nga “*Veprimet Simuluese*”, pasi ato janë marrë në kundërshtim të ndalimeve të parashikuara me ligj dhe si të tilla (sipas legjislacionit tonë, neni 151\4 të Kodit të Procedurës Penale)¹⁴² nuk duhen përdorur.

5.6.1. Dënueshmëria e oficerit të policisë

Aktiviteti i fshehtë ka qënë shpesh objekt diskutimesh dhe polemikash, për të gjithë studiuesit penalistë. Legjislacioni procedural penal parashikon, që veprimtaria e punonjësit të infiltruar të kalojë përmes një akti specifik autorizues, konkretisht “*autorizimit me shkrim*”. Ky akt përcakton limitet brenda të cilave ushtrohet ky aktivitet, si dhe legjitimon ato veprime, të cilat kryhen nga oficeri i policisë dhe që në mungesë të këtij legjitimimi do të konsideroheshin *penalisht të dënueshme*.

Veprimtaria e oficerit të policisë në rolin e agjentit të infiltruar, konsiston në veprime penalisht të dënueshme, të cilat gjejnë shprehje dhe sanksionohen si të tilla në legjislacionin tonë penal. Për të krijuar një kornizë më të qartë të asaj ane të paligjshme nga e cila karakterizohet aktiviteti i oficerit të policisë si agjent i infiltruar, bëjmë një përshkrim më të detajuar të aktivitetit në të cilin përfshihet kjo figurë e posaçme hetimore.

Siç e kemi trajtuar dhe më parë veprimtaria e oficerit të policisë fillon:

1. Nën një identitet të rremë (me dokumenta të fallsifikuar)
2. Përfshirja në ambjete kriminale, me sjellje aktive (në rastin e agjentit të infiltruar)
3. Ka si qëllim nxitjen e një akti kriminal, i cili normalisht duhet të jetë egzistent në *reo*.

¹⁴² Neni 151\4, *Marrja e provave*

4. Provat e marra në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji nuk mund të përdoren. Papërdorshmëria ngrihet edhe kryesisht në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit.

Aktiviteti i fshehtë, ka hapsira të mjaftueshme, të cilat lënë vend për abuzim dhe arbitraritet.

Po t'i referohemi legjislacionit italian:

“Agjenti provokator¹⁴³ nuk dënohet vetëm në rastin kur ndërhyrja e tij është indirekte dhe anësore në idejimin dhe egzekutimin e faktit, në qoftë se, ndërhyrja e tij përbën kryesisht një aktivitet kontrolli, mbikqyrjeje dhe kufizimin të veprimtarive të paligjshme; ndërkohë që është e dënueshme në rastin kur konkurren me veprën dhe veprimtaria e tij përfshihet me një rëndësi shkakësore në lidhje me veprën e kryer nga i provokuari, në kuptimin që ngjarja kriminale e përfshirë është gjithashtu edhe pasojë e veprimtarisë së agjentit provokues”.
(Minna, Sutura, 2003:100)

Është e një rëndësie thelbësore dhe përcaktimi i momentit në të cilin agjentët provokator ndërhyjnë në zbulimin e veprës, pasi kemi dhe raste të tilla, ku ndërhyrja e tyre është e vonuar. Problematikë, e cila ka dalë dhe në praktika të ndryshme gjyqësore.

“Ndërhyrja e policisë përpara ose në momentin e shkëmbimit të mallit me kundravlerën e rënë dakord, nuk e pengon kryerjen e veprës penale, në të vërtetë nuk përjashtohet që, pavarësisht ndërhyrjes së agjentëve, reo mund të arrijë qëllimin dhe të mos ndalohej nga policia. Në këtë rast nuk mund të njihet roli i agjentit provokator, pasi ai nuk ka ndikuar në ndalimin e veprimtarisë kriminale, por ndjek thjesht ecurinë e aktivitetit kriminal, duke lejuar kështu që pala e dëmtuar (viktima) të sillet ashtu siç është diktuar nga fajtori në fjalë”. (Minna, Sutura, 2003:100)

Për të tillë çështje gjykata e Kasacionit Penal të Italisë,¹⁴⁴ ka mbajtur këtë qëndrim: *“vepra penale në këtë rast është konsumuar dhe ndërhyrja e policisë kishte ndodhur atëherë kur çdo gjë kishte marrë fund”*

Nuk mungojnë gjithësesi prononcimet të cilat ripohojnë, parimet e dala në bazë të modeleve legislative të provokimit të krimit të përfshira nga legjislatori.¹⁴⁵

¹⁴³ Agjenti i infiltruar, i cili përfshihet në “blerjet e simuluar”, neni 294\ a i K. Pr. P., pika 1.

¹⁴⁴ Cassazione penale, Sez. VI 7. 7.1987.

¹⁴⁵ Cassazione penale, Sez. VI 7. 7.1987.

“Ligjshmëria e veprimtarisë së agjentit edhe pse i përket policisë gjyqësore, dikton domosdoshmërinë e përdorimit të një forme indirekte dhe anësore ndërhyrjeje, në idejimin dhe egzekutimin e një vepre kriminale. Domethënë, duhet të përbëjë kryesisht një aktivitet observimi, kontrolli dhe lokalizimi të veprimtarive kriminale, por, nëse sjellja e agjentit provokator përfshihet në iter criminis¹⁴⁶me një rëndësi shkakësore, në kuptimin që ngjarja kriminale të konsiderohet si një pasojë direkte e sjelljeve të tija, atëherë dënueshmëria në këtë rast nuk do të përjashtohet”. (Minna, Sutera, 2003: 101)

Disiplina në lidhje me këtë tip veprimtarie, është konsoliduar historikisht, nga debate doktrinale rreth figurës së agjentit provokator. Meqënëse legjislacioni shqiptar nuk njih një traditë të hershme të përdorimit të kësaj disipline jemi të detyruar t’i referohemi legjislacioneve të vendeve më të zhvilluara, për të kuptuar më qartë evoluimin e kësaj figure.

Sipas një vizioni klasik, *agjenti provokator*, nuk ka interes në realizimin e krimit në vetvete. Krimi, i cili provokohet përfaqëson thjesht një mjet përmes të cilit ai mund të realizojë objektivin e tij. Objektivi, i cili konsiston në vënien para drejtësisë së personit të cilin ai ka provokuar. Kjo figurë, trajtohet në kontekstin e përfshirjes morale, duke qënë e nevojshme prezenca e një lidhjeje shkakësore midis sjelljes nxitëse dhe reagimit të personit të nxitur (pasoja). Qëllimi në vetvete i agjentit provokator nuk është të realizojë një krim të ri, por të grumbullojë prova rreth një krimi tashmë egzistues.

Në fillim të *shek. XX*, doktrina rikthen nocioni tradicional të zgjeruar të agjentit provokator. Kështu që, siç është trajtuar nga shkolla klasike të *shek. XIX*, është konsideruar provokator, agjenti i cili konstaton krimin për të zënë në flagrancë *reo*, apo për ta denoncuar përpara autoriteteve përkatëse. Është një bindje unanime, ajo e cila përkrah idenë, se nuk përfshihet në qëllimin e agjentit provokator, zbulimi i kriminelëve, të cilët njihen si përsëritës në krim. (De Maglie, 1991:566)

¹⁴⁶ Itinerarin kriminal

*Mes viteve '30 dhe '50, u bë e mundur nxjerrja e një ligji, që i dedikohej shprehimisht figurës së agjentit provokator. Interesi nga ana e jurisprudencës dhe e doktrinës, të një tipologjie të veçantë të agjentit provokator, që individualizohet në *fictus emptor*¹⁴⁷ apo e viktimës së rremë.*

Në një çështje të Gjykatës së Kasacionit të Italisë, si *agjent provokator*, identifikohet personi i cili, “*kamuflohet si një kriminel për të parandaluar progresin e aktit kriminal*”, duke e dalluar atë nga figura e “*nxitësit të vërtetë*”. Si “*nxitës i vërtetë*” është përcaktuar agjenti, i cili ka si qëllim të tijin të vetëm të shtyjë drejt kryerjes së krimit persona. Krime të cilat, nuk do të ishin kryer pa ndërhyrjen e tij.¹⁴⁸

Me përfshirjen e një tjetër figure në legjislacionin procedural penal, atë të *agjentit të infiltruar*, u fragmentarizua dhe koncepti egzistues. Bëhet fjalë për agjentin e policisë, i cili futet të bëjë pjesë në një organizatë kriminale me qëllim shkatërrimin e tyre. Figura e agjentit provokator nga ana strukturore qëndron në antitezë me figurën e agjentit të infiltruar. Në fakt, në realitetin kriminologjik, agjenti i infiltruar nuk ka si qëllim provokimin e krimit, por “*është i detyruar të lejojë të tjerët, që ta provokojnë për të kryer një krim, në të cilin ai është aktiv. Kjo, për arsye që të mos zbulojë funksionet e tija dhe për të penetruar më në thellësi të strukturës kriminale*”.

Deri në këtë moment ky argument, i kishte interesuar doktrinës dhe jurisprudencës së asaj kohe. Por në vitet '90 do të merrte në konsideratë modelin legjislativ të agjentit provokator. Në veçanti bëhet fjalë për figurën e *fictus emptor*, e cila doli në pah pas ndryshimeve legjislative të bëra në vitin 1975.¹⁴⁹ Ajo që evidentohet në këtë normativë, është para së gjithash, krijimi i një figure *ad hoc*, që rregullon me ligj aktivitetin provokues dhe që ka

¹⁴⁷ Blerës i rremë.

¹⁴⁸ Cass., Sez. I, 6 luglio 1943, in Riv. Pen., 1945, p. 258

¹⁴⁹ Art. 25 l. 162/1990 introduttivo di un art. 84 bis nella l. 685/1975 (art. 97 t.u. sugli stupefacenti)

zënë një vend të rëndësishëm në kod. Përveç kësaj, legjislatori e konsideron provokimin ndaj një veprë, si një metodë të ligjshme hetimi mbi krimet e kryera në fushën e lëndëve narkotike dhe specifika tjetër e këtij sistemi, është nënshtrimi i plotë i aktivitetit provokator ndaj autoriteteve gjyqësore.

Më tej, në vitin 1992 është parë si nevojë emergjente implementimi në legjislacionin e brendshëm italian, të figurës së agjentit provokator, si mjet për të luftuar kriminalitetin mafioz. Që në atë vit legjislatori shprehu vullnetin për t'i dhënë hapsirë në sistemin e brendshëm italian, figurës së *agjentit provokator*, dhe *figurës së agjentit të infiltruar*, e cila do të konsiderohej si një figurë më komplekse. Legjislacioni italian, gjatë një dekade ka njohur ndryshime të here pas hershme, të cilat ka trajtuar figura të reja dhe gjithnjë dhe më të dallueshme të *agjentit provokator*. Ndër to mund të përmendim katër fusha të një rëndësie të veçantë, të tilla si: trafikimi i lëndëve narkotike, pastrimi i parave, pedopornografia (pornografia e fëmijëve) si dhe terrorizmi. Gjithnjë dhe më shumë trajtohet si e një rëndësie madhore dallimi mes dy figurave në fjalë (agjentit provokator dhe agjentit të infiltruar), si domos e parë kjo në dritën e jurisprudencës së Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.¹⁵⁰ (De Maglie, 1991: 206)

Në vazhdim të këtij evolucioni normativ, në nenin 9 të ligjit nr. 146/2006, legjislatori ka përfshirë një listë të veprave penale në të cilat lejohet përfshirja e veprimtarisë së fshehtë hetimore në zbulimin dhe procedimin e tyre. Duke përjashtuar njëkohësisht përfshirjen e kësaj veprimtarie hetimore në veprat penale të komplotit¹⁵¹ dhe të korrupsionit.¹⁵² Ato sjellje kriminale, të cilat mund të jenë objekte të *undercover operations*, janë të parashikuara me qëllim rritjen e kompetencave të dhëna ndaj forcave të inteligjencës. Në këtë ligj është e

¹⁵⁰ GJEDNJ, sez. I, 21/2/2008, n. 15100.

¹⁵¹ Nenet 416 dhe 416 bis, Kodi Penal Italian, Articolo 416 - Associazione per delinquere.

¹⁵² Nenet 318 – 321, Kodi Penal Italian, Articolo 318 - Corruzione per l'esercizio della funzione.

artikular qartë *mos dënueshmëria* e të gjithë personelit të “agjentëve të infiltruar”, duke u konsideruar për ta, si një rast i veçantë i përmbushjes së detyrës.

Sipas legjislacionit gjerman, pjesa më e madhe e vendimeve gjyqësore, është përqëndruar më shumë mbi dënueshmërinë e kriminelit dhe jo mbi përgjegjësinë e agjentit provokator. (De Maglie, 1991:146)

Antikushtetueshmërinë e taktikave policore edhe pse parandalohen nga autorizimi i prokurorit publik, pasqyrohet mbi procesin duke përjashtuar dënueshmërinë e provokuesit për veprën e shkaktuar.

Analiza e *agjentit provokator* sipas sistemit *spanjoll*, është përqëndruar në fakt në aspektet substanciale, shihet si një figurë dogmatike e lidhur me pashmangshmërinë e dënimit në rastet kur jemi përpara *shtyrjes për të kryer një krim “àmbito de participación en el delito”,*¹⁵³ si në aspektet procedurale me referencë të veçantë në *técnica de investigación encubierta.*¹⁵⁴

*Nga njëra anë, është diskutuar në lidhje me çështjen e përgjegjësisë penale të agjentit provokator, nga ana tjetër analiza është fokusuar në limitimet që duhet t'i imponohen hetimit të fshehtë, të kryer përmes funksionarëve të policisë, që futet në një organizatë kriminale me një identitet fiktiv apo dhe e një të besuari të thjeshtë.*¹⁵⁵ (Perèz Arroyo M. R., 2000)

Edhe pse nuk kemi asnjë referencë statistikore me çfarë frekuence është përdorur agjenti i fshehtë si teknikë hetimore vendimet e organeve gjyqësore, në veçanti të *Sala Segunda, te el*

¹⁵³ Shtrirja e pjesëmarrjes në krim.

¹⁵⁴ Teknikat e hetimit të fshehtë.

¹⁵⁵ La Ley, 1765

Tribunal Costituzional y la Audiencia Nacional,¹⁵⁶ reflekojnë një prirje për identifikimin e agjentit provokator me atë të agjentit nën mbulim.

Problematikat më të mëdha dalin kur agjenti nën mbulim identifikohet me “njeri të besuar”, në mënyrë që të zbulojnë *modus operandi*,¹⁵⁷ të organizatave kriminale, duke u infiltruar në brendësi të strukturave të tyre. Në bazë të dispozitave të *Ley Organica 5/1999 të 13 janarit*, agjenti provokator, si njeriu i besuar i policisë, duhet të konsiderohet pra, jashtë fushës së mbulimit ligjor. I besuari, i cili shkon përtej një observimi të aktivitetit të jashtëligjshëm të tjerëve, duhet për këtë arsye të ekspozohet përpara mundësisë së përgjegjësisë penale si një *bashkëpunëtor në krim*. Duke u përfshirë në specifikën e normës, duhet thënë se kjo u konsiderua si përgjigjja *repressive* e të drejtës penale, materiale dhe procedurale, për një lloj kriminaliteti jo të zakonshëm, të identifikuar nga disa sektorë të doktrinës si “narkokriminaliteti”, edhe pse duhet mbajtur në konsideratë se një definicion i tillë nuk përfshin të gjitha deliktet për të cilat është i operueshëm aktiviteti nën mbulim. duhet thënë se, përjashtimi nga përgjegjësia penale shtrihet deri në justifikimin e veprimtarisë së agjentit, i cili aderon përmes një aktiviteti nën mbulim “*como consecuencia necesaria del desarrollo de la investigacion*”.¹⁵⁸ *Ky aktivitet duhet të jetë domosdoshmërisht në proporcion me qëllimin e hetimit dhe nuk mund të rezultojë të jetë një nxitje (në kuptimin e plotë të fjalës) për të kryer një delikt.* (Perèz Arroyo M. R., 2000: 1789)

U bënë përpjekje më pas për të thyer një traditë legjislativë, duke përfshirë një diferencim mes agjentit *provocador*, duke vendosur një limitim të ekzekutimit të mbulimit të tij. Kështu që, si nevoja edhe proporcionaliteti i veprimtarisë *undercover*, në çdo rast janë kritere, që në

¹⁵⁶ Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë.

¹⁵⁷ Mënyrën e operimit.

¹⁵⁸ Si pasojë e domosdoshmërisë për të zhvilluar hetimet.

mënyrë rigorozë qëndrojnë përballë limitit material të mosprovokimit të deliktit duke dalë si korrektor të natyrës sekondare. (Perèz Arroyo M. R., 2000: 1789)

U mbështet fillimisht egzistenca e një parimi të përgjithshëm, në të cilin provokimi nuk do të përballej të paktën, nga aspekti teorik me asnjë limit, kjo duke pasur parasysh cilësitë e veçanta të subjektit, që vepron si provokator. Vullneti legjislativ në këtë rast është projektuar për të kufizuar nga aspekti subjektiv figurën e agjentit *encubierto*, duke pasur parasysh kushtet e veçanta të agjentit të policisë gjyqësore, duke përfshirë një dallim midis “delito provocado” dhe “provocación policial”.¹⁵⁹ Nga njëra anë, sa i përket deliktit të provokuar, jurisprudenca është orientuar më shumë në pandëshkueshmërinë e të provokuarit (personi nën hetim), sesa të provokatorit (agjenti provokator), për qëndrimin e këtij aktiviteti, të cilat ndikojnë në parimet Kushtetuese të vendosura në bazat e një shteti me të drejta socialo- demokratike.

*Nëse agjenti i policisë gjyqësore nuk do të ndikonte ex novo në kryerjen e krimeve, duke u limituar në krijimin e kushteve për një skenar të përshtatshëm në kryerjen e një vepre në rrethana të veçanta, aktiviteti duhet të konsiderohet i ligjshëm, përse kohë ka si qëllim marrjen e provave rreth faktit.*¹⁶⁰ (Perèz Arroyo M. R., 2000), (Barrocu, G., 2011:122)

Ky është limiti lëndor që neni 285 bis i *Ley de Enjuiciamiento Criminal*¹⁶¹, përcakton ligjshmërinë e aktivitetit në mbulim të agjentit provokator dhe për përjashtimin e tij nga përgjegjësia penale. Ndalimi për të shkaktuar një delikt, për agjentin nuk është një limit absolut, por relativ përse kohë nuk të konsiderohet haptazi në kundërshtim me parimet kushtetuese dhe me lirinë e formimit të vullnetit të të provokuarit. Respektimi i kufizimeve të tilla jo vetëm që reflekton në mënyrë të drejpërdrejtë mbi përjashtimin nga përgjegjësia e agjentit provokator, por është e rëndësishme për të ruajtur vlefshmërinë e provave që varet nga hetimi i fshehtë, bëhet fjalë në këto raste për *prueba provocada* (prova të provokuara). (Perèz Arroyo M. R., 2000), (Barrocu, 2011:122)

¹⁵⁹ “Deliktit të provokuar” dhe “Provokimit policor”.

¹⁶⁰ La Ley, cit., 1789.

¹⁶¹ Ligji i Procedurës Penale të Spanjës.

Duke vënë re kriteret e pakufizuara të veprimtarisë të *agentes encubiertas*, qofshin ato provokator apo të infiltruar të thjeshtë, arrijmë në përfundimin që, në vija të përgjithshme, kur provokatori nuk konsiderohet i dënueshem, provat e marra përmes aktivitetit të tij do të jenë të ligjshme në proces, në rastin e përgjegjësisë penale të *agente encubierto*, provat e marra prej tij do të konsiderohen të paligjshme.

5.7. Dokumentacioni i operacionit të fshehtë dhe përdorshmëria në procese penale

Agjenti i infiltruar, duke fshehur cilësinë e tij si agjent i policisë, arrin të futet në kontakt me një organizatë kriminale, dhe në fund arrin të grumbullojë provat apo dhe të kapë në flagrancë të dyshuarit. Përfshirja e tij në brendësi të një grupi kriminal shkon përtej një hetimi të zakonshëm mbi fakte të ndodhura apo mbi fakte që do të ndodhin. Në të tilla raste, nëse rezulton se subjekti, shkon përtej të qenit një “i infiltruar” i thjeshtë, atëherë kemi përftuar një kontribut, të cilin mund ta quajmë një “faliment të vërtetë”, rezultateve të përftuara nga veprimet hetimore. Kemi parasysh këtu rastin kur personi i provokuar, në një mënyrë apo në një tjetër shtyhet apo nxitet për të kryer një krim, i cili po të mos egzistonte provokimi nuk do të ishte kryer. (Vallini, 2011)

Shtrojmë për trajtim çështjen e dënueshmërisë ose jo të personave “të nxitur” për të kryer krim nga agjenti i policisë.

Në këtë pikë është shprehur qartë jurisprudenca e Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut.¹⁶² Në arsyetimet e vendimeve të saj, Gjykata shprehet se, konsiderohet një shkelje e të “drejtës për një proces të rregullt” (neni 6 i KEDNJ), në rastin kur subjekti është dënuar për një vepër të shkaktuar nga një provokim i agjentëve të policisë “në kuptimin e ngushtë”.

¹⁶² Teixeira de Castro kundër Portugalisë, viti 9. 6.1998, Pyrgiotakis kundër Greqisë, viti 21. 2. 2008, Malinas kunder Lituanisë, viti 1.7. 2008.

E tillë qasje, nga pikëpamja e legjislacionit tonë të brendshëm gjen mbështetje në pikën 3 të nenit 294 të K.Pr.P:

“Nuk duhet provokuar një akt kriminal, duke shtyrë një person të kryejë një krim, të cilin nuk do ta kishte kryer po të mos ishte ndërhyrja e policisë. Kur vërtetohet provokimi, rezultati nuk mund të përdoret”

Edhe në praktikat tona gjyqësore, të cilat kemi pasur rastin t'i trajtojmë në kapitujt paraardhës, ka pasë një numër të konsiderueshëm rastesh, në të cilat janë përfshirë hetimet e fshehta. Edhe gjykatat tona, ashtu si ato të vendeve të huaja, kanë pasë rastin të diskutojnë rreth çështjes së përdorshmërisë së provave të përfuara nga aktiviteti nën mbulim, në dy mënyra diametralisht të kundërta. Ky diskutim ka bërë evident vështirësinë interpretative dhe pasigurinë e gjërë operationale nga e cila karakterizohet kjo formë e veçantë hetimore. Kemi agjentin provokator në qendër të referencave tona, i cili duhet të rregullojë jo vetëm e marrëdhëniet mes garantimit të lirisë dhe të drejtës për të vetvendosur, por dhe nga ana tjetër mes nevojës për represion dhe parandalimin të krimit. Ajo çfarë e bën edhe më delikat këtë trajtim është përcaktimi i kufijve që ekzistojnë në marrëdhëniet delikate mes hetimit dhe shqyrtimit gjyqësor pra mes policisë dhe prokurorisë.

5.8. Teknikat e posaçme hetimore sipas Jurisprudencës së Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut

Rritja e veprimtarisë kriminale si dhe kompleksiteti i krimit financiar, në veçanti janë përballuar me rritjen e larmisë së mjeteve në dispozicion të shtetit për të penetruar dhe më shumë në jetën private të individëve.¹⁶³ Është e dukshme, që në këtë pikë ndodhemi përballë nevojës dhe domosdoshmërisë për të luftuar krimin dhe për të mbrojtur sigurinë dhe nga ana tjetër ndodhemi përballë ndërhyrjes së shtetit, ndoshta më shumë seç duhet, në jetën private

¹⁶³ Udhëzues për hetimin e korrupsionit dhe krimit financiar, (2010), Dudaj, Tiranë, fq 118.

të individëve, duke cënuar kështu *“të drejtën e individëve për një jetë private”*, që gjen mbrojtje në nenin 8 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

KEDNJ-ja dhe vendimet e GJEDNJ-së po kthehen ngadalë në një standard mbarëevropian në lidhje me përdorimin e teknikave të posaçme të hetimit. Mënyra si i trajton GJEDNJ-ja këto teknika është krejtësisht pragmatiste. Ajo e pranon se këto mjete janë të domosdoshme, nëse pretendohet të luftohet si duhet krimi, në të gjitha format dhe larmitë e tij.¹⁶⁴ Pra, Konventa dhe GJEDNJ-ja nuk e përjashtojnë vëzhgimin e fshehtë, përgjimin e telefonave, operacionet e fshehta. Por nga ana tjetër, Konventa kërkon, që shteti përpara se të përdorë këto strategji, të tregojë se ndërhyrja në privatësi dhe shkalla e kësaj ndërhyrjeje janë të nevojshme.¹⁶⁵ Për më tepër, Konventa kërkon që strategjitë të shoqërohen nga garanci procedurale të mjaftueshme, për të garantuar që ato nuk do të përdoren në mënyrë arbitrare, të paparashikueshme dhe të pakontrolluar. Dy të drejtat kryesore të mbrojtura nga Konventa, që mund të shkelen nga përdorimi i teknikave të posaçme hetimore janë e *“drejta për jetë private”* dhe e *“drejta për gjykim të drejtë”*.¹⁶⁶

Është pika 2 e nenit 8 të KEDNJ, e cila legjitimon në një farë mënyre ndërhyrjen e autoritetit publik në jetën private të individit, në të thuhet:

“Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve”.¹⁶⁷

Në çështje të ndryshme të shqyrtuara nga GJEDNJ, vëmë re një larmi strategjish vëzhgimi të përdorura nga ana e shtetit, ku ndër to rradhisim: Përgjimin e telefonit dhe të korre-

¹⁶⁴ Po aty.

¹⁶⁵ Neni 8 pika 2, KEDNJ.

¹⁶⁶ Neni 6, *“E drejta për gjykim të drejtë”* dhe neni 8 *“E drejta për jetë private”*.

¹⁶⁷ Neni 8\2, Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut.

spondencës, matja dhe verifikimi i telefonatave (d.m.th verifikimi i numrave, të telefonatave hyrëse dhe dalëse), përgjimi i një pager-i, përdorimi i mjeteve dëgjimore të fshehta, vëzhgimi me video ¹⁶⁸ etj. GJEDNJ është shprehur, se këto teknika hetimore, ndërhyjnë në privatësinë e jetës së individëve, duke cënuar kështu nenin 8 të KEDNJ.

Hetimet paraprake përbëjnë një tematike thuajse dytësore në kontekstin e jurisprudencës së Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut. E tillë fazë e procesit penal nuk ka si qëllim të finalizojë në formimin e provave në kuptimin e plotë të fjalës, është më tepër një fazë e cila ka si qëllim “sigurimin” e burimit të provave. Megjithatë, kjo nuk do të thotë që, në lidhje me një fazë të tillë të procesit penal, nuk duhet të regjistrohen gjykime dhe disa vendime të Gjykatës Europiane, veçanërisht në lidhje me përndjekjet dhe sekuestrimet, përgjimet dhe aktivitetet nën mbulim. (Lettieri, 2006: 31)

- *Përgjimet*

Mbi *përgjimet* në veçanti, paramatrat normativ të përmendura nga Gjykata Europiane, janë bërë zakonisht referuar në nenet 3, 8 dhe 13 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. (Lettieri, 2006:32)

Neni 3, parashikon ndalimin e torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose degraduese.

Neni 8, vendos të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare, banesës dhe korespondencës së tij.

¹⁶⁸ Udhëzues për hetimin e korrupsionit dhe krimit financiar, (2010), Dudaj, Tiranë, faqe 120.

Neni 13, kërkon që çdo person duhet të ketë të drejtë për të paraqitur denoncime përpara një gjykatë kombëtare, denoncime këto që lidhen me shkeljen e të drejtave dhe të lirive të njohura nga Konventa e të Drejtave të Njeriut.¹⁶⁹

Në vendimin Rossem kundër Belgjikës datë 09.12.2004, Gjykata Europiane ka deklaruar se, *egzistojnë shkelje të Nenit 8 (të drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij) në rastin kur është bërë kontrollimi i lokalit nuk është shoqëruar nga garanci procedurale, dhe në veçanti kur i referohemi faktit që autorizimi nuk përmban një minimum informacioni, në mënyrë që të mundësojë verifikimin nëse agjentët, të cilët kanë zbatuar, i janë përmbajtur qëllimit të hetimit për të cilin ato janë autorizuar*. GJEDNJ nënvijëzon nevojën e “çdo dokumenti të dobishëm për hetimin”, pa specifikime të mëtejshme dhe pa përcaktuar një inventar për sendet e sekuestruara, të cilat kanë ardhë si rezultat i përndjekjes. (Lettieri, 2006:32)

Parime të ngjashme janë vendosur në çështjen e *Buck* kundër *Germanisë* datë 28.04.2005, ku GJEDNJ ka deklaruar se, përndjekja merr formën e ndërhyrjes në jetën private dhe për të mos u konsideruar në kundërshtim me Konventën Europiane, duhet të përmbushi këto tre kushte: të jetë e parashikuar me ligj, përndjekja të bëhet për qëllime të ligjshme dhe të jetë e nevojshme për një shoqëri demokratike (pra, të jetë proporcionale me objektivin që do të arrijë). Në rastin konkret gjykata ka konstatuar një mungesë të kërkesës për proporcionalitet në lidhje me një urdhër përndjekjeje, e cila përmban një përshkrim mjaft të gjerë, në drejtim të një subjekti të pahetuar më parë dhe të mirënjohur në atë zonë, për një vepër jo shumë alarmante, që supozohet të jetë kryer gjoja nga një person i tretë. (Lettieri, 2006:32)

¹⁶⁹ Ligj nr.8137, datë 31.7.1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe lirive themelore”, Flet.Zyrtare Nr.20, Faqe: 724.

Vendimi *LL.M.* kundër *Italisë* datë 08.02.2005, Gjykata Europiane ka rigjetur shkelje të ne-neve 8 dhe 13 të Konventës në lidhje me një rast në të cilin aplikanti ankohej për:

a) Shkelje të nenit 8 të Konventës, pasi në rastin specifik, urdhëri i përndjekjes apo autorizimi ishte lëshuar në mënyrë verbale, duke mos u bërë kështu objekt i një vlerësimi ligjor nga ana e prokurorit. Prandaj jemi përpara faktit, ku mungon një autorizim i ligjshëm, ose e thënë ndryshe, mungon baza ligjore, ku ndër të tjera është e nevojshme për të lejuar një kontroll, në retrospektive me aktivitetin e bërë me iniciativë të policisë.

b) Shkelje të nenit 13 të Konventës, duke marrë parasysh mungesën në legjislacionin Italian të së drejtës për të ushtruar një ankim ndaj një urdhër-kontrolli, në rastin e një rezultati negativ të aktit. (Lettieri, 2006:32)

- *Përgjimet telefonike*

Sa herë që GJEDNJ, është dashur të shprehet në lidhje me përgjimet telefonike dhe ato ambjentale, i është referuar nenit 8 të Konventës. Ky nen tekstualisht shprehet në lidhje me mbrojtjen e “*jetës private*”. Për gjykatën jeta private përfshin, integritetin fizik dhe moral të personit, si dhe të drejtën e individit për të lidhur dhe zhvilluar marrëdhënie me të ngjashmit e tyre si dhe me botën e jashtme.¹⁷⁰ Duke u nisur nga ky nocion themelor gjykata thekson se, edhe pse paragrafi 1 i nenit 8 nuk përmend bisedat telefonike, ato janë të përfshira në nocionin e “*jetës private*” dhe “*korrespondencës*” të përfshira në këtë normë.¹⁷¹ Pasojat e mëtejshme për gjykatën janë se “kur kryhet kundër një individ, secila nga masat e përgjimit të lejuara do të sillte një ndërhyrje të një autoriteti publik në ushtrimin e të drejtës të të interesuarit në respekt të jetës private dhe familjare dhe të korrespondencës së tij. Megjithatë gjykata pranon nevojën e dispozitave legjislative të cilat të mund të kontribuojnë në

¹⁷⁰ Çështja e GJ EDNJ, C. c. kundër Belgjikës, paragrafi 25.

¹⁷¹ Çështja e GJEDNJ, Klass § 41, Malone § 64.

përgjime të fshehta të korrespondencës, të dërgesave postare dhe të telekomunikacionit. Të gjitha këto të bëhen në raste të jashtëzakonshme, të nevojshme për një shoqëri demokratike në interes të sigurisë kombëtare dhe\ose për parandalimin e trazirave dhe për parandalimin e krimit.¹⁷²

Prandaj, derisa përgjimet telefonike të kryhen nga një shtet që është anëtar, për të mos qënë në kundërshtim me Konventën janë të nevojshme kushtet e mëposhtme:

1-Duhet që, ndërhyrja në “jetën private”, përmes përgjimeve telefonike, të jetë e parashikuar me ligj. Nuk bëhet fjalë të jetë një ligj nën emërtimin “ligj”, mund të bëjë pjesë si në të drejtën e shkruar dhe në atë të pashkruar.¹⁷³ “Bazë ligjore”, nuk janë vetëm aktet normative, por janë edhe aktet që në të drejtën e brendshme nuk janë “ligje”, kështu për gjykatën konsiderohen “bazë ligjore” edhe qarkoret administrative.¹⁷⁴ Parimet e përgjithshme të të drejtës¹⁷⁵ është edhe e drejta e pashkruar.¹⁷⁶

2-Kërkesa e dytë ka të bëjë me “cilësinë e ligjit”. Term ky, i përdorur shpesh nga gjykata për të sqaruar se për qëllime të papajtueshmërisë me parimet e Konventës. Nuk është e mjaftueshme të përfshih një ligj për të rregulluar një situatë të caktuar, është e nevojshme që ligji t’i përgjigjet kërkesës dhe nevojës që ka të bëjë me njohjen dhe aksesin që qytetari duhet të ketë mbi këtë ligj. Duhet njëkohësisht të jetë një ligj mjaftueshmërisht i qartë dhe i saktë në lidhje me shtrirjen dhe kufinj të diskrecionit të thirrjes kombëtare për të zbatuar ndërhyrjen. Sa i përket pikës së parë gjykata në çështjen *Sunday Times* kundër *Kombeve të Bashkuara*, ka sqaruar se, qytetari duhet të ketë qasje dhe informata të mjaftueshme mbi normat juridike të aplikueshme për një rast të veçantë, në mënyrë që ai të jetë në gjendje të rregullojë sjelljet e tija dhe të parashikojë në mënyrë të arsyeshme pasojat. Sa i përket pikës së dytë, në shumë raste,¹⁷⁷ shteti kontraktues ka qënë i dënuar për shkelje të nenit 8, përsakohë ligji rregullues nuk përdorte terminologji të qartë për të treguar në mënyrë mjaftueshmërisht të qartë në cilat rrethana dhe në çfarë kushtesh pushteti publik ishte i autorizuar për të vepruar me përgjimet telefonike, duke kërcënua praktikisht të drejtën për respektimin e jetës private dhe korrespondencën. (Lettieri, 2006: 34)

¹⁷² Çështja e GJEDNJ, *Klass* § 41, 48.

¹⁷³ Çështja e GJEDNJ, *Sunday Times* §47.

¹⁷⁴ Çështjet e GJEDNJ, *Kruslin, Huvig, N .F.* kundër *Italisë, Maestri* kundër *Italisë*.

¹⁷⁵ Çështja e GJEDNJ e vitit 1979, *Winterwerp* kundër *Hollandës*.

¹⁷⁶ Çështja e GJEDNJ e vitit 1979, *Sunday Times* kundër *Mbretërisë së Bashkuar* n. 1

¹⁷⁷ Çështja *Malone* kundër *Kombeve të Bashkuara* e datës 02.08.1984, *Prado Bugallo* kundër *Spanjës*, *Huvig* kundër *Francës* e datës 27 mars 1990)

3-Kërkesa e tretë është se nuk mjafton që ndërhyrja të jetë e parashikuar me ligj, nevojitet gjithashtu që ligji të ndjekë qëllime të ligjshme, kjo në referim të paragrafit 2 të nenit 8 të Konventës.

4-Së fundi ndërhyrja duhet të plotësojë një kusht të fundit, pra, ajo duhet të jetë e “nevojshme për një shoqëri demokratike”, për të arritur qëllimet e përcaktuara më lart. Një kushti të tillë nuk i jepet një përkufizimi thjeshtë dhe ende përkon me kërkesën që duhet të ketë një proporcionalitet mes ndërhyrjes dhe ndjekjes penale nga ana e shtetit për një qëllim legjitim.¹⁷⁸ Në thelb, madje brenda përgjimeve telefonike, të cilat janë të parashikuara rregullisht me ligj për një qëllim të ligjshëm, të tilla përgjime mund të jenë njëlloj në kundërshtim me parimet e Konventës, atëherë kur të ishte e mundur për të gjetur një përballje apo një disproporcion mes interes publik dhe interes themelor të individit për respektimin e jetës private dhe familjare me kusht që ndërhyrjet në jetën private të personit të duken të disproporcionuara.

Drita këtyre koordinatave të përgjithshme brenda të cilave gjykata inkuadron problematikën e përgjimeve telefonike, pikëpamja e jurisprudencës europiane mbi aspekte të caktuara përfshin problematikat e sipërpërmendura mund të inkuadrohet sa poshtë:

A) Gjykata duket të ketë një koncept unik të “*onere probatorio*”¹⁷⁹, për të cilin si rregull duhet t’i takojë atij që pohon një fakt, ta provojë gjithësesi. Pra, në gjykimin Klass dhe Halford (paragrafi 57) konstatohet se, “*për aplikantin, i cili shprehu keqardhje për masat konkrete të përgjimit telefonik nuk është në përputhje me ligjin, gjykata duhet të bindet për egzistencën e një mundësie të arsyeshme që i interesuari të ketë qënë objekt i masave të tilla*”, nga kjo gjykata forcon konceptin e “*viktims potenciale*”, në referim të nenit 34 të Konventës (të jesh viktimë e një shkeljeje të Konventës, është një nga kërkesat e nevojshme për të paraqitur një kërkesë në Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut). Konsideron të jetë i autorizuar të kritikojë një ligj kombëtar ose praktikë që autorizon përgjimin, pavarësisht aplikimit të tyre për një çështje konkrete është me shumë mundësia e tyre për të cënuar të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare.

B) Neni 8 i Konventës nuk është i limituar për të ngarkuar mbi shtetin një detyrim për të mos bërë një ndërhyrje në jetën private, por nganjëherë gjithashtu përfshin një detyrim për të bërë të mundur sugurimin e të drejtës për jetën private dhe familjare. Gjykata megjithatë nuk jep udhëzime të qarta për të arritur në përcaktimin e detyrimeve positive të shtetit.¹⁸⁰ Në një tjetër çështje Craxi kundër Italisë gjykim i datës 17.07.2003, gjykata e kritikoi faktin së transkriptimet telefonike, të depozituara në zyrën e prokurorit publik dhe që ka një përmbajtje rreptësisht private, kanë qënë të publikuara nga shtypi i përditshëm, kështu që duke çuar në një shtrydhje të të drejtave të të akuzuarit në mënyrë të papajtueshme me Konventën.

¹⁷⁸ Çështja e GJEDNJ, *Silver* § 97.

¹⁷⁹ Barra e provës.

¹⁸⁰ *Keegan* kundër *Irlandës*, gjykimi i 26 majit 1994, §49.

Kështu që, garancitë që shteti ishte dashur të ofronte për të shmangur një zbulim të materialit të mbajtur në sekretari ishin paraqitur si të pamjaftueshme. Nuk rezultonte as që vetë shteti të kishte kryer një hetim efektiv, si për të sqaruar mënyrën se si gazetarët kishin arritur të kishin qasje mbi dokumentat ashtu edhe për të dënua përgjegjësit. Shkelja e nenit 8 të Konventës u vëzhgua në një mungesë të një reagimi të përshtatshëm të shtetit përballë publikimit të transkriptimit të përgjimeve telefonike.

C) Në çështjen *Craxi* të sipërcituar, Gjykata Europiane ka vendosur premisën që, edhe pse është detyrë e autoriteteve kombëtare të interpretojnë rregullat e brendshëm, gjykata mund dhe duhet të ushtrojë të drejtën e kontrollit në këtë fushë, nëse interpretimi është ose jo në përputhje me respektimin ose jo të të drejtave themelore të njeriut, nisur nga kjo ka deklaruar një shkelje të nenit 8 të Konventës, si rezultat i përjashtimit nga gjykata në nevojën për të mbajtur një fragment nga seancë, parashikuar në nenin 268 pika 6 e K.Pr.P., pas fillimit të fazës së debatit gjyqësor (përmëtepër mbajtja e një fragmenti të seancës, për të hedhur materiale jorelevante ose të papërdorshëm dhe për të parandaluar që ato të bëhen publike, përbën një garanci thelbësore për të mbrojtur konfidencialitetin, kështu që mosveprimi i saj i mundshëm do të thotë se ose ligji i brendshëm nuk është respektuar ose që është jo në përputhje me Konventën).

D) Në çështjen *M.M. kundër Hollandës* të datës 08.04.2003, gjykata ka interpretuar si jo në përputhje me një interpretim korrekt të ligjit kombëtar, sjelljen e disa policëve dhe e prokurorit, të cilët kishin shtyrë një grua të hezitojë të kontaktojë me drejtësinë, të rregjistrojë fshehurazi një bisedë me një njeri që i ishte paraqitur më parë interes seksual përkundrejt saj. Në këtë rast gjykata kishte vërejtur si një mungesë të hetimeve paraprake, si mungesën e një urdhëri nga ana e një gjyqtari, i cili autorizon rregjistrimin (kërkesa këto, të cilat nuk kërkojnë shprehimisht, në lidhje me përgjimin e një bisede të bërë nga njëra palë pa dijeninë e palës tjetër, por që për gjykatën duhej zgjeruar dhe një hipotezë e tillë).

E) Gjykata ka konsideruar si shkelje të nenit 8, edhe në rastin e rregjistrimit të zërave të dy personave të arrestuar, pa dijeninë e tyre në qelinë e tyre në momentin kur ata i përgjigjeshin pyetjeve të formuluar nga policia, duke pasë si qëllim krahasimin e këtyre zërave me ato që ishin objekt në disa përgjime të mëparshme ambjentale. Gjykata u shpreh se ky përbente një ndërhyrje në respekt të të drejtës së tyre për një jetë private, siç kuptohet dhe të integritetit fizik dhe atij moral, e cila çenohej në këtë mënyrë nga një mbështetje e përhershme të rregjistruar që i nënshtroheshin analizimit.¹⁸¹

F) Në aferën *Lambert kundër Francës*, gjykata europiane ka vendosur parimin sipas të cilit ligji duhet të japë garanci të mjaftueshme jo vetëm për titullarin e linjës telefonike që është nën përgjim por edhe për të tretët, të cilët mund të telefonojnë ose dhe mund të telefonohen nga një linjë e tillë të ketë pasoja nga përgjimi i bisedës së tij. Për gjykatën europiane mungesa e legjitimitetit për të tretët, për të ngritur në gjykim një veçim për pavlefshmëri të përgjimit, përbën një dhunim të nenit 8 të Konventës, përsakohë mekanizmi i mbrojtje nuk

¹⁸¹ P.G. dhe J.H. kundër U.K. §56-60)

mund të anashkalojë një numër të madh njerëzish, domethënë të gjithë ato të cilët komunikojnë me të tjetër të cilët kanë linja telefonike në përgjim.

G) Gjykata konstatoi se mungesa e një ligji që e parashikon, gjithashtu dhe blerja nga ana e policisë e tabulantëve telefonike të një abonenti pa pëlqimin e këtij të fundit, çon në shkeljen e të drejtës së sanksionuar nga neni 8 i Konventës¹⁸²

H) Në *Lanz kundër Austrisë* të datës 31. 01. 2002,¹⁸³ gjykata europiane ka dënuar shtetin palë për dhunim të nenit 6 paragrafit 3 të Konventës, duke qënë se ai ka mbajtur nën përgjim për një periudhë prej 3 muajsh, bisedat mes të dyshuarit të arrestuar dhe avokatit të tij, pa pasur arsye serioze dhe bindëse për të justifikuar një ndërhyrje të tillë në të drejtën e mbrojtjes së individit. Anasjelltas në çështjen e *Kempers kundër Austrisë* vendim i datës 27.02.1997, gjykata ka njohur një rast ekstrem, në të cilën përgjimi ishte i justifikueshëm, duke heshur poshtë ankesën, bëhej fjalë për një të arrestur në krye të një bande kriminale dhe konfidencat e mundshme të shprehura mund të çonin në arrestimin e komponentëve të tjerë të bandës. (Lettieri, 2006:34)

Në konkluzion të sa parashtruam, sipas GJEDNJ, mjetet duhet me çdo kusht të justifikojnë rrethanat dhe se këto rrethana duhet të gjejnë shprehje në pikën 2 të nenit 8 të KEDNJ, dhe vetëm në këtë mënyrë teknikat hetimore do të legjitimoheshin.

5.9. Avantazhet e përdorimit të “Veprimeve simuluese” dhe “Infiltrimit”

Sa trajtuam në kapitujt paraardhës, kishte të bënte me problematikat, që ka paraqitur përdorimi i teknikave të veçanta hetimore (hetimi pro-aktiv). Trajtuam kufinj të e brishtë ligjor brenda të cilëve zhvillohet ky lloj aktiviteti. Pamë një konkurrim mes nevojës për të zbuluar dhe proceduar krimin në format më të sofistikuar të shfaqjes së tij dhe të drejtave të tjera ligjore dhe kushtetuese, që gëzon secili nga ne. Pavarësisht kësaj, në asnjë rast nuk duhet të

¹⁸²Çështja e GjEDNJ, *Malone* §83-84.

¹⁸³ *Lanz kundër Austrisë*, datë 31.01. 2002, § 45-53.

anashkalojmë rëndësinë, që paraqet ky mjet i veçantë hetimor në zbulimin e disa formave të reja të shfaqjes së krimit.

Me zhvillimin e internetit, krimi ka gjetur një tjetër formë shprehjeje, të panjohur më parë. Si çdo teknologji e re e vënë në dispozicion të një numri të madh përdoruesish, interneti paraqet jo vetëm të mira dhe përfitime, por në të njëjtën kohë dhe një sërë problemesh. Keqpërdorimi i saj nga elementë kriminal njihet me emrin krim kibernetik (cybercrime). Në praktikën e përditshme konstatohen dy lloj sjelljesh përballë fenomenit të krimit kibernetik. Nga njëra anë qëndrojnë përdoruesit e zakonshëm dhe indiferent, të cilët mendojnë se janë imun përballë këtij rreziku dhe nga ana tjetër qëndrojnë specialistët, të cilët analizojnë këtë fenomen me shumë kujdes, në mënyrë, që të kuptojnë mënyrën e funksionimit të tij. Scott Peck, një psikiatër i njohur amerikan dhe autor i suksesshëm librash shkruan: *“E vetmja mënyrë për të pasur siguri në jetë është të njohësh pasigurinë”*.

Mes formave të shumta të shfaqjes të krimeve kibernetike, një terren të përshtatshëm për “kultivim” ka gjetur pedofilia. Por, duke qënë se teknologjitë e reja janë në evolucion të vazhdueshëm dhe rreziqet e lidhura me këtë teknologji evoluojnë në të njëjtën mënyrë, natyrshëm lind pyejtja, a ecën me të njëjtin ritëm teknikat investigative, që mund të parandalojnë apo ndëshkojnë këtë krim?

5.9.1. Agjenti i infiltruar në dhomat e “chat”-it

Konteksti dhe fushëveprimi i krimit kibernetik është i gjërë dhe shumë llojshëm, por ne do te fokusohemi tek, Pedofilia-online. Kur flasim për pedofilinë on-line, i referohemi sjelljeve devijante të pedofilëve në moshë madhore, të cilët kërkojnë të hyjnë në kontakt me pedofilë të tjerë, përmes internetit (chat, forum etj). Këto takime ato i shfrytëzojnë si mënyrë për të

ushqyer fantazitë e tyre seksuale, përmes gjurmimit dhe shkëmbimit të materialeve pornografike.

Materialet pornografike konsistojnë në fotografi apo video pedopornografike, që mundësojnë me pas takimin apo hyrjen në kontakt me të mitur, të cilët gjenden në rrjet. Bazuar në statistikat e institucioneve shtetërore të vendeve të zhvilluara, arrijmë të përcaktojmë një trend, gjithmonë e më në rritje, sa i përket përhapjes së këtij fenomeni.

- Ku qëndron vështirësia në identifikimin, procedimin dhe më pas gjykimin e këtij krimi?

Çfarë përbën problem në këtë drejtim, është vetë forma e shfaqjes së këtij krimi. Nga një këndvështrim legal, interneti është i konceptuar dhe funksionon në një mënyrë të tillë, që për të, nocioni i kufijve nuk ekziston. Në fushën juridike një krim në radhë të parë sanksionohet nga një ligj. Ky ligj i përket një shteti të caktuar dhe zbatohet nga një gjykatë kompetente e një shteti të caktuar. Nocioni i shtetit është i lidhur ngushtë me nocionin e territorit, pra me kufijtë shtetërorë. E shpjeguar më qartë, krimi kryhet në një juridiksion të caktuar, edhe pse, kriminelin fizikisht ndodhet në një tjetër juridiksion. Kjo ndikon shumë në fazën e përndjekjes së këtij krimi.

5.9.2. Profili krimilogjik i pedofilëve

Pedofilët janë subjekte, të cilët karakterizohen nga kthjellësi e plotë në të menduar. Ata pas një procesi të gjatë dhe kompleks të menduari, hyjnë në veprim për të gjurmuar të miturit.¹⁸⁴ Përgjithësisht, ata nuk veprojnë nën ndikimin e një vrulli të shfrenuar, por përkundrazi, janë

¹⁸⁴ Policia di stato-UACI (Unita di Analisi sui Crimini Informatici)-2004.

subjekte që mendojnë, reflektojnë në mënyrë të qartë duke marrë parasysh të mirat dhe të këqijat që lidhen me ekzekutimin e sjelljeve kriminale dhe kënaqësive perverse.¹⁸⁵

Veprojnë në fshehtësi të plotë. Në shoqëri janë thujtë të padukshëm, dhe sa të padukshëm aq dhe vrashtar. Parashtruam sa sipër, për të kuptuar vështirësitë, që kanë të bëjnë me identifikimin e subjekteve të tilla kriminale në jetën tonë të përditshme, si dhe për t'u ndërgjegjësuar për rrezikun ndaj të cilit janë të ekspozuar minorenët në mbarë botën. Në bazë të statistikave, 12% e meshkujve dhe 17% e grave amerikane janë keqtrajtuar në fëmijëri dhe numri i rasteve të abuzimit seksual është rritur në mes të 1986 dhe 2003 me 120%. (Bruzzone, 2007)

Ndikim në zgjerimin e këtij krimi, ka pasur zhvillimi teknologjisë, i cili shndërrohet në një “armë të rrezikshme”, në duart e gabuara. Pedofilët shfrytëzojnë burimet pafund, që ofron interneti, për të kapur “prenë” e rradhës. Ata konsiderohen si njohës të mirë të programeve kompjuterike dhe duke qënë të tillë, dinë të veprojnë pa lënë gjurmë dhe nëse dyshojnë se mund të identifikohen, dinë të tërhiqen në kohë.

5.9.3. Edukimi si masë mbrojtëse

Pedofilia është një rrezik real për fëmijët dhe ne nuk mund të pretendojmë, që ata të dinë si të vetëmbrohen. *“Fëmija nuk mund të vetëmbrohet, pasi është tipike e periudhës së tyre të rritjes, mbajtja e një qëndrim besues kundrejt botës së jashtme”*. (Pajardi, 1990:72)

Dhe pikërisht, kur ky besim goditet, marrëdhënia, që vendos më pas fëmija me botën e jashtme ndërpritet, duke ndikuar kështu negativisht në zhvillimin e tij psikologjik.

¹⁸⁵ Policia di stato-UACI (Unita di Analisi sui Crimini Informatici)-2004.

Ti mësosh fëmijët të mbrohen nuk do të thotë t'i mësosh të dyshojnë tek të gjithë, pasi të jetuarit në dyshime mund ta bllokojë fëmijën, duke i hequr dëshirën për të eksploruar botën, eksplorime këto, që e ndihmojnë të rritet. Liria, të jetuarit pa preokupime si dhe besimi janë të mira shumë të çmuara për t'u sakrifikuar nën altarin e frikës. (Andreoli, 2003:173-174)

Duke thënë se një fëmijë nuk mund të vetëmbrohet, nuk nënkupton se nuk mund të jetë i mbrojtur. Është shoqëria, që duhet ta mbrojë, është familja, është shkolla. (Gombia, 2002:101)

Pa dyshim familja është struktura primare, që duhet t'i ofrojë fëmijëve mbrojtje, duke e këshilluar, duke i qëndruar afër apo duke i lënë fëmijët nën shoqërinë e një të rrituri gjatë orëve, që ai kalon në internet.¹⁸⁶

- Cilët janë programet më të përdorura nga pedofilët?

Peer-to-peer (P2P) - Shërbimi peer-to peer (P2P) mundëson shkëmbimin e fotografive mes kompjuterave pa u lidhur me ndonjë faqe internet (web site). Funkcioni kryesor i këtyre shërbimeve është të mundësojë shkëmbimin e të gjitha llojeve të dosjeve (file), nëpërmjet kompjuterave të përdoruesve të lidhur njëkohësisht me rrjetin të vendosura në të gjithë botën. Shumë nga sistemet peer-to-peer mundësojnë shpërndarjen e filmave, fotografive, muzikës, videove, librave etj. Duhet të kemi parasysh, që kjo është një prej mënyrave më të përdorura prej pedofileve për të shkëmbyer pamje apo videodhune dhe abuzimi, ndaj fëmijëve, madje edhe ndaj atyre në moshë fare të vogël. Shumë shërbime peer-to peer inkurajojnë përdoruesit të shkarkojnë një numër të madh dosjesh (file). Mjafton një lidhje ADSL

¹⁸⁶ "Le strategie di contrasto" <http://www.altrodiritto.unifi.it>, datë 02. 02.2013.

dhe pa asnjë pagesë shtesë, kompjuteri mund të lihet për orë të tëra duke shkarkuar kështu dhe duke shkëmbyer materiale pornografike.¹⁸⁷

Duhet të reflektojmë mbi këtë fakt, pasi kompjuteri në këtë rast, na ekspozon përpara rreziqeve shumë të rënda, që lejojnë një qasje të lirë në kompjuterat tonë duke bërë kështu analogji me lënien e portës së shtëpisë hapur, pasi çdokush mund të marrë nga dosjet apo nga harddisku ynë atë që dëshiron.

Chatroom- Dhomat e chat, na mundësojnë një komunikim në kohë reale me njerëz nga e gjithë bota, duke përdorur kompjuterin tonë të lidhur me rrjetin. Shumë chat-e janë të organizuara në “dhoma”, çdo dhomë ka një emër, që korrespondon me argumentin prevalues për të cilin po flasim personat në atë moment. Ne mund të shkruajmë në mënyrë publike, në mënyrë që, të gjithë të mund ta shohin atë që po shkruajmë ose mund të mbajmë një bashkëbisedim privat me një apo më shumë përdorues të chat-it. Duket argëtuese, por mund të jetë shumë e rrezikshme, nëse nuk kujdesemi për privatësinë (privacy) dhe për sigurinë tonë. Në fakt chat është një vend ku shumë njerëz kanë bindjen, se nuk është e rëndësishme të thuash të vërtetën, ka të rritur dhe djem, të cilët gjënejnë në lidhje me identitetin e tyre, moshën, punën që bëjnë dhe mbi shijet e tyre. Disa argëtohen duke krijuar personazhe të ndryshëm nga realiteti, të tjerët mes të cilëve dhe abuzuesit seksual dhe pedofilët, përdorin chat për të hyrë në kontakt me fëmijët, për t’i dërguar pamje dhe video pornografike. Këto persona mund të diskutojnë rreth çështjeve, që lidhen me seksin dhe mund të bëjnë edhe kërcënime, apo dhe të thonë gjëra të pakëndëshme dhe të papërshtatshme për moshën e fëmijës. Për këtë arsye, asnjëherë nuk duhen dhënë të dhënat tona personale(emri dhe mbiemri apo numrat e telefonit qofshin ato celular apo telefon fiks), një të panjohuri përmes

¹⁸⁷ “Pedofilia-online”, <http://www.commissariatodips.it>, date 01.02.2013,

chat, edhe pse fillimisht na duket simpatik. Pasi këto të dhëna do t'i mundësonin pedofilëve gjurmimin dhe gjetjen e të miturve.¹⁸⁸

E-mail- Shërbimet e-mail, mundësojnë dërgimin e letrave miqve apo të afërmeve tanë pa përdorur stilolaps dhe letër, por thjesht me një klikim në kompjuterin tonë të lidhur me internet. Persona dhe kompani dërgojnë çdo ditë në të gjithë botën qindra email me ftesa për të blerë diçka apo për të vizituar ndonjë faqe internet(web site). Kur është fjala për spamming ne i referohemi pikërisht këtij bombardimi të emailit, të padëshiruar, që sipas ligjeve të vendeve të zhvilluara, ajo është e paligjshme dhe për këtë arsye e ndaluar me ligj. Zgjedhja e adreses së emailit nuk duhet të përmbajë elemente, që duhet të japin udhëzime në lidhje me cilët jemi ne. P.sh. mund të ishte e përshtatshme zgjedhja e një adresë të postës elektronike të tipit: paperina15@...it, në vend të anarossi@...it, në mënyrë që të mund të mbrojmë identitetin tonë të vërtetë, nga persona që mund ta përdorin në mënyra të ndryshme, ndryshe nga çmendojmë ne. Njëkohësisht duhet patur kujdes, sa i përket mesazheve të marra nga individë të panjohur, asnjëherë nuk duhen hapur pasi mund të përmbajnë virus, spyware, apo pamje të padëshirueshme. Kur i përgjigjem një emaili, duhet patur kujdes nëse përdorim funksionin "përgjigju" (reply), pasi kjo i nis automatikisht adresën tonë edhe të tjerëve, që nuk i njeh. Është mirë të evitojmë dërgimin e fotove apo informacioneve private përmes emailit, pasi nuk mund të jemi të sigurt që miqtë tanë respektojnë privatësinë tonë.¹⁸⁹

Newsgroup, forum, bbs- Newsgroupet, forumet dhe Bbs, të mundësojnë të dërgosh dhe të lexosh mesazhe, të shkarkosh dhe shkëmbesh fotografi mes përdoruesve të rrjetit, në kohë reale dhe pastaj pasi mesazhi të jetë dërguar në forum mund të lexohet nga kushdo. Kjo

¹⁸⁸ "Pedofilia-online", <http://www.commissariatodips.it>, datë1.02.2013.

¹⁸⁹ "Pedofilia-online", <http://www.commissariatodips.it>, datë1.02.2013.

është një mënyrë për të gjetur dhe shkëmbyer informacion mbi dëshirat dhe pasionet dhe të ndajnë video, foto, programe të përdoruesve të tjerë. Të dërgosh mesazhe në newsgroups ose në forume përmban rreziqe, që duhen marrë në konsideratë, veçanërisht në lidhje me privatësinë dhe sigurinë tonë. Shumë shpesh dërgimi i një mesazhi në një forum apo newsgroup, automatikisht bëhet i lexueshëm për të gjithë. Është e mundur, që dikush të përdorë për të na dërguar mesazhe të bezdisshme apo të papërshtatshme. Kështu që duhet të bëjmë kujdes të përdorim adresa emaili, që nuk lejojnë të japin informacione mbi identitetin tonë të vërtetë. Disa newsgroup apo forume i përkasin në mënyrë eksplicite seksit dhe pa dashur mund ta gjejmë veten përballë imazheve dhe videove mbresëlënëse, të padëshiruara apo dhe të paligjshme, nëse i përkasin skenave të të rriturve me të mitur nën 18 vjeç. Nëse rastësisht na ndodh të bëhemi dëshmitarë, të sjelljeve të paligjshme, menjëherë duhet të denoncojmë pranë autoriteteve përkatëse.¹⁹⁰

Instant messaging- Mesazhet e çastit (IM) është një shërbim i ofruar nga shumë shërbime të internetit, që na lejojnë të dërgojmë mesazhe me tekst të shkurtër, në telefonat celular ku ne dëshirojmë apo edhe drejt përdoruesve të tjerë të lidhur në rrjet në atë kohë. Menjëherë pas klikimit të dërgimit të mesazhit tonë, personi të cilit i kemi dërguar mesazhin mund ta lexojë.

Si duke përdorur chat-in, newsgroup dhe mesazheve të çastit (IM), ne vëmë në rrezik privatësinë dhe sigurinë tonë. Para se gjithash nuk duhen dërguar mesazhe, që përmbajnë informacione mbi kush jemi dhe ku gjendemi, nëse nuk jemi të sigurtë100% për qëllimin e mirë të atij që i merr këto informacione.¹⁹¹

¹⁹⁰ "Pedofilia-online", <http://www.commissariatodips.it>, datë 04.02.2013.

¹⁹¹ "Pedofilia-online", <http://www.commissariatodips.it>, date 04.02.2013.

5.10. Teknikat e posaçme hetimore sipas legjislacionit procedural penal shqiptar

“Veprimeve simuluese” dhe “Infiltrimi” forma te reja hetimore përdoren nga policia, përmes veprimtarisë së fshehtë. Që të japin rezultatin e duhur, duhen vënë në dorë të personave të kualifikuar dhe të përdoren me maturi.

Do të ishte e rastit, që ky mjet apo e thënë ndryshe, kjo “armë kundër kriminalitetit”, të përdorej për të luftuar Pedofilinë–online. Vende të ndryshme duke përmendur këtu Italinë, e përdorin veprimtarinë fshehtë, për të hyrë në kontakt me pedofilët, që ndodhen në rrjet. Chat-i është ai sektor, ku manifestohen më së shumti, rreziqet për të miturit. Një mjet i tillë komunikimi mundëson futjen në kontakt mes njerëzve pa dallim, moshe apo kulture, gjë, që në “jetën reale” do të ishte e limituar. (Spanti, 2013)

E gjithë kjo, ndihmon pedofilët në fazën e parë të komunikimit me viktimat potenciale, për të mundësuar më pas një kontakt verbal apo një përmbushje të plotë të aktit kriminal, jashta rrjetit.

Përfshirja apo futja e agjentëve të policisë në dhomat e chatit, do të bënte të mundur identifikimin dhe më pas procedimin e kësaj kategorie kriminelësh. Kontakti i parë me pedofilët do të ndodhte përmes veprimtarisë së fshehtë, në të cilën një agjent i infiltruar do të hiqej si i mitur dhe do të futej në kontakt me të, për të kuptuar më mirë qasjet e tija perverse. (Spanti, 2013) Agjentët në rolin e të miturit, do të kërkonin më pas të mundësonin një takim jashta rrjetit. (Spanti, 2013)

Por, brishtësia nga e cila karakterizohen veprimet simuluese dhe infiltrimi, kërkojnë profesionalizëm, pasi një provokim apo një joshje e tepruar nga ana e agjentëve, kundrejt “Pe-

dofilit” të prezumuar, do të përbënte një shkak për pavlefshmëri të rezultateve të këtij hetimi.¹⁹²

5.10.1. Karakteri ndërkombëtar i krimit kibernetik dhe mekanizmat mbrojtës

Krimi kibernetik është një krim, që ka karakter ndërkombëtar, pasi veprimtaria kryhet në një territor dhe pasojat mund të vijnë në një territor tjetër. Nisur nga kjo, shqetësimi nuk kufizohet në një shtet të vetëm, por merr përmasa globale. Duke qënë i tillë, ky aktivitet kriminal, meriton vëmendjen e duhur sa i përket miratimit dhe marrjes së masave të përshtatshme ligjore dhe implementimit të mjeteve efektive teknologjike dhe shtrënguese, që reduktojnë aktivitetin kriminal kibernetik. Përhapja e shpejtë dhe rritja e përdorimit të internetit ka mundësuar evoluimin e sistemeve kriminale, si dhe ka rritur kompleksitetin e hetimeve për këto çështje. Ky fakt ka shtyrë legjislatorin në parashikimin e dispozitave dhe normave të reja, që kanë të bëjnë me mjete moderne investigative. I referohemi këtu, dispozitave dhe normave, që rregullojnë veprimtarinë e fshehtë dhe infiltrimin, në fusha të ndryshme operative.¹⁹³ Pasi është parë si mjete më të përshtatshme, që mund t’i përgjigjet mesazhirë krimit në fjalë. Zhvillimi i vrullshëm i teknologjisë, ka prekur edhe vendon tonë, duke na bërë kështu përfitues të të mirave pafund, që teknologjia ofron, por dhe njëkohësisht duke na përballur me një sërë problematikash, të panjohura më parë.

- Natyrshëm lind pyejtja, sa të pregatitur jemi ne për t’u përballur me format të reja të shfaqjes së kriminalitetit?

- A janë bërë reforma legjislative dhe intitucionale, nga Shteti Shqiptar, për të mundësuar, garantimin e një lundrimi të sigurtë për fëmijët tanë?

¹⁹² Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, neni 294\A, pika 3.

¹⁹³ Guardia di finanza scuola di Polizia Tributaria”Tecniche Investigative Speciali per il Contrasto Patrimoniale alla Criminalita Organizzata”: 31.

Shqipëria, në kuadër të luftës kundër krimit kibernetik dhe krimit të organizuar, ka ratifikuar një sërë aktesh ndërkombëtare, ku ndër to mund të radhisim:

- Konventa mbi Krimin Kibernetik (ETS 185)¹⁹⁴
- Protokolle Shtesë i Konventës për Krimin Kibernetik në lidhje me Konsiderimin si Vepra Penale të Akteve Raciste dhe të Ksenofobisë, të cilat kryhen nëpërmjet sistemeve kompjuterike (CETS no. 189)
- Konventa Europiane “Për ndihmën e ndërsjellte juridike në fushën penale (ETS 030)”
- Protokolle shtesë i ETS 030 (ETS 099)
- Protokolle i dyte shtese i ETS 030 (ETS 182)
- Konventa Europiane “Për transferimin e procedimeve në çështjet penale” (ETS 073)
- Konventa e Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e Fëmijëve nga Abuzimi dhe Shfrytëzimi Seksual (CETS No.201)”
- Marrëveshja Europiane për Transmetimin e Kërkesave për Aplikimin e Ndhmës Ligjore(CETS No. 092)
- Protokolle Shtesë i Marrëveshjes Europiane për Transmetimin e Kërkesave për Aplikimin e Ndhmës Ligjore (ETS 179)
- Konventa Europiane për Vlefshmërinë e Vendimeve Gjyqësore të Huaja (ETS 070)
- Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Trafikimit të Paligjshëm të Substancave Narkotike dhe Psikotrope
- Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkufitar (UN-TOC)

¹⁹⁴Ligji Nr. 8888, Dt.Aktit:25.04. 2002, Për ratifikimin e “Konventës për krimin në fushën e kibernetikës”, Dt.Miratimit:25.04.2002, Flet.Zyrtare Nr.18, Faqe:553

- Protokoll i UNTOC për Parandalimin, Goditjen dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Personave, veçanërisht Grave dhe Fëmijëve
- Protokoll i UNTOC kundër Kontrabandimit të Emigrantëve nëpërmjet Tokës, Detit dhe Ajrit-nënshkruar më 12.12.2000
- Protokoll i UNTOC kundër Prodhimit të Paligjshëm dhe Trafikimit të Armëve të Zjarrit

Konventat e ratifikuara nga Shqipëria, në bazë të nenit 122 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, bëhen pjesë e legjislacionit tonë të brendshëm dhe kanë epërsi mbi ligjet e vendit, që nuk pajtohen me to.¹⁹⁵Ratifikimi i këtyre konventave, duhet të shoqërohet edhe me ndërhyrjen në legjislacionin tonë penal, duke nxjerrë ligje të veçanta, që do t'i vinin në ndihmë parandalimit të këtij fenomeni. Gjithashtu nevojitet ngritja e strukturave të specializuara shtetërore, që do të kishin si funksion monitorimin dhe hetimin e fenomenit në fjalë. Kjo, duke marrë shembull dhe nga Italia, si një nga vendet e zhvilluara, në të cilën egzistojnë tashmë prej kohësh sektore të veçantë pranë Policisë së Shtetit, të quajtura "Polizia Postale delle Comunicazioni", që ushtron një aktivitet intensive hetimor dhe monitories, përmes një stafi të specializuar.

Çështjet që shtrohen për zgjidhje gjatë këtij kapitulli, nuk gëzojnë një rregullim ligjor nga legjislacioni ynë penal, për këtë mendojmë, se duhen bërë ndërhyrje në ligj, duke sjellë modelet legjislative të shteteve më të zhvilluara.

¹⁹⁵ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 122.

Kapitulli VI: Aktiviteti i fshehtë. Trajtimi juridik nga legjislacione të huaja

6.1. Sistemi kontinental

Nën pikëpamjen ndërkombëtare, instituti i *veprimtarive nën mbulim* ka paraqitur problematika serioze, të njëjta, në sisteme të ndryshme. (Barrocu, 2011:115).

Nevoja për të luftuar në mënyrë sa më të shpejtë dhe efikase kriminalitetin e kohëve moderne, ka bërë të mundur përdorimin e mjeteve të tilla hetimore, siç është *aktiviteti nën koperturë*. Të tilla mjete hetimore janë huazuar nga akte të ndryshme ndërkombëtare të ratifikuara nga një numër i madh shtetesh, duke u përfshirë më pas në legjislacionet e tyre të brendshme. Nevoja për të luftuar krimin e organizuar në vende të ndryshme konceptohet në forma të ndryshme. Bëjmë dallimin këtu mes dy sistemeve procedurale atij *kontinental* dhe atij *common law*.

Nëse do t'i referohemi sistemit *procedural kontinental*, në ndryshim nga sistemi *common law*, i jepet përparësi nevojës së mbrojtjes së shoqërisë, duke u përballuar me parimet e rrepta kushtetuese, të cilat imponojnë respektimin e parimit të ligjshmërisë në funksionimin dhe organizimin e gjyqësorit. Në këto vende është pranuar gjerësisht nevoja e përfshirjes së *hetimeve të fshehta* në veprimtari të tilla kriminale, të cilat konsiderohen si të papenetrueshme nga drejtësia. (Barrocu, 2011: 115).

- Nëse bëhet fjalë për grumbullim të dhënash, faktesh, të cilat do të përdreshin më pas si prova në procese penale për të represionuar krimin e organizuar, në ç'formë më mirë se përmes penetrimit në struktura të tilla kriminale do të siguroheshin (gjithmonë kur mjetet e tjera hetimore janë ezauruar)?

Janë vënë re ndryshime progresive, të bëra në legjislacionet e shteteve kontinentale, të cilat janë nxitur nga nevoja për represion ndaj asaj që mund ta quajmë *emergjencë sociale* që është krimi i organizuar. Ky evolucion normativ përfshin të gjitha vendet europiane dhe në na duket i dobishëm verifikimi i zgjedhjeve legjislative të ndërmarra nga shtete të tjera kontinentale, si nevojë edhe e nevojës gjithmonë në rritje për mjete investigative të përbashkëta dhe të përshtatshme për të represionuar format e rënda të krimit ndërkombëtar. (Melillo, Motta, 2001:131)

6.2. Kuadri rregullues danez

Në *nenin 754 A* të aktit të *Administration Justice Act* të 1986 u ligjërua figura e përgjithshme e *agjentit provokator* (kufizuar në kategori të caktuara të veprave) dhe kjo mundëson operacionin bazuar në tri kushte:

- Duhet të ndodhemi përpara një dyshimi të arsyeshëm që një krim është gati për t'u kryer ose është në fazën përgatitore,
- Duhet të ndodhemi përpara një pamjaftueshmërie të mjeteve të tjera hetimore,
- Duhet të ndodhemi përpara çështjeve të një rëndësie të veçantë në lidhje me krimet për të cilat po hetohet, limitohet në ato vepra për të cilat parashikohet burgim jo më pak se gjashtë vjet, ose krimet e kontrabandës të një rëndësie të veçantë.¹⁹⁶

Në bazë të *nenit pasardhës 754 B*, figura e *agjentit provokator* mund të merret, me përjashtim të rasteve të veçanta të përmendura në *nenin 754 E*, vetëm nga një funksionar i policisë. Aktiviteti i *agjentit provokator* është rreptësisht subjekt i vendimeve të arsyetuara të gjykatës (*neni 754 C*) dhe për fillimin e veprimtarisë është e nevojshme t'i japin

¹⁹⁶Politiets Efterretningstjeneste, Danish Security and Intelligence Service, Undercover agent, <https://www.pet.dk>.

njoftim avokatit mbrojtës (*neni 754 D*), dhe vetëm në raste të veçanta (për dmth sigurinë e shtetit), policia mund të urdhërojë që hetimi mbetet sekret.¹⁹⁷

6.3. Kuadri rregullues francez

Në Francë ligji mbi përforcimin e luftës kundër trafikut të narkotikëve i datës 19 dhjetor 1991, nr. 1264, ndryshoi *Code de la Santé Publique*,¹⁹⁸ si dhe *Code des douanes*,¹⁹⁹ duke përfshirë një klauzolë të përgjithshme që përjashton dënueshmërinë e agjentit të policisë gjyqësore dhe të agjentëve të doganës, të cilët kanë si qëllim mbikqyrjen (joaktive) ndaj prodhimit të drogës dhe substancave narkotike apo të plantacioneve të klasifikuara si narkotike ose që grumbullojnë, mbajnë, transportojnë ose dërgojnë të tilla substanca apo dhe vënë në dispozicion të shkelësve të ligjit në fushën e narkotikëve mjete transportit, magazinimin dhe ruajtjen.

- Në rastin e parë, kërkohet njoftimi paraprak i prokurorit publik apo gjyqtarit hetues, ndërsa në rastin e dytë është e nevojshme autorizimi i tyre me shkrim. Në formulimin e ligjit, merren në konsideratë praktikatat hetimore franceze në fushën e narkotikëve në fushën e të cilave janë elaboruar tre modele të ndryshme të aktivitetit nën mbulim.

- Në analizë të parë janë *livraisons surveillées*,²⁰⁰ që konsistojnë në një aktivitet thjesht pasiv të agjentëve të doganës apo të policisë gjyqësore,²⁰¹ që kufizohen në ndjekjen dhe dokumentimin pa ndërhyrë, transaksionet e paligjshme të grupeve kriminale të vendosur nën hetim. (Barrocu, 2011:116)

¹⁹⁷ Guardia di Finanza Scuola di Polizia Tributaria, "TECNICHE INVESTIGATIVE SPECIALI PER IL CONTRASTO PATRIMONIALE ALLA CRIMINALITÀ ORGANIZZATA", Anno di studi 2007 – 2008, p.45; Politiets Efterretningstjeneste, Danish Security and Intelligence Service, Undercover agent, <https://www.pet.dk>.

¹⁹⁸ Kodi i shëndetit publik.

¹⁹⁹ Kodi doganor.

²⁰⁰ Dërgesat e survejuara.

²⁰¹ Parashikuara në nenet 706-32 i Kodit të Procedurës Penale dhe nenin 67 bis të Kodit Doganor francez.

- Në kategorinë e dytë të përkufizuar si *livraisons contrôlées*,²⁰² përfshihen sjelljet aktive të zyrtarëve publik, të cilët ndërhyjnë në faza të ndryshme të tregtisë (blerje, transport, posedim, shitje) duke ndërmarrë personalisht detyrën e ruajtjes dhe klasifikimit duke bërë kështu “shërbimin e komanduar”, akte të cilat përbëjnë një vepër penale. (Barrocu, 2011:117)²⁰³
- *Modeli i fundit* të cilit i referohemi është infiltrimi²⁰⁴ që parashikon përfshirjen e zyrtarit publik në grupin kriminal në rolin e trafikantit, në fushën e të cilit, natyrisht, agjenti i infiltruar jo vetëm që duhet të zotërojë, të blejë, të transportojë substanca narkotike, por mund të jetë dhe i detyruar të *ndërmarrë iniciativa, të koordinimit ose stimulimit të veprimtarisë kriminale*. (Melillo, Motta, 2001: 132)

Qoftë doktrina, ashtu edhe jurisprudenca kanë hartuar një koncept të ngushtë të agjentit të fshehtë, sipas të cilit kurrë nuk mund të jetë një qytetar i thjeshtë qoftë ai dhe privat. Duhet të jetë *një person i kualifikuar, zyrtar i policisë gjyqësore ose një agjent i një administrate të veçantë*, të cilët përgjigjen për veprimtarinë e tyre dhe prej të cilëve merr udhëzime të sakta sa i përket *modus operandi* (mënyra e operimit). (De Maglie, 1991: 15); (Barrocu, 2011:117)

E njëjta doktrinë, duke iu përshtatur pjesës më të madhe të praktikave gjyqësore ka dhënë një përshkrim, i cili na lejon të përcaktojmë me shumë qartësi fushëveprimin e këtij instituti

“në lidhje me disa lloje të veprave penale, të cilat për arsye të ndryshme është e vështirë të zbulohen, është afirmuar në policinë gjyqësore ngritja e kurtheve. Një rast delikti i ngritur artificialisht është një mënyrë për të arrestuar ata, të cilët supozohet se kryejnë krime në mënyrë

²⁰² Dërgesat e kontrolluara.

²⁰³ Response au Questionnaire Sur Les Techniques Speciales D’Enquete En Relation Avec des Actes De Terrorisme, France, p. 1-3.

²⁰⁴ Neni 706-81 të 706-87 i Kodit i Pcedurës Penale, Francë.

të vazhdueshme, dhe t'ia dorëzojnë ato drejtësisë". (De Maglie, 1991: 15); (Barrocu, 2011:117)

Në vitin 2004, si rezultat i një studimi kompleks i kryer bashkërisht nga autoritetet policore dhe gjyqësore, Franca ka nisur aplikimin e një kuadri të ri rregullator, i cili hyri në fuqi më 1 tetor 2004.

Ai pranon të gjithë gamën e zbatueshmërisë (një ligj i vetem për të gjitha operacionet), duke i dhënë te ashtuquajturit "Gjyqtar hetues", detyra e monitorimit të operacioneve undercover.

*Legjislacioni i ri, gjithashtu përcakton me saktësi rolin dhe atributet e agjentit undercover dhe te handler,*²⁰⁵ *duke përjashtuar ndjekjen penale për agjentin në fjalë dhe për ndihmësit e tij (figurë kjo, e krahasueshme me ndihmësin) për veprat penale të parashikuara nga ligji.*²⁰⁶

*Është e parashikuar nxjerrja e dekretit autorizues, që përmban me saktësi veprimtarinë e pranuar për agjentin e fshehtë, duke lejuar një përdorim të gjërë të identitetit fiktiv dhe mbajtjen e këtij identitet edhe në debatin gjyqësor. Kushtet që kanë favorizuar procesin legjislativ të lartpërmendur, gjenden para së gjithash në bësimin e ndërsjelltë dhe harmoninë ndërmjet autoriteteve gjyqësore dhe policisë gjyqësore. Kjo, në sajë të një njohje të përbashkët të rëndësisë së këtij instrumenti. Paraqet një rëndësi të madhe detyra specifike e *monitorimit të veprimtarisë undercover* si dhe transparenca e sistemit autorizues të lëshuar dhe më në fund vetëdija e egzistencës së nevojave për *bashkëpunim ndërkombëtar dhe për një penetrim deri në qelizat e krimit kombëtar.**

Mes efekteve që përfshirja e kësaj normative në legjislacion ka shkaktuar, janë të rradhitura: ndarja e rëndësisë dhe përgjegjësisë se tërë mjetit mes agjentit dhe policisë gjyqësore rezultojnë në harmoni më të madhe, krijimi i një organizmi vërtetë efektiv, dhe në proces te

²⁰⁵ Asistuesit, ndihmësit.

²⁰⁶ Guardia di Finanza Scuola di Polizia Tributaria, "TECNICHE INVESTIGATIVE SPECIALI PER IL CONTRASTO PATRIMONIALE ALLA CRIMINALITÀ ORGANIZZATA", Anno di studi 2007 – 2008, fq.43.

vazhdueshëm përpunimi, mund të përdoret në çdo operacion të parashikuar me ligj dhe të pajisur me burime, njerëzore dhe teknologjike, i adaptueshëm për çdo nevojë, kërkimi i një evoluimi të tillë të të dyjave, legjislacionit dhe teknikat e përdorura (shkathtësia e mjetit hetimor), një bashkëpunim më efektiv ndërkombëtar, mbrojtja e *undercover* dhe e familjes së tij si dhe riperfshirja në aktivitete të tjera të njëjta të agjenti *undercover*, përdorimi më i madh i infiltrimit me afat të gjatë për arritjen e objektivave strategjike (të kërkuar informacion).²⁰⁷

Provokimi policor mund të përkufizohet si një mjet për të sqaruar një vepër penale, që përmes metodave të zakonshme vështirë se do të përcaktohej, zbatuar si rregull përkundrejt personit të dyshuar si kryes i zakonshëm i veprave penale. (De Maglie, 1991:18), (Barrocu, 2011:117)

Në përfundim të sa parashtruam, arrijmë të bëjmë dallimin mes sistemit francez nga ai italian dhe gjerman. Modelin francez mund ta konsiderojmë një *case law*, për të cilën figura e agjentit provokator merr tiparet e kërkuara nga *faza e hetimeve paraprake* në veçanti të fenomenologjisë kriminale. Nga ana tjetër, karakteristikat e spikatura të kësaj figure, rrjedhin direkt nga një ndryshim rrënjësor nga sistemi gjerman dhe si rrjedhojë dhe nga ai Italian. E ashtëquajtura “*situatë shpirtërore*” e shkencës penale franceze nuk është e prirur të ndërtojë kategori dogmatike të rrepta, por më të favorshme për të marrë formë nga përpunimet doktrinale me një prespektivë më shumë pragmatiste. (De Maglie, 1991: 15); (Barrocu, 2011:117)

²⁰⁷ Guardia di Finanza Scuola di Polizia Tributaria, “TECNICHE INVESTIGATIVE SPECIALI PER IL CONTRASTO PATRIMONIALE ALLA CRIMINALITÀ ORGANIZZATA”, Anno di studi 2007 – 2008, fq. 43.

6.4. Kuadri rregullues Gjerman

Ligji i OrgKG i 15 korrikut 1992 mbi luftën kundër trafikut të paligjshëm të drogës dhe formave të tjera të shfaqjes së krimit të organizuar, ka parashikuar figuren e *hetuesit të mbuluar* ose hetuesit sekret -*Verdeckte Ermittler*- me të drejtën për të vepruar në fushën e krimit të trafikut të drogës dhe të armëve, falsifikimit të parave apo letrave me vlerë, si dhe në krimet kundër shtetit (figura bashkon me rregulla organike figura të ngjashme dhe më specifike tashmë të përshkruara nga legjislacioni emergjent i viteve tetëdhjetë të gjermanise).²⁰⁸ (Barrocu, 2011:118)

Përdorimi i një hetuesi fshehtë lejohet:

- 1) *vetëm mbi lloje të veçanta veprash penale*, të gjitha në lidhje me llojet e shfaqjes së krimit të organizuar;
- 2) *vetëm në mënyrë subsidiare*, në rastet kur hetimi i veprave të tilla, me instrumente të tjera do të ishte i kotë apo seriozisht i vështirë;
- 3) parashikon *autorizimin me shkrim*²⁰⁹ të prokurorit publik (në raste emergjente, aktiviteti mund të fillojë pa autorizim, por duhet menjëherë të ndërpritet brenda tri ditëve, nëse prokuroria nuk do të ndërhyjë).²¹⁰

Aspekti i veçantë i *normativës gjermane* përfaqësohet, përveç karakterit elastik të modelit nga e cila është e predispozuar (si në atë francez) dhe nga diskrecioni i gjërë i kushteve të përdorimit, në vendosjen e një identiteti të ndryshëm për hetuesin nën mbulim apo

²⁰⁸ Guardia di Finanza Scuola di Polizia Tributaria, "TECNICHE INVESTIGATIVE SPECIALI PER IL CONTRASTO PATRIMONIALE ALLA CRIMINALITÀ ORGANIZZATA", Anno di studi 2007 – 2008, fq. 44

²⁰⁹ Pëlqimin paraprak.

²¹⁰ Guardia di Finanza Scuola di Polizia Tributaria, "TECNICHE INVESTIGATIVE SPECIALI PER IL CONTRASTO PATRIMONIALE ALLA CRIMINALITÀ ORGANIZZATA", Anno di studi 2007 – 2008, fq. 44;

sekret.²¹¹ Në të drejtën gjermane, sidomos vitet e fundit, çështja ka pasë një zhvillim të habitshëm në planin procedural. Edhe pse në *Gjermani* si legjislatori, ashtu dhe doktrina në vetvete, nuk kanë lënë asnjëherë pasdore çështjen në fjalë. Të paktën në mënyrë periodike, figura e agentit *undercover*, kjo pikë kthese evolutive procedurale ka ndodhur kryesisht falë praktikave gjyqësore. *Bundesgerichtshof*, është marrë më tepër me frazën *provokim policor*. Megjithëse pjesa më e madhe e vendimeve gjyqësore, është përqëndruar më shumë mbi *dënueshmërinë e kriminelit* dhe jo mbi *përgjegjësinë e agentit provokator*. (De Maglie, 1991:146).

Në mënyrë të veçantë, dyshohet seriozisht në lidhje me pajtueshmërinë me parimet e shtetit të së drejtës, sa i përket punësimit të subjekteve, për qëllime thjesht procedurale dhe hetimore të subjekteve, përmëtepër të zyrtarëve publik, që në vend të parandalimit, provokojnë (shkaktojnë) kryerjen e veprave penale nga palët e treta. Çështja zhvendoset në një plan ngushtësisht procedural;

- *Antikushtetueshmërinë e taktikave policore* edhe pse paraprihet nga autorizimi i prokurorit publik, pasqyrohet mbi procesin duke përjashtuar dënueshmërinë e provokuesit për veprën e shkaktuar. Sipas këtij rindërtimi prania e një *agjenti provokator* në dinamikën e faktit, do të integronte një lloj pengese procedurale, si në lidhje me parimet kushtetuese ashtu dhe në lidhje me dënueshmërinë e agentit, veprimtaria e të cilit nga shteti do të pranohej në mënyrë të heshtur edhe pse veprimet e tij janë kontradiktore - *nxitja e kriminimit me qëllim parandalimin*

- në përputhje me parimet e prejardhura nga Amerika e Veriut të ardhjes *contra factum proprium*.²¹²

²¹¹ Guardia di Finanza Scuola di Polizia Tributaria, "TECNICHE INVESTIGATIVE SPECIALI PER IL CONTRASTO PATRIMONIALE ALLA CRIMINALITÀ ORGANIZZATA", Anno di studi 2007 – 2008, fq. 44.

²¹² Guardia di Finanza Scuola di Polizia Tributaria, "TECNICHE INVESTIGATIVE SPECIALI PER IL CONTRASTO PATRIMONIALE ALLA CRIMINALITÀ ORGANIZZATA", Anno di studi 2007 – 2008, fq. 44, cit. 148.

Evolucioni i jurisprudencës, për të zbutur ngurtësinë e supozimeve të trajtuara nga gjykatat më të ulëta, *ka sjellë një ekspozim të plotë të çështjes drejtuar përjashtimit të plotë nga dënueshmëria e agentit provokues*. Në shumicën e rasteve të paraqitura mund të gjehet një evoluim, të cilat do të merren në vazhdim nga vetë Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, për të cilën parametri i gjykimit ka të bëjë me verifikimin e ndonjë *“padrejtësie procedurale”* të mundshme, tipike e paradigmave të një procesi të rregullt ligjor, për këtë arsye do të vlerësohet rast pas rasti ecuria procedurale. Për këtë arsye, i është ndaluar agjentëve të përdorin mjete për kërkimin e provës, përmes të cilave alternohet *“vendimi i vullnetshëm”* apo *“sjellja e vullnetshme”*. Sanksioni për veprimet e ndaluara është *papërdorshmëria*, kundër vullnetit të vetë të akuzuarit, të njohurive të përfutuara përmes këtyre mjeteve. (Barrocu, 2011:119).

Për të tilla konsiderata, ndryshojnë në varësi të faktit, nëse ishte ushtruar provokim në drejtim të një subjekti tashmë të dyshuar ose përmëtepër për të realizuar një arrest në flagrancë ose për të verifikuar një lajm që ka të bëjë me krimin në fjalë, që bazohet në dyshime të arsyeshme si dhe në rastin kur nxitet një subjekt, i cili deri në atë moment kishte mbetur formalisht i padyshtuar. *Në rastin e fundit do të gjendeshim pra në brendësi të një provokimi të papranueshëm*, rezultatet e të cilit në asnjë mënyrë nuk do të kontribuonin në zhvillimin e një procesi të drejtë. (Barrocu, 2011:120)

Vetëm në referim të kësaj fazë ngushtësisht procedurale, normativa gjermane merret me rregullimin me ligj të hetuesve të përfshirë në aktivitetin *undercover*, duke parashikuar shprehimisht mundësinë për të evituar dëshminë e agentit nën mbulim në procedim në lidhje me faktet e konstatuara prej tij. *Në debatin gjyqësor paraqitja e tij direkte mund të zëvendësohet me një dëshmi të ngjashme, burimi i të cilëve janë edhe në aktet procedurale,*

të cilat korrespondojnë me identitetin fiktiv të agjentit të fshehtë dhe jo me atë real të tij.

(Barrocu, 2011: 120)

6.5. Kuadri rregullues spanjoll

Në kërkim të efikasitetit maksimal në ndjekjen penale të krimet të organizuar, janë bërë shumë ndërhyrje, duke përfshirë metoda të reja në legjislacion, në nivel kombëtar, kjo falë ndikimit ndërkombëtar. Shpesh këto metoda paraqesin një rrezik serioz për policinë, e cila drejton proceset penale dhe pajtueshmëria e tyre me parimet e së drejtës është shpesh herë shumë e diskutueshme. (De la Cuesta, J. L., 2004: 808)

Këto përfshijnë të tilla parime, si: Ndryshim sa i përket barrës së provës, prezumimi i pafajësisë, teknika të reja të hetimit proaktiv, dëshmitarët anonim, etj. Zgjerimi i juridiksionit, në bazë të parimit të ekstraterritorialitetit dhe përmirësimet në bashkëpunimin policor dhe gjyqësor në këtë fushë janë promovuar edhe në këtë mënyrë (Pradel, 1998: 681) ngjashmëri me vendet e tjera, reforma të shumta kanë sjellë në mënyrë progresive ndryshime institucionale në Spanjë dhe duke përfshirë kështu instrumente të reja dhe specifike si për nga natyra ashtu dhe nga fushëveprimi. (De la Cuesta, J. L., 2004:808)

Për të siguruar një mbrojtje më të mirë, për ata që bashkëpunojnë me autoritetet gjyqësore *Organic Act 19/1994*, vendosi një sistem për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe ekspertëve Moreno (Catena, 1999:135) duke njohur ndikimin e qartë të ligjit ndërkombëtar dhe atij krahasues dhe duke kujtuar se ky është një sistem i pranuar nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (Preambula). Mbrojtje të veçantë u siguruan me ligj për ata persona jeta dhe prona e të cilëve apo/dhe e familjarëve të tyre është në rrezik serioz. Vendoset nga gjyqtari hetues dhe mund të konsistojë në mbrojtje policore, fshehja e të dhënave që kanë të bëjnë me identitetin (kjo edhe gjatë procedimit) dhe parandalimi i identifikimit pamor (Neni

2). Këto masa mund të mbahen edhe pas gjyqit dhe nëse konsiderohet e nevojshme mund të lehtësohet dhënia e një identiteti të ri. (Neni 4.1) Disa dispozita, përpiqen të bëjnë mbrojtjen e dëshmitarit në përputhje me parimet për një proces të rregullt dhe të drejtat themelore. Sipas Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Supreme, sistemi spanjoll nuk lejon dëshminë anonime. Kështu, kontradita është gjithmonë e mundur dhe në rast se palët në një proces e kërkojnë këtë, gjyqtari mund të japë emrin e personit të mbrojtur (Neni 4), dëshmia apo raportimi i të cilit në mënyrë që të përbëjnë provë, duhet që të ratifikohen gjatë seancës (parimi i kontradiktoritetit) (Neni 4.5). (Granados Pérez, 2001:99). (De la Cuesta, J. L., 2004:809)

Personat e besuar dhe agjentët nën mbulim mundet gjithashtu të përfitojnë nga sistemi i mbrojtjes së dëshmitarëve dhe të ekspertëve. Megjithëse, agjentët e fshehtë përdoren si një formë e infiltrimit të policisë, kohët e fundit i është dhënë një trajtim i ri ligjor nga *Organic Act 5/1999*, i cili ndryshoi ligjin procedural penal Spanjoll, në lidhje me hetimin e trafikimit ilegal të drogës dhe përfshiu masa të ndryshme ligjore për të luftuar krimin e organizuar. (Gutiérrez-Alviz Conradi, 2001:29)

Jurisprudenca tashmë bën një dallim të qartë (siç është pranuar gjërësisht nga Pradel), (Pradel, J. 1998: 686) në mes provokimit të një krimi dhe provokimit policor dhe infiltrimit, duke marrë parasysh së fundmi si jo të paligjshëm, në qoftë se nuk i drejtohen inicimit të një krimi të ri (kjo do të ishte shkas për përgjegjësi penale kundrejt policit), por për të lehtësuar mbledhjen e provave të një vepre penale tashmë egzistuese. (Pérez Arroyo, 2000:1765), (De la Cuesta, J. L., 2004: 809)

Megjithatë, *neni i ri 282bis*, miratuar në vitin 1999, është kritikuar rëndë nga literatura, (Rodríguez Fernández, R. 1999:91), (Delgado Martín, J. 2000:1-28) rregullon procedurën

për të autorizuar ndërhyrjen e agjentëve të fshehtë në lidhje me krimin e organizuar dhe lejon gjykatësin hetues (ose prokurorin), të pranojë identitetin e rremë të agjentëve, të cilët mund të përvetësojnë dhe të transportojnë objekte dhe instrumenta të veprës pa shkaktuar përgjegjësi penale nga fakti i shtyrjes së konfiskimit të tyre, për aq kohë sa respektohet parimi i proporcionalitetit. Autorët diskutuan nëse në mënyrë që të përbëjnë prova, deklaratat e agjentëve të fshehtë (i cili mund të ndërhyjë nën një identitet të rremë, pa problem gjatë fazës së hetimeve), mund të ratifikohet (miratohet) plotësisht në seanca pa zbuluar identitetin e vërtetë të agjentit (De la Cuesta, J. L., 2004:809), (Giménez García, 1994: 729) ngjashëm me ndërhyrjen e agjentit të infiltruar. Qarkullimi ose shpërndarja e kontrolluar është gjithashtu një masë e rëndësishme, e promovuar nga organizmat ndërkombëtar, e përdorur për t'u marrë me krimin e organizuar (kryesisht trafikun e drogës). *Sipas nenit 73 të Konventës Shengen dhe nenit 3.1 të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi narkotikët (1988), Kodi Spanjoll i Procedurës Penale, u reformua në 1992, duke futur një dispozitë të veçantë që konsiderohej gjerësisht si legjitimimi i parë i provokimit policor. Neni 263bis, paraqiti disa mosfunksionime (De la Cuesta, J. L., 2004:810), (Granados Pérez, 2001: 77) dhe ka qënë objekt i një interpretimi shumë të kufizuar gjyqësor si dhe ka qënë reformuar kohët e fundit nga *Organic Act 5/1999. Qëllimi i reformës së re, ishte të lehtësonte zbatimin e blerjes së kontrolluar, jo vetëm në rastin e trafikut të drogës por edhe të formave të tjera të shfaqjes së krimit të organizuar, duke pasur si qëllim zbulimin dhe identifikimin e anëtarëve të organizatës kriminale. Ajo mund të urdhërohet nga gjyqtari hetues, nga prokurori ose nga shefat e policisë gjyqësore, por është gjithmonë e kontrolluar nga një autoritet gjyqësor.* (De la Cuesta, J. L., 2004:810)*

Nisur nga bazaligjore e sipërcituar, mund të trajtojmë në mënyrë të detajuar pikat kyçe të le gjislacionit Spanjoll me qëllim krahasimin e këtij rregullimi ligjor me atë të vendeve të tjera.

Analiza e *agjentit provokator* sipas sistemit *spanjoll*, është përqëndruar në fakt në aspektet substanciale, shihet si një figurë dogmatike e lidhur me rregullat e *detyrueshmërisë së dënueshmërisë të shtyrjes për të kryer një krim “àmbito de participación en el delito”*²¹³, si në aspektet procedurale me referencë të veçantë në *técnica de investigación encubierta*²¹⁴. Nga njëra anë, është diskutuar në lidhje me çështjen e *përgjegjësisë penale* të agjentit provokator, nga ana tjetër analiza është fokusuar në *limitimet që duhet t'i imponohen hetimit të fshehtë*, të kryer përmes funksionarëve të policisë, që futet në një organizatë kriminale me një identitet fiktiv apo dhe e një të besuari të thjeshtë. (Perèz Arroyo M. R., 2000:1765)

Referenca ligjore është dhënë në *Ley Organica 5/1999* të 13 janarit, kjo normë ka rregulluar për herë të parë implementimin e “*agente encubierto*”²¹⁵ dhe ka ndryshuar nenin 263 *bis de la Ley de Enjuiciamiento Criminal sobre la “entregada vigilata”*²¹⁶. Dekreti Mbretëror i 14 shtator i 1882, duke zgjeruar dhe supozimet e “*circulatiòn*”²¹⁷ dhe të “*entregadas vigiladas*”²¹⁸ Edhe pse nuk kemi asnjë referencë statistikore me çfarë frekuence është përdorur agjenti i fshehtë si teknike hetimore vendimet e organeve gjyqësore, në veçanti te *Sala Segunda, te el Tribunal Costituzional y la Audiencia Nacional*²¹⁹, reflektojnë një prirje për identifikimin e agjentit provokator me atë të agjentit nën mbulim. (Perèz Arroyo M. R., 2000:1766)

Duke marrë shkas nga e dhëna legislative, në fushën penale dhe procedurale spanjolle, figura e agjentit nën mbulim identifikohet në mënyrë të veçantë me figurën e “*funksionarit të policisë*”, i trajnuar për të vepruar nën një identitet të rremë me qëllim luftën kundër

²¹³ Shtirja e pjesëmarrjes në krim.

²¹⁴ Teknikat e hetimit të fshehtë.

²¹⁵ Agjent i fshehtë.

²¹⁶ Ligji mbi “Dorëzimet e Mbikqyrura”.

²¹⁷ Qarkullimit.

²¹⁸ Dërgesat e kontrolluara.

²¹⁹ Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë.

formave me komplekse të shfaqjes së krimit. Kjo nuk është e vetmja figurë e mundshme, në figurën e agentit të fshehtë mund të përfshihet edhe një qytetar privat, mjafton që të bashkëpunojë me *organet e sigurimit të shtetit*, pra bëhet fjalë thjesht për një person të besuar. (Barrocu, 2011:121)

Në Spanjë, pas rregullimit me *Ley Organica 5/1999*²²⁰ është njehsuar dhe nga ana legjislative figura e “*agente provocador*” dhe i “*agente encubierto*”²²¹ Një barazim i tillë është bërë mbi bazën e privilegjeve sa i përket papërgjegjshmërisë penale në lidhje me “*actividad ecubierta*”²²² dhe të nevojës së vazhdueshme, kështu që si në lidhje me limitet e aktivitetit të tij nën mbulim me specifikimet për të cilat, “*no deben provocar el delito y encuadrarse de esta manera dentro del supuesto del art. 373 del Código Penal, se si tratara de un caso de tráfico de drogas*” (Nuk duhet provokuar një krim dhe duke iu përshtatur në këtë mënyrë supozimit të nenit 373, të Kodit Penal, kur bëhet fjalë për çështje të trafikut të drogës). (Montón García M. L., 1999:178)

Ky asimilim është i bazuar në pasojat juridike të dy aktiviteteve, nuk krijon asnjë vështirësi interpretative, respektimi i agentit të infiltruar, siç ndodh gati në të gjitha rastet agjenti provokator përfshihet në kategorinë e “*agentes encubiertos*”, kuptuar si funksionar policie. Problematikat më të mëdha dalin kur agjenti nën mbulim identifikohet me “njeri të besuar”, në mënyrë që të zbulojnë *modus operandi*,²²³ të organizatave kriminale, duke u infiltruar në brendësi të strukturave të tyre. Në bazë të dispozitave të *Ley Organica 5/1999 të 13 janarit*, agjenti provokator, si njeriu i besuar i policisë, duhet të konsiderohet pra, jashtë fushës së mbulimit ligjor. I besuari, i cili shkon përtej një observimi të aktivitetit të jashtëligjshëm të

²²⁰ LEY ORGÁNICA 5/1999, de 13 de enero, demodificación de la Ley de Enjuiciamiento Criminal en materia de perfeccionamiento de la acción investigadora relacionada con el tráfico ilegal de drogas y otras actividades ilícitas graves, Jueves 14 enero 1999.

²²¹ *Agjentit provokator dhe i agentit të fshehtë.*

²²² Aktivitetin e fshehtë.

²²³ Mënyrën e operimit.

të tjerëve, duhet për këtë arsye të ekspozohet përpara mundësisë së përgjegjësisë penale si një *bashkëpunëtorë në krim*. Duke u përfshirë në specifikën e normës, duhet thënë se kjo u konsiderua si përgjigjja *repressive* e të drejtës penale, materiale dhe procedurale, për një lloj kriminaliteti jo të zakonshëm, të identifikuar nga disa sektore të doktrinës si “narkokriminaliteti”, edhe pse duhet mbajtur në konsideratë se një definicion i tillë nuk përfshin të gjitha deliktet për të cilat është i operueshëm aktiviteti nën mbulim. (Muñoz Sarmiento J., 1997), (Barrocu, 2011:121-123)

Burim i një referencë të tillë ishte *Konventa e Vjenës e Kombeve të Bashkuara të 20 dhjetor 1988 mbi Trafikun e paligjshëm të substancave narkotike dhe psikotrope*. Norma përmban një sërë kufizimesh të natyrës objektive dhe subjektive të veprimtarisë *undercover*, respektimi i të cilave ka pasë zhvillime thelbësore, si në aspektin e përgjegjësisë së agjentit *encubierto-provocador*, ashtu dhe në aspektin e përdorshmërisë së dëshmive dhe provave të mbledhura. (Barrocu, 2011: 122)

Së pari, siç u trajtua edhe më lart, agjenti i fshehtë duhet të jetë me patjetër një funksionar i policisë gjyqësore. Në këtë mënyrë saktësohet, cilësia e agjentit *encubierto*, sipas të cilit, ai duhet t'i përkasi një grupi të specializuar të policisë gjyqësore që për të vepruar duhet domosdoshmërisht të jetë i autorizuar nga gjyqtari apo nga prokurori, i cili është i detyruar që të informojë gjykatën nga ana e tij për autorizimin e lëshuar. Kjo pasohet më pas me një masë që ka të bëjë me dhënien e një identiteti dhe i një punësimi fiktiv agjentit në fjalë, diktuar paraprakisht nga Ministria e Brendshme, e gjithë kjo e vlefshme për gjashtë muaj, që mund të shtyhet më pas me periudha kohore me kohëzgjatje të njëjtë. (Barrocu, 2011: 122)

Fushëveprimi i agjentit *encubierto* është i përkufizuar nga një kriter i politikës kriminale në luftën kundër krimit të pazakontë, që *Ley Organica 5/1999 e 13 janarit*, e identifikon si

“*criminalidad organizada*” (krimi i organizuar). Legjislatori spanjoll, ashtu si dhe ai italian, ka vendosur një sërë supozimesh taksative të veprave për të cilat mund të procedohet me veprimtarinë nën mbulim, duke krijuar kështu një tablo të qartë dhe shumë më të gjerë, që variojnë mes formave klasike të shfaqjes së krimet të organizuar, të tilla si trafikimi i armëve, terrorizmi, krimet kundër trashëgimia publike apo historike, fallsifikimi i parave si dhe shkeljet penale të të drejtave të punëtorëve. (Barrocu, 2011: 122)

Përveç kësaj, duhet thënë se, përjashtimi nga përgjegjësia penale shtrihet deri në justifikimin e veprimtarisë së agjentit, i cili aderon përmes një aktiviteti nën mbulim “*como consecuencia necesaria del desarrollo de la investigacion*”²²⁴ Ky aktivitet duhet të jetë domosdoshmërisht në proporcion me qëllimin e hetimit dhe nuk mund të rezultojë të jetë një nxitje (në kuptimin e plotë të fjalës) për të kryer një delikt. (Perèz Arroyo M. R., 2000:1789)

U bënë përpjekje më pas për të thyer një traditë legislative, duke përfshirë një diferencim mes agjentit *provocador*, duke vendosur një limitim të ekzekutimit të mbulimit të tij. Kështu që, si nevoja edhe proporcionaliteti i veprimtarisë *undercover*, në çdo rast janë kritere që në mënyrë rigoroze qëndrojnë përballë limitit material të mosprovokimit të deliktit duke dalë si korrektor të natyrës sekondare. (Barrocu, 2011: 122)

U mbështet fillimisht egzistenca e një parimi të përgjithshëm, në të cilin provokimi nuk do të përballej të paktën, nga aspekti teorik me asnjë limit, kjo duke pasur parasysh cilësitë e veçanta të subjektit, që vepron si provokator. Vullneti legjislativ në këtë rast është projektuar për të kufizuar nga aspekti subjektiv figurën e agjentit *encubierto*, duke pasur parasysh kushtet e veçanta të agjentit të policisë gjyqësore, duke përfshirë një dallim midis “*delito provocado*” dhe “*provocación policial*”.²²⁵ Nga njëra anë, sa i përket deliktit të pro-

²²⁴ Si pasojë e domosdoshmërisë për të zhvilluar hetimet.

²²⁵ “Deliktit të provokuar” dhe “Provokimit policor”.

vokuar, jurisprudenca është orientuar më shumë në pandëshkueshmërinë e të provokuarit (personi nën hetim), sesa të provokatorit (agjenti provokator), për qëndrimin e këtij aktiviteti, të cilat ndikojnë në parimet Kushtetuese të vendosura në bazat e një shteti me të drejta socialo- demokratike. *Nëse agjenti i policisë gjyqësore nuk do të ndikonte ex novo në kryerjen e krimeve, duke u limituar në krijimin e kushteve për një skenar të përshtatshëm në kryerjen e një veprë në rrethana të veçanta, aktiviteti duhet të konsiderohet i ligjshëm*, përse kohe ka si qëllim marrjen e provave rreth faktit. (Perèz Arroyo M. R., 2000:1789), (Barrocu, 2011: 122)

Ky është limiti lëndor që neni 285 bis i *Ley de Enjuiciamiento Criminal*²²⁶, përcakton ligjshmërinë e aktiviteti në mbulim të agjentit provokator dhe për përjashtimin e tij nga përgjegjësia penale. Ndalimi për të shkaktuar një delikt, për agjentin nuk është një limit absolut, por relativ përse kohë nuk të konsiderohet haptazi në kundërshtim me parimet kushtetuese dhe me lirinë e formimit të vullnetit të të provokuarit. Respektimi i kufizimeve të tilla jo vetëm që reflekton në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi përjashtimin nga përgjegjësia e agjentit provokator, por është e rëndësishme për të ruajtur vlefshmërinë e provave që varet nga hetimi i fshehtë, bëhet fjalë në këto raste për *prueba provocada* (prova të provokuara). (Perèz Arroyo M. R., 2000:1789), (Barrocu, 2011: 123-124)

Duke vënë re kriteret e pakufizuara të veprimtarisë të *agentes encubiertos*, qofshin ato provokator apo të infiltruar të thjeshtë, arrijmë në përfundimin që, në vija të përgjithshme, kur provokatori nuk konsiderohet i dënueshëm, provat e marra përmes aktivitetit të tij do të jenë të ligjshme në proces, në rastin e përgjegjësisë penale të *agente encubierto*, provat e marra prej tij do të konsiderohen të paligjshme. Doktrina spanjolle në këtë pikë nuk është unanime

²²⁶ Ligji i Procedurës Penale të Spanjës.

dhe është e rëndësishme të vihet re, se si qëndron në pritje të vendimeve nga praktikat gjyqësore, sa i përket kësaj çështjeje. (Barrocu, 2011:123- 124)

6.6. Kuadri rregullues zviceran

Zvicra është padyshim ndër vendet, që ka një prejardhje nga një legjislacion, i cili mund të konsiderohet në sintezë të vërtetë mes rasteve në praktikë dhe doktrinës. Në shtetin Zviceran është arritur një nivel i lakmueshëm i saktësisë legjislative, jo vetëm sa i përket egzistencës së një ligji të veçantë për çështjen në fjalë, por edhe për karakteristikat e këtij rregullimi ligjor, që e bëjnë atë një model për t'u marrë si shembull. (Barrocu, 2011:123- 124)

Ndërkohë që, përmbajtja e ligjit penal në Zvicër, bie në kompetencë të Konfederatës (pushtetit qendror), procedura penale, akoma qëndron në kompetencë të Kantoneve (shteteve federale). Për këtë arsye, Zvicra ka 26 kode të ndryshme të Procedurës Penale kantonale, përveç kësaj për Kodin Procedural Penal Federal (veprimet nën mbulim janë brenda kompetencave të Konfederatës, të cilat përfshijnë spiunazhin, krimin e organizuar, larjen e parave, korrupsionin etj).²²⁷

Në 12 mars të vitit 2000, populli Zviceran adoptoi një amendament në Kushtetutën Federale, duke transferuar Procedurën Penale nga kompetencë e kantoneve në kompetencë të Konfederatës. Departamenti Federal Zviceran i Drejtësisë, punoi mbi një draft të unifikuar të Kodit të Procedurës Penale. Planifikoi ta paraqiste atë përpara Parlamentit në fund të vitit 2004. Duhet të theksohet se, pavarësisht egzistencës me bollëk të Kodeve të Procedurës, praktikat gjyqësore të Gjykatës Federale, kanë pasur një efekt harmonizues, në respekt me të drejtat themelore të njeriut, të mbrojtura nga Kushtetuta dhe nga Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut. E njëjta gjë, vlen për praktikat gjyqësore të Gjykatës së të Drejtave të

²²⁷ Council of Europe, (2006), "Terrorism: Special Investigation Techniques", Volume 328, Strasbourg Council of Europe Publ. 2006, p. 399.

Njeriut në Strasburg, të cilat janë gjithashtu të aplikueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë nga ligji i Zvicrës.²²⁸

- Cilat janë ndryshimet legjislative, që kanë njohur *undercover operations*, në Zvicër?

Neni 23 i ligjit të 20 mars 1975, ka ndryshuar ligjin e *Betäubungsmittelgesetz* të datës 3 tetor 1951, që parashikon funksionarin e policisë, në rolin e kryesit të një trafiku narkotikësh. Ligji parashikon një *exonerating*²²⁹ për oficerin, i cili për "qëllime hetimore pajtohet personalisht ose nëpërmjet të tjerëve me një ofertë narkotikesh, ose pranon personalisht ose nëpërmjet një personi tjetër substanca narkotike".

Më pas, në vijim të prezantimit të mesazhit të *Këshillit Federal* të datës 1 Korrik 1998, është miratuar ligji federal mbi hetimin e maskuar të 20 qershor 2003.

Ligji në fjalë, *neni 1* sqaron para së gjithash qëllimin e hetimin të maskuar, parashikuar me qëllim për të "depërtuar në ambjentet kriminale përmes anëtarëve të policisë, që nuk njihen si të tillë (agjentët e infiltruar) dhe për të kontribuar në këtë mënyrë në sqarimin e krimeve veçanërisht të rënda". (Barrocu, 2011:123- 124)

Neni 3 përmban dy parime të përgjithshme, të cilat rregullojnë këtë disiplinë. Nga njëra anë parashikohet, "mbrojtja e integritetit dhe identitetit të agjentit të infiltruar" dhe nga ana tjetër qëndron forma e mjeteve të përdorura për këtë qëllim, duhet të lejojnë të vërtetojnë faktet, duke ruajtur në të njëjtën kohë të drejtat e personave në fjalë për një proces të rregullt gjyqësor dhe të drejtën për një mbrojtje efektive. (Barrocu, 2011:124- 125)

²²⁸ Council of Europe, (2006), "Terrorism: Special Investigation Techniques", Volume 328, Strasbourg Council of Europe Publ. 2006, p. 399.

²²⁹ Shfajësim, justifikim.

Për këtë arsye, janë regjistruar një sërë kërkesash për të garantuar ligjshmërinë e *aktivitetit të fshehtë*.

Në *nenin 4*, përfshihet një listë e veprave të rënda penale, për të cilat është e mundur të aktivizohet hetimi i maskuar. Dispozita e *nenit 5*, saktëson cilët janë subjektet protagonist në hetim. Hetimi mund të ndërmerret si nga anëtarët e policisë dhe nga persona të punësuar me status të përkohshëm, me qëllim zhvillimin e detyrave të policisë edhe pse u mungon formimi profesional specifik. Një dispozitë e tillë lejon zgjidhjen e pasigurive, sa i përket përfshirjes së subjekteve private në brendësi të aktivitetit nën mbulim, përmes punësimit të përkohshëm, për një kohë të mjaftueshme për kryerjen e veprimtarisë hetimore. Përmëtepër, parashikohet shprehimisht mundësia për t'i caktuar subjekteve të tilla një identitet fiktiv me garanci, që identiteti i tyre i vërtetë nuk do të zbulohet kjo vlen edhe për kohëzgjatjen e procedimit gjyqësor, në të cilin agjenti i infiltruar do të paraqitet si një person i informuar mbi faktet ose si dëshmitar, me saktësimin që, nëse i njëjti agjent i infiltruar të këtë kryer një krim gjatë kryerjes së aktivitetit të tij, i takon autoriteteve gjyqësore të vendosin nën cilin identitet do të zhvillohet procedimi penal. Ligji federal mbi hetimin e maskuar të *20 qershor 2003*, mban merita të konsiderueshme sa i përket zgjidhjes legislative mes dy dyshimeve më të ngutshme, të cilat kërkonin interpretim, dyshime këto të lindura gjatë përdorimit në praktikë të një instituti të tillë në vendet kontinentale. *Nga njëra anë*, përcakton raportet mes policisë gjyqësore dhe autoriteteve gjyqësore dhe nga ana tjetër një dispozitë e veçantë parashikon, që aktiviteti *undercover*, duhet të zhvillohet në brendësi të një procedimi penal tashmë të filluar ose të ketë lindur një dyshim apo frikë, që mund të jetë duke u kryer një veprë e rëndë penale. (Barrocu, 2011:125- 129)

Sa i përket aspektit të parë, *neni 7* sqaron që përcaktimi i një agjenti të infiltruar, duhet t'i nënshtrohet një *aprovimi gjyqësor*, duke specifikuar, që i njëjti autoritet duhet të vendosë

shprehimisht rreth mundësisë të”*përshatjes ose ndryshimit të dokumentave për të ndryshuar ose mbajtur një identitet fiktiv*”, “*të bëjë premtimin e konfidencialitetit*”, të identiteti të agjentit dhe të caktojë një agjent të infiltruar, i cili nuk është pjesë e forcave policore. Një autorizim i tillë, duhet të jetë i motivuar dhe nuk mund të ketë vlerë për një periudhë kohore më të gjatë se një vit. Përpara përfundimit të këtij afati, komanda e policisë të cilëve i përket personi i infiltruar duhet të raportojë me shkrim mbi aktivitetin e përfunduar dhe kur është e nevojshme të kërkojë një zgjatje të këtij afati. Kjo normë është për t’u vlerësuar në atë pikë kur vëmë re se ajo nuk e anashkalon rregullimin ligjor të aspekteve konkrete, të cilat kanë paraqitur problematika të shumta në fazën operative. (Barrocu, 2011:125- 129)

Neni 9 në fakt, pasi na kujton, që “*agjenti i infiltruar gëzon të drejtën e një mbrojtjeje më të mirë të mundshme, në rastet e ndonjë rreziku të mundshëm për jetën dhe për integritetin e tij*”. Merret me rregullimin e aspektit ekonomik të veprimtarisë nën mbulim. Agjenti infiltruar duhet të kryejë ndërhyrje, duke iu përmbajtur udhëzimeve dhe duhet të raportojë në mënyrë periodike mbi aktivitetin e tij të plotë dhe mbi ato çfarë ai ka hetuar deri në momentin e raportimit. Autoritetet kompetente, nxjerrin rregullore të brendshme sa i përket hetimit të maskuar, në veçanti rregullojnë, kompensimin e shpenzimeve shtesë, të dëmeve të pësuar gjatë veprimtarisë nën mbulim si dhe kompesojnë dhe humbjet e mbështetjeve financiare, që më parë ishin kompensuar nga familjarët e tyre. Ky ligj përfundon duke saktësuar paligjshmërinë e çdo pakti të bërë për të dhënë çmime në lidhje me rezultatet e hetimit. (Barrocu, 2011:124- 129)

Duke pasë si qëllim, krijimin e një ekuilibri mes një raporti të nevojshëm varësie me autoritetet gjyqësore dhe nevojat e sigurisë së agjentit të infiltruar u krijua një figurë e re e “*personit kontaktues*”. Këto, për të gjithë kohëzgjatjen e veprimtarisë, udhëzojnë agjentin dhe mban lidhje me autoritetet, të cilët kanë urdhëruar hetimin e maskuar. Personi i kontaktuar

ka të drejtë të japë udhëzime si një superior dhe gjithashtu”*udhëzon në detaje agjentin e infiltruar mbi ndërhyrjen e tij, mbi atributet e tija dhe mbi përdorimin e identitetit fiktiv*”. Po i njëjti person, merret gjithashtu me drejtimin dhe mbështetjen e agjentit të infiltruar gjatë gjithë kohëzgjatjes së ndërhyrjes.

Neni pasardhës (neni 10), i ligjit federal të 20 qershorit 2003, zgjidh nga ana legislative problemin e limiteve të aktivitetit të agjentit *undercover*, duke i dhënë fund në këtë mënyrë modelit të vjetër të agjentit të infiltruar, veprimtaria e të cilit karakterizohet nga një shtrirje e gjerë e sjelljeve gjatë veprimtarisë së tij, potencialisht kriminale dhe kriminogjenë. Dispozita në fjalë në lidhje me *nenin 4*, shënojnë në fakt limitet brenda të cilëve mund të shtrihet një hetim *undercover*, si në lidhje me qëllimin objektiv, brenda të cilit mund të jetë pregatitur, ashtu dhe në lidhje me sjelljen e vetë të të infitruarit.

Kështu që hetimet e fshehtë mund të urdhërohen vetëm në qoftë se, fakte të caktuara konfirmojnë dyshimin se janë kryer ose me shumë mundësi janë duke u kryer krime të një rëndësie të veçantë - *duke futur kështu një lloj parimi, sa i përket aktivizimit apo përfshirjes së hetimeve të fshehta në çështje të caktuara*. Nëse hetimet e fshehta të mëparshme kanë rezultuar të pafrytshme ose kur hetimet të rezultonin të kota ose disproporcionale. *Nën profilin subjektiv*, ligjvënësi zviceran ka dashur të shënojë kufirin e raportit psikik dhe atij material, që i infiltruari mund të ketë në përgatitjen e faktit anti- juridik. *Agjenti nën koperturë* nuk mund të zgjojë një *instikt latent* për të kryer një krim ose për të kryer një krim më të rëndë se ai i parashikuar, por duhet të kufizohet në konkretizimin e një instikti apo qëllimi për të kryer krim, tashmë të pranishëm. Vlen të theksohet që, “*aktiviteti i agjentit të infiltruar duhet të ndikojë vetëm në mënyrë sekondare mbi vendosmërinë për të kryer një krim konkret*” (neni 10, pika 2). Parashikohen më pas, pasojat me të cilat përballet një aktivitet i mundshëm i agjentit të infiltruar, *i cili tejkalon limitet e vendosura me ligj*. Ligji zviceran

nuk e shtron problemin nën një optikë dënueshmërie të agjentit, i cili ka vepruar në kundërshtim me ligjin, por merret me verifikimin e faktit, nëse aktiviteti i tij devijues lejon akoma dënimin e personit/personave të provokuar për t'u dënuar. (Barrocu, 124-129)

“Nëse agjenti i infiltruar, tejkalon limitet e sjelljeve të lejuara, gjykata duhet të marrë në konsideratë proporcionalitetin e dënimit për personat e ndikuar pavarësisht dënimit” (neni 10 pika 40). Bëhet fjalë, padyshim për një zgjidhje legislative plotësisht në përputhje me të gjitha diktimet e bëra nga GJEDNJ, në drejtim të një gjykimi të drejtë, për të cilat hetimet nën mbulim nuk duhet të përbëjnë të vetmin rast për të kryer një krim për një subjekt, i cili edhe në qoftë se ka një tendencë latente kriminale, në mungesë të provokimit të krijuar nga policia gjyqësore me siguri që nuk do të kishte kryer atë krim specifik, apo krime të tjera të të njëjtës natyre. (Barrocu, 2011:124-129)

*Siç u përmend, ligji federal mbi hetimin e fshehtë i 20 qershor 2003, me një zgjedhje të lumtur legislative, në mënyrë të qartë bën dallimin mes aktivitetit nën koperturë “preventiv” nga veprimtari *undercover*, të cilat kanë si qëllim “*represionimin*” e veprës.*

*Neni 12, përcakton se cili duhet të jetë përdorimi i elementeve, që dolën gjatë hetimit të zhvilluar jashta një procedimi penal. Nëse raporti i agjentit të infiltruar përmban gjetje që lidhen me një krim apo me një delikt, komanda e policisë, raporton rastin pranë autoriteteve gjyqësore kompetente për procedimin penal. Për të shmangur faktin që fillimi i një procedimi gjyqësor të mund të kompromentojë hetimet nën mbulim “*pacia mund të shoqërohet me një kërkesë, lidhur me heqjen dorë përkohësisht nga çdo veprimtari hetimore të njohura si të tilla*” (neni 12)*

- 1) Në qoftë se gjetjet janë të dosdoshme për marrtjen e provave, një raport i punonjësit të policisë përfshihet në aktet procedurale (neni 12, pika 3)

Neni 13, bën të qartë nga ana tjetër, se në cilat raste komandat e policisë mund t'i japin fund një ndërhyrjeje dhe janë të përshkruara në detaje *tre raste* në të cilat nuk është më e dobishme apo e arsyeshme ndërhyrja në fushën e një procedimi penal. Veprimtaria nën mbulim ndërpritet pa vonesë atëherë kur:

- 1- rreziku ose shpenzimet e ndërhyrjes janë në disproporcion me rezultatet e pritura,
- 2- ose në rastet kur agjenti i fshehtë nuk i përmbahet udhëzimeve, referon në mënyrë të vetedijshme informacione të pavërteta tek “personat e kontaktit”,
- 3- ose kur nuk respekton detyrimet në çfarëdo lloj mënyrë tjetër (neni 13, pika 2).

1) *Pika 2 e nenit 13*, përcakton një sërë kërkesash të detyrueshme rreth “*demontimit*”, të gjithë asaj strukturë nën mbulim. Do të jenë “*personat e kontaktit*”, ato të cilët do të japin udhëzimet e nevojshme, për t'i dhënë fund ndërhyrjes, duke evituar në këtë mënyrë ekspozimin kundrejt një rreziku të mundshëm të agjentit të infiltruar apo dhe të personave të tretë të përfshirë në këtë hetim. Përmëtepër, kur identiteti fiktiv të mos jetë më i nevojshëm “komanda e policisë, vendos në vende të sigurta dokumentat të cilat kanë mundësuar ndryshimin e identitetit” dhe “sipas rastit jep asistencë të përshtatshme për agjentët e infiltruar, të cilët tashmë janë privuar nga funksionet e tyre. Kjo vlen edhe për personat e tretë të përfshirë në këtë hetim”. (Barrocu, 2011: 128-129)

Sesioni i dytë i ligjit federal, mbi hetimin e maskuar të datës 20 qershor 2003, titullohet “*Ndërhyrja në kontekstin e procedimeve penale*”, pas një sërë dispozitash që përcaktojnë në mënyrë të detajuar detyrat e zbulimit të policisë gjyqësore dhe zbulimin e autoriteteve gjyqësore kompetente, kjo normë merret me informatat e subjektit të përfshirë në hetimet e fshehta dhe për masat mbrojtëse procedurale për të infiltruarin.

Sipas dispozitës së nenit 22, “*autoritete, të cilët kanë urdhëruar hetimet e fshehta informojnë të pandehurin, jo më vonë se përfundimi i hetimit ose pas vendimit për të mos vazhduar më tej procedimin, që sipas tyre është zhvilluar një hetim i fshehtë*”. Nëse informacionet nuk janë përdorur për qëllime dëshmuese, autoriteti gjyqësor mundet me iniciativën e vet të shtyjë ose të heq dorë nga njoftimi, në rastet kur egziston rreziku i një paragjykimi të rëndë për agjentin e infiltruar ose kur paraqet një rrezik serioz për palët e treta ose akoma nëse është e mbizotëruese domosdoshmëria e mbrojtja së interesit publik, në mënyrë të veçantë për sigurinë e brendshme ose të jashtme ose për luftën ndaj krimit të organizuar. (Barrocu, 2011:128-129)

Së fundi, do të jetë i mundur referimi i komunikimeve kur i pandehuri është i zhdukur ose kur duhet t’i frikësohemi paragjykimeve të rënda sa i përket procedimit, që është në vazhdim.

Në fund *neni 23*, përcakton mënyrat përmes, të cilave do të sigurohen masat e mbrojtjes së identitetit të të infiltruarit edhe pasi ndërhyrja do të këtë përfunduar. Theksohet që, atëherë kur subjekti i nënshtrohet masave të tilla, gjeneralitetet e tija të mos zbulohen edhe gjatë procedurës gjyqësore dhe të mos figurojnë në aktet procedurale. Nëse është e nevojshme gjyqtari kompetent merr informacione rreth identitetit të agjentit të infiltruar dhe sigurohet nëse ky i fundit ka marrë pjesë në procedim, për këtë qëllim vetë ai mund ta marrë në pyetje. Nëse marrja në pyetje është e nevojshme, autoritetet kompetente marrin masat e nevojshme për të mbajtur “*premtimin e fshehtësisë*”, ata mund të bëjnë ndryshimin e pamjes së jashtme dhe deformimin e zërit, dëgjimi mund të bëhet në dhoma të veçanta dhe me dyer të mbyllura ose mund të insistojnë në përjashtimin e të akzuarit nëse përballja do të përbente një kërcënim të konsiderueshëm për të infiltruarin. Nga analiza e neneve më të rëndësishme, të përfshira në legjislacionin Zviceran me reformën e hetimeve nën mbulim, del se si ato

vetë përgjigjen nevojave për garanci dhe për një gjykim të drejtë dhe nevojen për të garantuar sigurinë e atyre që janë të përfshirë. Ndërsa është e nevojshme për të pritur se cili është impakti i të tilla modifikimeve dhe në veçanti, nëse kemi arritur një pikë sintezë mes nevojës së represionit për veprat e rënda që lidhen me krimin e organizuar dhe nevojën për të tuteluar një shoqëri që rrezikohet nga një aktivitet hetimor potencialisht kriminogjen, nuk mund të mos vlerësohet përpjekja e legjislatorit Zviceran. (Barrocu, 2011:128-129)

Përmëtepër, janë në diskutim ndryshime, të cilat edhe pse duke e mbajtur nën një shtrirje të kufizuar ndërhyrjen e agjentit provokator në trafikun e paligjshëm të substancave narkotike gjatë hetimeve penale, si federale ashtu dhe kantonale, lejojnë atribuimin e agjentit, i cili merr rolin e të infiltuarit me një identitet fiktiv, duke e ruajtur edhe gjatë gjykimit përballë gjykatës (siç ndodh aktualisht në Gjermani). Është e parashikuar, që aktiviteti nën koperturë, të autorizohet nga Prokurori i Përgjithshëm i Konfederatës ose gjykatësit hetues federal apo nga autoritetet kantonale, përgjegjëse për procedurë penale. *Kjo, e lejuar vetëm si alternative, në qoftë se hetimi me mjete të tjera hetimore do të ishin të kota ose tepër të vështira ose në rastin e veprave që kanë të bëjnë me krimin e organizuar ose nga ana tjetër janë të një natyrë të rëndë.*²³⁰

6.7. Agjenti i fshehtë në sistemet “common law”.

Në analizën tonë sa i përket rregullimeve legjislative të aktivitetit *undercover* nuk mund të mungonin Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Fokusoheci kryesisht në supozimet e ndryshme në lidhje me ligjshmërinë e përfshirjes së shtetit në kriminalitet, edhe pse për qëllime hetimore. Divergjencat e para dhe thelbësore del duke konsideruar se si sistemi amerikan dhe ai kontinental dallojnë në kontrollin dhe në legjitimitimin e hetimeve *undercover*. Mund të

²³⁰ Guardia di Finanza Scuola di Polizia Tributaria, “TECNICHE INVESTIGATIVE SPECIALI PER IL CONTRASTO PATRIMONIALE ALLA CRIMINALITÀ ORGANIZZATA”, Anno di studi 2007 – 2008, fq. 46.

themi që, të dy këto rregullime legislative njohin aspektet kritike të hetimeve nën mbulim, por ato trajtohen në mënyra tërësish të ndryshme.

Në të dy sistemet, nisemi nga një konsideratë thelbësore, në të cilën provokimet, që vijnë nga bashkëpunëtorët apo subjektet më të afërt të të dyshuarit, i përkasin fiziologjikisht kontekstit penal dhe që nxitja e krijuar dhe e inkurajuar nga Shteti pengon rrjedhjen normale të ngjarjeve. Megjithatë, ndërkohë që përtej oqeanit shqetësohen për ndikimin negativ mbi të dyshuarin, frika e legjislacionit tonë fokusohet mbi faktin, që agjenti i infiltruar mund të korruptohet. (Carron, 1972: 633-635)

Sipas sistemit amerikan, “sanksionet penale në përgjithësi nuk zbatohen ndaj sjelljeve të arsyeshme, të cilave u nënshtrohen agjentët e policies”²³¹ dhe që në mesin e tyre duhet të përfshihet pjesëmarrja në aktivitetin kriminal si “teknikë hetimore e ligjshme dhe e njo-hur”.²³² Çdo juridiksion amerikan, pranon egzistencën e një justifikimi të “autoriteteve publike”, e aplikueshme si për zyrtarët publik ashtu edhe për ato privat, të cilët veprojnë në mënyrë të ligjshme në bazë të një autoriteti shtetëror, që rregullon sjelljen e tyre. Kjo do të thotë se hetimet *undercover* nuk janë objekt kufizimesh të tilla, siç janë të adoptuara në Itali, për të kufizuar në mënyrë taksative mundësinë e përdorimit të detyrueshëm të teknikave të tilla hetimi. “Justifikimi” i parashikuar nga normativa amerikane, ka efekt të përgjithshëm dhe nuk është kufizim i lidhur me tipologjinë e krimit ose me subjektet e legjitimuara. Një amplitudë që nuk zgjerohet gjithësesi deri aty sa ta bëjë absolute. Një agjent mundet pra, “të çënojë parashikimin eksplicit të disa ligjeve penale”, megjithatë deri në një nivel të caktuar simulimi, në pjesëmarrjen e një episodi kriminal arrin në një ngjashmëri të tillë me vete veprën penale, saqë na rezulton e patolerueshme për shoqërinë. Askush nuk dyshon në faktin

²³¹Çështja, *Brogan v. United States*, 522 U.S. 398- (1998).

²³²Çështja, *Sorrels v. United States* (1932), op. cit., 1196.

që një agjent i infiltruar nuk mund punojë si i infiltruar në një bandë të rinjsh, të cilët janë dhunues seksual, dhe të arrijë deri në atë pikë sa të marrë pjesë aktivisht në një dhunim seksual!!! Pra, çështja që shtrihet për trajtim është, se deri në çfarë pikë mund të shtrihet aktiviteti i policisë dhe i prokurorisë në të mbeturin të përfshirë në çështje të cilat në të kundërt do të rezultonin si të paligjshme? (Blakey, 1980:41), (Barrocu, 2011: 133)

Nga kjo rrjedh natyrisht që, dallimet ekzitojnë në drejtim të mbrojtjes mes dy veprave; vetëm në të parat efekti i krimit të kryer nuk do të prodhonte një dëm definitiv, për të drejtën ligjore të mbrojtur nga dispozitat inkriminuese të ligjit penal. (Barrocu, 2011:134)

Për të kuptuar më mirë, zgjerimin e mundshëm të aktivitetit nën mbulim tërësisht në dritën e krahasimit të sistemit tonë mund të bëhet dallimi mes rregullimit ligjor të Amerikës mes aktiviteteve të ndryshme të bëra brenda një aktiviteti nën mbulim tërësisht të “paligjshmeve” kryesore dhe dytësore me qëllime të drejtpërdrejta private. *Vepra kryesore, duhet të kuptohet se fakti që, agjenti ka si qëllim të provojë duke pasë si qëllim parandalimin e një fenomeni të caktuar kriminal, agjenti mund të ketë nevojë të marrë pjesë në përfshirjen në një vepër për të cilën po heton, që korrespondon me veprën kryesore. Krimet ndihmëse janë ato, të cilat agjenti kryen ose lejon të tjerët të kryejnë, duke pasë si qëllim të hetojë mbi krimin kryesor, duke mbajtur të pazbuluar mbulimin e tij. Së fundi, krimet e drejtuara nga qëllime private, janë ato në të cilat agjenti angazhohet për të mos avancuar në hetime ose mbron mbulimin e tij, për më tepër për arsye ekskluzivisht personale.* (ROSS J., 2006: 62); (Barrocu, 2011: 135)

Në SHBA, policët veprojnë gjithmonë sipas rregullave të diktuar nga agjencia e hetimeve, që rregullojnë veprimtarinë e sjelljeve të autorizuara. Duke pasur parasysh që, agjenti nuk mund të kryejë akte të dhunshme, përveç rastit kur bëhet fjalë për mbrojtje të nevojshme, autorizimi mund të ketë objekt kryerjen e veprave të caktuara, duke përfshirë dhe riciklimin

e mallrave të vjedhur “*administrimin*” e kontrolluar të drogës, në mënyrë që të mos hyjë në treg, pagimi i ryshfetit si dhe nënshkrimin e deklarimeve të rremë për të fshehur identitetin e tij. Pjesëmarrja në vepra kriminale të një rëndësie të madhe, kërkon një autorizim paraprak nga drejtuesit e FBI- së, të legjitimuar më pas për të justifikuar veprimtarinë në emër të “*sigurisë publike dhe autoriteteve*”, në rastin kur mund të ngrihen akuza penale.²³³

Rregullat hetimore federale errësojnë dallimin mes *krimeve kryesore* dhe të atyre *dytësore*, si dhe mbi llojin e autorizimit që është i nevojshëm, për pasojë të paktën në mënyrë të përgjithshme agjentët nën mbulim nuk mund të kryejnë veprime, të cilat do të përbënin shkelje të ligjit federal, shtetëror ose lokal. Megjithatë është paraparë që,

(1) Justification: “*no official shall recommend or approve participation by an undercover employee in otherwise illegal activity unless the participation is justified:*

a) to obtain information or evidence necessary for the success of the investigation and not reasonably available without participation in the otherwise illegal activity;

b) to establish or maintain credibility of a cover identity, or

*c) to prevent death or serious bodily injury”.*²³⁴

Sipas normativës së SHBA, hyrja në krim nuk sjell dënim për agjentin, por ajo mund të çojë në pafajësinë e të akuzuarit. Provokimi nuk përbën, pra një formë përgjegjësie penale, por një shkak të justifikimi në favor të individëve, të cilët mund të provojnë se ato kanë qënë nën presionin ose tundimin e agjentëve të fshehtë. Ky nocion i hyrjes në krim, lind nga frika, që operacionet e fshehta, mund t’i shmangen ligjit, duke detyruar dhe influencuar vullnetin e subjekteve, të cilët në të kundërt do të hezitonin të kryenin një krim. Me fjalë të tjera, nëse e shohim nga një pikëpamje formale, një nocion i tillë lidhet me shqetësimin që vetëvendosja e të dyshuarit, në thelb mundet dhe të parashikohet një frikë më shumë instru-

²³³ Attorney General's Guidelines on Fbi Undercover Operations, www.usdoj.gov, 10.07.2013.

²³⁴ Undercover and Sensitive Operations Unit Attorney General's Guidelines on FBI Undercover Operations Revised 11/13/92, “*Participation in Otherwise Illegal Activity by Undercover Employees*”.

mentale dhe pragmatike, domethënë për të adresuar burimet hetimore jo drejt të dyshuarve më të prirur për të kryer krime, por drejt objektivave më të përshtatshëm, pasi në këtë mënyrë do të ishte më pak e rrezikshme ose për arsye se infiltrimi mes njerëzve të tillë do të ishte më i lehtë, sepse ato janë më të ekspozuar, duke mos u mbështetur në mbrojtjen e organizatave kriminale. Në këtë mënyrë, teoria amerikane e hyrjes në krim ka për qëllim të ridrejtojë fokusin e hetimeve nga thjesht i korruptueshëm tek i korruptuari. (Ross J., 2006: 66), (Barrocu, 2011:137)

Shkon përtej, duke theksuar kushtëzimet e ndryshme që kanë zgjedhjet operative të agjentit italian, kjo rreth ndërgjegjësimit të tij në lidhje me tendencën për të kryer krime të të dyshuarit, i dëshmuar nga fakti që në SHBA, një agjent që njeh të kaluarën kriminale të të “dyshuarit” dhe për këtë arsye është i vetëdijshëm për një prirje të tij për të kryer krime, mund të vazhdojë me provokimin me më shumë qetësi kundrejt atij që injoron të dhënat paraprake të të dyshuarit.²³⁵ (Barrocu, 2011:137) Mund të thuhet atëherë, që egziston një shkallë diplomimi në sjelljet e agjentit Amerikan, që zgjerohet ose tërhiqet në varësi të tendencës për të kryer krime të të “dyshuarit”. (Ross J., 2006: 66), (Barrocu, 2011:137)

Më shumë se një normativë që ka tendencë për t'u kujdesur për të parandaluar shkeljen e ligjit të përbashkët, ka një prirje për të rregulluar veprimtarinë e policisë me rregulla të veçanta që lejojnë një trajtim dhe një kuptim të fenomenit më të gjitha tiparet që janë të pandashme me atë vetë, jo më pak për një trajtim të veçantë për ata të cilët kryejnë një aktivitet të rrezikshëm në interes të shtetit. Përmëtepër, aplikimi i sanksioneve penale, luan një rol minimal në rregullimin e hetimeve të fshehta, sistemi amerikan mbështetet kryesisht në rregulla të brendshme disiplinore të policisë, në rregullat e sjelljes profesionale të prokurorëve dhe në mundësinë për të apeluar të të pandehurit, sa i përket justifikimit të hyrjes në

²³⁵ Sorrels v. United States (1932), op. cit., 1196.

krim. E gjithë kjo, vlen si dëshmi për të kuptuar se si metoda e infiltrimit, duhet të konsidërohet si një teknikë e vërtetë hetimore, të rregulluara nga norma specifike të policisë. (Ross J., 2006: 66)

Është e vetkuptueshme se legjislacioni i SHBA-së në lidhje me agjentin e fshehtë, nuk mundet asnjëherë të kryhet nga subjekte të cilët nuk janë pjesë e forcave të policisë, ndryshe nga sistemi italian (do të thoshim dhe ai Shqiptar), ku përfshirja në krim, e kuptuar si formë bashkëveprimi, gjen aplikim si për forcat e policisë ashtu edhe për qytetarët privatë. (Barrocu, 2011:138)

Duke u spostuar më tej në brendësi të fazës gjyqësore, vëmendja duhet të përqëndrohet tek provokuesi dhe tek mundësia e tij për të kërkuar si shkak justifikimi për hyrje në krim nga ana e policisë. Sistemi gjyqësor amerikan ka elaboruar një metodë të njohur si “testi subjektiv”, kjo për të demonstruar nëse i dyshuari ka shfaqur ose jo prirjet e tija për të kryer krime, pavarësisht nga provokimi që i është bërë. *Gjykata Supreme* ka deklaruar se: “*justifikimi i përfshirjes në krim, mund të gjejë aplikim vetëm nëse ka qënë sjellja e të infiltruarve ajo që ka shtyrë të dyshuarin në qëllime kriminale*”²³⁶ Duke adoptuar një test të natyrës subjektive, rezultati do të variojë sipas mentalitetit individual, të secilit të dyshuar, përmëtepër, nuk është krijuar asnjë rregull i përgjithshëm, që të rregullojë ligjshmërinë e sjelljes së agjentëve të policisë. Megjithatë ekziston një jurisprudencë në pakicë, që aplikon një test të natyrës objektive, duke përdorur si parametër për të justifikuar sjelljen në favor të të dyshuarit, mënyrat e nxitjes së agjentëve provokatorë.²³⁷ (Barrocu, 2011: 139)

²³⁶ United States v. Russell, 411 U.S. 423,436 – 1973. 138.

²³⁷ Kontrasti i praktikës gjyqësore, egziston, në të njëjtin kuptim se si Gjykata Supreme ka argumentuar me deklaratat e rastësishme në gjykimet në të cilat është përdorur i ashtëquajtur i “Test objektiv” , si rregulla kushtetuese, që në do i thërrasim si “proces i rregullt”(Due Process Cause), mund të parandalojnë veprën penale, në qofte se sjellja e agjentëve të infiltruar rezulton aq e egër sa të “trondisë ndërgjegjen” dhe të ofendojë parimet themelore të drejtësisë. A mund të bëhet fjalë për sjellje të egër kur rezulton e

Fakti që, i dyshuari ishte i prirur për të kryer krimet, të cilat i atribuoheshin, është një aspekt, që nuk u shpalos në fund të testit. Varianti objektiv i hyrjes në krim, tregon disa ngjashmëri me konceptimin italian, kështu që hyrja në krim është ligjërisht një formë e pjesëmarrjes material ose morale në veprën penale. Ky interpretim alternativ është interpretuar mbi paligjshmërinë e sjelljes së agjentëve të shtetit. Pa marrë në konsideratë, ndjeshmërinë e të dyshuarit, përballë provokimeve dhe presioneve të pësuarra. Sipas këtij argument, sjellja e agjentëve të fshehtë, duhet të luftohet si në rastin kur përfshihen shkelësit e përhershëm ashtu dhe në rastin kur bëhet fjalë për subjekte të cilët hezitojnë të kryejnë krime. (Ross J., 2006: 68)

Duhet thënë se pikat e kontaktit edhe në rastin kur pranojmë testin objektiv të përfundojnë këtu. Në fakt ky rindërtim, nuk vë në dyshim imunitetin e agjentit ose të informatorit, përballë përgjegjësisë penale, por disiplinon një standart të vetë forcave të policisë pas së cilët shteti humbet pushtet për të imponuar dënime kundër provokimit. Në këtë drejtim duke mbetur në fushën e normativës *common law*, është e rëndësishme të kujtojmë, evoluimin e praktikës gjyqësore në *Mbretërinë e Bashkuar*, sa i përket përgjegjësisë së agjentit provokator. (Barrocu, 2011:140)

Në *Mbretërinë e Bashkuar* operacionet *undercover* janë të frymëzuar, në parime, të njëjtat ligjore me ato *kanadeze*.

